




Dom Simon Jubani

Burgjet e mia



Dom Simon Jubani

Burgjet e mia
kujtime



Dom Simon Jubani

Burgjet e mia

*Botim Jubilar me rastin e 10-vjetorit të Kalimit në Amshim të autorit
si edhe të 20-vjetorit të botimit të parë të kësaj vepre.*

Ribotim i miratuem nga Arqipeshkvia Metropolitane Shkodër-Pult

Lektorimi

Lisandri & Aristea Kola

Ballina

Lulecirka corpus, s.l. s.d.

© i këtij botimi *Kolana Kêns* / *Kêns Collection*-Michigan, 2021
www.kens.al

Riprodhimi, kopjimi, skanimi a elementë të tjerë që çojnë në cenimin e pronësisë intelektuale të kësaj vepre janë rreptësisht të ndalueme. Shpërndamja e çdo sasie teksti ndalohet në çfarëdolloj forme të mundshme, pa autorizimin përkatës të bartësit e të drejtave autoriale.



Kolana

ME RRËFYE PËR BURGJET, QË ME KUPTUE BURGJET MBRENDIA NESH

Para se me e lexue librin *Burgjet e mia*

Dom Simon Jubanin, para se me e njohë si autor, e kam njohë si qytetar të Shkodrës, meshtar, meqë banonim pothuajse në të njejtën lagje; e mbaj mend si person që na bërtiste kur shkonim me zanë gardalina Zallit të Kirit (shtegu i shtëpisë së tij të qitës në atë drejtim), e na thoshte “*Pse nuk i lironi këta zogj, po doni me i ndry, sikurse mue Enver Hoxha? Keni me çka me u marrë boll; loni futboll*”. Sigurisht nuk kuptoja gja atëherë, kund 10-12 vjeç, se pse nxehej ky i bekuem kaq shumë. E natyrisht nuk dija me i kuptue as fjalët e tij në lidhje me diktatorin, as turfullimet e tij, tue folë vetmevete, po befas më hynte në zemër se kishte përmendë një pikë të dobët timen të fëmënisë: futbollin. Mandej Dom Simonin, si shumica e brezit tim dhe e edukatës sime familjare e kemi njohë në Kishë, e ma konkretisht kur ia kemi rrëfye mëkatet. Mbj mend se disa që e njihnin pak ma prej afër ose kishin ndigjue për të, kur ishte në rrëfyestore Dom Simoni, largoheshin për me ardhë një ditë tjetër, se ‘hajde e qite me të’. Aty, baja lidhjen mandej me ndonji situatë qytetase me të dhe natyrën e tij, ashpërsinë që tregonte me njerëzit gjatë komunikimit. Ishte pak a shumë natyrë ‘eshke’. Po prapë nuk e njihja aq sa

duhet, për me e kuptue këtë trajtë të reagimit të tij. Të shtëpisë, kur binte biseda për të, më kishin tregue se ishte i pari që kishte hapë Kishën mbas diktaturës. Me hapë Kishën nënkuptohej me çue Meshë, mbasi ajo ishte e ndalueme zyrtarisht qysh prej 1967. Ma tutje, pra prej moshës së katekizmit e këtej, portreti i Dom Simon Jubanit më ka pasë humbë porsi humbë filli i një andrre. Pata mësue, patjetër, për vdekjen e tij në 2011, që nuk e di se ku më ka gjetë, por nuk kam marrë pjesë në ceremoninë e përcjelljes. Me librin e tij kam ra në kontakt kah vjeti 2014. Kur pyesja ndonji nga kolegët, atëherë ish-profesorët e mi, për të dhe veprën e tij, më jepnin ndonji ravijëzim të shpejtë e gjithçka mbyllej aty. Kjo dhe për fajin tim, tham, se nuk e kisha sigurue tekstin apo tekstet e tij, e mbase do të kem pyetë persona që nuk kanë pasë ndonji interes me folë për të ose nuk e kanë njohë mirë edhe pse mendoja se mund ta njihnin, tue qenë ma të mëdhaj në moshë sesa unë.

Veprën e Jubanit, *Burgjet e mia*, e kam gjetë në Shkodër, në një librari, aksidentalisht. Një librari, që as unë nuk e di sesi kishte përfundue aty. E mora, e qysh atëherë natyrisht për këtë vepër kam ndërtue një simpati në mendjen time dhe një vlerësim të pashembullt për mënyrën e artikulimit. Në diskutimet e mia me një librar të vjetër në Shkodër, me të cilin unë të paktën njihem tash afro 17 vjet, e pyes: “Po pse nuk e ke në librari ti këtë libër? (tue ia tregue ndërkohë librin)”; e ai ma kthen me një buzëqeshje “Po ku me e pasë profe këtë, sepse ka kënë i ndaluem prej PD-së!” Kjo gja më futi edhe ma shumë në ethje për me e lexue me kujdes.

Mbas hetimeve fizike të librit—ende nuk kisha nisë me e lexue—më xënte ma shumë vend fjala e mikut tim librar

e më peshonte në krye si pikëpyetje sa përbindi. Nji libër që nuk kishte shtëpi botuese. Nji libër që shkruhej: Shkodër 2001, po nuk ishte shtypë në atë qytet (gja që e thotë edhe vetë Jubani);¹ nji libër me nji para-e-mbasfjalë të Anzës Shkodrane, me nji konsideratë të P. Daniel Gjeçajt për autorin (mbasballina). Me sa duket censura paska qenë paramendue për këtë libër. Përderisa: 1. Nuk ka shtëpi botuese, kohë që sigurisht ka veprue ligjrisht matrikullimi në shtëpi botuese; 2. Nji parathanie me pseudonim; 3. Nji libër që nuk shtypet në Shkodër. Nuk besoj se asnjena nga këto pika mund të jetë rastsisht zgjidhje apo zgjedhje e autorit/ëve. Diçka tjetër medoemos do të kishte.

¹ Khs. kap. “Mesha e parë”: “*këtë libër të ri vendosa me e shtypë në shtëpi botuese të huej*”. Duhet të shtojmë se shtëpia botuese që thotë autori nuk ekziston kund e shënueme në ed. I.

Leximi i parë i *Burgjet e mia* ose si u njoha realisht me Dom Simonin

Nisa me e lexue me shumë kujdes veprën *Burgjet e mia*, meqë gjatë këtyne viteve isha shujtue me letërsi të burgut *deri te s've' ma* thonë malsorët e fisëm. Nga faqja në faqe, po bindesha për çështjen e një pengese politike, tue marrë shkas nga artikulimi i hapun i **arrës gungçe**, siç e quente veten Dom Simoni. Kisha lexue dëshmi konkrete të personave që e kishin vujtë mbi kurriz burgun enverist si Át Zef Pllumi, Arshi Pipa, Át Konrrad Gjollaj, dëshmitë e Uran Kalakullës, Fatos Lubonjës e me radhë. Sigurisht që ka vepra të tjera për sa i përket kësaj tematike, por disa prej tyre, tue ditë dhe kontekstin e autorëve, kam rezervat e mia, për të cilat nuk asht vendi me folë. Por një kumt kaq denoncues dhe një materializim aq racional të asaj që thuhej aty, nuk e kisha ndeshë ma parë. Diskutimi që shtrohet aty, rrëfimi i historive dhe i ngjarjeve nëpër burgje e po ashtu stili kuptohet janë relative. Secila vepër e autorëve që përmenda ka veçantinë e saj. Nëse do të më pyesni se cilat kanë qenë historitë ma drithëruese të këtij korpusi veprash, do të thosha *Çinarët*. Aty, kam lexue e jam rrëqethë si në asnjë vepër tjetër. Sigurisht që kjo nuk ka peshën e as strukturën e veprës kanonike *Rrno vetëm për me tregue*, por mënyra e rrëfimit të historive, me atë formë stilistike—që asht—e të mirit Padër Konrrad, më emocionon pa masë. Tash që po shkruaj këto rreshta, po më ndërhyjnë në arsyetim historia e dhimbshme e Monsinjorit Ernest Çoba, të cilin e kishin futë në një thes e firue baras se pesha e një qeni kur e

çuen me i krye kontrollin mjeksor. Pra ky personazh e ky klerik asht si në veprën e Pllumit e si në veprën e Jubanit. Tek secila asht e tregueme simbas optikës personale të autorëve, dhe sipas njave historike, e kontaktit të personazhit me autorët në fjalë.

Burgjet e mia,² nisë me një autobiografi të autorit. Aty flitet për lindjen, familjen, helmimin e të vëllait, Dom Lazër Jubanit, në 1982, me anë të arsenikut siç do të na e detajojë autori ma shumë në faqet vijuese të veprës, tue dhanë dhe mbiemnin e personit që e kryen krimin. Për shkak të ngjarjeve historike e politike, aty vrehet dhe detyrimi i mbijetesës jashtë petkut të priftit: siç janë puna në Sanatorium, në profesionin e radiologut: “M’u desht ta rifillojshe, për të fitue bukën e gojës, profesionin në radiologjinë e Sanatoriumit të Shkodrës” – shkruen ai. Kjo ishte sa për me mbajtë frymën gjallë, ndërsa me mbajtë fizikun e mendjen shëndosh Jubani dëshmon: “për ta mbajtë trupin në formë, sportin që më pëlqente aq shumë: atletikën e lehtë e jo ma pak edhe futbollin”. Këtu natyrisht baja lidhjen me dialogun tonë të kahvitshëm, për të cilin fola në krye...

Por prej këtij vetëjetëshkrimi shohim se ka disa suksese jashtë fushës së interesit kryesor, siç ishte pranimi në ekipin e Vllaznisë dhe në atë Kombtar. Po shpejt këto punë braktisen nga Jubani për t’u kthye në devocionin e tij. Dhe qysh këtu shohim se nuk kemi të bajmë me një meshtar

² Homonimisht dhe si epitomë narrative, ky titull libri, asht i ngjashëm me atë të Silvio Pellico-s *Le miei prigionie*, paraqitë edhe në shqip (*Burgjet e mija*) prej Emz. Vinçencit Prennushi O.F.M., në 1939 [Shkodër: Shtyp. Françeskane].

konformist, që zbaton çka parashikojnë rregullat strikte të fesë, por arra gungçe thotë se gjatë jetës së tij: *“iu kushtova apostullimit të hapun, sepse nuk më ka pëlqye kurrë me luejtë rolet e mbaskuintave”*, e ma poshtë: *“Më ka pëlqye gjithmonë apostullimi i rrezikshëm”*. Ai natyrisht që nuk ka pranue mos me u ba protagonist i ngjarjeve të mëdhaja historike në vend, tue e ditë dhe rrezikun që e pret. Në këtë mënyrë do të shohim se në sajë të predikimit të Krishtit dhe të guximit qytetar, ai u ka ba ballë burgjeve famëkëqija dhe ka lidhë pênin e këputun enverian, tue çue Meshën e parë ditën e të Shumëve. Si kudo në libër nuk mungon (auto)ironia as në këtë pjesë. Kur flet për lirimin e tij, mbas 26 vjetësh burg, ai shprehet: *“u lirova më 13 Prill 1989 bashkë me klerikë të tjerë, si në sajë të Perestrojkës, tue i mbetë borxh 14 vjet burgim Komitetit Qendror. Me çka thonë faktet, nuk jam aspak i sigurtë nëse ky borxh tashma më asht falë e s’ka me m’u dashtë me e pague deri më një...”*. Apo ma tej me arsyetim praktik thotë: *“Nëse ndonjë piktori do t’i tekej me e pikturue simbolikisht jetën teme, do t’i duhej me ble një kalë bojë të zezë”*. Pjesa ma prekëse e kësaj autobiografie asht pohimi që ka për dhimbjen e së amës Çile, për vdekjen e saj dhe për rrëfimet e njerëzve sesi ajo blunte me vete për të birin e saj. Jubani do të shprehej:

Ma vonë më treguen se rrinte gjatë në dritore, zhytë në heshtim, tue shikjue malet që e ndajshin prej djalit të vet të vogël, të hekuruem veç pse besonte në Zotin e shpallte me za të naltë të drejtat e liritë e njeriut, nëpërkambë prej sundimtarëve të djeshëm, bash njatyne që po na sundojnë edhe sot pa u shqetësue fare me i mbyllë plagët e vjetra, madje tue u mundue me hapë sa ma shumë plagë të reja.

Mbas nanës, pesha tjetër ekuilibruese e dhimbjes, dhimbë narrative e vetëpërjetuese asht epilogu i kësaj autobiografie, për të cilin do flasim ma tej. Por ndërkaq le të ndalemi në pika të ndërmjetme që i bashkojnë këto dy skaje. Autori flet për politikat amerikane,³ tue dhanë kështu një observim personal, sa u takojnë ngjarjeve në sfondin politik botënor. Dihet tashma publikisht qëndrimi i tij i ashpër me fuqitë politike dhe me institucionet. Ndokush që e mban mend një emision të Alban Dudushit, ku ka qenë i ftuem dhe Dom Simoni, e ka të qartë reagimin e tij për shtetin e Amerikës. Këto janë qëndrime, kuptohet, individuale, të cilat kanë gjetë pajtim me autorin edhe në sajë të leximeve, të cilat i shprehë në faqet e autobiografisë së tij.

Tue ditë ndërkaq disa pozicionime të figurave të ndryshme në lidhje me aderimet politike, Jubani në këtë vepër gjen rast me folë për veten, që me sqarue ma saktë lexuesin, se mos ndoshta ka ndonji primje politike. Kështu, ai shprehet shkurt se *“Baj pjesë në partinë e të vorfënve, të masakruemve, të viktimave të së djeshmes e të së sotmes”*. E meqë ai ban pjesë në këtë parti, Zoti i ka dhanë shëndet të plotë aq sa thotë: *“ndonëse pa dhambë, ‘ha për ditë nga një komunist’ po t’i kisha dhambët në rregull, ‘kishe me hangër’ dhetë në ditë”* po prapë me ironi.

Që kjo asht një vepër që flet qartas për (neo)komunizmin ai e dëshmon në këtë katranzë të jetës së

³ Khs. ndër të tjera pohimin: *“të gjitha shtetet e botës janë kapërthye prej marimangës amerikane, që qëndron në mjedis të rretit, gadi me i këcye syfri atij shtet që nuk i bindet”* (kap. “Arrestime psikologjike”).

vet, tue folë për një fenomen aspak të hijshëm, me sa dëshmon autori. Bahet fjalë për çështjen e politizimit apo e përkrahjes politike, pikërisht në nandorin e 1990. Vreni se çka thotë ai:

Për me ruejtë pamvarësinë e mendimit, nuk kam pranue grada. E këtë e provoj me dialogun e Nandorit 1990, zhvillue ndërmjet meshtarit kryenejçë me Sali Berishën, që ma kishte dërgue Komiteti Qendror i Tiranës së Kuqe, për të më bindë që t'i thoshte popullit prej elterit të Kishës të votonte për partinë demokratike. Shumkush u rrejt, por jo Dom Simoni, që la dhambë e dhëmballë ndër biruca, tue fitue, në shkëmbim një nuhatje aq të hollë, sa me e ndie menjëherë erën e gjakut, që lëshojnë komunistat, edhe atëherë kur ndërrojnë emën e lëkurë, kur flasin për paqë e progres.

Mbështetë në këto fjalë, e në të tjera dëshmi autoriale, ky libër nuk kishte si me qarkullue në Shkodrën e verbueme politikisht. Në Shkodrën e bjerrun vlerash dhe që sot e kësaj dite asht në agoninë e saj. Në atë qytet ku komunizmi dhe mbaskomunizmi e banë me ra pingul. Në atë Shkodër të veshun n'zi, e që ka ndër dej gjakun e martirëve të fesë apo të ramëve të tjerë (le t'na kujtohet përkufizimi i autorit vetë: *“E Shkodra e vërtetë tashma asht një nga lagjet kryesore të Jeruzalemit qiellor”*). Në atë Shkodër pa kujtesë e që pranoi kuqaloshat me i qeverisë për sa decenie. Kjo nuk asht Shkodra që i përulet Dom Simoni në epilogun e jetës, i cili asht prologu i veprës në fakt. Shkodra e Jubanit asht një qytet që jeton vetëm idealisht në mendjen e tij, kur ai shkruen në mënyrë postulative: *“Mbes deri në dekë bir i padejë i Shkodrës historike, martire, demokrate, të panështrueme*.

Prej saj pranoj me përvujtni çdo gjykim!” Shkodra, po mos të prirej prej ngjyrave partiake, nuk kishte si mos e ia lanë pa qarkullue veprën domit. Po jo! Shkodra asht me zile në vesh. Erdhi lajmi. Hiqe. Kështu duhet. Se janë emna aty, dhe për emna të pushtetarëve që janë në pushtet, apo ishin figura emblematike, partia nuk ka nevojë. Dhe krijo distanca, si gjithmonë, me njerëz që thonë të vërtetën sepse e vërteta nuk ka çka duhet. Atë asht mirë me e manipulue, me e retushue siç bante dikur partia, e në gjurmët e së cilës po ecë sot.

Mbaje, pra, këtë kori në gjinin tand o Shkodër! Ti, o qytet që ke pranue stramastikun me të udhëheqë. Ata që dje ishin me tesera të kuqe e sot janë me blu a turli ngjyrash. Ti që nuk e din se cilët janë bijtë tu të vërtetë. Se cilët e kanë pranue kryqin për ty. Ti që nuk e pranon përvujtninë po vetëm KRENINË. Sjellja jote veç e ka nderue figurën e Dom S. Jubanit. Për me e hiper(kon)tekstualizue postulatit e autorit po shtoj: *“Shkodra, mbetë deri në dekë e padejë për Dom Simon Jubanin, figurë historike e kanonike, demokrat, i panështruem. Prej tij prano me përvujtni çdo kontribut!”* Po kaq i përulun ishte para teje, ky njeri, saqë nuk ta ktheu mbrapsht as letrën e bakallit “Qytetar Nderi i Shkodrës”, lëshue më 01. 11. 2010, nga Këshilli i Bashkisë, shumë pak kohë para se me ndërrue jetë. Asht krejt paradoksale, këtëj ta ndalon veprën e këtëj të jep letra mirënjohje; krejt si në diktaturë.

*

*

*

Jeta e Dom Simonit fillon me thirrjen drejt rrugës meshtarake. Nji rrugë plot me travaje e mundime derisa finalizohet me ndihmën e Zotit. Në kapitullin “*Thirrja për rrugën meshtarake*”, flitet për shêjat e para të instalimit të komunizmit, për kundërshtimet e para publike të pushtetit enverist me anë të trakteve nga Mark Çuni e të tjerë, e për masakrat e Shkodrës. Për vrasjet masive rrazë vorreve të Rrmajit e në Zall të Kirit. Zakonisht nëpër librat e kësaj natyre (ku përbahen nga kujtimet), autorët flasin për ngjarje të cilat i detajojnë me të dhana të sakta, me emën, mbiemën etj. Ose parapëlqejnë mos me i përmendë fare nëse nuk kanë siguri për identitetin e tyre. Por me Jubanin ndodhë ndryshe. Ai kërkon që me i dëshmue krimet e komunizmit, veç tjerash, pa pasë si kriter protagonistët dhe identitetin e tyre. Në dëshminë e tij ka vlerë memoria kombtare. E tillë asht dhe skena e zojës së re. Jubani kujton:

Më kujtohet një zonjë e re që e kishin flakë në qeli menjëherë mbas lindjes, vetëm sepse i shoqi nuk ndigjonte me dorëzue arin. Foshnjën ia bijshin tri herë në ditë policët për me i dhanë gji, sepse – thojshin – komunistat janë të drejtë, nuk e fusin në birucë edhe foshnjën e pafajshme bashkë me nanën fajtores!

Makabriteti i diktaturës nuk njihnte asnji parim njerëzor. Terrori ka qenë justifikimi i çdo vandalizmi. Aq ma tepër që ky ishte në kohë dhe në vende jo gjithmonë njisoj. Këtë e tregon zharitja e Veriut dhe e kryeqendrës së

saj, Shkodrës. E ndjekin ma pas pabesitë e Hoxhës me rastin e 3000 shqiptarëve të Kosovës që janë dorëzue në dorën e Titos. Detaj që e merr për me krijue një argument sa i takon çështjes së gegënishtes, ma vonë, për të cilën intelektualët e Kosovës e simpatizuen Hoxhën dhe vendimet e tij të standardit (1972). Qëndrimi i tyre, dhe i politikave staliniste gjuhësore—po shtojmë me këtë rast—vetvetiu nënkuptonte një neutralizim të traditës disashekullore gegë dhe aktivizimin e një gjuhe e cila sikurse e kanë thanë në atë kohë dhe disa gjuhëtarë, ishte një aktivizim *a priori* që nuk kishte studiue vullnetin e folësit, por kishte ndërtue një bazë artificiale-politike, e cila do të shërbente si parim krejt diktatorial. Tentativë që mbas disa sprovave konkrete, e arritën në fillim të '70 dhe na kanë trashëgue deri tash një *mumie*.

Sigurisht, koha kur asht shkruar *Burgjet e mia* ka pasë tjetër sfond, rrjedhë qëndrimesh dhe rezultatesh sa i takon kësaj pike. Në ditët që flasim, kam bindjen se ky argument “përkrahja e gegënishtes nga Kosova mbas ndërrimit të sistemeve” asht i vërtetë pjesërisht. Janë 20 vjet në mes dhe raportet nuk janë të njëjta. Sot për sot, Kosova asht një ndër damarët realë të jetësimit të gegënishtes. Mjafton me kujtue vetëm tekstet e kangëve, përpos letërsisë mirëfilli, të cilët shumë kangëtarë jogegë po i marrin si modele, edhe pse dalin imitues të dobët. Patjetër, ky problem i parashtruem nga Dom Simoni nuk e ka thellësinë shkencore në këtë problematikë, po ka një opinion konstatues të shëndoshë. Dhe ma e randësishmja asht se po flet prej pozitave të zotit të shtëpisë. Pra si autor i një tradite historike, ku denjësisht ban pjesë kleri katolik.

Kapitulli pasues, “Një park zoologjik, që quhet *Shqipni*”, ndërtohet mbi bazën e një barsolote por që shprehë në mënyrë alegorike realitetin shqiptar gjatë e mbas enverizmit. Ky tregim që ban Jubani ka në thelb dhe punën e gjuhës, e cila del si dallim lokal por në finale asht i njejtë mentalitet i përdoruesve. Pra shqiptari në substancë asht i njejtë (qoftë ai diakronik e ky sinkronik): produkt i sistemeve politike dhe i genit natyral të tij. Prej këtu lindë dhe një tjetër problematikë: ajo e përballjes së traditave, në këtë rast *fe* vs. *shkencë*; ma saktë problemi i teorisë së Ch. Darwin-it, një ndër diskutimet ma të mëdhaja të shoqnisë njerëzore. Krahas këtyne, dhe problemi *autor* [entitet e përfaqësues i një komuniteti fetar] vs. *komunizëm* [enverizëm + ateizëm]. Diku ma herët Jubani e thotë, pak a shumë në mënyrë perifrazuese se “komunizmi i kishte mësue shqiptarëve se njeriu asht majmun pa qime”.

Asht e pamundun që me e reduktue këtë rrëfim komik të autorit, e me përfutue efektin e duhun, nëse nuk jepet e plotë sekuenca tekstore. Prandej për arsye receptimi, jemi të detyruem ta paraqesim sikurse e shprehë shkrimtari:⁴

⁴ Mbrenda strukturës narrative (shoqnie me alegorinë njëherësh) të barcoletës mund të cekim dhe rastin tjetër: “Na ishin një gjel, një qen e një gomar, që jetojshin si s’ka ma mirë në një vend perëndimor. I mori malli për me shtegtue në Shqipninë, që komunistat na e paraqitshin si parrizin e tokës. Erdh te na gjeli shi në vaktin ma të keq për gjelat, kur po ia pritshin tanëve krenat, mos me i çue në kooperativë. S’ndjeu kangë gjeli as s’pa kambë pule, e t’u nis fluturim me kthye kah kishte ardhë. Erdh qeni, posa e pa se te na ishte e ndalueme deri me lehë, ai mbathi me të katërta. Erdh së mbrami gomari. Prit e prit shokët e tij se po kthehet, e s’e panë ma. Tek e mbramja morën një letër, në të cilën shkruhej: “Mos më

Në parkun zoologjik ma të madh të një kryeqyteti european u paraqit një shqiptar i papunë. Pyeti nëse mund të gjindej një vend i vogël për të. I thanë se aty punë kishte boll. Varej prej tij me pranue ose jo. Shqiptari s'u besoi veshëve. Kishte punë boll, po çfarë pune se? Ishte gati me pastrue kafazet e shtazëve të egra, me u dhanë me hangër, me i mjekue. Me i dashtë, madje. Por jo! S'ishte fjala për punë kësisoj, të xanuna kaherë e mot prej të tjerëve. Ishte fjala me u veshë me lëkurë majmuni, me hy në një kafaz e me luejtë rolin e gorrilës, që parkut zoologjik i mungonte. E meqë kushtonte shumë ma tepër me e ble e me e ushqye, kishin mendue me e zëvendësue kësisoj. Por deri atëherë askush s'e kishte pranue propozimin. Ndonëse komunizmi asht mundue boll qyqari, me na e shti mirë në krye se jemi stërnipat e majmunave.

Shqiptari e ndjeu vedin të lumtun: nuk e kishte aspak të zorshme me e luejtë këtë rol. A s'e kishte luejtë tanë jetën në skenën e atdheut të vet, shndërrue kahmot në park zoologjik? Pranoi pra, menjëherë, e si e mbyllën në kafaz, t'ia nisi me zellë e qejf me luejtë rolin e ri, sa ia kaloi edhe vetë gorrilës. Kështu kafazi i tij ishte përditë i rrethuem prej turmave të fëmijëve, madje edhe të rritunve. E kësisoj po mendojshin edhe me e dekorue si gorrilë shembullore. Një ditë, ndërsa hidhej e përdridhej, ngërdheshej e shpërvilej, i rrëshitën të dyja kambët, e lëshuen duerët e shkoi e ra rrokoll e fillë e në kafaz të luanit. T'ia dha brimës sa ku i hangri zani. E tue harrue tana gjuhët e shtazëve e të njerëzve, përveç gjuhës amtare, bërtiti shqip: “Ndihmëëëë! Ndihmëëë!” E

pritni. Nuk kthehem ma. Një vend që asht i vetmi vend në botë ku më thërrasin 'shok!'"

ndërsa zgurdullonte sytë prej hataje, tek i afrohej luani, ndjeu një za që delte prej gojës së tmerrshme të bishës e i thotë në gjuhën zyrtare shqipe: “Pusho, ore budalla! A po do që të na pushojnë të gjithëve menjëherë nga puna e ta humbasim edhe këtë parajsë!” Ishte një shqiptar tjetër, që i kallëxoi menjëherë se të gjitha kafshët e parkut ishin shqiptarë e e kishin quejtë atë vend, ku e fitojshin bukën e gojës pa kurrfarë mundi, “Parajsa komuniste”.

Ajo çka kam mujtë me vû re gjatë leximit të kësaj vepre, asht një objektivizëm i autorit i cili krijohet si prerogativë narrative. Këtë e shfaqë me të njejtin kriter si në sakramentin e pendesës (rrëfimit), para lexuesit, ku nuk kërkon me fshehtë asgjë nga mëkatet e tij njerëzore, qofshin ato sekondare apo edhe primare. Pra lexuesi asht rrëfyesorja ku ai ban kallëzimet e jetës, e cila ka pos travajeve e qëndrimeve edhe mëkatet. Mëkatet në këtë rast janë mëkate syni, të cilat ka mujtë me i ndeshë atëbotë kur ishte në kursin e radiologjisë në Tiranë. Të qortueshme e të konsiderueme mortare në edukimin katolik. I detyruem me e lanë formimin jezuit—i cili prirej kah bota e thellimit të doktrinës dhe e marrjes së Krishtit në zemër për me e predikue mandej, gjithashtu për rrethana jetësore dhe me ndalimin e procedimeve fetare, institucionale (me ardhjen e kuqaloshëve) etc.—shkon në një kurs radiologjie, atëherë kur ishte vetëm 20 vjeç. Aty natyrisht përballet me “shtysat e djallit”, kur asht i detyruem me pá vajza me flokë të lëshueme e lakuriq. Nji botë krejt e kundërt me formimin e tij të rreptë. Ishte pak a shumë një jetë shekullare, për të cilën nuk ishte nisë as nuk ishte pré Dom Simoni. Aty përballet me mësimin e këcimve të ndryshme: tango,

rumba, valcer e me radhë. Këto tundime për formatin e tij, Jubani i pranon dhe i dëfton në kapitullin “Në Tiranë në 1947”. Për me i ndëjtë larg shtysave të shejtanit, që e nxitnin kah bota e instinktit, shpëtimi i vetëm ishte lutja. Atë e kryente në Kishëzën e Spitalit, meqë murgeshat kishin marrë leje për ushtrimin e një gjaje të tillë. Aty ai merrte kungimin “*kundërpeshën e patrandshme të pasioneve të shfrenueme*”. Shekullarizimin e tij (sikurse u pà në krye si atlet, futbollist) do ta shohim edhe ma tutje. Ma së forti kemi të bajmë me një prift, i cili asht sanguin dhe nuk e merr parasysh stolën e veladonin që do të kishte (edhe pse ishte me tesha burgu). Detajet dhe skenat në vijim kanë me e konfirmue për sa thashë.

Monsinjon E. Çoba, për të cilin autori ka një venerim, që kuptohet e shprehë në kapitullin përkatës, “*Martiri Imzot Ernest Çoba*”, ka optikën personale të portretizimit. Ai për të asht simboli i optimizmit atëherë kur mjerimi e kishte mbulue Shqipninë nga Enver Hoxha, të cilit Jubani “*po të mos ishte meshtar katolik*” do t’ia kishte shkruar emnin me të vogël. Emën e mbiemën që në fakt asht i detyruem me ia shkruar 43 herë gjatë veprës. Pastaj vetëm mbiemni *Hoxha*, dhe mbiemnat *enverian*, *enverist* kanë statistikë tjetër. Gjithsesi kryefjala kyçe asht emni i diktatorit, instaluesi i kobit shqiptar.

Njohja me figurën e Çobës, siç e përmenda ma nalt, ngjanë se asht relative. P. sh. për mue, qysh i vogël, me sa më tregonte baba që i kishte shërbye si ndihmës në moshë të njomë Mons. E. Çobës, ai asht krejt periferik: doemos një person(azh) i dëftuem simbas një iks perceptimi fëmënor. Për Jubanin që e ka pasë epror dhe e ka njohë nga afër asht një

tjetër kandveshtrim. Nji figurë madhshtore, staturë e fisme e katolicizmit dhe person që kishte mujtë me i ba rezistencë komunizmit tue tubue ma se 5000 vetë në katedrale (muejin e Zojës, 1958), në kohë të vështira për ekzistencën e kishës. Për At Zef Pllumin ka nji optikë të kundërt. Kjo gja besoj ka të bajë vetëm me anë të njohjeve personale në kontekste të caktueme. Po peshoj se roli i Monsinjorit në atë kohë, ka qenë kontinuitet i vektorit të rezistencës së klerit katolik dhe i kohës së lejimit të ushtrimit të fesë.

Në shkrimet e Jubanit ka nji pohim, si të thuesh telegrafik, për eksponentë të komunizmit shqiptar, siç ishte Tuk Jakova, – themelues i komunizmit në Shqipni (pjesëtar i rrethit/grupit të Zef Malës etc.), i vetmi gegë katolik i Byrosë Politike të PKSH ndërkaq, – tek pohon se kur T.K u identifikue dhe u solidarizue me katolikët, **atëherë ai** (diktatori pra) **e mbyti**. Kjo fjali e mbrame, shënue me të zeza, do të merrej në shumicën e rasteve si nji konstatim përgjithësues, i pambështetun dhe që asht praktikë shkrimore në diskurse të tilla memuaristike. Por nëse do të lexojmë pohimet e së bijës së T. Jakovës, do të shohim se Jubani dinte diçka në atë fjali aq të rezervueme, e lakonike. Për gazetën “Panorama” Bujana Jakova, më dt. 26 shkurt 2018, do të shprehej se të atin e helmuen. Ish-Gjeneral Koloneli i E. Hoxhës u helmue nga “mysafirët” në drejtorinë e burgut, tue ia hedhë helmin në konjak. Detaje të tilla të eliminimeve të kundërshtarëve politikë të regjimit enverist, sigurisht kemi në shumë materiale (libra, dokumentarë, artikuj etc.) E veçanta asht se në këtë vepër kemi të bajmë me informacione prej nji personi që ka qenë dëshmitar okular, ose ka pasë burim mjaftueshëm të sigurt, të atyne që

rrëfen, përderisa ka kalue ma shumë se gjysmën e pushtetit të asoherëshëm në burg. Për vdekjen e T. Jakovës, autori shprehet: “Gegënia hupi të vetmin dalazotës në qeveri. Mbet e vejë, si grue pa burrë – si thotë Vaso Pasha”. Ndërkohë kapitullin me titull-varg nga Mjedja: “Gegë e Toskë, janë një komb, me u da s’duron!” e ndjekin qëndrime të ndryshme që kanë të bajnë me atmosferën e krijueme në Gegëni, dhe me pasojat e humbjeve të zaneve përkrahëse, tue pohue: “Gegënia e mjerë u vu ndërmjet dy zjarreve: sllavit e të vetit të shitun te sllavi”. Pra tue dhanë kështu me kuptue, se ishin fuqi të jashtme dhe të mbrendshme që çuen në zbehjen e substancës geqe në kulturën vendase. I vetmi mekanizëm që e zhbani këtë substancë solide ishte komunizmi që përdori me intensitet çdo mjet për me e dobësue traditën shekullore. Nji ndër personat që punoi në këtë drejtim—sipas mendimit të autorit—ishte dhe Fan Noli, i cili e mbrojti diktatorin në arenën ndërkombtare. Polemika të kësaj natyre në fakt i ndeshim qysh me Dom Lazër Shantojën, në artikullin e tij të famshëm, i cili nuk e kursen gjuhën për Nolin, dhe impostimin e tij politik apo mbrapaskenat e sajueme prej tij. Marrë shkas nga kjo dhe nga pohimet e Dom Jubanit, ky i fundit (pra D. S. J.) ishte ndër ata “që s’pranuem kurrë me ndezë qira në elter të diktaturës”. Shikoni çfarë efekti emocional ndërton stilistikisht kjo frazë! Si duket misioni i tij, sikurse ai i modelit bazik të tij (Krishtit), për me dëshmue të vërtetën e pengon dhe po e cenon në vazhden e jetës. Në këtë pikë ai asht si Sokrati, si Jezusi, si Bruno, si Galileo e shumë të tjerë sa i takon mbrojtjes e dëshmisë të së vërtetës. Natyrisht me këtë qëndrim të tij ai veçse ka shtue anmiqtë. Në nji shëjë kallëzimi ai pohon:

E çka më çuditë ma tepër sot, kur mund të ndreqen shumë prej gabimeve të randa të historisë, asht alergjia që kanë anmiqtë e katolicizmit e të Veriut për të vërtetën dhe dishira e çuditshme, e papërligjshme para Zotit e para kombit, për me vijue me kryeneçësi ecjen në rrugën e rrenave, të cilat me çka më duket, në përpjekjen për të rrujtë kontributin e tyre kriminal, pseudoshkencëtarë e kalemxhijtë e tjerë të diktaturës kanë fillue me i besue edhe vetë si të vërteta.

Shumica e priftave, të cilët kishin të njëjtin mision si S. Jubani, e pësuen me inskenimet e pushtetit të dikurshëm, ose ma saktë u vû në skenë tragedia e klerit katolik. Teatri nisi me Dom Ejëll Kovaçin, siç pohon autori, në kapitullin “*Raprezalja*”. Ky teatër real, ma vonë u ba burim i kinematografisë socrealiste; skenarë ku priftat katolikë “kishin vra njerin në qelë” e se akuzoheshin edhe për veprime të ulëta sikurse ishte incesti. Skenaristi ishte shefi i sigurimit të shtetit në Shkodër, Hilmi Seiti, sipas pohimit të autorit, e mandej këtë veprim e kanë marrë ma vonë shumë shkrimtarë, e disa herë përshtatë në filma. Mjafton të kujtojmë filma me portrete figurat e priftave katolikë si “Shembja e idhujve”, “Komisari i Dritës” e me radhë. Arti si shprehje e propagandës ishte një fenomen tepër i njohun asohere.

Sigurisht në këtë drejtim, jo të gjithë janë apo kanë qenë ki’a (qengja) të Jezusit. Autori përmendë në disa vende emna priftash, të cilët e kanë pranue e përkrahë regjimin enverist. Nji shembull interesant asht rrëfimi mes tij dhe Dom Prend Qefalisë, në Mirditë, në mbajtjen e homelisë së panegjirikut të Shnjergjit. Autori kujton se ky dom “*Shkoi*

deri në gjysë të predkut, pa përmendë as Krisht as Zot, por tue folë mirë vetëm për qeverinë”, e mbasi kjo gja e kishte tensionue e acarue Dom Jubanin, ky ia kishte pritë faqe njerëzve që po ndigjonin meshën: “se s’ishte aty vendi me folë për meritat e qeverisë, por tue pasë parasysh rasën e krenimit, së paku duhej me folë për meritat e Shën Gjergjit”. Sikurse ka emna të ndritun në historinë e klerit katolik në Shqipni, po ashtu edhe që nuk duhet me u krenue dhe aq, ka edhe prej atyne që historia për një arsye apo një tjetër i ka skajue. Një emën i tillë asht dhe Injac Gjoka, për të cilin Jubani flet në kapitullin “Modele” dhe e konsideron shëjt. Nga historia e këtij të fundit, kalon në një përshkrim mbas lirimt të tij, në 1992, me të Lumen Nanë Tereza. Në një komunikim që kishte pasë me të, dhe që ai kishte marrë rrugën prej Kalivaçit (Mirditë) e deri në Tiranë për me e takue. Rruga në atë kohë ishte e vështirë, dhe vajtje-ardhje siç dëshmon Jubani ishte të paktën një ditë. Përshkrimi që ban autori, asht i mbushun me humor të hollë dhe ka si bazë stilistikore narrativen e kësonatyrshme të Shkodrës. Si përfundim ai kishte shkue në Tiranë, mbasi e kishin lanë me pritë për disa kohë mbas dere, e kishte takue Nanë Terezën dhe kishte mbetë i habitun se pse e kishte thirrë për një punë aq të lehtë saqë mirë fort mund t’ia kryente me postë. Për këtë mungesë praktikiteti ai shprehet:

U ktheva në Kalivaç lodhë e këputë, tue mendue se këta shenjtët e shenjtëshat jetojnë vetëm më Shpirtin Shenjt dhe nuk kanë kurrfarë aftësie praktike. Se, more zotni, unë që nuk i afrohesha faret në shenjtini, mëkatnova tue mendue se mbasi më kishte thirrë vetë, duhet të më kishte pague të paktën udhëtimin,

ndonëse natyrisht nuk do të kisha pranue me marrë
gja.

Siç edhe mund të vrehet nga pjesët e zgjedhuna për argument, ky autor ka një frekuencë të naltë komiciteti në atë tragjizëm, që ka pësue mbi vete por edhe që ka pësue e gjithë Shqipnia në fakt. Asht në njëfarësoji paradigma e R. Begnini-t në filmin e tij *La vita è bella*. Pra në anën ma të errët të jetës, përpiqet me gjetë elementin ma vital të jetës: gëzimin, të qeshunën, humorin etc. edhe kur mjedisi e situata nuk ia mundsojnë diçka të tillë. Duket se me përvojën e kalueme Jubani e ka jetue jetën në krejt dimensionin e saj, me paradokset e saj, me ferrin e saj, me ditët e qeta, me përmbysjen e regjimit, me vrullin, me kaosin, me gjithçka. Prandej dhe nuk mungojnë pasazhe, të cilat mund të ishin krejt natyrshëm në cilësinë e maksimave, siç asht p. sh. përcaktimi në kapitullin “*Spijunazhi*”: “*Spijujtë e vijojnë edhe sot e kësaj dite zanatin e tyre: i ke në të gjitha poret e shoqnisë shqiptare, prej qeverie në kishë*”.

Nji përvojë të tillë për me vëzhgue shumë probleme e realitete të shoqnisë shqiptare, ai e ka fitue gjatë burgimit medoemos, i cili ka qenë një universitet konkret, paçka se mund të duket paradoksale. Ai e pranon pa rezervë se “*Në fakt kur u arrestova, isha meshtar mediokër, e kisha horizontin sa një birë gjylpane...*” (kap. “*Ndër pranga*”). Vitet e mundimshme fizike, çnjerëzore e kishin ba me fitue dhe me pasë përgatitje të naltë shpirtnore e mendore. Pra kishte veprue *ligji i kompensimit*. Ato 26 vite mungesë lirie i kishte kthye në 26 vite liri për vetveten, kremtim të shëjtë për shpirtin dhe mendjen e tij. Pak ma ’ndej ai ka me shtue: “*Kur dola prej burgut, mbas 26 vjetësh, më ishte hapë para një dritore e gjanë,*

prej nga isha në gjendje me pa botën mbarë me sy të lirë nga çdo paragjykim. Synin tem e kishin pastrue torturat fizike, prej të cilave kisha fitue një pasuni të pamasë shpirtënore”. Por për Jubanin ka edhe një kohë përpara burgut, e cila ishte po aq e tmerrshme sa koha kur ai viente dënimin. Ajo asht koha e përgatitjes për burg—strategji enveriane kjo, e cila konsiston në forma presioni dhe dhune psikologjike. Akuzat se mesha që çonte Dom Simoni, e lënte “popullin pa punë”, se radioja që kishte ai ishte pa leje dhe se autoritetet druhashin se ai mund të lidhej e të komunikonte (!!) me Papën, banin që ai të ecte rreth 16 orë në kambë⁵ për me u paraqitë tek autoritetet lokale. Kjo sjellje ishte periodike. Madje çudia kishte shkue deri aty sa e kanë quejtë “sabotator të bimëve mjekësore” vetëm se u kishte thanë banorëve me shkue të Dielën e Larit me gema të kësaj peme. Sikundërse shihet fantazia e pushtetit për akuza asht e pashembullt! Shkurt: kur ta vënin synin ta gjenin rrëfanën për në birucë (ma e pakta, se edhe mund të pushkatoheshe). Kërcënimet me pistoletë në krye, që mos me folë ma me anë të fjalëve të Ungjillit ishte formë e njohun dhe praktikë e shpeshtë. Mandej kur nuk bindej, vinte medoemos arrestimi, kalvari. Mundimet e Mjeshtrit, të cilat po i viente dhe nxanësi i tij në Golgotën e Enver Hoxhës.

⁵ Në kap. “Biruca”, autori për këtë episod dhe pohim, do të shprehet ma gjanë, në lidhje me personat e funksionarët e regjimit: “më vinte para syve figura e sekretarit të partisë të rrethit të Lezhës, Xhorxhi Robo, fill mbas tij, natyrisht, e kryetarit të degës, Azem Kërzhallit dhe e kryetarit të komitetit ekzekutiv, Shaqir Dibrës, tre princat e Lezhës, të tre peshkaqej e kokodrila, që e merrshin nëpër kambë popullin e shkretë, 90% katolik. Më kishin thirrë sa e sa herë nga Ungrej për t’u paraqitë mbas 16 orësh rruge kambë para zotnisë së tyne, vetëm e vetëm për me ndigjue shamje e kërcënime”.

Janë të paktë ata të dënuem, të cilët kanë pasë konsekuencë në qëndrimet e veta, edhe gjatë kohës kur ishin jashtë, por edhe gjatë kohës së burgjeve. Nji ndër ta asht S. Jubani, i cili ka pasë refuzim total për atë regjim të kaluem. Me pasë refuzim për punën e detyrueshme asht në fakt nji *qëndrim atipik* mbrenda shteteve totalitare, e sidomos për regjimin enverian që nuk kishte asfarë tolerance e principi njerëzor, intelektual, shpirtnor e me radhë. Diku, Jubani thotë: “*Nuk pranova me punue në kampet e punës, tue ngulë kambë se jam i burgosun i ndërgjegjes, prandaj i përjashtuem prej punës së detyrueshme*”.

Pse *Burgjet e mia* u ba paradoksalisht epitomë e censurës së komunistëve të ‘rehabilituem’ në qytetin e Shkodrës e dëshmojnë mjaft pasazhe, por edhe emna konkretë të funksionarëve shtetnorë apo deputetë të së ashtuquejtunës Parti Demokratike.⁶ Tash, se sa janë të vërteta deklarinimet e Dom Simon Jubanit në lidhje me figurën e kryeparlamentarit në ‘pluralizëm’, këtë me siguri e dinë organet shtetnore si AIDSSH-ja.

⁶ Khs. kap. “*Si ishte i organizuem spijunazhi në burgun e Burrelit*”, ku thuhet: “*Intelektualët e burgut, spijujtë me shkollë kryesoheshin prej spijunit ma të rrafinuem, 24 karatësh, Pjetër Arbnorit, Pjeprit, siç e tallshin kur prej burgut na u naltue në majë të opes së Parlamentit. Pjepri nuk informonte në mënyrë vulgare, si spiju dosido, por i qindiste informacionet, tue vu gjithë mjeshttrinë e vet në pikturimin romantik të karaktereve e të sjelljeve të të gjithë të burgosunve. Nuk e di nëse kanë pështue këto vepra të atij, që ma vonë do të ngjitej në majën e pushtetit, se atëherë nuk do të kishte fare nevojë të botonte shkarravina të tjera: do të mjaftojshin këto, që të ngjitej edhe në Parnasin e letërsisë spijunore, në të cilën nuk mungojnë kryeveprat e të gjitha vendeve e të gjitha kohëve. Në botë gjinden kilometra arkiva me padi e shpifje spijujsh*”.

Vepra, botue së pari në 2001, nuk rezulton të ketë kund (në dijeninë time) ndonji oponentë shkrimore, a kontestim në lidhje me pohimet e Jubanit, përveçse metodës enveriane me censurue. Skena e situata të ndryshme në Burgun e Burrelit me Pjetër Arbnorin, Dom Simoni i rrëfen prapë herë me ftohtësi e herë me (auto)ironi.

A ka një motiv pse autori i përmendë nominalisht ata që i quen 'spiu'? – përgjigjen e jep vetë në këtë mënyrë: *“Prandej mendoj me i përmendë emnat e plotë. Përndryshej nuk do të kuptohet mësimi i historisë e ajo do të vijojë me u tallë keqas me ne deri në ditën e gjyqit të mbramë, kur ma në fund politikanët e të gjitha kohnave kanë me u detyrue me i tregue publikisht mëkatet e tyre, krimet e tyre”*.

Edhe pse Jubani i vetëdijshëm se *“mikrofonat janë mbyllë për arrat gungçe”*, ai me anë të kësaj vepre ka futë kulturën e dëshmisë pa initiale, pa pseudonime, pa asnjë fshehje a maskim, nganjherë edhe artifice fiksionale, gja e cila ndodhë edhe sot, mbas 20 vjetësh që asht botue vepra. Kultura shqipe, peng i një tranzicioni post-komunist, ka nevojë me u përballë ma drejtazi me historinë e vet në mënyrë që me reflektue qartë mbi përvojat e së nesërme. Prandej, mishmashi i sotëm tridhetëvjeçar nuk prodhon përvojë të re përpos riciklimit të enverizmit: lundrimi historik ma katastrofë i kombit shqiptar.

Qëndrimet e Dom Simonit janë të rrepta, pse e tillë ishte Golgota e tij. I pajisun me një eksperiencë afro tri dekadash ndër burgjet enveriane si edhe protagonist i shumë ngjarjeve historike, kundrimi i realitetit për të ishte i tejdashëm, e shpesh ngjan që pohimet e tij janë në kuadrin e një profetizmi. Në disa kapituj të veprës ai ban edhe

krahasime mes ngjarjeve të randësishme politike e historike nëpër botë dhe komunizmit shqiptar. Shumë pikëpamje të tij përputhen mes Revolucionit Francez dhe tramontanës komuniste. Metoda e tij krahasuese dhe konstatuese asht empirike, e çlirët prej ndonji aksiomatizme shkollareske. Ai nuk synon me ndërtue ndonji teori për narrativën e vet, por i lën mundsi receptuesit me e teorizue dëshminë e komunistizimit shqiptar. Por një gjë e tillë ka kalue në heshtje si shumë punë edhe ndër departamente e auditorë në Shqipëri, në trajtesa shkencore apo edhe në trajtime të tjera. Kjo disfatë kombtare ka progresue zhvillimit e disa kryptoizmave që sot duket se shprehin gravitetin kulturologjik në vend. Organe botuese dhe media në një lidhni të pashpjegueshme, promovojnë sot tekste e dëshmi, si matëse (?) të së vërtetave të t'ashtuquejtunit komunizëm shqiptar. Ndërkohë janë dorëdytësue vepra kanonike si ajo e Pipës, Pllumit, Gjollajt, Kostrecit etc., e natyrisht edhe e Jubanit. Për fatin e keq, përpos ndonji shembulli si përkthimi në italisht e anglisht i *Rrno vetëm për me tregue* apo në gjuhë analoge i veprave të Fatos Lubonjës, publiku i huej shumë pak e njeh martirizimin shqiptar nën komunizëm. Edhe në raste kur studiues të huej kanë folë për letërsinë e burgut në Shqipëri, rezultati ka qenë qesharak si ai i Harold B. Segel, *The Walls Behind the Curtain: East European Prison Literature, 1945-1990*, i cili ka përfshî në këtë lloj letërsie një autor si Besnik Mustafaj, i njohun si propagandist i regjimit diktatorial dhe që nuk ka prodhue asnjherë letërsi burgu, sepse nuk ka qenë në burg. Përligjjet shkencore të Segel-it për këtë autor në letërsinë shqipe të burgut janë një bjerre totale e vlerave akademike. Natyrisht, janë fyemje për autorët shqiptarë të burgosun politikisht dhe njëkohëshit

për vetë ata që ka përzgjedhë Segel (Jusuf Vrioni, Arshi Pipa, Kasëm Trebeshina, Maks Velo, Fatos T. Lubonja, Visar Zhiti), të cilët i paraprijnë të fundit në listë: B. Mustafaj, 'advokatit: kampionit' të t'drejtave njerëzore.⁷ Për kush e njeh letërsinë shqipe, kjo asht me qeshë edhe, kur sheh një autor që i ka shërbye me devocion regjimit diktatorial gjatë socrealizmit e madje, ka punue përkthyes në Institutin e Studimeve Marksiste dhe Leniniste (1988) pranë KQ të PPSH-së, ku drejtoresh ishte vetë e veja e diktatorit, Nexhmije Hoxha.

Rotacioni politik i kuadrove si Mustafaj ka sjellë dhe rotacionin letrar në traditën shqipe, që sot shumëkujt i duket normale me ndodhë. Autorë e individë të kësaj natyre, kanë ra në mbramje komunistë dhe kanë zbardhë në mjes demokratë. Jo pa arsye edhe skoriet partiake që i vërviteshin Meshtarit, i cili çoi Meshë e foli për Zotin, trajtohen pamëshirshëm nga ai. Jubani e distancoi veten nga politika, tue qenë kondend gjithnji për vokacionin fetar të cilit i ishte true (kushtue) me mish e me shpirt. Veprimi i këtij Meshtari, që me u shmangë prej grremçave politikë të kohës, në gjykimin tim ia ka naltësue pahun klerit katolik dhe disidencës së njimendte shqiptare.

⁷ Khs. "Although Mustafaj never spent time in prison, he has been a champion of human rights who has often spoken out against political injustice". Harold B. Segel. (2012). *The Walls Behind the Curtain: East European Prison Literature, 1945-1990*. University of Pittsburgh Press, 70.

Leximi i dytë: letrariteti i *Burgjet e mia*

Asht e dukshme se në krejt veprën e Simon Jubanit, dallohet një stilistikë e mrekullueshme, e cila buron vetvetishëm e pa sforcime autoriale.

Dy figura bazike që mund të identifikohen në tekst janë ironia, jo pak herë edhe ndaj vetes, dhe sarkazma. Nji përvojë të ngjashme në letrat shqipe e ka dhanë ma së miri Gjergj Fishta, në të cilin gjykoj se Jubani asht shujtue shpesh.

Në këtë syth do të ndalem vetëm në kapitullin përmbyllës “*Epilog në qiell*”, si bazë modelore për krejt letraritetin e veprës së Jubanit.

Elementi i andrrës si artific letrar, në traditën shqipe ndeshet jo rrallëherë, por në dimensionet e një satire fishtiane ndoshta tekstet shqipe ende nuk kanë prodhues një ekzistencë të konsiderueshme. Ky kapitull i Dom Simon Jubanit, për kah niveli satirik dhe i procedimit të klimakseve, kisha me thanë ka të ngjamë me poezinë *Kuer pata kë në bā Papë*.⁸

Kapitulli në fjalë hapet me një pyetje angështuese: *Po tashti o Zot, kah t’ia mbaj?* Me këtë lloj gjendje fillon rrëfimi mbi *Dies irae*-n e tij. Jubani, kishte pa’ vdekë e qëndronte mbi vetveten, trupi i të cilit ishte shtrë mbi arkivol e vendue në kapelën e Rrmajit, pikërisht në atë tempull ku kishte çue Meshën e Parë mbas 90-s. Kjo situatë ishte e pazakontë për të, sepse (shprehet autori): “*Kufoma eme rrinte aty pa lëvizë,*

⁸ Khs. Át Gjergj Fishta O.F.M. (2020). *Satira*. Shkodër: Botimet Françeskane, 452-5.

gja e pazakontë për mue". Për me i dhanë 'solemnitet' këtij procesi mortor: "Në rreshtat e parë, si zakonisht e si për ironi të fatit, gjithmonë lojçak me mue, autoritetet ma të nalta komuniste të vendit. Ta pret mendja se ishin aty për me kja për dekë teme?" Kjo asht njena anë e sarkazmës së Jubanit—e cila siç u pá gjatë këtij studimi të përvûjtë dhe ka me u pá ma mirë gjatë leximit të veprës në tanësi—lidhun pashkëputas me sfondin politik. Në anën tjetër, ai vijon, krejt natyrshëm në rrëfim edhe në sarkazmën ndaj meshtarit i cili ishte tue mbajtë predikimin mbi trupin e Jubanit. Autori kallëzon:

Mandej predku, me fjalë që kisha pasë ma kënaqësi me i ndie sa isha gjallë. Flitëte e flitëte predikatari, tue u paraqitë besimtarëve një Dom Simon që s'kishte kurrëgjia të përbashkët me të vërtetin, me atë që kishte mbetë prej mejet e që gjindej as në qiell as në tokë. Në vend që me theksue se i prina shkodranëve drejt elterit të Meshës së parë të mbas persekutimit, s'prani tue vu në dukje se jam rritë jetim. Nuk po e merrshe vesht a ishte meritë kjo, apor u donte me më ardhë marre se isha rritë pa babë.

Pra, po të shihet me kujdes stili i rrëfimit asht ai i modelit parak të Fishtës, sidomos në korpusin e poezive që gjenden së bashku në *Nikolejda*. Nji nisjativë e tillë, tue besue ngultas në aspektin korrigjues të problematikave që lidhen me shoqninë, jam i gjykimit se në staturën e shkrimtarit (të D. S. Jubanit) ka prû binomin etik *me e dashtë-dhe-me e drashtë*. Edhe pse në të shumtën, për fatin e keq, në qytetin e tij të lindjes, ky binom asht skarcue në indiferentizëm e deri në neutralizim të personit: pra nji

periferizëm ndaj Jubanit, gja e cila asht ndie dhe vrejtë dukshëm sa ishte gjallë. Kjo gja i shkakton gaz të pamatë 'shpirtit' të rrëfyesit. Epilogu i autorit, s'asht asgja tjetër veçse me i paraprë kurrsi ma ndryshe se fatit real, në dekë të tij, tue pasë si postulacion fjalët e vetë Jubanit në këtë kapitull: "*Kështu kam ba gjithë jetën: kam qeshë për e me vetvedi e kam kja për e me vedi!*"⁹

Si mbyllë kallëzimin për zhvillimet në tokë: prej te mbajtja e arkivolit, gozhdat e çekiçi, stomi i dheut hedhun përmbi gropë e me radhë, nisë flutrimi kah qiella. Mbërrin te dera e Parrizit! Si me qenë para kullave të Mirditës, Jubani bret: "*A don miq, o i Zoti i shtëpisë*". Përpara i del Sh'Pali që e njeh se kush ishte, dhe i dikton se sendet duhen me u vù në kandar ma së parit. Pra, me gjykue se kah kishte me e vù majen e këpucës: o kah ferri o kah Parrizi. Tue pritë se mos vetë Sh'Mëhilli kishte me iu afrue Dom Simonit, ai po vren i tmerruem se po u afroka me kandar në dorë Enver Hoxha, i cili:

Ishte veshë krejt me të bardha e kishte një palë krahë të mëdhaj. Taman njashtu si i kanë kryengjujt ndër fugure. Më hyni hataja, më hyni. Brita tue m'u marrë goja: - Sh'Pjetër (pa dashtë kisha kujtue Pjeprin), bre, po ky s'asht Sh'Mëhilli. A e dini bre, kush asht ky? S'asht arkangjull, asht dreqi vetë. Asht shejtan! Shejtan! Shejtaaaaan! Ushtoi zani em, si ai i një shpirti të bjerrun në hapësinën pa fund të qiellit.

⁹ Shih edhe: "*Vargani i gjatë i klerit, me paramenta bojë vjollcë, kinse për jazë teme, u shtrëngue rreth arkivolit për herë të fundit.*"

Na delka pra se E. Hoxha kishte pa' qenë xêvendsi i Sh'Mëhillit, sepse këtë të mbramin e kishte thirrë Zoti për do punë tjera. Për ironi fatit, ai që e kishte dërmue se gjalli tash kishte me ia peshue mëkatet edhe mbas vdekjes. Pra, vetë dikatori me i peshue shpirtin dhe madje i autorizuem prej vetë Kryengjëllit. Simbas Sh'Pjetrit, Enver Hoxha kishte hy në Parriz simbas të gjitha parimeve të Kishës Katolike dhe Apostolike, sepse pak para se me dhanë shpirt, Enver Hoxha ishte pendue tue i ra mohit Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit e i cili ishte pa' kthye me mend e zemër në fe të Krishtit. Si pat mbërrî në Parriz, kishte pasë sjellje shembullore e ishte kthye në njifarë censori që s'lënte me hy shpirtna (sidomos shqiptarësh) për be aty, tue ditë cilat ishin veset e tyne. Nisë prej këtyne fakteve Sh'Mëhilli e kishte emnue bash xêvendës të tij. "Tash hyp në kandar e mos ban za", ishte me fjalë të tjera urdhni i Sh'Pjetrit. Si pau kandin në duert e Hoxhës, e paksa derën e Parrizit çilë, Jubani ia mbathi me të shpejtë, tue i hupë kambët nëpër retë e bardha. Nji angështi e parrëfyeme e kapë, saqë i tmerruem ban pyetjen: "*Po tashti kah t'ia mbaj?*" Kjo pyetje, e jo '*nji dreq minit*' si te Fishta ia nxuer gjumin. Shkak i kësaj andrre sa komike aq edhe të zorshme, kishte qenë nji seancë dëgjimore e nji lektori të huej jezuit, të cilin Jubani kishte shkue me shumë dëshirë me e ndjekë. Në fund të ligjëratës, kishin pa' ardhë nga salla pyetjet: "*Çka duhet me ba njeriu për me u shëlbje? – e – A mund të shëlbehen edhe ata që kanë ba krime të randa, si Enver Hoxha, bje fjala?*" Jubanit i interesonte, natyrshëm, pyetja e dytë. Por, përgjigja për habi të vetë Dom Simonit ishte: "*Në qoftë se ai asht pendue në çasin e fundit – tha jezuiti, mundet edhe me kenë i shëlbuem. Madje ndoshta tashti gëzon lumninë e Parrizit!*" Ky rrëfim, sa i thjeshtë në dukje, të

orienton kah argumentet teologjike për probleme të ndryshme që lidhen me botën katolike (në këtë rast), dhe të cilat interpretohen në varësi të kontekstit. Fjala vjen, ndieshmëria e një të hueji që nuk ka vujtë pasoja komuniste, vështirë se e ka masën e ndiesisë dhe të përgjegjësisë sikurse një person që e ka (për)jetue vetë komunizmin. Tash a mund ta merrni me mend zoritjen e një të burgosuni për afro 30 vjet nën diktaturën enveriane? Reagimi i këtij deduksioni, asht kësodore prej Jubanit. Tue mos mujtë me i durue protezat prej nervozizmit, i heqë e i shtien në xhep dhe i thotë padrit:

Padre, ju po na thoni këtu se Enver Hoxha ndoshta-ndoshta na prët në Parriz. Në kjoftë se ai ka shkue në Parriz, unë ku kam me shkue? Se Dom Simoni e Enver Hoxha në një vend bashkë s'mund të rrinë. Përndryshej Parrizi i Enver Hoxhës kishte me kenë ferri i Dom Simonit. A e sheh këtë gojë pa dhambë. Ai m'i ka zhgulë të tanë. E çka ka me zhgulë ma, në ndejsha me të në Parriz? Se ai veç me zhgulë mendon. Atëherë Parrizi kishte me kenë vend dënimi e jo shpërblimi për ata që e kanë la me gjak flamurin, për mos me e ndërue! Jooo, more zotni, në daç me falë, në daç më vra, unë në atë soj Parrizi që po na thoni ju, s'kam punë as sot as kur të më dalë shpirti!

Thjeshtsia e argumentit në këtë rast, shkakton gaz në sallë, dhe doemos gjatë hipotipozës leximore. Ky dialog e kjo situatë, shkak i një andrre me tharm genuin letrar, i avitet moralizimit dhe etikës që shpesh gjendet në parabolat e ungijve. Pra, shkrimit ndër vetë fjalët e Zotit ma fort se interpretimit kontekstual në këtë rast.

Në mjetet figuracionale të prozës së Jubanit, dallohet stilicizmi përmes figurave që përmenda në krye, dhe ato bahen dukshëm funksionale për shkak se autori nuk kursehet me i përdorë as për vete. Nji dimension i tillë, e ban veprën apo bërthamat narrative universale dhe neutrale. Arbitrariteti, asht fjalë që kryesisht mungon në këtë vepër. Gja që e vendos autorin në një stad të veçantë të narratologjisë së burgjeve komuniste, dhe prozës mbas-komuniste.

Leximet e tjera

Herëmbashere gjatë punëve të mia veprën në fjalë të D. S. Jubanit, përveç leximeve edhe e kam referue/citue apo e kam këshillue për lexim te studentët e mi, gjatë kohës që shërbeja në Universitetin e Tiranës.

Në mars të vitit 2018, unë isha i ftuem në një rezidencë shkrimore në Serbi (KROKODIL's Writer-in-Residence) dhe librin e Jubanit e kisha marrë me vete ndër atë sasi tjetër që kisha planifikue për lexim dhe rilexim. Në këtë kohë skicova edhe bocën e parë të një studimi, me qëllimin që kisha me gjetë mënyrën sesi me e ribotue këtë vepër, dhe me e shfrytëzue me të njëjtin synim sikur tash.

Lëvizjet e mia të shpeshta, sa në Shqipëri e Amerikë por edhe në disa vende europiane për motive autoriale, e patën regresue finalizimin e këtij studimi, i cili mbeti në mendjen time si gozhdë pa korrnizë në murin e zdashun. Mbas orvatjeve të mia disavjeçare për me gjetë personat që trashëgojnë të drejtat e autorit, mora vesh se Arkipeshkënia Metropolitane Shkodër-Pult, së mbrami kishte marrë të drejtat e trashëgimisë autoriale mbi veprën e Dom Simon Jubanit. Kjo gja më gëzoi pa masë, sepse trokitjet e mia në derën e shtëpisë së Jubanit ishin kthye gjithmonë pa përgjigje. Me këtë rast i shkrova institucionit përkatës¹⁰ një letër të arsyetuar si vijon:

¹⁰ Në vitin 2014 (23 korrik) i pata shkruar një e-mail përkatës, ish-Famullitarit të Shën Shtjefnit-Shkodër t'asaj kohe, lidhur me bartësit e të drejtat autoriale mbi këtë vepër dhe propozimin tim për me ribotue veprën [cartaceo]—nismë individuale që parashihja me

Ann Arbor, Michigan

9 Nandor, 2019

LANDA: KËRKESE

(Mbi lejen e *ribotimit online* të veprës së Dom Simon Jubanit † *Burgjet e mia*)

Drejtue: Sh. T. Imzot Angelo Massafra

I Përnderti dhe i dashtuni Imzot Massafra,

Po Ju drejtohem Juve me anë të kësaj letre mbi një përpjekje e dëshirë timen të kahershme mbi veprën e Dom Simon Jubanit †, *Burgjet e mia*. Ka disa vite që orvatem me gjetë personat e kontaktit mbi trashëgiminë letrare të D. S. Jubanit, por nuk ia kam arritë. Nuk ka shumë që jam informue se trashëgimia e këtij kleriku të nderuem gjendet në Arkipeshkyni, në Famullinë e Shën Shtjefnit. Për këtë u gëzova shumë!

Po Ju parashtroj kërkesën time mbi veprën *Burgjet e mia*, me shpresën se do të arrijmë një mirëkuptim nga ana e Juej. Kjo vepër, tue qenë se nuk qarkullon prej shumë kohësh, por edhe atëherë kur ka qarkullue ka pasë probleme në praninë e saj reale në librari, si ligjërues (ma heret në Tiranë) kam pasë vështirësi me i orientue studentët e mi drejt kësaj vepre. Por kjo më asht vështirësue edhe ma shumë në Amerikë, sepse nuk mund ta drejtoj studentin e këtushëm me eficiencën e duhur. Po flas për ata studentë (pra atë përqindje) të kursit tim ‘Albanian Literature of Exile’ që kanë rrajë shqiptare. Nji fatkeqsi tjetër asht mosbotimi i saj në anglisht! Ky asht një diskutim i dytë, në një kohë tjetër. Do t’Ju isha lutë me më miratue *nji leje ribotimi të veprës online* në faqen e revistës sonë *Këns*. Qëllimi asht vetëm LEXIMI I SAJ, dhe asnji

e marrë vetë përsipër si kosto pune dhe kosto financiare—por përgjigja e asoherhme ishte që Famullia nuk e gëzon copyright-in mbi këtë vepër.

benefit financiar sikurse asht edhe natyra e revistës në fjalë, e cila vetëfinancohet nga unë dhe ime shoqe. Pra çdo gja, qysh prej 2017, del nga buxheti ynë familjar. Arsyet se pse e kërkoj të drejtën e lejes po Jua shtjelloj ma poshtë:

1- Vepra nuk asht e pranishme në bibliotekën e Universitetit ku jap mësim: <https://www.lib.umich.edu/>.

2- Botimi ka nevojë për korrektim profesional dhe e marr përsipër unë me e krye personalisht pa asnji shpërblim. Ai edicion ka shumë gabime drejtshkrimore dhe inkonsekuenca gjuhësore.

3- Lexuesi e akseson botimin [nëse dakordsohemi] vetëm online: NUK E PRINTON dhe NUK E KOPJON DOT TEKSTIN. Pra këto dy masa sigurie sikurse e ka revista *Këns* marrim përsipër me ia vendosë edhe *Burgjet e mia*. Nëse mendoni Ju mund të shtojmë edhe elementin e tretë të sigurisë që MOS ME U SHKARKUE, pra vetëm me u LEXUE ONLINE. Për këtë vepër si edhe të tjera, që i kemi në proces pune, jemi shumë të lumtun me ofrue hapësinën tonë të uebfaqes, por edhe me pague koston e mirëmbajtjes për të. Pra po e ritheksoj së interesi ynë financiar asht zero lekë (apo valutë tjetër). Nuk interesohemi për botim në letër.

4- Publiku shqipfolës dhe lexuesi në shqip (d.m.th. ai internacional) ka nevojë urgjente me e njohë të shkuemen diktatoriale në Shqipni, dhe kjo vepër së bashku me disa tjera janë pilastra të DËSHMISË.

5- Me këtë vepër i bajmë një shërbim shumë modest e të përvujtë Martirëve të Kishës Katolike në Shqipni.

Baza e leksioneve të mia në Amerikë [apo edhe e studimeve ndër vite] asht NDRIÇIMI mbi KLERIN KATOLIK / PERSEKUTIMI KOMUNIST NDAJ KËTIJ KOMUNITETI si edhe individualiteti LETRAR E KRIJUES i shkollave Jezuïte e Françeskane.

Me shpresën në konsensus, mbetem në pritje të përgjigjes Suej,

Jueji sinqerisht



Mbas marrjes së letrës sime, Arkipeshkvnia pati mirësinë që më 4 janar 2020 (nr. Prot. 08/2020) me e miratue lejen, gja që mund të shihet edhe në faksimilen ma poshtë:

ARQIPESHKVINIA METROPOLITANE
SHKODËR - PULT



Prot. N. 08/2020
Shkoder, 04/01/2020

Objekti: Leje për ribotimin e veprës *Burgjet e mia* të Dom Simon Jubanit

I nderuar Z Lisandri,

Zoti ju dashte paqe!

Mbështur në kërkesën e datës 9 nëntor, 2019 të z. **Lisandri Kola**, lektor pranë Universitetit të Michigan-it, Ann Arbor (Mbi lejen e *ribotimit online* të veprës së † Dom Simon Jubanit "*Burgjet e mia*"), unë, **Mons. Angelo Massafra**, në cilësinë e Arqipeshpeshkvit Metropolitan Shkodër-Pult, lejoj *ribotimin online* të kësaj vepre, në faqen e revistës Këns duke iu përmbajtur arsyetimit të z. Kola në letrën përkatëse:

1- Veptra nuk është e pranishme në fondin e bibliotekës së Universitetit të Michigan-it, Ann Arbor <https://www.lib.umich.edu/> dhe për rrjedhojë do të shërbejë si burim referencial për komunitetin e studentëve në Amerikë, që kanë njohuri për shqipen, por do t'i shërbejë dhe lektorit të lëndës "Albanian Literature of Exile" që të përkthejë pasazhe në anglisht, me qëllim funksional për leksionet.

2- *Burgjet e mia*, në këtë ribotim do t'i nënshtrohet një korrektimi, proces që e merr përsipër z. Kola.

3- Kjo vepër, në faqen e revistës Këns, miratohet të aksesohet me këto kritere sigurie: **nuk printohet dhe nuk kopjohet** si tekst.

4- Ky ribotim *online* do t'i shërbejë dëshmisë së Klerit Katolik, në rezistencën e tij ndaj komunizmit shqiptar dhe denoncimit të pasojave të këtij regjimi. Në kuadrin e një projekti sensibilizues për të kaluarën dikatoriale në Shqipëri, jemi dakord që ky projekt i bashkeditorit të kësaj reviste (Këns), të marrë jetë.

Z. Lisandri ju falenderoj për kete angazhim për te trteguar edhe ne gjuhe anglese jeten dhe vuajtjet i dom simonit dhe te kishes katolike.

Urime për vitin e ri 2020.


+ Angelo Massafra-EPM
Arqipeshkev Metropolit i Shkoder-Pult



Adresa: Sheshi "Gjon Pali II" - Shkodër - Albania. Tel: 00355 22242744 - Fax: 00355 22243673
E-Mail: curiashkoder@hotmail.com - Web page: kishakatolikeshkoder.com

- Rruga drejt procesit të publikimit

Tue qenë me detyrime dhe projekte të tjera, dhe tue mos pasë lehtësime të tjera që e ndihmojnë finalizimin në kohën e pritshme të veprës, na asht dashtë me punue gradualisht në renditjen e materialit libror, në lektorimin përkatës dhe fazën redaksionale; e natyrisht me ba një inkuadrim studimor, gja që i mungonte prej vitesh kësaj vepre.

Me punue në një tekst (2001) që asht i paraqitun me probleme të shpeshta drejtshkrimore e pa pasë në tryezë dorëshkrimet e *Burgjeve*, rezultoi një sipërmarrje e vështirë:

- a) Së *pari* asht dashtë me respektue vullnetin tekstual të statusit gjuhësor, i cili në gjykimin tim asht jo i qëndrueshëm në plotninë e vet, dhe i afrohet një ekzistence tekstuale si ajo e P. Daniel Gjeçajt,¹¹ ku forma shumë inovatore të gegënishtes trupzohen së bashku me disa arkaizma gramatikorë (si mbaresat e hershme [gege] të dëftores në të pakryemen, *-shem* {v. I. nj. *banojshe(m)*} apo v. sh. si p.sh. *blej/-shim*, *-shit*, *-shin*), që kahmot—tash 30 vjet e këtej—në tekste fundamentale gege nuk përdoren ma.

¹¹ Këtu kemi parasysh botimet e tij mbas 90-s, sepse në shkrimet e hershme të tij si ata në *Shêjzat*, 1957/4-5, 99-107 apo 1961/11-12, 438-67; 1963/5-8, 277-87, autori [nën pseud. Gjin Duka] e ruen trajtën *nji* në vend të *një* apo edhe involucionin e grupit bashkëtingëllor *mb/-/mb-* në *m*, që ma vonë kthehet në një prani të njisue me tue u ba *mb*. Me përjashtim të ndonji trajte foljore si *me mërrijtë*. Gja që ndeshet edhe te Jubani; khs. pikën d) ma poshtë në tekst.

- b) Së *dyti* asht dashtë me krijue njipërnjisim dhe ndjekësi ortografike, gja që teksti e ka pasë të metë, tue dalë në disa raste edhe si forma të standardit—kjo në kundërshti me vetë variantin e gegënishtes, në të cilin ka punue Jubani apo autorë të tjerë të kësaj tradite.
- c) Së *treti* vepra tue pasë një moshë tekstore dhe stil, e ka pasë të nevojshme me u pajisë me disa shënime shpjeguese në nënvijë, gja e cila e ndihmon një lexim ma të suksesshëm.
- d) Së *katërti* asht respektue me vetëdije pozicionaliteti i ë-së (herë po e herë jo: *zell*, *fill* vs. *zellë*, *fillë*) khs. edhe *nderë*, *ligjë* etc.; (mos)prania e grupit *mb-*: *me mërrijtë*, *me mbajtë*; ndërkëmbimet shkodranishte: *me pështue* vs. *me shpëtue* ose *këpurdha* etj. Shpjegime të ngjashme mundeni me i konsultue në korpusin e shënimeve ba në tekst prej meje.
- e) Së *pesti* asht standardizue një paraqitje tipografike që mungonte në tekstin e 2001-shit, dhe ba ma të përshatshëm për synin disa gjymtyrë pasazhesh (tue u ba me të pjerrëta), aty ku ka pasë citime vargjesh etc.
- f) Së *mbrami* çdo ndreqje tjetër e kryeme nga ana e lektorëve në këtë ribotim [përfshî edhe *Lahuta e Malcís* në vend të *Lahuta e Malcisë*; Ndrë Mjedja në vend të *Ndre Mjeda*] besoj se asht në dobi të tekstit.

Paralelisht, në këtë valë pune, në shtator (o rrotull këtij mueji) të 2020-s, mësuem se Botimet Françeskane, ribotuen [cartaceo] *Burgjet e mia*, gja e cila na lumtunoi. Ku

kishte ma mirë se një vepër e mohueme në tregun e ligjshëm tash dy dekada, me e prû Zoti apo Dom Simoni—mbasi pat lanë kendarin e Sh’Mëhillit (larg qoftë të xêvendsit të tij)—përmes Lumnisë së tij, që me u gjendë të treg? Siç shihet edhe në dy shkresat e masipërme synimi ynë ishte me mbërritë lexuesin e kopjes jofizike, pra atë lexues që gjendet kudo që ka akses interneti. Por, na duhet me e pranue se synimi ynë bazik ka qenë lexuesi jashtë Shqipnie, e ndër-kohë mbrenda Shqipnie tash kanë mendue Fretnit, të cilëve u shprehim mirënjohjen që e kanë ba Dom Simonin me qarkullue ligjrisht e jo në mënyrë të paligjshme, siç rishtypej tinëz para do viteve dhe qarkullonte si ‘samizdat’. Nuk kanë mungue rastet, që vetë e kam pá me sy të mi këtë vepër tue u shitë në trotuare (në treg të zi). E futa në kllapa këtë përcaktim, sepse vepra ka qenë për vite, një piratim i disa individëve me qëllim përfitimin vetjak. Vepra me sa dukej asht shtypë identik si ajo e 2001-shit, tue shënue të njejtin vit, dhe asnjë parametër tjetër katalogues. Pa shtëpi botuese, natyrisht.

Fundja, dhe ma me interes në krejt këtë shtegtim, asht se *Burgjet e mia*, mundet me u lexue lirisht dhe konform një edicioni legal [si online, si në letër], tashma edhe nga individë që dikur e banë të pamundun qarkullimin e kësaj vepre.

LISANDRI KOLA

Beograd, mars 2018 (fillue)

Ann Arbor, dhator 2020 (mbarue).

Parafjalë¹²

Ky libër lindi prej revoltës dhe prej ndjenjës së detyrës për t'i pa nën një dritë ma objektive ngjarjet e këtyne dhjetë vjetëve, që s'banë tjetër veçse shtuen mjerimin, shuen shpresat e mbytën andrrat.

Kur Dom Simoni ma dorëzoi, pata mendue se duhet t'i epshe vetëm dorën e fundit. Ia kisha premtue kahmot. E xanun siç jam me njëmijë punë, e lashë për shumë kohë në një skutë, derisa një ditë të bukur e hapa. Si një grumbull perlash, m'u derdhën në prehën përshtypjet e një jete të jashtëzakonshme, rishfaqë në një kujtesë të vume në provë të randë prej tridhetë vjet torturash. Gjeta ndër ato fletë biruca burgjesh, zyra hetuesie, oda torturash, kampe përqendrimi, kuvende të lashta përhapë nëpër botë, salla senatesh e kongresesh, mjedise emigracioni në Evropë, Amerikë e Azi, fëtyra herojsh, turij kriminelësh, rrëfime, meditime, idhnime e çaste gëzimi të papërs shkrueshëm, rrëxime e naltime, që mërrijshin deri në ekstazën e një elteri ku çohet Mesha e Parë publike, mbas 50 vjet salvimi: kalime nga terri i vdekjes në dritën e lirisë, nga izolimi i plotë në një bredhje të palodhun nëpër botë, prej Japonie në Amerikë, për t'i tregue miqve e anmiqve se Shqipnia asht Golgota moderne, ku Zoti u kryqëzue rishtas, e rishtas u ngjall në të tretën ditë.

¹² *Parafjala* dhe *Mbasfjala* janë shoqnuese të ed. I, 3-7 dhe 224-30, që logjikisht kanë të njejten autorësi edhe pse në *Mbasfjalë* nuk shënohet.

Libri më përtriu disa prej kujtimeve ma të thekshme të jetës. Nuk kam qenë e pranishme as në Meshën e Parë, ku s'di sesi e s'di se kush ishte mbledhë ashtu, pa farë njoftimi; e as në të dytën, sepse më duhej me shkue në Tiranë, në një përkujtim vdekje, ku nuk mund të mungojshë kurrsesi. Po të mos isha nisë, do të kisha mendue mirë me shkue a mos me shkue në Meshë, sepse atë ditë deka e jeta na u patën dukë ma pranë se kurrë e kufini ndërmjet tyne, gati i papërfillshëm. Me një fjalë, na u duk se, në vorrezën e vjetër me kryqa të thyem, mordja kishte dalë prej qindra gryka vorresh të zbulueme e i kërcëllonte njerëzve dhambët e mprehtë, që buzët e shpulpueme nuk i pengojshin ma me kafshue. Të paktën kështu mendojshim na, katolikët, që kishim jetue gjithnjë ndërmjet territ të verbët e gjakut, ndërmjet krygjës e amshimit.

Kujtova ditët e para të kthimit të Krishtit, dalldinë mbarëpopullore, njerëzit që lajshin me lot pabesinë ndaj Krijuesit të tyne.

E mandej kujtova natën e lume të Krishtlindjes 1990, kur mija njerëz, shtrëngue fort njeni mbas tjetrit, e xenë vetë dimnin e acartë e e banë veriun e akullt të këndonte me jonet e fladeve. Pata shkue herët fort për me xanë vend sa ma pranë elterit, sa ma fër Zotit tem, që ishte kthye rishtas. Në shtëpi pata lanë sofrën shtrue, me premtimin mos me mbyllë sy atë natë aq të pritun. Më ka mbetë në mend fëtyra e Meshatrit, e kuqun si prushi prej frymëzimit; më kanë mbetë në mend fjalët e tij, që derdheshin, pa gjetë kurrfarë pengese, tue çuditë mbarë besimtarët, të cilët e dijshin mirë se Zotnia belbëzonte nga pak: “Doni me pa një mrekulli, për me besue? Qe, pra, mrekullinë e keni para sysh. A nuk asht mrekulli kjo natë e

lume, me selvi vorresh kthye në bredha Krishtlindje, me Krishtin, që, si në kohët e të krishtenëve të parë, lind mbi shtroje eshtënshe, për me na pru jetën?”..

E më ka mbetë në mend edhe çasti kur u çue i Shenjtueshmi Sakramend. Ndërsa Meshtari naltonte osten, gjithë turma ra në dy gjuhë të mëdhaj, aty ku e xuni akti solemn: mbi rrasa gjysë të thyeme, tue u rrezikue me u kapërdi ndër gropa, në hapësinat e stërngusha ndërmjet vorresh, në shtigjet e përmytyna nga balta e ftoftë e Dhetorit, ngjeshë për selvi e çinarë. Mbetën në kambë vetëm përfaqësuesit e partisë demokratike, që kishin ardhë me na e mbushë mendën se edhe ata ishin me Krishtin, tashti që po ulej prej krygie, që po ngjitej në e djathtën e Atit, prej nga do të gjykonte të gjallët e të dekunt. Shikjue të habitun para e mbrapa, tue mos e dijtë çka po ndodhte, e si e panë se ishin të vetmit mbetë në kambë si pura, u detyruen me ra në të dy gjunjët, si mbarë grigja e Zotit. Fundja ishte ma mirë me u gjunjëzue para një Zoti, se para një katili. E në këtë lamë gjunjët e tyne nuk ishin të pamësue....

Shfletoshe letrat tue mendue me idhnim se historia e soçme dhe e vërteta ndryshojnë si terri me dritë, si e shtrembta me të drejtë, sepse faktet vijojnë të shikohen nën prizma ideologjike, idealistike ose edhe ma keq, personale. Në një atmosferë të tillë, profetët bahen të padishirueshëm, të bezdishëm. Atëherë rroftë çikuta. A s’ia dhanë edhe grekët Sokratit, kur demokracia e tyne degjenoroi në demagogji, në ateizëm e në sofizëm? S’i dëbuen jashta vendit fatosat e tyne ma të mëdhaj, si njerëz të rrezikshëm për hyjneshën demokraci? E a s’i kthyen me krye teposhtë fëtyrat ma të ndritunat, tue i quejtë herojtë gjaksorë e gjaksorët hyjni? Sepse kështu ua donte puna. Krejt njashtu si ndër ne!

Madje nuk jemi as të parët as të mbramët që e shtremb-
nojmë historinë. Ndër miliona faqe që janë shkruar mbi gur,
mbi tulla, tjegulla, papiruse, pergamenë, mbi metal e letër,
rrallëherë asht thanë e vërteta. Aq ma pak asht thanë në
letrat shqipe. Ka njerëz që besojnë se kështu krijojnë një
përfytyrim të denjë të Shqipnisë, për përdorim të jashtëm,
natyrisht. Tue harrue se të huejt nuk hanë bar. Ndërsa
shqiptarët e kanë rjepë tashma të tanë barin e pranverave
socialiste.

Por, të kthejmë ku qemë:

Vijova me i kaluar nëpër dorë fletët-perla, si kalohen
kokrrat e rruzares: ishin fletë të bardha, të verdheme, rozë,
jeshile, të reja e të breme, shkruar me kompjuter, me makinë
shkrimi, me dorë. Të shumngjyrshme, si i zoti.

Gjeta mes tyre edhe fillin ku duhet t'i përshkojshe.
Sa lexova rreshtat e parë, e kuptova menjëherë se shënimet
burojshin nga një revoltë e fuqishme, e jo ma pak nga ideja
se dikush duhet të trimnohet e t'ia tregojë këtij populli të
shkretë të vërtetën pikak, të djeshmen, të sotmen e atë që do
të vijë. Gjeta vetveten në faqet fluturake të librit, që nuk
kishte ende kurrfarë trajte. Lashë punë e zanatë, e iu
kushtova përshkimit të perlave të Dom Simonit në varg, me
bindjen se Shqipnia ka nevojë pikërisht për kësi guxim-
tarësh, që dashamirët i quejnë idealistë e atdhetarë; dasha-
këqijte; të marrë.

Ky libër u gatit pa kurrfarë shpenzimi. Por, kur erdhi
ora me pa dritën e shtypit, u duk rishtas se në Shqipni e
vërteta asht tepër e idhtë e se cenzura nuk asht fjalë boshe.
Prandaj priftit iu desht sërish me kërkue lëmoshë, siç bani
kur ndërtoi kishat e Mirditës, për me e shtypë në shtëpinë e
tjetërkujt. Natyrisht nuk shkoi me trokitë ndër dyer partish,

as grupesh, klasash a shtresash, që mendojnë se deri penda e mendimi i lirë mund të blehen me pare e me kolltukë. Larg çdo tundimi për kompromis, autori mujti ta ruente krijesën e tij nga gjithfarë përdhunimesh dhe të mbetej zotnia i saj, tue ia dhanë në duer lexuesit, ashtu siç desht: si çilc për leximin e jetës shqiptare.

Po kush do ta lexojë atë? Këtë autori e di mirë: do ta lexojnë me etje shokët e tij të mjerimit, me të cilët dau qelitë e kampet e përqendrimit, do ta lexojnë ata që u zgënjyen, u zvjerdhën, u përvnerën nga pseudodemokracia dhe komediantët e saj, do ta lexojnë të gjithë ata që duen me dijtë të vërtetën për sot e për nesër. Ndërkaq e di mirë edhe se kush do ta sulmojë: do ta sulmojnë ata që nuk duen të zbulohet loja e mbrapakuintave, që po përpiqen të ngrejnë në piedestalin e herojve, ish kriminelët, të cilët i hangrën kryet njeni-tjetrit në garën për pushtet e të krijojnë psikozën se komunizmi nuk asht ideologji kriminale, por e zbatueme në mënyrë kriminale, sepse i vumë në jetë nga kriminelë të dekun tashma. Ndërsa të gjallët. Autori ia njeh sistemit në të cilin jeton, të gjitha plagët e nuk ngurron t'i tregojë shqiptarit se ka vetëm një alternativë: të kthehet në kampin e përqendrimit ku ishte, ose të shkundë apatinë, të çlirohet nga psikoza e izolimit e t'i marrë në dorë fatet e veta, pa ndejë tue pritë çka po na vjen prej jashtë. Në gjithë rrjedhën e historisë, prej jashtë na ka ardhë veç vdekja, me njëmijë fëtyra, njëmijë duer, njëmijë gjuhë.

Revoltohet autori, dënon, mohon. Por revolta, dënimi e mohimi nuk mjaftojnë. Shqiptari ka nevojë për pohime, për propozime. E prifti nuk e mëson popullin me trokitë ndër dyert e të pushtetshëmve të tokës, për me kërkue lëmoshë, tue u luhatë herë nga lindja e herë nga

perëndimi. E mëson me trokitë në dyert e qiellit, me i kërkuë ndihmë Zotit të jetës, që ka në duer shartet e të mëdhajve e të vogjëlve. Njeriu që e ka mujtë persekutimin, me forcën e Atij që mujtë dekën, propozon me bindje të thellë e pa kurrfarë ngurrimi një qytetnim, që e ka përligjë vedin gjatë ma se dymijë vjet jetë: qytetnimin e krishtenë, qytetnimin e dashunisë e të jetës, të vërtetësisë e të drejtësisë: “Ku të shkoj, o Zot, vetëm ti ke fjalë jete së pasosun!”, asht pohimi që përmbyll librin, i cili shkruhet e botohet për Shqipërinë, që nuk asht vetëm Shkodra, por që te Shkodra ka pasë gjithnjë Rozafën e lirisë.

Nuk bana tjetër, veçse përshkova një grumbull perlash në varg. Shpresoj ta pasunojnë peshtafin e vorfnuem të letrave të sotme shqipe me një libër që e kallëxon picak të vërtetën.

Anza Shkodra
Shkodër, Gusht 2001

Autobiografi

Linda në Shkodër, më 5 Marc 1927. Prindët e mi, Zefi e Çilja, katolikë të devotshëm, i falën Kishës e Atdheut një martir intelektual, Dom Lazër Jubanin, helmue me arsenik nga policia sekrete komuniste më 1982.

Në moshën 16-vjeçare, i thirrur prej Zotit, hyna në Shkollën Apostolike për t'u ba jezuit. Në Marc të vjetës 1946, kur komunistat shqiptarë, nga frika e një përmbysje të shpejtë, suprimuen, sekuestruen e shkatërruen të gjitha shkollat katolike tradicionale, prej të cilave ka mësue me shkruar e me lexue mbarë Kombi, m'u desht me ndërrue vend e bankë. U ula, pa dashtë, në bankat e Gjimnazit të Shtetit, ku ende sot mësohet se njeriu asht majmun pa qime. Në vijim u transferova në Tiranë, ku kreu një kurs radio-rontgen. Mbasi punova për pak kohë në spitalin ushtarak të kryeqytetit, u mobilizova në ushtri. Mue, që dishrojshe aq shumë me u ba jezuit, misionar, predikatar i paqës ungjillore, m'u desht me veshë uniformën e gjelbër, me ngjeshë armën vrastare e me u nisë drejt kufinit jugor. Shpëtova gjallë nga konflikti civil në Greqi, ku më 1949, më vunë para si bagëtinë për të luftue krah për krah me komunistat e gjeneral Markosit, kundër koalicionit të Athinës. Mbas tri vjet vuetjtësh në ushtri, që në kujtesën teme mbeten njëlloj të tmerrshme, si ato të burgut, ktheva rishtas në Shkodër, ku u paraqita menjëherë te Imzot Ernest Çoba, të cilit iu luta me më shugurue meshtar. Ipeshkvi shenjt e martir më këshilloi të pres. M'u desht ta rifillojshe, për të fitue bukën e gojës, profesionin në radiologjinë e

Sanatoriumit të Shkodrës, ndërsa për ta mbajtur trupin në formë, sportin që më pëlqente aq shumë: atletikën e lehtë e jo ma pak edhe futbollin. Më pranuen menjëherë si anëtar të ekipit të Vllaznisë, e ma vonë edhe të ekipit kombëtar të futbollit, ku ishte trajner Aputin Boris, i trashit sovjetik me rrogë mujore 33.000 lekë, në një kohë kur nëpunësi ma i mirë shqiptar merrte vetëm 3000. Në vjetën 1957-1958, mora urdhnat e meshtarisë dhe u nisa në Mirditë si famullitar, për të mbajtur gjallë e në kambë fenë dhe kishat e dhetueme nga ateizmi. Tue pasë kenë gjithmonë arrë gunçe, iu kushtova apostullimit të hapun, sepse nuk më ka pëlqye kurrë me luejtë rolet e mbaskuintave. Por çka më pëlqente mue, nuk i pëlqente komunistave, të cilët më vunë prangat e më banë me u nisë për një rrugë të gjatë e të mundimshme, tue e lanë Mirditën me katër meshtarë.

Në këtë rrugë do të përshkohesha për 26 vjet me rradhë, tue lanë kudo gjurmë gjaku. Gjithnjë militant aktiv, ballë për ballë katilëve e spiujve të Burrelit, u lirova më 13 Prill 1989 bashkë me klerikë të tjerë, si në sajë të Perestrojkës, tue i mbetë borxh 14 vjet burgim Komitetit Qendror. Me çka thonë faktet, nuk jam aspak i sigurtë në se ky borxh tashma më asht falë e s'ka me m'u dashtë me e pague deri më një...

U ktheva përsëri gjallë. Në shtëpinë teme të vjetër, rranzë mureve të Rrëmajit, nën hijen e çinarëve e të selvive. Kjo shtëpi u ba menjëherë kishë, ashtu si ishin ba edhe banesat e 27 meshtarëve, teprue prej shpatës gjithnjë të mprehun të Enverit të cilit (po të mos isha meshtar katolik), do t'ia kisha shkruar edhe emnin me të vogël.

Derisa të marrë frymë, njeriu jeton herë në dritë, herë në hije, herë në të zezë, herë në të bardhë, herë në

thellësi humnerash e herë ndër rrethe të qiellit. Nëse ndonjë piktori do t'i tekej me e pikturue simbolikisht jetën teme, do t'i duhej me ble një kalë bojë të zezë. Pa harrue veç edhe ngjyrën e arit, sepse kudo që kam marrë frymë, terri asht ça gjithmonë nga rrezja e përditshme e Hostes shenjte.

Gjithsesi, me më pyetë cila asht dita ma e zezë, kisha me u përgjegjë pa u mendue dy herë: asht dita kur mora lajmin se më kishte dekë nana, mbasi kishte kja Dom Lazrin e helmuem e djalin e vogël, lidhun me zinxhirë, mbyllë në një birucë të largët, ku s'kishte mujtë kurrë me hy. Ma vonë më treguen se rrinte gjatë në dritore, zhytë në heshtim, tue shikjue malet që e ndajshin prej djalit të vet të vogël, të hekuruem veç pse besonte në Zotin e shpallte me za të naltë të drejtat e liritë e njeriut, nëpërkambë prej sundimtarëve të djeshëm, bash njatyne që po na sundojnë edhe sot pa u shqetësue fare me i mbyllë plagët e vjetra, madje tue u mundue me hapë sa ma shumë plagë të reja.

Sa do të ishte gëzue, po të kishte kenë gjallë deri më 4 Nanduer 1990, e të më kishte pa në kapelën e djegun të vorrezave të Rrëmajit, të sekuestrueme, të dhunueme e të shpalluna tashti monument kombëtar, ndriçue prej dritës së zbehtë të qirave të purgatorëve, tue kremtue të parën Meshë publike në praninë e 200-300 besimtarëve. Ishte një ditë e zymtë nandori. Cikërronte shi. Piklat rrëshitshin si lot nëpër petalet e luleve vjeshtarake mbi vorre. S'ishin ma lot mortit, po lot gëzimi. Lajmojshin epokën e re, lirinë e fesë, që filloi me një fjalim të improvizuem të një meshtari të laskaruem burgjesh, të kundërshtuem prej të huejve e prej të vetëve, i cili kishte në qafë vetëm stolën e breme tejet e ne dorë, misalin e vjetër latinisht. Kështu fillonte lidhja e fijes së këputun!

Java do të zhdukej me shpejtësinë e vetimës, për të afrue sa ma shpejt ngjarjen e madhe: 11 Nandorin. Gjithnjë në kapelën e Rrëmajit e rishtas në mjedis të terrorit komunist, kur dihej e s'dihej çka po ndodhte, e sidomos çka mund të ndodhte, kremtova Meshën e dytë publike, këtë herë me një fjalim të mirëpërgatitun, programatik, që thente heshtjen 23-vjeçare të katakombeve.

Erdhën mbas kësaj date ditë të bukura e të zymta. Liria, që besuem se ishte fitue, filloi me u tallë me vetvedin. Klasa politike shënoi në analet e historisë së këtyne vjetëve, vetëm shëmtime. Prandej, ndoshta, atmosfera e Meshës së parë mbeti e paharrueshme në zemrën e popullit, që po zgjohej. E ndoshta prandej përmendet me nderim të thellë e me lot në sy prej të gjithëve.

Për këtë kontribut të çmueshëm mbarëkombëtar, që Zoti ma besoi mue, të padejit, tue më ngarkue me barrën e kësaj sfide të rrezikshme, Universiteti i San Francisco-s në Kaliforni, në vjetën 1991 më akordoi diplomën “Doctor Honoris Causa” në shkenca humane me motivacionin: “Protagonist i një epoke së re në Shqipni”. Ishte një nderim që i bahej klerit katolik të martirizuem në Shqipni, një çmim që meriton të veket mbi vorret e martirëve të Kishës. Pak ma vonë, në Korrik 1996, shteti i Miçiganit më nderoi me diplomë të posaçme. Motivacioni: “Nismëtar i lirisë së fjalës dhe i shtypit katolik, që e ka zanafillën e vet në fletushkën e 20 Dhetorit 1990, në prag të Krishtlindjes; përshpejtues i të gjitha veprimtarive, që ia hapën shqiptarëve dyert e perëndimit; ndërtues i urave ndërmjet Tiranës e Vatikanit; ideator i misionarëve të parë, i bursave të para të studimit dhe ndihmave të para nga jashtë; meshtar që me fjalimet e veta sensibilizoi mbarë globin, tue ba të njoftuna vëejtjet

dhe rezistencën e popullit shqiptar kundër komunizmit dhe anarkisë që e pasoi”.

Jam i pari shqiptar i mbas-Perestrojkës, që asht thirrë në audiencë nga Papa Gjon Pali II, e që asht takue me shumë personalitete të tjera botënore, si mbreti i Belgjikës, Andreotti, senatorë, kongresmenë, ministra.

Jam i pari klerik pa kurrfarë gradet, që ftohet dy herë nga administrata amerikane në Washington, një herë nga parlamenti Rus, shumë herë nga Franca, Italia, Belgjika, Gjermania, një herë Spanja, Izraeli, Egjipti, Turqia, ndërsa kam refuzue me vizitue Kinën, Taivanin, Meksikën, Argjentinën, sepse mendoj se tashma roli em jashtë shteti në mbrojtje të lirive e të drejtave të popullit shqiptar nuk ka kuptim, përderisa nëpër kancelaritë e botës fjalën e fundit e thonë Klintoni me të shoqen e tashti Bushi Jr. Kur isha në birucë, pata besue se bota ndigjon ma shumë të martirizuemët për kauzën e drejtësisë, sesa katilat. Përvoja e daljes nga biruca nëpër shtigjet e mbarë botës, më bani fatkeqësisht, me ndërrue mendim!

Vijoj të shtegtoj me kënaqësi ndër Kishat motra dhe institucionet e tjera jo të krishtena, të përhapuna kudo nëpër glob, e vijoj të punoj me të gjitha forcat për Kishën katolike në Shqipni, si ushtar i thjeshtë i Krishtit. Me thanë të drejtën, kur kaloj disa ditë ndër vendet e shenjta përhapun kudo nëpër botë, rinohem së paku dhetë vjet, ndërsa pa u kthye mirë në Shqipni, plakem së paku njëzet vjet. E kështu, rinoju e plaku, zhyt e mbyt, po rrokullisen ditët e fundit të jetës seme.

Më ka pëlqye gjithmonë apostullimi i rrezikshëm, atje ku ateizmi ka hedhë ma shumë farë të së keqes, e ku si pasojë ka mbi egërsia, mënia, padija, krimi. Udhëtoj ditë-

natë nëpër rrugë lakadredhëse e mes për mes rrymës së fuqishme të Gjadrit, tue rrezikue shumë herë jetën e tue u përmbysë shumë shpesh me gjithë “ujkun tem të bardhë”, Toyoten e pashkatrrueshme, si i zoti. Me ndihmën e Zotit, kam temelue Kalivaçin pa rrugë, si një qendër vigane fetare, shendetësore, kulturore, sportive dhe kam sjellë për herë të parë në historinë e këtyne trojeve, katër murgesha dhe dy misionarë. Temelova edhe famullitë e Spitenit e të Kaftallit për t’u ardhë në ndihmë ma të vorfënve.

Nuk ia vlen barra qiranë me përmendë të hollat që kam sjellë për Kishat e Jubanit, Çelës, Hajmelit, për restaurimin e Argjipeshkvisë, të katedrales së Shkodrës e automjetet për kishat. E po ashtu edhe bursat jashtë shteti që kam sigurue për ma se njëqind të rij e të reja, intelektualë katolikë të së ardhmes, e mbi të gjitha, për formimin e murgeshave e të meshtarëve, tue ndejë mbas dyerve të ambasadave në shi e në diell, për t’u xjerrë vizat e tue rrahë dyert e botës për fëmijët tonë të talentuem, por të harruem e të panjoftun.

Baj pjesë në partinë e të vorfënve, të masakruemve, të viktimave të së djeshmes e të së sotmes. Kam le shkodran, po plakem mirditor. Po mundohem të ndërtoj, çka ka shkatërrue e vijon të shkatërrojë klasa politike. Që prej 1990-tës i kam ba me dijtë gjithë botës se shqiptarët kanë ra prej fulteres në prush. E mbasi kam lexue kujtimet e Boutros Ghalit, ish Sekretar i përgjithshëm i OKB-së, bashkohem plotësisht me mendimin e tij mbi rolin e soçëm të Amerikës. Antikrishti i ditëve tona, ajo po shkakton tepër shumë ngatërresa, gjak, lot e djersë prej Ruande në Ballkan, prej Shqipnie në Timorin Lindor.

Kam krye Universitetin e burgut komunist, ku vijova të mësoj çka deshtën me më ba me harrue kur më dëbuen prej jezuitëve. Mësova, pra me folë e me shkruar latinisht, greqisht, italisht, frëngjisht, anglisht. Më vleftën, sepse mujta me mbushë faqe të tana gazetash në gjithë rruzullin tokësor, me i ba shumë miq Shqipnisë, me i parafolë botës çka po ndodh në vendin tem, tue fitue kështu epitetin “Profetë”.

Më vjen me të vërtetë keq, kur shikoj se brezi i vjetër i paraluftës, në të cilin kam nderën me ba pjesë, asht shumë ma i kulturuem e i moralshëm se breznitë e mbasluftës, që i kanë xhepat plot me biljeta jeshile, por shpirtin, gjysë të zbrazun, me pak kulturë, shumë pak moral e edhe ma pak fe, sepse të degraduem prej ateizmit e pragmatizmit që sollën Konferenca e Jaltës (Shkurt 1945), televizori, shtëpitë publike, droga, diskotekat. Kjo s’asht pasuni, asht vorfnia ma e frikshme që ka pa ndonjëherë shpirti i njeriut.

Gëzoj shëndet të mirë mbasi, ndonëse pa dhambë, “ha për ditë nga një komunist”: po t’i kisha dhambët në rregull, “kishe me hangër” dhetë në ditë. E kështu, i ushqyem për së mbarit me ata që m’i thyen dhambë e dhëmballë, po i përdori të gjitha energjitë fizike e mendore për shërimin e plagëve që solli lufta, por sidomos mbas Lufta II Botërore.

Falenderoj përzemërsisht misionarët e misionaret që na ka dërgue Selia Shenjtë për rilindjen e Kishës në Shqipni, veçanërisht italianët të cilëve, tue kenë me kulturë qytetare kristiane, përfaqësues të një Kontinenti të pagëzue dhe të Kishës tradicionale në Europë, u takon t’ia transmetojnë të gjitha këto pasuni popullit shqiptar. Falenderoj edhe kosovarët, që kanë ardhë me punue në vneshtën e shparta-

llueme të Krishtit në Shqipni. Ata, në njenën anë mund të bajnë shumë, sepse dijnë gjuhën, por më anën tjetër, kultura e tyre len për të dishrue, e për kulturë kemi nevojë ndoshta ma shumë se për bukë, sepse kultura asht gurra e lirisë.

Kisha në perëndim mbahet nga ndihmat e besimtarëve, prandej nuk kam sesi të mos i kritikoj katolikët dhe jokatolikët shqiptarë, që pretendojnë me pasë gjithçka prej saj, sikur të ishte një multinacionale me bilanc pozitiv.

Në sajë të qarkullimit të lirë në botë, të emigracionit, sot gjendja ekonomike asht përmirësue shumë, në krahasim me epokën enveriane, që e kishte hjedhë popullin në humnerën e mjerimit.

Por, mjerisht në Shqipni po lind një plutokraci e bazueme në fitime të pista, e destinueme të falimentojë, si e ma keq se plutokracia e regjimit të vjetër, që ndihmoi ardhjen e komunizmit në Shqipni.

Për me ruejtë pamvarësinë e mendimit, nuk kam pranue grada. E këtë e provoj me dialogun e Nandorit 1990, zhvillue ndërmjet meshtarit kryenejçë me Sali Berishën, që ma kishte dërgue Komiteti Qendror i Tiranës së Kuqe, për të më bindë që t'i thoshte popullit prej elterit të Kishës të votonte për partinë demokratike. Shumkush u rrejt, por jo Dom Simoni, që la dhambë e dhëmballë ndër biruca, tue fitue, në shkëmbim një nuhatje aq të hollë, sa me e ndie menjëherë erën e gjakut, që lëshojnë komunistat, edhe atëherë kur ndërrojnë emën e lëkurë, kur flasin për paqë e progres.

Nuk jam njeriu i mitingjeve, por i elterit, i kumbonëve, i qirave, i Meshëve, i dialogut ekumenik. Mbes deri në dekë bir i padejë i Shkodrës historike, martire, demokrate, të panështrueme. Prej saj pranoj me përvujtni çdo gjykim!

Thirrja për rrugën meshtarake

Rruga e vërtetë e jetës seme fillon në vjetin 1943, kur Zoti më thirri për t'u ba jezuit.

Me kenë se shoku em ma i ngushtë ishte Tonin Harapi, me të cilin ndajshim të mirë e të keqe, natyrisht e poqëm bashkë edhe mendimin me ia kushtue tanë jetën Zotit. Kështu një ditë të bukur i thamë lamtumirë familjes dhe u nisëm: unë në Shkollën Apostolike, për t'u ba jezuit, Tonini në Seminarin Papnor, për t'u pa prift dioqezan. U rrethova menjëherë nga atmosfera shpirtnore, kulturore, e mund të thom me plot gojën, edhe atnore, në të cilën përgatiteshin filizat e ri të Shoqnisë së Jezusit. Për të ruejtë të shëndoshtë sistemin nervor, çdo mbasdite bajshim dy orë shëtitje në rrethinat e qytetit, kurse të dielën e të ejten, shëtitshim edhe paradite. Po mbarojshe gjimnazin klasik më 1944, kur erdhën në fuqi komunistat, që thirreshin ushtria nacionalçlirimtare. Na lindi të gjithëve kureshtja me e dijtë kuptimin e fjalës “çlirim”. Ndër kuptime që na interesojshin ne, ishte ky “çlirim don me thanë me u librue prej një së keqeje e me u ba i mirë!” Thue të ishte ky kuptimi i asaj që po ndodhte? Këtë do ta tregonte koha!

Kisha, e para që kishte krijuë laboratorin për studimin e virusit të komunizmit, lindë në Rusi rreth 1917-ës, na kishte përgatitë edhe ne për ta dallue menjëherë. Na kishte folë për luftat civile të organizueme prej komunizmit kudo nëpër botë. Na kishte krijuë mundësitë me lexue libra e me pa filma për Revolucionin Francez, për Luftën në Meksikë, për Patër Pro-në, për Luftën Civile në Spanjë më

1936, për pasanikët spanjollë, që shkrinë tanë pasuninë e vet kundër farës së keqe; kishin ndigjue për veprimtarinë e Huan Marces; kishim lexue librin me titull G.P.U. ku tregoheshin të gjitha mizoritë e policisë sekrete ruse kundër disidentëve, aristokracisë së vjetër, pasanikëve të ri e inteligjencies ruse.

Në të njëjtën ndërtesë me gjimnazin klasik, gjindej edhe seminari ndërdioqezan, në trapazin e të cilit seminaristi me shpirt luftarak, i padekshmi Mark Çuni me teologë të tjerë, tinzë eprorëve, shtypën traktin e parë kundër komunizmit, që u përhap në mbarë Shkodrën e përtej. Menjëherë mbas traktit, u dukën rrugëve lisat e gjata të të pushkatuemeve. Madje të parët u vunë para plotonit në mjedis të shëtitores, para syve të tmerruem të kalimtarëve. Kështu fillonte pushkatimi pa gjyq i njerëzve ma të mirë të vendit, i kundërshtarëve të vërtetë të paepun të komunizmit. Terrori fillonte kështu me urdhën të serbëve, që kishin për qëllim të nxitshin luftën civile. Për ta terrorizue Shkodrën martire të demokracisë së vërtetë, Shkodrën gjithmonë disidente, të pushkatuemet mbas murit të vorreve, te Zalli i Kirit, nuk i mbulojshin menjëherë me dhe. Madje, në kundërshtim me çdo normë të etikës kombëtare, organizojshin farsa makabre me kufomat, plot me plagë të llahtarshme, atje ku i kishte marrë breshnia e plumbave. Thashë ma nalt se shtrëpia eme asht pranë vorrezës, prandej unë e familjarët e mi ishim të parët që i ndigjojshim breshnitë e mordes, që vijshin nga Zalli i Kirit. E, a mund të ndalej “arra gungçe” pa vrapue me pa çka po ndodhte e kush kishte ra dëshmor nën plumbat e “çlirimtarëve”? Nuk mund të mos më përqethet shtati, sa herë e kujtoj, e nuk mund të mos e përsëris mija herë të njëjtën pyetje: “A mund të quhen

njerëzore, ata që na prunë komunizmin? Ata që, si hordhitë barbare u dyndën nga Jugu në Veri për të vu nën plumb inteligjencën dhe burrat ma të urtë të maleve, në një kohë kur mbarë bota tregon kujdesin ma të madh për njerëzit e ditun e të urtë?”

Ata erdhën e s’dijtën ma me shkue. Shkodra me pesë Malet e Mëdha humbi paqen e mbrendshme, bori qetësinë shpirtnore. S’dihej tjetër, veçse emna të vramësh, të varunsh, të mbytnsh me krye teposhtë ndër gropa nevojtoresh, si Dom Aleksandër Sirdani i Bogës e Dom Pjetër Çuni i Rrjollit. Këto ishin idealet e “çlirimtarëve” që nuk luftuen për liri, jo, po për pare e për poste, ideale këto të politikajve të djeshëm e të soçëm. Prandej, krahas pushkatimeve, filloi edhe grabitja e arit të tregtarëve, madje edhe të atyne që kishin ndihmue partizanët e Enver Hoxhës. Tashti po merrshin shpërblimin që meritojshin! Kush kundërshtonte me dorëzue arin, përfundonte menjëherë në birucat e sigurimit me gjithë familje; ose edhe ma keq: në burg mbylleshin burrë e grue, tue lanë foshnjët e djepit pa nanë pa babë. Më kujtohet një zonjë e re që e kishin flakë në qeli menjëherë mbas lindjes, vetëm sepse i shoqi nuk ndigjonte me dorëzue arin. Foshnjën ia bijshin tri herë në ditë policët për me i dhanë gji, sepse – thojshin – komunistat janë të drejtë, nuk e fusin në birucë edhe foshnjën e pafajshme bashkë me nanën fajtores! Ku shkoi vallë, gjithë ai ar i grabitun prej “çlirimtarëve”?

Shkodra filloi me “përparue” me shpejtësi të çuditshme. Kishte një burg të vogël, u ba me 15 burgje të mëdha! Kush mujte me dalë në perëndim, puthte tokën e huej, ndërsa mshehte në krahnuer një grusht dhe shqiptar, të lagun me gjak të pafajshëm! Në të vërtetë, kudo ndër

satelitët e Rusisë, komunizmin e kishin vendosë tanket ruse. Vetëm te na e sollën vetë shqiptarët, madje para Jugosllavisë, ku u nisën me turr për të shpejtue ngadhënjimin e bolshevizmit. Tremijë kosovarë, kundërshtarë të Titos, iu dorëzuen në besë Enver Hoxhës, me kusht që t’ua shpëtonte jetën, por “heroi” ynë i dorëzoi menjëherë në duer të sigurimit jugosllav, që nuk vonoi me i pushkatue. Po ky Enver Hoxhë ma vonë do t’i mbushte kosovarët me armë e shtyp kundër serbëve, tue u ba shkak për represione të egra kundër tyne. E megjithatë, kosovarët simpatizuen gjithnjë Enver Hoxhën e asnjëherë nuk u solidarizuen me vëjtjet e shqiptarëve nën komunizmin enverian. Një prej pasojave ma të idhta të kësaj simpatie të çuditshme, që shumë arsye të tjera mund të ketë, veç patriotizmin jo, asht sulmi kundër gegënishtes e autorëve gegë, pothuajse të gjithë klerikë e laikë katolikë, një pjesë e mirë të pushkatuem e të vorrosun bashkë me veprat e tyne! Turp për një vend që e quen vedin europian!

Mbas tri vjetësh në shkollën apostolike, mbasi na kishin kontrollue nja tri herë “çlirimtarët” e Enver Hoxhës, na përxunë pa na lanë me marrë asnjë libër, asnjë lapcë. Gjithçka u plaçkit ose u ba pronë e institucioneve komuniste. Bibliotekat e Shkodrës, ma të pasunat e vendit, të mbledhuna me kulturë e pasion, u grabitën. Libra me vlerë të pallogaritshme, u shitën ndër dyqane, si letër ambalazh. Çka teproi, u nis drejt Tiranës e Beogradit për t’u ba karton, sepse bibliotekat perëndimore nuk mund të ishin ma të pasuna se mendimi marksist. Prandej u zhdukën, si biblioteka aleksandrine.

Një park zoologjik, që quhet Shqipni

Me 29 Nanduer në Shqipni rivendosej sistemi skllavopronar, tue e kthye vendin në një park zoologjik. Por ndërsa niseshin nga Bashkimi Sovjetik telat me gjemba e përgatitej rrethimi me ta i kopshtit të ri zoologjik, mija shqiptarë mujtën me u arratisë, për me dishmue para botës së kulturue me komunizëm donte me thanë terror e mjerim. Realiteti do të provonte se komunizmi, i sjellun në trojet tona nga tringëllimi i rublave të arit në xhepat e serbëve Miladin Popoviq, Dushan Mugosha e shqiptarëve jugorë, do ta hidhte në erë jo vetëm Ballkanin, por një të tretën e botës. Sa u ndigjue zani i tyne? Cili prej shqiptarëve i njef sot relacionet e bazueme mbi fakte të tmerrshme, që u nisën jo pa flijime, për atje ku duhej? Askush nuk e ka marrë mundimin me i botue, me i njoftë, me xjerrë mësimë prej tyne! Fakti që ndejëm 50 vjet nën thundër, flet vetë. E do të kishim ndejë edhe 500 vjet, ashtu siç e kemi pasë zakon, po mos të kishte krisë e bumbullue ndër të tjera horizonte.

Trauma të cilën e pësoi populli shqiptar nga shqiptarët që sollën komunizmin, kje ma katastrofike se ajo që shkaktoi pushtimi turk në shekullin XV, sepse në atë kohë të largët, kush nuk desht me iu nënshtrur osmanllisë, hypi në barkë, kaloi Adriatikun e vijoi jetën e zhvillimin normal në Itali e në vise të tjera të Europës e të botës, tue i dhurue disa vepra të mëdha në të gjitha fushat, qytetnimit e kulturës botënore, ndërsa në dhe të parëve dendej terri ma i zi i injorancës. Kush s'mujti me pështue tue kalue detin, pështoi tue u ngjitë në majë të shkrepave të Dukagjinit, të

Malësisë së Madhe, të Mirditës, të Pukës e të Lezhës, ku ruejti fe e kanu, doke e zakone e identitet europian. Të dytëve, të cilët nuk e patën të lehtë, si të parët, iu desht me ba flijime të papërshkrueshme. Jetën ndër shpella në fillim, mandej i ndërtuen pak nga pak tbanat në maje të shkambijve, buzë humnerave, si shqipet e malit, për me kenë gjithmonë të mbrojtun nga rreziku i anmikut. E kështu, ndër shkrepave, valoi përherë një flamur i vetëm, që s'u zëvendësue kurrë me tjetër, veç për me fitue rybe¹³ e nderime prej pushtuesit. E sot po na thonë e po na shkruajnë se këta njerëz kenkan malokë të trashë, me zhalloga, që s'dijnë çka asht qeverisja, të mësuem siç janë me u vetëqeverisë si ujqt e si shqipet, sepse tue mos pasë pranue, me çmimin e jetës, në maje të shkrepave të tyne, asnjë farë bashkëpunimi me pushtuesit, natyrisht që nuk patën kurrë vend ndër qeverina, as ndër parlamente, as atëherë e as sot. E po na kenka nderë e lumni me pasë trathtue vendin tand, gjuhën tande, zakonet e sidomos fenë tande, tue bashkëpunue me ata që janë ulë kambëkryq në votër për me të shnderue me grue e me motër, veç për me xanë një vend në pope të qeverisë, natyrisht tue punue simbas dëshirave e interesave të pushtuesit. Prandej sot e mot veç ata po na ditkan me qeverisë, tue ia vu pa pikë turpi kambën herojve të heshtun, atyne që mësuen në shkollën e shqipeve si mbrohet liria, atyne që për pa u vjerrë kortarë ndër kërraba s'i banë knjazëve tungjatjeta. Derisa të qeveriset vendi me këtë filozofi, qeveritarët tonë të dalun prej kënetave të turkut, kanë me i ba tungjatjeta gjithkujt, tue vijue mësimet që i morën në shkollën e komunizmit, i cili ia bani vendit ma zi

¹³ *Dinjitet*, simbas Fj. Bashk., 375.

se turku. Tue e rrethue Shqipninë me perden e hekurt, komunistat ia mbyllën mirë e mirë rrugët të gjithë anmiquë të tyne, që do të kishin kalue me kënaqësi detin, për t'u bashkue mbatanë¹⁴ me kushërijtë e ikun qysh kaheër e mot... Mandej t'iu qepën maleve e ia dolën me u ngjitë, aty ku turqit s'kishin mujtë kurrë. Thjesht sepse shqiptarë, e s'u shkoi në mend malësorëve të thjeshtë e të çiltër se shqiptari do t'ia bante shqiptarit ma zi se osmanllia, tue shkaktue vëllavrasjen deri në genocid radikal, tue shrrajosë besë, tue prishë fe, tue çartë ndore e tue mbjellë, në vend të tyne një korrupsion që s'e ka njoftë kurrë historia. Traumë psikologjike kjo, që ka me lanë gjurmët e veta për shumë shekuj në shpirtin e shqiptarit, më sa na vajtojmë e çuditemi, si s'u ndreq kurrëgjia tash dhjetë vjet që ka ra komunizmi. E gjithë kësaj shtoj ndikimin e tmerrshëm të televizorit. Për me harrue traumat e shkaktueme prej vëllazënshe, shqiptari hangri bukë thatë e bleu televizorin, e ia nisi me kullotë paksa sytë e me harrue. Ishte një lloj dehje e përnatshme, e sigurueme me flijime të mëdha, sepse edhe me rrezikun e burgimit për ndjekjen e programeve të hueja televizive. Kështu, çka la pa ba komunizmi, e plotësoi e po e përkryen televizori, tue gatue një rod shqiptarit të cilit ia gjen shoqin veç ndër parqet zoologjike të botës.

Prandej tregojnë:

Në parkun zoologjik ma të madh të një kryeqyteti europian u paraqit një shqiptar i papunë. Pyeti nëse mund të gjindej një vend i vogël për të. I thanë se aty punë kishte boll. Varej prej tij me pranue ose jo. Shqiptari s'u besoi

¹⁴ Atrofizim arkaik i *mb(ë)+at(ë)+anë*, që ka sjellë përngjitjen e mavonshem *matanë*.

veshëve. Kishte punë boll, po çfarë pune se? Ishte gati me pastrue kafazet e shtazëve të egra, me u dhanë me hangër, me i mjekue. Me i dashtë, madje. Por jo! S'ishte fjala për punë kësisoji, të xanuna kaheër e mot prej të tjerëve. Ishte fjala me u veshë me lëkurë majmuni, me hy në një kafaz e me luejtë rolin e gorrilës, që parkut zoologjik i mungonte. E meqë kushtonte shumë ma tepër me e ble e me e ushqye, kishin mendue me e zëvendësue kësisoj. Por deri atëherë askush s'e kishte pranue propozimin. Ndonëse komunizmi asht mundue boll qyqari, me na e shti mirë në krye se jemi stërnipat e majmunave.

Shqiptari e ndjeu vedin të lumtun: nuk e kishte aspak të zorshme me e luejtë këtë rol. A s'e kishte luejtë tanë jetën në skenën e atdheut të vet, shndërrue kahmot në park zoologjik? Pranoi pra, menjëherë, e si e mbyllën në kafaz, t'ia nisi me zellë e qejf me luejtë rolin e ri, sa ia kaloi edhe vetë gorrilës. Kështu kafazi i tij ishte përditë i rrethuem prej turmave të fëmijëve, madje edhe të rritunve. E kësisoj po mendojshin edhe me e dekorue si gorrilë shembullore. Një ditë, ndërsa hidhej e përdridhej, ngërdheshej e shpërvilej, i rrëshitën të dyja kambët, e lëshuen duerët e shkoi e ra rrokoll e fillë e në kafaz të luanit. T'ia dha brimës sa ku i hangri zani. E tue harrue tana gjuhët e shtazëve e të njerëzve, përveç gjuhës amtare, bërtiti shqip: “Ndihmëëëë! Ndihmëëëë!” E ndërsa zgurdullonte sytë prej hataje, tek i afrohej luani, ndjeu një za që delte prej gojës së tmerrshme të bishës e i thotë në gjuhën zyrtare shqipe: “Pusho, ore budalla! A po do që të na pushojnë të gjithëve menjëherë nga puna e ta humbasim edhe këtë parajsë!” Ishte një shqiptar tjetër, që i kallëxoi menjëherë se të gjitha kafshët e parkut ishin shqiptarë e e kishin quejtë atë vend, ku e

fitojshin bukën e gojës pa kurrfarë mendi, “Parajsa komuniste”.

E mandej kundërshtarët vijnë e na thojnë se shqiptari nuk paska përfitue kurrëgjia prej shkollës së komunizmit! Ta tregon puna vetë se asht në gjendje me luejtë rolin e tana shtazëve të buta e të egra! Vetëm rolin e njeriut vonë e herë ka me mësue me e luejtë.

Natyrisht kisha katolike nuk mund ta pranonte të mbyllej mbrenda telave të parkut zoologjik komunist shqiptar, bashkë me njerëzit bisha, kryevepra të komunizmit. Komunistat e dijshtin mirë se tiparet themelore të njerëzve të Kishës ishin trimnia dhe guximi për t’u vu ballë për ballë botënisht me çdo të keqe, që mbin si këpurdha mbas shiut prej mbretnisë së djallit. Kështu që, kur ra mbi ne shplaka sovjetike, ishim të mirëpritun me e përballue, sepse kryqëzatat kundër bolshevizmit i kishim fillue qysh më 1917. Por, me gjithë lutjet, flijimet, gjakun e martirëve, rolin e shtypit, të konferencave, nuk mujtëm me ia ndalue hovin. Na u desht me ngarkue kryqin e me iu ngjitë Golgotës! Zoti na vlerësoi aq, sa me na përgatitë të njëjtën rrugë, të njëjtën kryqë që kishte përgatitë për të Birin e vet Hyjnuer!



Në Tiranë në 1947

“Me institucionet katolike në Shqipni, nuk mund të ndërtohet komunizmi!” thojshin “çlirimtarët” e rij. Një vjetë mbasi u mbyllën shkollat katolike (1946), shkova në Tiranë për të krye një kurs radiologjie mjekësore: isha vetëm njëzet vjeç, me të tanë dhambët në gojë, e me tanë flokët, e të tanë të zij, në krye! Prej shkollës së Jezuitëve – në shkollën e shejtanit. Nuk mund pra të mos më fillojshin tundimet. Për herë të parë u ndodha në një shkollë, në bankat e së cilës uleshin bashkë djelm e vajza. E për herë të parë, tue ba praktikën e radiologjisë, pashë djem e vajza lakuriq, picak! Tri herë në javë vinte mësuesi i vallëzimit me na mësue me këcye tango, valcer, rumba! Si nisi s’krisi! E kulmi mërrijti kur një ditë prej ditësh, në radiologji prunë për vizitë femnat e shkollës së korrektimit, sepse thohej se regjimi komunist do t’i edukonte edhe ato pak prostituta që na kishte lanë si trashëgim regjimi i vjetër. Ku e ku ma pak se ato që trashiguem prej regjimit të ri! Ishin vetëm 30, nga gjithë Shqipnia. Sa për mashkujt, të cilët i kishin degjenerue deri në këtë pikë, nuk i njihte kurrkush, kurrkush nuk i dënonte.

Tundime gjithfarësh, prej të cilave ndoshta nuk do të kishe shpëtue, po të mos ishte ende e hapun kishëza e spitalit, spitali i shpirtit, që po epte shenjat e para të sëmundjes. Asokohe në korridoret e gjata të shtëpisë së dhimbjes, endeshin ende engjujt e bardhë, murgeshat, shumica të hueja. Pritej të mbaronte kursi njëvjeçar, në të cilin përgatiteshin rreth 500 infermiere shqiptare, për t’i riatdhesue menjëherë motrat, që shumkujt ia vritshin sytë,

aq sa me dekë me shikimin plot urrejtje ngulë tek kryqi që rrezatonte në ballin e tynel! Murgeshat kishin kërkuar lejen e kremtimit të përditshëm të Meshës. Për ta në kishëzën e spitalit çohesh përditë Mesha e Shenjtë. Natyrisht, edhe unë shkojshe për ditë me marrë kungimin, kundërpeshën e patrandshme të pasioneve të shfrenueme, të epsheve e të instinkteve që e kafshojnë e e kafshërojnë njeriun. Kungohesha e lexojsh, me bindjen se vetëm feja e kultura mund të më shpëtojshin në atë kaos, në të cilin ishte zhytë Tirana, që po kalonte prej perëndimit, në lindje; prej së mirës në të keqe; prej dritës në terr të verbët!



Martiri Imzot Ernest Çoba

Martiri i madh, Monsinjon Ernest Çoba, optimisti ma frymëzues që kam njohur në atë kohë terrori, që me atë buzëqeshjen e vet të amshueshme dhe me fjalën e tij të ambël ka shërue mija zemra njerëzish në atë epokë të vështirë, edhe pse i rrethuem nga hagepat e sigurimit kudo të pranishëm, hyni në historinë e Kishës Katolike në Shqipëri sa për shenjtinë e tij, aq edhe për rezistencën heroike ballë për ballë diktaturës.

Në mjedis të terrorit, në maj të vitit 1958, organizoi kremtimin e njëqindvjetorit të ndërtimit të Katedrales së Shkodrës me një ekspozitë madhështore, të papërsëritshme, sepse menjëherë mbas, hunët e Tiranës morën të gjitha masat për t'i zhdukur të gjithë dokumentat, që në një fazë kur flitej për jetë a dekë, dishmojshin madhështinë e veprimtarisë së Kishës katolike në shërbim të Kombit. Dita e këtij kremtimi u shty shumë herë nga Prelati, sepse siguri organizonte piknikë, aksione e mbledhje nga ma të ndryshmet në të njëjtën datë e orë, tue i detyrue të marrin pjesë në to, të gjitha shtresat e popullsisë. Shtyj e shtyj e ma në fund Prelati triumfoi. Një të diele, shteti komunist u detyrue ta lente të qetë popullin, i cili ishte përkulë më dysh nën peshën e angarive që skllavopronarët e rij i ngarkojshin pambarimisht mbi kurrizin e tij, pa e kursye as në ditë të diele, sepse e dojshin gjithnjë të inkuadruem, për ta kontrollue e për ta torturue, që t'ia largojshin kështu vëmendjen nga rrëzimi i këtij farë shteti.

Për katolikët tashma persekutimi bahet një dekor, kthehet në guxim e nxitje, shton devocionin ndaj fesë. Besimtarët e ndiejnë vedin si të krishtenët e parë!

Më kujtohen edhe sot autobusat që ndaleshin para Katedrales, mërrijtë prej Tirane e prej Durrësi, ngarkue me besimtarë të veshun shik, që kishin ardhë me marrë pjesë në këtë ceremoni të paharrueshme, e cila inkurajoi dhe mbushi me entuziazëm të gjithë popullin, në mes të persekutimit. Por fatkeqësisht këtë ngjarje do ta shfrytëzonte edhe Komiteti Qendror për t'i thanë botës: "Jemi shtet demokrat dhe e lamë të lirë Kishën". E këtë komedi do ta luante, sa herë t'i leverdiste.

Ndërkaq Kisha vorfnohej çdo ditë e ma shumë nga internimet, burgosjet e vrasjet e meshatrëve, që veheshin pa mëshirë para plotoneve, si spiuj të Vatikanit. Megjithatë, atë ditë të paharrueshme, mbarë Kisha e gjallë, besimtarët, ishin aty, të pranishëm. Spiujve të sigurimit, që ndiqshin kremtimin, u duel punë me numrue të 5000 vetët që kishin mbushë katedralen, pa llogaritë besimtarët e Arrës së Madhe, të Gjuhadolit e të Ballabanës. Ishte kjo grigja guximtare që udhëhiqte ipeshkvi i butë, Monsinjon Çoba. Besimtarët lëvizshin në heshtje, plot devocion e mahnitje, tue shikjue zbukurimet e katedrales. Ndaleshin posaçërisht para shtyllave, ku ishin pikturue pamje nga dy Testamendet. U bante përshtypje një pikturë e mikut tem, Ismail Lulanit, që kishte pikëzue Kullën e Babelit, tue pikturue edhe portretin e vet në atë mishmash e konfuzion, i cili që më atëherë, e deri më sot, mbetet simbol i Shqipnisë sonë.

Përrjashta, anekand mureve të katedrales, në stenda të mëdha, vareshin mija dokumenta e fotografi, që pasqyrojshin themelimin e historikun e katedrales. Ishte aty edhe

kompozimi me temë “Vendosja e gurit të parë të Katedrales”. Vepra kje nisë prej piktorit të njoftun, Simon Rrota. Por mjeshtri ishte detyrue me e lanë përgjysë, sepse kje thirrë në Komitetin Ekzekutiv prej Sadik Ramës. E nisi Simoni, e përfundoi Patër Leon Kabashi me Dom Injac Demën. Vepër simbolike kjo, me tre autorë, që dëshmon në ç’rrugë po hynte arti ynë kishtar, në fasha. Piktura përfundoi në bodrumet e Muzeut ateist, për të dalë në dritë, shumë e damtuemee nga lagështina, kur, së bashku me besimtarët, u liruen nga burgu komunist edhe shenjtënt e shenjtëshat, njëlloj të shkatërruem. Piktura ndeji disa kohë në shtëpinë teme, mandej e dorëzova në argjipeshkvi. Mbas restaurimit u var, e zvogëlueme, në presbiter të Katedrales.

Sigurimi kujtonte se më 1958 e kishte bindë grigjën e udhëhequn nga Monsinjon Çoba që të mos shkonte ma në kishë, por të merrej me dokrrat e Enverit. Erdh kështu Maji, mueji i Zojës. Imzot Çoba caktoi si predikatar Dom Tish Lisnën. Predikimet e tij, me oratori të jashtëzakonshme, e elektrizuen Shkodrën. Pjesëmarrja në ceremonitë fetare kje pesëfish ma e madhe se vitet tjera. Organizatat e partisë u shqetësuen shumë, sepse nuk kishin dijtë me e tërhjekë popullin me thanë-e thaçat e marksizmit. Me këtë rasë morën një kritikë të randë nga diktatori, i cili u çudit e u mrekullue me këtë guxim të popullit katolik dhe e kapi frika e tmerrshme, sepse nuk ka ma tutës se tirani, që jeton tue ba zollume e anmiq, tue vra majtas e djathtas. E sa ma shumë ban keq, aq ma tepër pushtohet prej ankthit e pasigurisë, sepse e din se mbas krimit, vjen hakmarrja. Mësim i thjeshtë historie ky.

Raprezalja u gatue në Tiranë, simbas parimit të centralizimit diktatorial. Shkodra martire, Shkodra demokrate,

duhej ndëshkue. Ndër mbledhjet e partisë u tha se dyndja e katolikëve ndër kishat, tregonte se ata ishin të pandreqshëm, se duhet ta kuptojshin që mbas veprimeve të tilla vjen dhuna, se po prishnin rreshtat. Kur në mbledhje u lexue raporti që kishte dërgue Shkodra, ku shkruhej se në kremtim kishin marrë pjesë mbi 20 mijë besimtarë vetëm me një fjalë të Imzot Çobës, e se të gjithë kishin shkue në Kishë veshë e mbathë me teshat ma të mira, të qeshun e plot humor, si të mos ekzistonte salvimi, pa llogaritë pastaj se 40 priftën predikojshin nga amvona tanë ditën, tue folë me aq zjarr e mjeshtri sa me hipnotizue auditorin, që e harronte fare për ato çaste diktatin... njeni e ndërpreu leximin e tha: “Po sikur të na e sulmojnë degën e punëve të brendshme, komitetin ekzekutiv e komitetin e partisë këta 20 mijë civila, ç’do të ngjiste? Do të na e merrnin menjëherë pushtetin!” Një tjetër marksist i flaktë, shtoi: “Si nuk e kuptojnë se pas kësaj periudhe tranzitore, pas rradhëve të gjata të njerëzve që presin për të marrë një copë bukë thatë, që jetojnë ndërmjet pislëqeve, ne do të sjellim një bollëk të paparë..”

S’ka! Katolikët duheshin ndëshkue. Dhe së pari duhej ndëshkue ai që i udhëhiqte, Ipeshkvi Çoba! Por ky arrest duhej motivue mirë, që të mos çohet peshë opinionin botënor, i cili s’prante tue përsëritë me terr emnat e rradhëve të gjata të të pushkatuemeve, tue theksue se gjithë artilleria komuniste ishte drejtue kundër Kishës katolike.

Nuk do të vononte e prangat e farktueme prej kohe në Tiranë, do të shtrëngoishin duert e Ipeshkvit Shenjt, që do t’i përballonte torturat me një shqetësim të vetëm: me i përgja sa ma shumë të Kryqëzuemit!

Gegë e Toskë, janë një komb, me u da s'duron!

Nuk e ka thanë ndonjë toskë këtë, e ka thanë një gegë i madh, një meshtar katolik, Dom Ndrë Mjedja. E vuna në krye të këtij kapitulli, që ta kuptojnë kuartë e menjëherë të gjithë se gegët nuk kanë pasë e as nuk kanë kurrfarë mënie kundër toskëve. Përkundra! As nuk kanë ndër mend t'i denigrojnë Toskërinë e banorët e saj, shqiptarë njëloj si veriorët, vëllazën gjaku e mjerimi. Po njëkohësisht nuk mundem as me mshehë disa prej fakteve të idhta e kryeforta historike, që na flasin vetë, e na tregojnë se në planet e diktatorit e të diktaturës, Gegënia ishte e paracaktueme me u zhdukë, me gjuhë, me identitet e me tru. Prandej sot nuk del kurrkush me mbrojtë identitetin e Veriut, dikur si mal me borë e si fushë me lule, e sot veshë me crule!¹⁵ Krimet ma të shëmtueme të komunizmit u kryen në Veri, e sigurisht, jo nga veriorët. E as nga jugorët e ndershëm, që gjithashtu jetojshin me krye në rrezik, ndonëse ishte balli i katolikëve ai që u vu së pari në shënjestër të komunistave.

Tue ndie për ditë ankimet e katolikëve, që merreshin nëpër kambë, priteshin në besë, vriteshin, inter-noheshin, u digjeshin kullat, shnderoheshin, Tuk Jakova, ky marangon i thjeshtë, u ba simbol i rezistencës së Veriut, u flijue për Veriun, bir i të cilit ishte, të cilit i përkiste. U identifikue pra me katolikët, e bani të vetën nëpërkambjen

¹⁵ Parafrazim i poezisë së Pashko Vasës “O moj Shqypni”; *crule*: zhele khs. Fj. Bashk., 480.

e tyne, u solidarizue me mish e me shpirt jo vetëm me katolikët, tue kenë vetë katolik, por me gjithë veriorët dhe guxoi me ia thanë ndër sy, gegënisht e tokënisht diktatorit, se çka po bante në Veri. Atëherë ai e mbyti.

Gegënia hupi të vetmin dalazotës në qeveri. Mbet e vejë, si grue pa burrë – si thotë Vaso Pasha. Diktatori nuk u ngi tue e vra, tue e djegë e tue e pjekë Gegëninë, por ia preu edhe gjuhën! E di se shumkush ka me u tërbue kur të lexojë këta rreshta, ka me ia fillue avazit të moçëm të përçamjes, që del në skenë sa herë kundërshtarët tonë kanë nevojë për të, sepse ende sot Gegënia asht ndër çapoj të vrasësve të vet e të shërbëtorëve të tyne pseudoakademikë. Madje, ndonjë prej tregtarëve gjenialë të flamujve, që i çilë përditë tarabat në zemër të Europës, ka me përsëritë me inatin e zakonshëm kundër gegëve: “Doli edhe një matuf tjetër me na hapë avazet e vjetra!” Po, more zotni, doli e ka me dalë prap e prap, derisa të mos t’i vehet në vend nderi Veriut e t’i kthehen të gjitha të drejtat, në rradhë të parë gjuha e preme, të cilën megjithatë edhe sot e kësaj dite vijon ta përdorë: tue e folë me gishta, kur s’mund të artikulojë. E edhe eshtënt e bijëve të lavdishëm: Koliqit e Camajt, që vërtetojnë se Gegënia e pushkatueme te Zalli i Kirit, mbijetoi lumnueshëm në vise të tjera. E kështu zotnia juej nuk keni nevojë me shkue në Mynih për me ba kinse doni të nderoni eshtënt e një biri të Veriut. Madje jetoj me shpresën se ka me dalë një bir besnik geqe me e shkruet të vërtetën mbi tragjedinë e këtyre trevave, tue korrigjue kështu keqeshkrojtën e historisë së Shqipnisë: Sidoqoftë, unë që s’jam trembë në burg para mjeteve ma të tmerrshme të torturave, s’kam pse trembem nga disa gjuhë gjarprijshe që kanë me më fishkllue se po mbjelli sherre ndërmjet

krahinave, për bashkimin e të cilave u luftue në shekuj... Ashtu mendoj edhe unë, veç bashkimin e kuptoj disi ndryshe: me të gjithë vëllazën e shokë, por secili zot në shtëpi të vet, me gjuhë e me gjini të vet! Pse iu imponue dialekti toskë gjithë Veriut, tue përfshi edhe Kosovën? Duhet thanë e pranue një herë e mirë e vërteta. Ishte edhe kjo pjesë përbase e luftës ndërmjet Lindjes së kuqe e Perëndimit katolik. Tue kenë se na katolikët, kemi kenë gjithmonë historikisht të lidhun me perëndimin, filloi kundër nesh dueli i madh: në shesh të mejdanit u ndesh balalajka¹⁶ me *Lahutën e Malcís*, përmes së cilës Patër Gjergj Fishta, qysh shumë kohë para se t'i kërcënohej komunizmi sllav trojeve shqiptare, paralajmëronte se dreqi i kuq, që e kem' kojshi, po prehte thojtë, me të cilët do t'ia zhvatëte pa mëshirë Veriut, e jo vetëm, mish e shpirt! Gegënia e mjerë u vu ndërmjet dy zjarreve: sllavit e të vetit të shitun te sllavi. E punët u rrokullisën si u rrokullisën pikërisht për me zhdukë autorët e Veriut, mendësinë e tyne, fenë, kulturën, sepse kulturë veriore ka dashtë e don me thanë kulturë perëndimore. E këtë nuk mund ta mohojë askush, sado të mundohet me mbulue të vërtetën me parullat e një patriotizmi shterpë e të një bashkimi të naltuem mbi krimin e pandëshkuem. Kur të ndëshkohen para historisë krimet që janë ba kundër Gegënisë tash një shekull, vetëm atëherë bashkimi i shqiptarëve do të jetë një realitet i bukur e i qëndrueshëm. Po kjo sot duket krejt e largët, në mos po e parealizueshme, përderisa kodi genetik, geni, kromozomi asht tronditë deri në atë gradë prej ateizmit, terrorit, tensionit të vazhdueshëm, punëve të randa e mandej edhe

¹⁶ Instrument muzikor rus (trekordësh).

prej marrive të televizionit, sa po të thuesh të vërtetën, të vërsulen të tanë mbi shpinë, e të pamësuem sikurse janë, të sulmojnë me arsyen e mosarsyes deri në atë shkallë, sa nuk ke kurrfarë mundësie të skjarohesh. Qorra siç janë, kishin me dashtë me t'i qorrue edhe ty të dy sytë, për me u ndeshë në kushte të barabarta. Ose kishin me dashtë me të ngrehë në shpellën e errët të arsyetimit të tyne, ku s'shihet kurrnjë rreze arsyeje as vërtetësie.

Këtë çashtje, që natyrisht ishte pjesë përbase e vuejtjeve të mia, e kam ndjekë me vëmendjen ma të madhe atje, mbas hekurave. Isha përherë i lidhun ngushtë me situatën, ndoshta shumë ma tepër se ata që jetojshin jashtë, të cilët, përherë të xanun me marrinat që s'prante tue shpikë regjimi, s'kishin as kohë e as dishirë me ndjekë botimet e kohës. E botimet nuk kanë mungue, tue nisë prej shypit e tue përfundue te përpjekja me shkruë një histori, në të cilën edhe titulli “Historia e Shqipnisë” asht një rrenë me bisht. Ashtu mund të thomi edhe për shtypin: tregon një gazmore: “Në shtypin shqiptar vetëm titulli i gazetës asht i vërtetë; gjysë i vërtetë – moti sot e nesër, të tjerat more zotni, janë tana rrena!” Sidoqoftë, për atë që di me lexue ndërmjet rreshtave, në shtypin komunist gjindeshin njoftime të bollshme për gjithçka që të interesonte. Pa në kandvështrimin krejt të kundërt me atë zyrtar, natyrisht. Paraqet vërtet interes leximi i varianteve të panumërta të asaj që quhej “Historia e Shqipërisë”, e cila e gjora, ndryshonte tepër shpesh, ndonëse disa prej ngjarjeve ishin krye vite a shekuj ma parë. Botohej e ribotohej thjesht për t'u spastrue prej ndikimeve perëndimore e sidomos për të shlye prej saj kontributin e pamohueshëm të klerik katolik e parinë e Veriut në ngjarjet kryesore të historisë së Shqipërisë!

Gjithsesi klika e Tiranës i ngjiste atij fukarasë, që në përpjekjen për të mbulue kryet me jorganin e vet lecka – lecka e bira – bira, zbulon herë kambët e herë krahët, pa llogaritë se i hyn të ftohtit prej tana anëve. Kështu ka ndodhë edhe me Fan Nolin. Tue botue veprën e tij, shtypi i Enver Hoxhës na e la trashigim si agjent rus deri në frymën e fundit, e edhe ma zi si njeri për të cilin feja s’ ishte tjetër, veçse mjet për t’u pasunue. Mjafton me lexue botimin e parodisë së tij kundër Biblës, që ta mbushë plotësisht mendën se Teofan Mavromati e shkriu tanë inteligjencën e talentin që i kishte falë Perëndia, pikërisht për të luftue kundër Perëndisë, në shërbim të të cilit ishte vu, tue krijue kështu paradoksin nolian, që fort rrallë nuk asht as në historinë e as në letrat tona. Ky marifet për ne “gegët e trashë” s’asht tjetër veçse aftësia me i ndezë një qiri dyllit Zotit, e një tjetër vjamit, djallit. Për me e pasë mirë me të dyja palët, more zotni! Sepse realiteti tregon se njeriu ka nevojë herë për Zotin, herë për shejtanin, përndryshej pëson gjithë jetën si na, që s’pranuem kurrë me ndezë qira në elter të diktaturës, ndonëse nuk asht ndonjë dije e vështirë.

Ky shkrimtar i madh, pra, ky dijetar ndër ma të njoftunit, cilësi që nuk e kemi fare ndër mend me ia mohue, veshë me raso të zezë e me Kryq të madh në gjoksin ku i rrihte një zemër e kuqe, çoi gjithë jetën Meshë në elter të shejtanit, tue u ba shërbëtor i keq i perandorisë së Kremlinit. Iu kundërvu kështu perëndimit e bashkë me të, edhe Gegënisë, ashtu siç kanë veprue të gjithë shërbëtorët e shejtanit, dje e sot. Kështu pra shkrimtari i madh, i shan gegët si të mbrapambetun, vetëm pse këta kanë qenë, janë e do të jenë përgjithmonë e jetës antikomunista. Ndërkaq (ndërsa na që duhet ta mbrojshim Gegëninë e kishim si e

kemi gojën të qepun me telin e të huejve e të tonëve), na shërbente vetë shtypi enverian, tue sjellë prova që vërtetojshin se kryepeshkopi ortodoks ka ngranë sa ka mujtë pare prej Kremlinit, prej Zogut e prej Enver Hoxhës. Prandej kje vu me zell e qejf, ma zi se kosovarët, në mbrojtje të diktatorit në arenën ndërkombëtare, ku edhe kishte njëfarë zani.

Po nga shtypi komunist del se Ismail Qemali, ka kenë nën ndikimin e fortë të të huejve, se ka mbajtë një fjalim që s'e njeh kurrkush, sepse nuk asht botue kurrë, e se fillë mbas një ngjarje kaq të madhe për fatet e Shqipni-kërcunës, asht zhdukë prej skenës politike. Ndërsa mbulonte me lëvdata Ismailin e orientuem kah sulltanët, Enver Hoxha shante Faik Konicën, pikërisht sepse Konica shkriu gjithë jetën për një Shqipni europeanoperëndimore e ndoshta jo ma pak, sepse ishte edukue në Shkodër, e në gji të etënve jezuitë, të cilët i dhanë atë përgatitje, që i krijoi mundësitë me shndritë si kometë ndër shkollat ma të famshme të botës, kurse si po shihet edhe sot, komunizmi s'ka ba tjetër veçse me i përgatitë për 50 vjet me rradhë perëndimit, një ushtri me prostituta e me shërbëtorë!

Ndërsa populli shqiptar deri më 1994 mësohej me ecë në rrugët e gjana të qytetnimit, drejt perëndimit, më 1944 mori komandën: “Mbrapa ktheu! Para marsh drejt lindjes së mbrapambetun!” Komandë kjo që na çoi në çin e ma çin, deri në skajet ma të hupuna të Lindjes, në prehën të kinezëve. Por, një ditë të bukur, edhe miqtë kinezë na braktisën sepse u erdh marre që ishin lidhë me një kopsht zoologjik, të udhëhequn prej një majmuni.

Ndërkaq ndikimi jetëdhënës i shkollave katolike të Veriut, zbehej përditë. Shkolla ateiste e zhdeshte njeriun

prej të gjitha vlerave, për ta kthye në qenjen e cila udhëhiqet vetëm prej instinkteve, siç asht sot.

Ishte, prandej e natyrshme, që Gegënia, në rrjedhë shekujsh Rozafë e demokracisë e e progresit, të bahej epiqendra e termekut, që u duk se po i epte fund sundimit gjysë shekullor të drapnit të vdekjes e çekanit të skllavnisë, sapo nisi me fry sadopak flladi i lirisë. E, posë rrëximit të busteve¹⁷ të Enverit e të Stalinit, sinjali ma simbolik i rilidhjes së nenit¹⁸ të këputun, kje dalja rishtas e revistës së papërkulun “Hylli i Dritës”. Numri i saj i fundit pat pa dritën prej duerve të mira, që dijshin me mbajtë me dinjitet kryqin e pendën. Prej duersh të mira rilindi përsëri nga hini i vet, për t’u kthye prap në hi, si Feniksi. Qeverisë s’iu deshtën shumë mend me e kuptue se po t’i apësh një tribunë të lirë njerëzve si atë Zef Pllumi e Aurel Plasari, i vetmi që më duket se asht konvertue me gjithë mend e me gjithë zemër, ta çojnë popullin peshë e të kallin flakën me pishtarin ndezë në dritë të Hyllit. I frynë pra Hyllit me dy bulshijtë e u munduen me ia shkimë dritën. Po a mundet njeriu me fikë një Hyll? Besoj plotësisht se asht mshehë diku mbrapa reve e se do të dalë përsëri kur të agojë.

Gjaja që të zemron ma fort, pasojë e të ashtuquejtunës demokraci, asht se gjithnjë ma tepër mjetet e komunikimit e identifikojnë Gegëninë me Tropojën. Çudi e stërçudi! Deri këtu mërrin mohimi i qendrave të tjera të kulturës geqe, e posaçe Shkodrës të cilën po të mujshin, sigurisht do ta kishin shlye prej të tana hartave

¹⁷ Gabim i ngulitun, i automatizuem, logjik ndër shumë shqiptarë që e përdorin *bustin* në vet të *shtatores* (për rastin e ish-shtatores së E.H. në kryeqytet).

¹⁸ Kupto: *nyjes*.

gjeografike, tue harrue se tash 4 mijë vjet rri ndejë nën hije të Taraboshit, Maranajt e Cukalit, rrethue prej freskisë së tre lumejve e liqenit, e s'pranë tue përkundë në djepat e vet Teuta, Barleca, Beçikemë, Fishta. Mjerisht edhe Juda, sepse edhe Ramiz Alia në djep të saj kje lidhë së pari.

E çka më çuditë ma tepër sot, kur mund të ndreqen shumë prej gabimeve të randa të historisë, asht alergjia që kanë anmiqtë e katolicizmit e të Veriut për të vërtetën dhe dishira e çuditshme, e papërligjshme para Zotit e para kombit, për me vijue me kryeneçësi ecjen në rrugën e rrenave, të cilat me çka më duket, në përpjekjen për të ruejtë kontributin e tyne kriminal, pseudoshkencëtarë e kalemxhijtë e tjerë të diktaturës kanë fillue me i besue edhe vetë si të vërteta. E kështu fatkeqësisht po ua paraqesin edhe brezave të rij, pa pasë kush u del përballë. Sepse shi¹⁹ tashti ishte dashtë penda e Fishtës së madh, e i vu në bisht të lahutës! Qe pse Shqipja s'asht ma e zoja me fluturue: nuk mundet me sulmue lartësitë me një krah të vetëm, ndërsa tjetrin ia kanë thye copa-copa zogjtë e vet!

Le të mbesin prandej këto rreshta, si Apologji – a si epitaf – i Gegënisë në hjekashpirt, prej një biri të saj besnik, të shkatërruem ndër ato burgje, ku gjithashtu ligjin e bajshin së pari spiujtë toskë e mandej spiujtë gegë, në atmosferën e një raprezalje pa fund.

¹⁹ Pjesëz: *pikërisht, bash*.

Raprezalja

E raprezalja do të fillonte para arrestimit të Imzot Çobës, me arrestimet e disa barijve të grigjës së tij. U kurdis fajësimi i Dom Ejëll Kovaçit. Ishte hera e dytë që arrestohej, kësaj rradhe me akuza tepër të randa, të krijueme prej një fantazie djallëzore, me qëllim që të diskreditohej mbarë kleri katolik. Akuzohej për vrasjen e një njeriu në qelë e për inçest. Besojshin se vërtetimi, me hekur e zjarm në mish të gjallë, i një akuze të tillë, do t'i largonte besimtarët përfundimisht nga Kisha.

Montimi ishte vepër e artistit të krimeve e të torturave Hilmi Seitit, pështetë prej zagarit të tij, Gac Mazit, që filloi me e parapërgatitë shpirtnisht Shkodrën për hatanë që pritej me ndodhë: “Do të habiteni, kur të ndigjoni gjyqin! – thoshte kafehaneve – krime të shëmtueme, që vetëm kleri katolik mundet me i krye!”

Komiteti Qendror ishte i bindun se do t'ia delte me ia ulë hundën klerit e besimtarëve katolikë, tue vra dy zogj me një gur. Por kot. Këtë shpifje të shëmtueme nuk e besoi askush: as shqiptarët e as të huejtë. Të gjithë e dijshin tashma se po t'ia vente kujt synin sigurimi, nuk ishte i largët as i vështirë fillimi i tragjikomedisë. E mandej thonë se në letërsinë shqipe gjinia dramatike asht pak e zhvillueme! Po kryeveprat e farsave, luejtë me aktorë të vërtetë, të gjallë, që përfundojshin andej në tragjedi, me vrasjen e të gjithë aktorëve, të kriminelëve e të viktimave, në ç'disiplinë të dijes njerëzore bajnë pjesë? Ndoshta në historinë e pashkrume të raprezaljeve të shqiptarit kundër shqiptarit? Kur Tirana,

pra u gërvall në radio që t'ia mbushte mendën botës për shëmtimin e klerit katolik, radiot e hueja thanë: “Nëse kleri katolik kenka degjenerue kaq fort, kushedi sa thellë do të jenë zhytë në imoralitet të tjerët, që s’kanë din as iman!”

Do të vinte mandej viti ogurzi 1967 e Komiteti Qendror do të bante çmos me ia mbushë mendën opinionit botënor se kishat e xhamiat nuk po i mbyllte Enver Hoxha, po vetë krenët e klerit, të bindun se e ardhmja nuk i takon fesë, por komunizmit. Atëherë në majën e Golgotës së klerit, që prej vitesh ngjitej në Kalvar me krygjen²⁰ e randë të persekutimit mbi shpinën e shprishun nga torturat, u ngritën rishtas tre kryqat! Filloi një terror i pashoq: banë çmos me i bindë disa hoxhallarë e priftën ta digjshin publikisht petkun fetar, të rruejshin mjekrrat (kush nuk i kishte rrue ende) e të shpallshin botënisht, njëzani me partinë, se feja paska kenë gjithmonë opium për popullin.

U gjet ndo’i prift ortodoks a ndo’i hoxhë që bani informalisht abjurën²¹ gjatë gostive të përgatituna nga sekretarët e parë, quejtë me pompozitet kuvende të popullit, por kleri katolik, që gjithmonë i asht bindë vetëm Zotit, mori vendim gjithashtu të njëzashëm, që edhe me kisha të mbylluna e me rrezikun e dekës mbi krye, t’ia çonte popullit Krishtin kudo të kërkohej. Populli katolik e ndjeu vedin

²⁰ Grafolekt gegë i alternuem në gjini: *kryqa* (njejës) në vend të *kryqi*, arkaizëm: *krygja*. Khs. edhe rastet e tjera të këtij shkodranizmi të t’folmes katolike: *pushtedi-pushteda*, *shnedi-shned(j)a* ose *kështjella* (nj.)-*kështjelli* etc.

²¹ *Abjura*, term i përdorun kryesisht në religion që në shqip mund të përkthet *me u shpërbë*, në kuptimin me i ra mohit, me braktisë devocionin dhe detyrën fetare. Nji shpjegim të përafërt e jep edhe vetë autori në tekst.

kryenaltë para një qëndrimi të tillë të barijve të vet. Grigja u kishte qindruar ujqëve, të cilët u tërbuen dhe ma zi e nisën të ulurojnë në lukuni se i kishin suprimuar institucionet fetare si të panevojshme, sepse populli nuk i frekuentonte, e dokrra të tjera si këto.

Gjithnjë për t'i nënshtruar katolikët, në vjeshtën e vjetit 1967, u organizue një gjyq në Kishën e Motrave Stigmatine në Gjuhadol, ku u dënuen me dekë Dom Zef Bici e Dom Mark Dushi dhe me burgime të randa katër meshtarë të tjerë.

Viktimë e raprezaljes asht edhe em vëlla, Dom Lazër Jubani, akuzue prej njerëzve që duhet ta kishin mbrojtë, sepse krejt të afërm me familjen. Arsenikun ia dha me 10 Korrik 1982, spiuni i lashtë zoti Marleci, punëtor në fermën e Bardhejve, ku bante punë krahi edhe em vëlla. Helmi, injektue ndër mollatarta nga sigurimi, e bani punën e vet: Dom Lazri diq mbas një agonie tragjike. Askush nuk u kujdes për të, kur e shtruen në spital. Mjekët kishin urdhën nga sigurimi t'i mohojshin çdo mjekim dhe ia mohuen. Kush ishte mjeku që mërrijti deri me i shkulë tubat e transfuzionit? Cili prej doktorave, që edhe sot e kësaj dite mburren se kryejnë shërbimin humanitar ndaj njerëzve, ia shpejtoi meshtarit dekën, për me ruejtë jetën e vet? Këtë e din Zoti, që sheh e shkruen gjithçka prej qiellit! Sidoqoftë, si e panë të lanun në mëshirë të fatit, familjarët e morën në shtëpi në grahmat e fundit, me dekë së paku në krahët e të vetëve, ku edhe mbylli sytë për dritën e kësaj bote më 29 Korrik 1982.

Raprezalje e rezistencë! Nga të pesë malet që kanë ruejtë identitetin europian, si Puka, Malcija e Madhe, Dukagjini e Malcija e Lezhës, Mirdita asht krahina që i ka

rezistue ma tepër komunizmit, e natyrisht ka pësue edhe raprezaljet ma të egra. Nëse Enver Hoxha lavdohej se më 29 Nanduer 1944 shtroi gjithë Shqipninë, Mirditën muji me e shtruar vetëm në 1953. Deri në këtë vit malet e pyjet e Mirditës ishin plot mirditorë me pushkë për faqe, të drejtue nga dera e Gjomarkajve, që la në këtë luftë dy djelm: Sandrin e Markun, tue e bezdisë fort Komitetin Qendror, sepse tue qitë kushtimin për kryengritje të përgjithshme kundër bolshevizmit. Mirdita u revolte edhe ma tepër, kur çetat komuniste që deshtën me e shtruar, kryen krime të cilat s'ka pendë që mundet me i përshkrue, as gojë që mundet me i përmendë. Vetëm njerëzit pa ligjë e pa kanu munden me krye asisoj barbarish. Mjafton me përmendë rreshtin e gjatë të burrave e të grave, zhdeshtë lakuriq me dhunë prej toger Hodo Habidit , që shnderoi dheta gra e vajza mirditore e vrau njëqind burra të paarmatosun. Asht një ndër të paktët kriminelë të shëmtuem, që i pagoi shpejt e shpejt krimet e veta, sepse u kap e u var në Hajmel, prej atyne që kishin pështue nga dora e tij kriminale. Ndërsa fytin ia shtërngonte konopi, e ata që po e dënoishin me të drejtë, përgatiteshin me ia hjekë stolin, burrit të madh të Labërisë, nisën me i lagë e me i kullue pantallonat nga të katër anët, tue e mbushë kështu me “aromën” që delte prej tyne, historinë e heroizmit të komunistave shqiptarë. Sepse, mbas këtij heroizmi të fundit, ky kriminel i neveritshëm, që e përfundoi jetën rrethue me erën e qelbun të vetvedit, u shpall hero i Popullit!

Kështu Mirdita, e shkrueme ndër analet bizantine e turke si simbol qindrese, u ba sinonim i rezistencës edhe në analet e komunizmit.

Mbasi vrau e preu e mbyti me plumb e tortura e konop, Komiteti Qendror, vijoi raprezaljen kundër Mirditës me aksidente të organizueme e me helm, nga frika se do të çonte përsëri krye. Më 1949 komunistat vranë Bardhok Bibën dhe hapën fjalë se e kishin vra diversantat me urdhën të Gjo' Marka Gjonit të arratisun, tue gjetë kështu pretekstin me vra të fundmit mirditorë, që kishin peshë në Mirditën e panënshtrueme.

Një nga raprezaljet ma shtazarake kje organizue në Qafë të Valmirit, ku për t'i grumbullue të gjithë ata që ishin dënue me dekë, u organizue një mbledhje. Siç pat ba sulltani në Manastir me krenët shqiptarë kryengritës. U banë pra, tri ftesa të posaçme të gjithëve dhe mbasi ishin mbledhë, i lidhën. Shtatë prej tyne i varën ndër lisa, 15 të tjerë i lidhën me tel dorë për dore pranë një grope të madhe dhe u shkrehën koburet në tamth. E ata u rrokullisën njeni mbi tjetrin gjysa gjallë e gjysa dekë. Pa pritë t'u delte shpirti, i mbuluem me dhe, ndërsa prej nëntoke ndiheshin zanet e llahtarshme të burrave mirditorë, që nuk kërkojshin falje, jo, sepse e dijshin në duer të kujt kishin ra! Kërkojshin goditjen dekësore, plumbin e fundit, para se dheu t'ua merrte frymën për gazep! Ata ulurojshin me zane që i banë të përqetheshin deri drutë e pyllit, ku vareshin të tjerët, ndërsa kriminelët hidhshin vallen labërishte rreth e rreth gropës, shoqnue prej kangës makabre që delte prej nëndheut. Ishte brima ma e hatashme që kishin ndigjue ndonjëherë ato male, ku Kanuja që po merret aq shumë nëpër gojë, kërkon respekt të detyrueshëm për njeriun e dekun. Qe, pra çka asht i zoti me i ba shqiptari shqiptarit. E kur s'mundet me e varë a me e vorrosë së gjallit, ndërron formë e mënyrë: e varë e e vorrosë ma keq se në ato ditë të

hatahshme, që shënuen ramjen e njenës nga kështjellat e fundit të antikomunizmit!

Gjatë regjimit komunist, terrori ka kenë shumë ma i thkeksuem ndër male e fshate, sesa ndër qytete, sepse malësorët e katundarët e mbajtën fenë të gjallë shumë ma tepër se qytetarët, të cilët për një arsye a për një tjetër, ose e mshehën thellë në shpirt, tue mos pasë kurrfarë guximi për me e dishmue haptas, e u bane kështu njerëz me dy jetë, me dy shpirtën, me dy faqe; ose dolën haptas si kundërshtarë të saj. E për t'ia mbushë menden regjimit se ishin me të vërtetë të kthym, i bane Kishës dame të randa. Këtë e kam pa e prekë me dorë në malet e mia të Mirditës, e si shkodran që jam, kam pas mundësi me ba edhe krahasime të duhuna. Kam pa jo vetëm besimtarë të thjeshtë, por edhe klerikë tue mbajtë qëndrime të çuditshme e të papranueshme, prej tmerrit që u kishte hy në palc. Ndërmjet tyne, ma frigaci që kam njoftë, ka kenë Dom Lec Sahatçija, që kishte zëvendësue MonsinJOR GjiniN, Abatin e Mirditës. Prej tmerrit, ky meshtar që zëvendësonte një ipeshkëv të pushkatuem si hero feje, ishte kthye në famullitar ambulant, që shkonte shtëpi më shtëpi për me mbarështue sakramendet: me pagëzue, me krezmue, me bekue kunorat e banesat.

Selinë e kishte në Gëziq, ku jetonte në mjerimin ma të madh. Ma vonë ndërroi vend e shkoi në Shën Mi, por në e diele, prej frike, nuk kremtonte kurrë meshë aty ku duhej, në mjes të besimtarëve që i ishin besue. Përkundra, shkonte me kremtue në Shkodër, në katedrale, sepse në Mirditë kërcënohej me dekë nga komunistat të cilët, për ta largue popullin prej kishe, shpikshin gjithfarë marrinash. Kështu populli i shkretë detyrohej me e kalue edhe ditën e bekueme

tue u marrë me problem të kota, që nuk i shërbejshin as korpit as shpirtit. Edhe pse i përndjekun kamba kambës, populli vijonte me shkue ne e diele në Gëziq a në Shën Mi.²² Tue kenë se nuk po e gjeshin kurrë famullitarin në elter, njerëzit filluen me thanë se Dom Leci ka luejtë mendsh prej frike, qysh se nuk rrin në krye të detyrës,

Por Dom Leci i shkretë, me atë pak guxim që i kishte mbetë diku në një skaj të zemrës, vijoi edhe mbas mbylljes së kishave shërbimin e tij fetar shtëpi nëpër shtëpi. Natyrisht që nuk mujti me e çue gjatë, sepse e arrestuen. Në burg i ndodhi ajo që kishte drashtë gjithmonë: e torturuen aq keqas, sa nuk doli ma i gjallë. Kujtimet e mia më thonë se Dom Leci shkonte mirë me meshtarët konstitucionalë, po të përdorim një term të Revolucionit Francez, që do ta shpjegojmë ma poshtë, me Dom Prend Qefalinë, Dom Nikollë Lulin, Dom Gjergji Vatën, Dom Luigj Kolën. Nuk rrinte me ta sepse i shkonte fjala e gazi, por gjithnjë sepse i dronte. Tue kenë meshtarë konstitucionalë, peshojshin shumë ma tepër se ai para syve të qeverisë.

Më kujtohet një datë interesante, kur unë kisha thirrë Dom Prend Qefalinë për të mbajtur homelinë në panigjirikon e Shën Gjergjit. Shkoi deri në gjysë të predkut, pa përmendë as Krisht as Zot, por tue folë mirë vetëm për qeverinë. Unë, që po ndihmojshe Meshë, nuk mujta me e përmbajtë ma vedin e tue pasë frikë se predku do të kryste njashtu si nisi, ia ndërpreva fillë e prej elterit e në sy të mbarë popullit, që u çudit e u mrekullue sa për predkun, aq edhe për ndërpremen e tij. I bana vërejtje e i thashë se s'ishte aty vendi me folë për meritat e qeverisë, por tue pasë parasysht

²² Aberracion i Shën Eufemisë.

rasën e kremtimit, së paku duhej me folë për meritat e Shën Gjergjit. Me kenë se kjo punë s'kishte ba kurrë vaki, gjithë Mirdita u mbush me lajmin se unë isha antikomunist i tërbuem. Nuk ishte ndonjë nam fort i pëlqyeshëm për atë kohë, po mue m'u ba qejfi që ç'ke me të, sepse në fund të fundit ishte thanë një lajm i vërtetë, në mjedis të gjithë atyne rrenave, që thoheshin deri prej elterit, tue ngatërrue keqas në mendjen e besimtarëve të shkretë të Mirditës Shën Gjergjin me një turmë shejtanash që thirren qeveri.

Raprezalja ka kenë dhe asht edhe sot një mjet për me ruejtë status quo-në. Arratisëj një pjesëtar i familjes në perëndim, familjen e pritëte internimi, burgu, pushimi nga puna, transferimi e deri vrasja. E këto masa vijojshtin në përputhje me qëndrimin e të arratisunit në botën kapitaliste. Ka ndodhë shpesh që i arratisuni, ikë si antikomunist, të shndërrohej në agent të zbulimit të jashtëm e familja të lirohej. Por ka ndodhë edhe ma shpesh që e kanë nisë vetë jashtë shteti si spiju e familja e tij asht internue për me mbulue gjurmët.



Modele

Pat edhe njerëz që me hirin e Zotit, i banë ballë shnjerezimit të diktaturës, tue mbetë modele për shqiptarin e të gjitha kohëve. I përkitshin të tana shtresave të popullsisë. Në krye të tyre janë pa dyshim shumë meshtarë, që vuejtën me dinjitet, pa dhanë asnjë shenjë mërzie ndër burgje e kampe përqendrimi, por tue bartë gjithçka me duresë të vërtetë ungjillore. E në pararojë të tyre, unë do të kujtoj gjithmonë Dom Injac Gjokën. Sa shumë meriton të flitet për këtë njeri, që sigurisht sot asht shenjt para fytyrës së Zotit. E sa pak asht folë e flitet.

Një shenjt si Dom Njaci nuk mujte me mendue keq për kurrkend. Edhe persekutimin e konsideronte si pjesë e randësishme të jetës së tij meshtarake dhe gëzohej që po i takonte me vuejtë. Madje, ishte i lum, sepse kështu e ndiente vedin shumë ma afër Jezu Krishtit në rrugën drejt Kalvarit. Sa ma shumë vunte, aq ma mirë ndihej shpirtnisht, aq ma shumë bindej se po jetonte simbas mësimeve të Ungjillit. Ishe i dënuem si fajtor, ndonëse i pafaj si një ferishte. Po a nuk ishte dënue po kështu edhe Krishti para tij? Rrezikohej ta merrte plumbin ballit. Sa pak, në krahasim me vuejtjet e kryqëzimit. E të mendosh se i Kryqëzuemi nuk ishte njeri, po Zot. Do të kishte kenë i lumtun po t'u kishte shkue ndër mend xhelatëve komunistë me e kryqëzue. Dekë ma të mirë për vedi s'kishte dashtë. Ky ishte martiri i fesë Dom Njac Gjoka, që e dishmoi Krishtin në gjyq me një heroizëm të pashoq, për me dhanë menjëherë mbas gjykimit edhe dishminë tjetër, ma të naltën, atë të gjakut.

Në atë kohë terrori, kur askush nuk e ndiente vedin të sigurtë, por, sikurse sot jetonte me ankthin se po i bjen papritë mbi krye ndonjë plumb qorr, e po e çon në jetën tjetër, një ditë ndodheshim për vizitë. Një mik kishte ditën e emnit. Ishte një rasë e mirë për me u takue e me shndërrue dy fjalë ndërmjet miqsh. E atë ditë biseda ra për një llogaritar, që ishte arrestue pak kohë ma parë. Gjithkush bante komentet e veta. Dikush thonte se të tanë vjedhin. Tjetri shtonte se me vjedhë qeverinë nuk asht vjedhje, madje asht sevapë, sepse ma shumë i vjedh qeveria nënshtetasit, sesa ata qeverinë. Tjerët shtojshin se me të vërtetë asht sevapë me e vjedhë e me e gri këtë soj qeverie, por nuk duhet me vjedhë aq shumë, sa me ra në sy; sepse jeta luksoze në mjedis të këtij horlleku,²³ bjen menjëherë në sy. Kur të gjithë e kishin shprazë me fund strajcën e mendimeve të veta e në dhomë u nde heshtja, hapi gojën e foli Dom Njaci, që e kishin vu në krye të vendit, në daç si meshtar e në daç për shenjtninë e tij të njoftun botënisht. Hapi pra gojën e tha vetëm këto fjalë, të cilat të gjithëve iu dukën të çuditshme: “I shkreti, po më dhimbet, se nuk e paska dijtë mirë numratorën e paska gabue në llogari.” Nuk dijsim, a me qeshë, a me kja prej një përfundimi të tillë kaq të papritun e të pamenduem. Shyqyr e njëfshim aq, sa me e kuptue. Një shenjt si Dom Njaci nuk mund të mendonte keq për askend, sepse e kishte kuptue dhe e zbatonte kallep


²³ Në bot. I, 46, asht *hordhek-u*, por në këtë edicion asht lanë simbas ortoepisë së Fj. Bashk. *horllek-u*, që don me thanë *poshtnim*, *mjeri*, *padinjitet* (162). FGJSH e ka *horrllëk*. Në Shkodër, sot kjo fjalë ka marrë tjetër ngjyresë e përdoret rëndom si qyfyre, gallatë, hokë ndërkohë që (për paradoks), rraja e fjalës asht *hor* e mandej sufiksi, simbas shumicës së etimologëve, prej turqishtes *-llek/llëk*.

shenjtinë. As s'i shkonte ndër mend me e komentue thanien e Krishtit: "Të jeni të thjeshtë si pëllumbat e të urtë si gjarpijtë!" Krishti na e la këtë porosi që të mos jemi krejt naivë si pëllumbi, i cili nuk din me u ruejtë, por edhe të urtë si gjarpni, që kur e sulmon kush, din me e mbrojtë kryet e vet, tue rrëshitë nëpër biruca e skutuliqa, ku s'guxon me i shkue kurrkush mbrapa. A keni hy, zotni, ndonjëherë në një birë gjarpijsh? E a do të kishit dëshirë me e ndjekë një gjarpën deri në birën, ku banon së bashku me familjen e vet?

Edhe shenjti vetë duhet të jetë i urtë. Po Dom Njaci ishte shenjt i rrallë. Nuk u përkitëte atyne që gabojnë shtatë herë në ditë, sepse, si thotë fjala e urtë: "Me hiri a pa hiri, shtatë herë në ditë gabon ma i miri". Ai s'mund të gabonte kurrë ai s'mund të gabonte, sepse ishte krejt shpirt. Prandej ma në fund ia plasëm gazit, tek e ndigjuem që flitëte me një thjeshtësi çarmatosëse.

Barabar shenjtëshë Nana Tereza. Më kujtohet se si në vjetën 1992, më thirri nga Kalivaçi (unë jam i pari meshtar shqiptar që e kam takue në Romë më 1991). Me shkue prej Kalivaçit në Tiranë e kthim duhej së paku një ditë, e një ditë jo fort e kandëshme, sepse e kalueme në udhëtim nëpër një rrugë gropa-gropa që të ban me fluturue në hava tash e parë. Kur mërrija, më bani me pritë një copë herë të gjatë, sepse kishte punë të tjera. Mandej më thirri e foli me mue për një problem aq të thjeshtë, sa mund ta kishte krye fare mirë me postë, nëse nuk mund të dërgonte një njeri në malet e mia. U ktheva në Kalivaç lodhë e këputë, tue mendue se këta shenjtët e shenjtëshat jetojnë vetëm më Shpirtin Shenjt dhe nuk kanë kurrfarë aftësie praktike. Se, more zotni, unë që nuk i afrohesha faret në shenjtni, mëkatnova tue mendue se mbasi më kishte thirrë vetë,

duhet të më kishte pague të paktën udhëtimin, ndonëse natyrisht nuk do të kisha pranue me marrë gja. M'u duk e bukur me kenë shenjt, por njëkohësisht nisa me mendue se njeriu duhet të edukohet sadopak edhe me sherritë e njerëzve të shekullit, për mos me u dukë krejt i trashë në jetën praktike. Sepse, more zotni, me kenë shenjt ndërmjet shejtanash nuk asht punë e kollajshme.



Spijunazhi

Enver Hoxha nuk do të kishte mujtë me ushtruar tiraninë e tij të pashembullt në historinë moderne, nëse nuk do të ishte shërbye prej një turme spiujsh e kryespiujsh. Ai, mandej, u mësoi edhe zanatin e qeveritarit, të cilin njerëzit naivë çuditën sa mirë po dijnë me e vërtitë edhe sot e kësaj dite.

Tirania ngjall urrejtje tek të gjithë, por jo ma pak ngjall edhe frikë, madje do të thosha, tmerr. Ishte ky tmerr që i shtyu shumë shqiptarë me u ba spiuj. Pjesa ma e madhe nuk shkuen vetë në degë, jo sepse njerëzit jo vetëm nuk pranojshin me hy në degë, me ia shtruar rrugën me flori, por madje kur i afroreshin asaj ndërtese të flliqtë, ndërrojshin trotuar, për mos me kaluar pranë atij pragu, që simbolizonte torturën e deken. Mjerë zemra e atyne që e kalojshin atë prag si në shtëpi të vet. Ata e kanë marrë tashma dënimin. Janë vulosë një herë e përgjithmonë me vulën e kriminelit.

Pjesa tjetër s' shkuen jo se ishin trima, por pse po të paraqiteshin vetë, vullnetarisht do të dyshoheshin si agjenta të imperializmit amerikan, që dojshin me e marrë kalanë nga mbrenda. Gjithsesi të dyja palët u thirrën kur ishin në shtëpia të veta, në punë të vet, pa i shkue e bija e mendes me ia filluar një zanati kaq të ndytë. Kush nuk pranoi menjëherë, pranoi më vonë, mbasi i vunë prangat e e mbyllën në birucë: atëherë në vend që të bahej mi shtëpijak, u ba mi birucash.

Deri më 1989 të gjithë spiujtë u falën e dolën, ndonëse nuk mujtën me u çliruar nga Deklarata e bashkëpunimit me

sigurimin, që e kishin nënshkrue një herë e përgjithmonë, nënshkrim prej të cilit nuk do të pështojshin gjithë jetën, që do të randonte mbi ta ma keq se rrasa e vorrit. Spijujtë e vijojnë edhe sot e kësaj dite zanatin e tyre: i ke në të gjitha poret e shoqnisë shqiptare, prej qeverie në kishë. Madje tashti janë përhapë ma zi se ma parë edhe nëpër botë, ku kryejnë misionin e rojtarëve të kështjellës prej balte, që e rrenuene vetë. Kot i rrenë mendja shqiptarët e shkretë se kanë pështue prej tyre, tue kalue në botën e lirë: nuk kanë me pështue kurrë prej tyre, mësa mund të pështojnë prej hijes së vet. Kujdes pra! E mos gaboni me thanë se sot s'kanë ma çka me ju ba! Ju bajnë atë që nuk jua pret mendja. E në daçi me pësue si po tregoj ma poshtë, kujdes!



Arrestime psikologjike

Ateistat bajnë sikur nuk besojnë. Madje thonë se primare asht materia, kurse ideja asht sekondare. Nuk çuditem aspak! As që mund të thonë ndryshe, përderisa ata xjerrin fjalën ma parë, mandej mendojnë; bajnë krimin përpara e mandej kuptojnë se kanë gabue. Prandej shumkujt i ka ardhë falja mbasi ishte varë, pushkatue ose kishte dekë prej torturave shtazarake. Mandej, me të mendueme, për t'u tallë me familjen, të dekunit, zhdukë me kulm e temel,²⁴ për shpërblim, i naltohej një monument. Monument me litar në grykë!

Unë jam arrestue nja dhetë herë e gjithnjë ndër çaste ose data kritike. Ishte metodë e përdorun për me ba përshtypje si te viktima, ashtu edhe te familja e te rrethi shoqnor, sepse diktatorat, kudo e kurdoherë, janë autokratë e s'bajnë tjetër, veçse me shtue numrin e anmiqve. Kështu ka ndodhë dje, kështu e hiç ma pak po ndodh edhe sot, kur të gjitha shtetet e botës janë kapërthye prej marimangës amerikane, që qëndron në mjedis të rretit,²⁵ gadi me i këcye sypri atij shtet që nuk i bindet.

Kujtoj arrestimin e tretë. Ma banë vetëm tri ditë para se të mbushëshe dhetë vjetët e para të dënimit. Isha plot me gëzim në ato çaste, besojshë se kishin marrë fund vujtjet e birucave, se më kishte ardhë ora me u kthye në shtëpi, ku në mos tjetër, mund të shkojshe si njeri në nevojtoire. Shi

²⁴ Të moçmit në Shkodër nuk kanë thanë *themel* por *temel*.

²⁵ Njisoj për *rretit*.

atëherë, kur u përkundshe në këto andrra të bukura, më thirrën. Pështova! – këndoi një za mbrenda meje. U nisa fluturim! Drejt lirisë? Jo more zotni. Prej dhomës së përbashkët – në kokërr të birucës me myk e lagështinë, pa tesha fjetje, pa dyshekun me kashtë, që së paku m’i mbronte brijtë nga çimentoja, në shoqni me mijtë e birucave, që gjithsesi ishin ma fisnikë se spiujtë, hetuesët, policët. Shamje, fyemje e shamatë, në vend të përqaftimeve të njerëzve të familjes. Më pritëte përsëri batanija e qelbun e birucës, që më shkaktonte një neveri të padurueshme. Po kur lagështina m’i brente eshtënt, harrojshe erën e saj të keqe, kandrrat që shëtishin lirisht ndërmejt palave e u pështillshe krejt me lëkurë morri. Po njeriu që beson asht i fortë. E din se aty ku forcat tona mbarojnë, aty duket dora e Zotit, që të mbron prej të keqit, kur shpreson në Të. Ndërsa pritshe me ra në disprimin ma të pashpresë, në buzë më vinte lutja, e disprimi zhdukej.

Një herë më arrestuen natën e Krishtlindjes. Menduen se ma në fund do të më mposhtëte disprimi. Po Zoti më erdh ma pranë se kurrë: ma shndërroi birucën në Shpellë Betlemi e më dha hirin me e kremtue aty Meshën Shenjte. E ashtu si shpella dy mijë vjet ma parë, biruca u mbush me dritë, sepse unë isha aty pikërisht për Atë që vinte përsëri mes nesh atë natë të acartë. Mbi kashtë, si unë! Si unë në shoqni të shtazëve!

Po kur Zoti ishte i pranishëm, biruca sikur shkëputej nga kjo botë, që për mue ishte ba ferr. Atëherë më vijshin mendime, që po t’i kisha shkruar aty për aty, do të kisha

realizue një libër të çuditshëm, të pashkruem ndonjë herë. Po aty ku isha, shkruhej me shkroja²⁶ gjaku.

Njerëzit si unë, pra e kishin ma të lehtë ta përballojshin arrestimin psikologjik. Po kishte edhe të tjerë. Madje miq të partisë e deri anëtarë e udhëheqës të saj, që flakeshin në birucë në çastet ma të çuditshme. Dy tri ditë para se të niseshin për jashtë shteti, për shembull. Sa ma mik i partisë të ishte njeriu, aq ma shumë peshonte mbi të arrestimi, sepse duhej shkatërrue moralisht, duhej demoralizue, duhej dërmue fizikisht e shpirtnisht, që kur t'i nënshtrohej hetuesisë, të dorëzohej pa kushte, të hupte gjithçka njerëzore: personalitet, dinjitet e seriozitet, t'i shkatërrohej gjithçka, veç fantazisë. E kjo e fundit duhej të punonte vetëm në një drejtim: me shpikë prej mendes gjithfarë grupazhesh e komplotesh, të paqenuna, që i kërcënoheshin partisë, tue i dhanë asaj të drejtën e ligjshme me u ba ballë anmiquë, don me thanë, me mbushë burgjet e vorrezat.

Në fillim meshtarët i torturojshin për deké, me qëllim që të nxirrshin edhe rrëfimin. Kujtojshin, qyqarët se meshtari asht i pari që i merr vesh krimet, të cilat ndodhin nëpër botë e nuk e dijshin se njeriu i elterit asht i fundit që interesohet për këto punë, edhe kur i duhet me i ndigjue në rrëfyestore e me i zgjidhë, i harron menjëherë mbrapa e nuk i bje ma në mend për to, edhe kur takohet ballë për ballë me njeriun që ia ka shprazë zemrën ashtu si i shprazet veç Zotit, të cilit nuk mund t'i mshehet kurrja.

Gjithsesi njeriu mësohet me gjithçka, si me rahatit e komoditet, ashtu edhe me mungesat ma fillestare, si asht për shembull, mungesa e nevojtores dhe detyrimi me u ulë në

²⁶ Ark. për shkro(n)ja.

bajë me komandë, të gjithë së bashku, si pulat në shkop kur shkojnë me fjetë. Ose detyrimi me u shtri në rresht, pranë e pranë njerëzve me gjithfarë sëmundjesh, fryma e qelbun e të cilëve të dyndet pa mëshirë në hundë e në gojë, e ndërsa ma në fund të kotullon gjumi, e ndjen sesi përplasesh për tjetrin, që shtrëngohet mbas tejet në makthin e natës së burgut.



Ndër pranga

Në muzgun e datës 30 Marc 1963, policia u alarmue kur nuk më gjeti në Mirditë, ku po më kërkonte për të më vu hekurat. Iu desht të mobilizonte një rretë të tanë për me më zbulue, a thue se ku kisha shkue me mbarue. Isha krejt i çkujdesun në Dardhë të Pukës, ku kisha shkue për të meshue. Aty më gjetën e ditën për diell, më mbërthyen dy si unaza të trasha, të ndryshkuna, ndër duer. Duhet të ishin pranga! Merreni me mend vetë sa i madh ishte poshtnimi. Jo aq sepse isha i pafaj, por sepse këto hekura të ndryshkuna po m'i shtrëngoishin shkombëtarizuesit ma radikalë të popullit shqiptar, shi njata që sot po kërkojnë me lot kokodrili ndër sy, kocijtë e njëqindmijë shqiptarëve, që i kanë vra me duert e veta. Isha pra, një kriminel ordiner. Gazi i degës, ku më rrasën, fluturonte me shpejtësi: malet e fushat rrëshitshin, ikshin prej mejet e më dukej se nuk kisha për t'i pa ma kurrë. Më mbërtheu trishtimi ndër kthetrat e veta të tmerrshme, por menjëherë, si ngushëllim, më erdhën ndër mend fjalët e Krishtit: “Po ju çoj porsi kingjat midis ujqëve!” dhe sidomos: “Dyert e ferrit nuk kanë me e mposhtë kurrë Kishën teme!”

Ujqit më kishin vu hekurat dhe kishin mbyllë në Mirditë kishat e 15 katundeve, të cilat Zoti do të më ndihmonte me i hapë përsëri. E me të vërtetë, Ai që ka temelue Kishën, që nuk ka nevojë me marrë leje prej ujqëve, më ndihmoi 26 vjet ma vonë me 4 Nanduer 1990, me dhanë sinjalin e parë të ngjadhnjimit mbi lukuninë, i çuem për hava prej 50 mijë besimtarëve shkodranë.

Po kjo ditë ishte e largët, e andërrt, ndërsa gazi i degës fluturonte drejt torturave. E unë, i pranguemi, u mundojshe me i dhanë zemër vedit, tue kujtue fjalët e Mjeshtrit, të cilit ia kisha falë gjithçkafen, për të cilin isha në pranga: “Gëzoni, gëzoni se shpejt vëejtja juej do të kthehet në triumf!” “Mos i kini frikë ata që ju vrasin trupin, por drueni vetëm ata që ju vrasin shpirtin”. Kush ishte kriminel e kush viktimë?

Mbas nja katër orë udhëtimi, më përplasën në një nga birucat e policisë së Lezhës. U kujtova ku isha, vetëm kur ndjeva në tanë trupin akullimin e birucës. Më kishin zgjidhë e flakë në dërrasat e palame të dyshemes. E ndjeva vedin të çlodhun si ai që ka luftue me dallgët e oqeanit për të shpëtue e sapo ka prekë bregun. Biruca m’u duk si qelia e një murgu trapist. Gati-gati ma mirë që isha këtu, larg frikës së përhershme të burgimit e të internimit, ankthit të së pritmes. Tashti gjithçka ishte krye! Isha i kryqëzue. Burgu i madh ishte jashta qelisë seme, me të gjitha pikëllimet e veta, me sëmundjet fizike e psikike të shkaktueme nga operativi i degës, Bardhok Ndue Prendi, i cili sillej nëpër lokalitetin e Kashnjetit me dy qej gjuetije, tue i terrorizue katundarët e shkretë të zhdeshtun e të unshëm, që detyroheshin me ia shtrëue sofrën me çka s’kishin për vete, prej frike. Unë, si famullitar, pagëzojshe çdo vjetë ma se dyqind foshnje, por njëqind prej tyne disshin mbrenda vjetës nga mungesa e ushqimeve. Mirdita iu nënshtrëue persekutimit ma të egër, sepse deri në vjetin 1953, i qëndroi komunizmit. Prandej Enveri këtu derdhi ma shumë gjak se në çdo krahinë tjetër të Shqipnisë. U mundue me i stërpikë mirditorët prej trojeve të tyne, për të pasë kështu një Mirditë pa mirditorë, nëse nuk dorëzoheshin. Po ata një ditë u

dorëzuen, tue e lanë gjithsesi për një kohë të gjatë Mirditën pa mirditorë. Nuk mund të thom me plot gojën se janë kthye rishtas atje ku i pata lanë para se të fillojshin mundimet e mia.

Po tashti Mirdita ishte jashtë e unë mbrendë, në birucë. E shi këtu u kujtova se, tue u marrë me punët e Mirditës, kisha lanë mbas doret shpirtin tem. I mbuluem siç isha me punët e kujdeset e të tjerëve, kisha harrue se unë vetë duhet të isha plot me hirin shenjtnues e me virtyte. Kuptova se gati isha boshatisë, e se po të kisha vijue edhe pak në atë gjendje, do të isha rrëxue, si shumë të tjerë. Prandej edhe arrestimin e mora si shenj që më vinte prej nalt. Këtu fjala “nalt” natyrisht nuk e ka kuptimin e qeverisë! Në fakt kur u arrestova, isha meshtar mediokër, e kisha horizontin sa një birë gjylpane... Kur dola prej burgut, mbas 26 vjetësh, më ishte hapë para një dritore e gjanë, prej nga isha në gjendje me pa botën mbarë me sy të lirë nga çdo paragjykim. Synin tem e kishin pastrue torturat fizike, prej të cilave kisha fitue një pasuni të pamasë shpirtënore. U desht me u mbyllë në burg, për me kuptue se kisha ndërtue Kishat e Mirditës në mjes²⁷ të terrorit enverian, kisha ndërtue kishën e gjallë, popullin, por kisha lanë mbas doret ndërtimin e shpirtit tem. Gjithçka tek unë kishte fillue me u ndryshkë, me u vjetruë... Kuptova se po të mos kishin pasë travajë e halle, ashtu si pa u kujtue, shumë shpirtën do të kishin përfundue sigurisht në fund të ferrit. Vuejtjet na mprehin trunin, na shkëpusin nga vlerat e përkohshme, që ma të shumtën janë antivlera e na lidhin ngushtë me vlerat e amshueme.

²⁷ Ark. shkod. për mes.

Lexues i dashtun, mos e mendo të kollajtë gjendjen e famullitarit katolik në kohën teme, kur “arrë gungçe” siç isha, gjatë predikimeve të mia përdorshe po këtë fjalor që përdori sot. Kisha mbetë njeri i lirë, gja që e urrente ma shumë se gjithçka partia komuniste e cila, për shkak të qëndrimit tem, kishte sekuestrue të gjitha pasunitë e kishave të mia ndërmjet malesh të Mirditës, përshkue prej shtigjeve të dhive, nëper të cilat më duhej me u kacavjerrë në kambë, sepse nuk kishe mundësi me pasë as një mushk. Shërbimet fetare ishin të shumta e mue më duhej me i la me djersë shtigjet e maleve të vorfna të vendit të misionit. Deri banesa eme ishte e xanun prej infermjerisë së fshatit dhe infermjeri, Maliq Sokol Djala e kishte shndërrue qelën teme në qendër korrupsioni, në shtëpi publike, që kishte për drejtor një njeri që s’ishte njeri, për të cilin, po të mos isha meshtar katolik, do të kisha mujtë me rradhitë këtu një mori epitelesh aspak të kandshme.

Më thirrshin për orë e për çast ndër “sinagoga” – siç thotë Ungjilli – për të më terrorizue e për të më largue sa ma parë prej andej. Më duhej me ecë ma se 16 orë në kambë për t’u paraqitë pranë autoriteteve, ku edhe isha thirrë. E kur mërrishe, lodhë e këputë, më pritshin kërcënimet ma barbare, vetëm e vetëm sepse kremtojshe Meshë në ditë të dielë e në ditë jave. Më akuzojshin se Mesha e len popullin pa punë, se kisha një radio pa leje, se do të më kontrollojshin. E s’vonuen me hy brutalisht atje ku banojshe e me marrë edhe atë të shkretë radio batallë që më lidhte me botën, prej frike se po me atë mund të komunikojshme me Papën e Romës. Më quejshin shkatrrimtar e sabotator të bimëve mjekësore, vetëm e vetëm sepse e kisha porositë popullin të vinte të Dielën e Larit në kishë me gema dafine.

Një ditë në kishë erdhi një katundar me një mëzat, të cilin donte lirisht me ia falë kishës për shpirt të të zot të shtëpisë. Ia morën për duersh dhe e vodhën publikisht për vedi. Si kanë ba pa pikë turpi me të gjitha pasunitë e shtetizuese, ose ma mirë, të vjedhuna!

N'e dielë kisha gjithnjë mysafir në oborr të kishës, kryetarin e degës ose të lokalitetit. Nuk vijshin me pa Meshë, natyrisht. Vijshin me pengue popullin, që kishte fillue mos me shkue në mbledhjet e tyne pa fund, por nuk mungonte kurrë në Meshë. Vijshin e më pengojshin kremtimin shenjt. Bërtitshin në oborr: "Populli nuk ka nevojë për gënjeshttrat tua, ka punë me ne!" Nuk më bahej aspak vonë për miqtë e padishruem, për britmat e tyne, sepse kisha me vedi popullin që, ndonëse tepër i vorfën, kur vinte puna me ndihmue Kishën, nuk kursehej. Ishte populli që i mbante kishat me gjithçka kishin nevojë. Ndërsa shteti nuk ishte në gjendje t'i mbante si duhej institucionet e veta. Shkolla dhe vatra e kulturës ishin si kotec pulash. Si s'mujtën me e ndalue me këtë rrugë pjesëmarrjen në Meshë, filluen akuzat ndër mbledhje e në shtyp. Sekretari i parë i Komitetit të Partisë më akuzoi se i pagëzojshe fëmijët me forcë, se ushtrojshe dhunën mbi popullsinë. M'u sulën, mandej, edhe ndër gazeta. E vijuen me shkruë, deri në "Zanin e Popullit". Preludi i prangave! Kaq shumë dridheshin nga gjurmët që kishte lanë Krishti në ato male të vorfna. Ishin gjurmët e vetme të vërteta morale e kulture, të cilat i kundërviheshin gjurmëve që linte në ndërgjegje shteti imoral, hajdut, gjakpisë e demagog. Anëtarëve të partisë u lejohej gjithçka: puna e tyne kryesore ishte mos me ba asnjë lloj pune, me marrë çka të dishrojshtin, me shti në dorë femnat e bukura, me hangër e me pi ku të mujshin e si të

mujshin. Gëzojshin liri absolute, mbrenda kufijve që u kishte caktue partia. Ndërsa vogjëlia, jashtë kufijve partijake, kishte hupë çdo liri, kishte vetëm detyra e asnjë të drejtë, ishte kthye në epokën e skllavopronarisë. E, më thoni, a mund të rrinte famullitari indiferent para kësaj gjendje? Në atë atmosfere, nuk më mbetej tjetër, veçse të përdorshe fjalët e Krishtit: “Rracë gjarpinjsh, hipokritë, vorreza të zbardhueme përjashta, që qelben me erë kufome përmbranda”. Më vunë pistoletën në kokë, për me më ba me heshtë. E si e panë se nuk e kisha ndër mend me mbyllë gojën, më pranguen, tue më shpëtue kështu nga çdo frikë arrestimi, sepse tashma në birucë të burgut. Qeveria më kishte shpallë luftë me hekur e me zjarm. Skena e luftës ishte tragjikomike: Dom Simoni më njënjë anë – qeveria më anë tjetër. Natyrisht, qeveria mendoi se do ta fitonte menjëhere betejën kundër domit. Kishte harrue se mbas shpatullave të “zotnisë” ishte një “Zotni” shumë ma i madh e ma i fuqishëm, me të cilin nuk mund të haheshin kurrë. Tue e pa se diçka s’shkonte, vendosën me më nxjerrë prej asaj skene, si personazh të padishrueshëm. Atëherë scena e komedisë enveriane u rrotullue dhe u duk dekori i burgut. Njerëzit, që qeveria do t’i qironte nga të gjitha vlerat njerëzore, kishin mbetë mbrapa kuintave. Po herë mbas here nuk do të mungonte të hynte në skenë edhe ndonjë prej tyre.

Të gjitha këto mendime u përshkuen në trutë e mia, ndërsa vijshe në vedi mbas përplasjes ndër dërrasat e qelbuna të birucës, që binte pikërisht nën zyrën e kryetarit, Azem Kërzhalliu.

Nuk e kam ndër mend të përshkruej vujejtet e mia, që pak i interesojnë kujt. Dëshiroj vetëm të mos shkojë kot

dishmia eme, si njeri që ka pa me sy e ka prekë me dorë atë që quhet “e vërteta historike”. Lexuesi ta gjykojë vetë kush ishte kriminelin e kush viktimën.

Sipër Kërzhalliu, poshtë Dom Simoni. Kryepolici në zyrë, prifti në birucë. Nga zyra e tij mbi krye të domit, kryetari i degës ushtronte një terror të pashembullt mbi të gjithë qytetarët e Lezhës, që dishronte me i shti ndër çapoj. Kishin a s’kishin faj, kjo s’kishte asfarë randësi. Faji kurdiset menjëherë, kur duhet. Për ditë ky shërbëtoruc i tiranit të Tiranës thirrte në zyrë 20-30 të pabindun për t’i edukue. Atëherë mbi kryet e Dom Simonit fillonte vallja e shejtanit: ndiheshin hapa të randa, nervoze, që gërdhishtshin dyshtemen me gozha, brima të tmerrshme, ndërmjet të cilave dalloheshin, në kreshendo, kërcënimet: “Të pushoj në vend! Të arrestoj në vend! Të pushkatoj në vend!” Mbas disa ditësh, kur nisa me u familjarizue me torturat e birucës e me Spiro Taten, spijunin që më kishin vu pranë, fillova dal nga dalë të çlirohesh nga ankthi. Kisha pështue, isha shumë ma i lumtun sesa ata të mjerët, që pritshin orë e ças të pushoheshin, të arrestoheshin, të pushkatoheshin – don me thanë, të edukoheshin. Unë tashma isha pushue e arrestue. Më mbetej me krye vetëm detyrën e pushkatimit. Po ndërmjet arrestimit e pushkatimit lakohej rruga e gjatë e Kalvarit! Do të më duhej një kohë tepër e gjatë, e mue tashma nuk më mbetë shumë kohë, me përshkrue shputat, grushtat, shtjelmat e përplasjet për tokë, sa herë bijshe në duer të hetuesve, don me thanë të Shkëlzen Bajraktarit dhe nja katër shokëve të këtij zotnisë. Ma vonë, mbas asaj që kujtuem se ishte shembja e komunizmit, Mark Dema i shkretë më pat tregue se edukatori em kishte gjetë strehë në Romë, në shtëpinë e nuses së nipit, Ines Angjeli Murzaku,

bijë e kryeateistit, dekanit të fakultetit të marksizmit, e cila asokohe na predikonte Ungjillin në Radio Vatikan, tue vijue edhe studimet në Gregoriana, ndonëse Marku, katolik i devotçëm e i kulturuem, me studime të plota në Urbaniana, me peshën e 17 vjetëve burgu politik mbi shpatulla, e kishte kërkuë para saj atë vend. Për çudi, në vend të tij, u zgjodh nusja e re komuniste, në shtëpinë e së cilës shoku Shkëlzen hangri e piu si krajl nja gjashtë muej me pare të Vatikanit, ndërsa dialogonte me shtetin italian për me i shitë sekretet e komunizmit. Sepse more zotni, nuk ishte si shqiptarët tjerë, të marrë. E kishte mësue mirë, ndërsa na torturonte, se kjo botë asht: “Më ep, të ap!” Ndërsa shqiptari din me thanë vetëm “më ep” e “s’kam çka të ap”. Prandej nipat e mbesat e sivëllazënve të mi të masakruem flejshin nën urat e botës së zhvillueme, sepse i vetmi sekret i tyne, ishte martirizmi ynë, që me sa duket nuk i shërbente askujt, veç Zotit në qiell!

Si më torturuen për së mbarit e e panë se me të keq s’delte gjë, filluen me të mirë. Më thirri një nënkryetar dege për me më qortue, tue shti se i vinte tepër keq për mue, për prangat e mia, për nofullat e mia të thyeme... “Po mos kishe hy në rradhët e klerit reaksionar – më tha me keqardhje hipokrite – tashti do të ishe tue punue në radioskopi me doktor Liton. Ç’të shtyri, more i zi, të darovitesh prift?!” I përgjegja: “Për me i dalë zot Krishtit!” Heshti dhe më nisi përsëri në birucë.

Katër muej hetuesi mjaftojshin me krijue psikozën e skllavit. Terrori i gatuyente Shqipnisë brezni skllavësh, që veç deka mund t’i shëronte prej një sëmundje të tillë, hy për palc gjatë torturave me korrent elektrik, bajave me ujë të akullt, thyemjes së kokave, sharrimit të krahëve e të kambëve,

djegies me cingare, nxjerrjes së syve, gozhdimi të gjuhës mbi drunin e tryezës së hetimit, simbol elokuenti i lirisë së fjalës. Koleksion, për t'u qitë në muze, i të gjitha torturave ma të tmerrshme që ka përdorë ndonjëherë njerëzimi.

Për hir të së vërtetës, duhet të thom se kur u arrestova unë, disa prej këtyne torturave nuk përdorëshin ma. Ndoshta sepse skllavët ishin ligështue deri në atë masë, sa për ta mjaftojshin shputat, grushtat, shjelmat, pështymët e përkëdhelje të tjera të kësaj natyre! Ishte prologu i asaj që ma vonë do të quhej demokraci!

Më 1 gusht 1964 më nxorën në gjyq. Salla ishte e mbushun sa nuk xente ma. Në bankat e para ishin familjarët e miqtë e mi, të cilët arrestimi em i kishte tërbue edhe ma keq kundër regjimit, që nuk e kishin dashtë kurrë. Merrni me mend ku mërrijti inati, kur prej asaj sale²⁸ dola i dënuem me dhetë vjet punë të detyrueshme, si kundërshtar i komunizmit serb, rus e kinez, aleatë të Enver Hoxhës, thjesht sepse pa ta nuk mund ta mbante pushtetin. Mandej unë kisha fillue me folë kundër dy të parëve, kur vetë qeveria s'lente gja pa thanë për ta, si në televizor e ashtu në shtyp. Madje i shante ma zi, sepse i dinte punët edhe ma hollë se unë. Faji em ishte se, mbi bazën e një realiteti të tillë, ia kalova qeverisë, tue shpallë, para saj, se së shpejti do të prisheshim edhe me miqtë kinezë: – Prit tashti kur t'i vërsulen me të shame edhe kinezëve – paskam thanë unë – siç u vërtetue në gjyq, prej nga dola me pranga, që do të më randojshin dhetë vjet ndër duer. Për ma tepër e randova vedin edhe me pohimet që bana në hetuesi. U thashë, pra,

²⁸ Besoj italianizëm i vetëdijshëm në mos erratë radhitje', si në rastin e oficer.

hetuesve të mi, se i pari që duhej dënue për agitacion e propagandë duhet të ishte vetë Enver Hoxha i cili, si na kishte lidhë si mishi me kockën me Stalinin me artikullin e famshëm “Kulti i individit”, botue në “Zërin e Popullit”, që në të vërtetë ishte e asht vetëm zëri i tij. Hetuesët e shkretë, që kishin studiue në fakultetin e drejtësisë “Bjeri më hu, se diçka del me shkrue”, hapshin sytë të mrekulluem e, natyrisht, në vijim përdorshin mjetet që i kishin përvetësue gjatë studimeve.

Nuk pranova me punue në kampet e punës, tue ngulë kambë se jam i burgosun i ndërgjegjes, prandej i përjashtuem prej punës së detyrueshme. Madje i këshillova edhe të tjerët mos me pranue. E pse të lavdohej regjimi gjakatar me veprat e naltueme mbi kocat e skllavëve? Mirëpo puna asht në natyrën e njeriut: me ndejë pa ba kurrigia, asht ma shumë se dënim. Prandej një pjesë e mirë, për me shfrye nervat e shkatërrueme e me kalue mërzinë e padurueshme të burgut, shkojshin në punë. Ose thejshin kambë e duer e shkaktoshin infeksione të tmerrshme, vetëm e vetëm për me u çlodhë në spital, ku mund t’i shtrijshin brijtë në një shtrat në vedi, ndërsa në kamp flejshin si thitë në thark. Quhej “makinë mishi” automobili krejt i mbyllun, pa asnjë dritore, që i çonte të burgosunt²⁹ në spital. Diktatori kishte frikë nga drita e prandej edhe nga dritoret: dhe kishte të drejtë, sepse armiku bahet ma armik kur asht lidhë kambë e krye si suxhuk, ruejtë me bajoneta, edhe pse me kocij të thyem; e në këtë rasë mundet me lëshue, prej dritores me hekura, kushtrimin për fillimin e kryengritjes së

²⁹ Shumësi i zakonshëm i shkodranishtes, me bjerrje të zanores (në këtë rast *burgosunët*, jo *-it*). Ndodhë edhe raste të tjera në tekst.

përgjithshme. E ata që ishin përjashta, edhe ma të tmerruem se na që ishim ndër hekura, t'ia fillojshin, tue u dridhë prej llahtarit, kundër-revolucionit! Tragjikomedi skllavësh nga të dyja palët!

Kur e panë se e vetmja punë që më pëlqente ishte me vjedhë vner kundër pushtetit popullor, që e kishte ba Shqipninë bahçe me lule, tue u zburkue me burgje, me kampe përqendrimi, me njerëz të bremë prej ujet, prej terrorit, tmerrit, tuberkulozit, kancerit, sëmundjeve kardiale, veneriane, zboreve, mbledhjeve pa fund, punës vullnetare, shpikjes së përditshme të torturave të reja për kafshërimin sa ma të shpejtë të njeriut, menduen me më edukue në kamp të përqendrimit. Por, mbasi e panë se isha i pandreqshëm, më transferuen drejt e në burgun e Burrelit, ku u vetëparaqita si famullitari i burgut, mbasi të gjitha burgjet duhet të kenë të drejtën me pasë një prisë feje. Drejtori, që ishte gjithmonë toskë, sepse gegës nuk i besojshin, edhe e aq ma tepër kur trathtonte vetveten e bahej komunist, më ndigjoi me gojë haptë e kujtoi se gegët i thojshin famullitar mullixhiut. Kujtoi pra se isha mullixhi, madje, meqë më kishin rrasë aty, kapitalist mullijsh. Por kur i shpjegova se isha meshtar, prift, më tha: “Ç’thua, ore! Fenë e kemi varrosur qëkuri, sepse nuk ka zgjidhur asnjë problem. Problemet i zgjidhë vetëm komunizmi, prandej atij i takon e ardhmja”.

“Gaboni, zotni drejtor – i gjegja – fenë nuk e keni vorrosë e as mund ta vorrosni. Kristianizmi asht fe që jeton prej dymijë vjetësh, tue i kapërcye të gjitha persekutimet, të gjitha polemikat, të gjitha kundërshtimet, edhe ma të mnerrshme se tuejat, prandej ka fitue imunitet të përjetshëm, asht ba fe botënore pse ka dhanë kontributin kryesor

në ndërtimin e qytetnimit të soçëm dhe në ndërtimin e vlerave njerëzore, kurse komunizmi juej ende s'ka mbushë 50 vjet, e ju po hani njeni-tjetrin. Manastirin e keni të bukur, por ju mungojnë murgjit e s'keni për t'i gjetë kurrë”.

Drejtori, edhe pse komunist, u mundue me e mshehë kënaqësinë që ndjeu nga përgjegjja eme, desht të shtonte diçka, por me sa duket iu lidh fjala në fyt. U kujtue se ishte jashtë familjes e se duhej ta luate deri në fund pjesën e vet, prandej u tha policëve: “Këtë mos e dërgoni në dhomë me të tjerët, po izoloni për 30 ditë. Është tepër i rrezikshëm për shoqërinë”.

Më rrasën, pra në birucë, ku për shtroje kisha betonin e lagësht e për shokë, muret e ngushta e të qelbuna. Natyrisht nuk kisha të drejtë me vu në gojë tjetër, veç bukë e ujë.

Oficieri i rojes hapte çdo ditë sportelin e më pyeste në se isha bindë me dalë prej biruce e me ia fillue punës. E çdo ditë i përgjigjesha se s'ishte nevoja me ba mundë fizik, sepse atë e bante buldozeri, të cilin nuk kisha ndër mend me e lanë pa punë. Ai tërbohej e unë vijojshe jetën e birucës. Po Zoti nuk ia lejon askujt, e as diktatorit ma të tmerrshëm, ta bajë të keqen në mënyrë të përsosun. Prandej, kur qillonte ndonjë polic liberal, ndërsa na shoqnonte për në wc, na lejonte me u shmangë atje ku kishim ushqimet personale. Kështu ktheheshim vrap në birucë me ngarkesën e çmueshme: ndonjë kafshatë bukë e ndonjë bataniye për me përballue disi lagështinën e çimentos, që na i shkrinte gjymtyrët e na bante si meit,³⁰ si kufoma të gjalla, që s'kishin ma në trup as mish, as gjak, por vetëm sëmundje. Po, unë,

³⁰ Këtu: si të vdekun.

protestanti i përjetshëm, e sfidova komunizmin: falë shëndetit të çeliktë, dhanti e jetës së pastërt morale dhe marrjes me sport, buka e uji më shndërroheshin në vitamina, karbohidrate e krypna minerale, që ma mbajshin gjithnjë trupin në formë, ndoshta e kryesisht sepse nuk më mungonte kurrë ushqimi tjetër, ma i randësishmi: lutja. Atë nuk mund të ma merrte kush. Në sajë të lutjes dola gjallë prej birucet, ku lanë kocat mija njerëz të pafajshëm. Kur bisedojshe me Perëndinë, e ndiejshe vedin të fortë, të pathyeshëm. Kur më braktisshin forcat e mia tokësore, atëherë ndërhyshin forcat qiellore, që e kanë burimin te urata. Ishte e natyrshme. Kur bashkëbisedojmë me njeri të mirë e të dijtun, marrim forcë dhe e riejmë për një kohë të gjatë frymëzimin që na ka përcjellë në shpirt ky njeri. Merre me mend sa ma i madh asht frymëzimi, kur bisedojmë me vetë Zotin, me Nanën e tij Virgjin, me Engjuj e me Shenjtën, e aq ma tepër kur kungohemi e marrim në zemrën tonë të shkretë, vetë Zotin Jezu Krisht, burimin e autorin e gjithçkahes: të jetës, të qytetnimit e sidomos të amshimit. Mjerë kush nuk e njeh këtë ngushëllim!

Kështu, ndërmjet vujejtjes e shpresës u rrokullisën ditë e net ndër birucat e sigurimit, prej nga dola për të hy në kamp.

Nga deka në dekal!

Në kampin e punës së detyrueshme, ku do të bajshe dhetë vjet “riedukim” gati-gati i harrova të gjitha vujejtjet e hetuesisë, sepse menjëherë filluen të tjerat. E ndjeva vedin keq në mjedis të atij konglomerati shqiptarësh të të gjitha kategorive, të të gjitha krahinave e të të gjitha feve, të cilët i bashkonte vetëm vujejtja e përbashkët. Gjindeshim të gjithë në të njëjtin udhëkryq, nën terrorin e tmerrshëm që

ushtronte qeveria mbi të burgosunit e të burgosunit e ndërkryem, mbi njeni-tjetrin. Ishim të ndamë në tri grupe: të riedukuem, të pariedukuem e të pariedukueshëm. Kategoria e parë gëzonte të drejtën me punue në zyrë. Të tjerët, në minierë, ku nxirrej bakër e pirit dhe puna ishte aq e randë, sa shumë të burgosun aksidentoheshin me dashje, për me pështue prej këtij ferri. Mendo, mandej, aksidentet e padishrueshme e të përditshme. Aksidente ndodhshin përditë edhe në burgun e madh, që ishte Shqipnia, le mandej në thellësinë e galerive, ku askujt nuk i shkonte as e bija e mendes me sigurie kushtet e nevojshme teknike për mbrojtjen e jetës së atyne, që i kishin rrështa aty pikërisht për t'i pa një orë e ma parë dekun. Në kamp më konsideruen përherë dru të shtrembët, që prish barrën, mbasi jo vetëm që vetë nuk punojshë, por u thojshë edhe të tjerëve të mos prekin punë me dorë. Dekë se dekë!

U vuna, pra, në kushte të tmerrshme jetese, në të cilat mund të më fluturonte, bashkë me dhambët e me flokët, edhe kryet. I mbushun përplot me mendime dhe idena të cilat, falë karakterit tem të çiltër i shfaqshë krejt haptas në burg. Madje nuk u mjaftova me i shprehë me gojë. M'u duk e arsyeshme me i hjedhë edhe në letër e me ia dërgue drejtpërdrejt tiranit të Tiranës. Kështu dobare³¹ nuk do të lodheshin tue m'i thye kocijtë një nga një. Do t'm'i thejshin të tanë përnjëherë e unë do të realizojshë andrrën teme të vjetër, ma të bukurën, që ata asokohe nuk mujshin as me e marrë me mend: do të shkruhesha në listën e gjatë të Martirëve të Kishës katolike. Nisa drejt Tiranës letër mbas letret, derisa numri i faqeve e kaloi njëmijëshin. S'lashë gjatë

³¹ Ndajf. *të paktën*.

pa i thanë. I shkrova se partia komuniste s'asht tjetër, veçse shpellë hajnash, imoralash, njerëzish të shitun herë te serbi, herë te sovjetiku, herë te kinezi, të cilët e kanë ba gjithnjë ligjin në Shqipni. I shkrova se anëtarët e Komitetit Qendror s'kishin punë tjetër, veçse me vra, me shnderue, me burgosë, me internue. E kur të kenë mbarue punë me popullin e shkretë, ia fillojnë të njëjtit zanat me të vetët. Shkruejshe e pritshe padurueshëm pushkatimin. Por ata, në vend që me më pushkatue mue, më mbytën me helm vëllanë, Dom Lazër Jubanin. E dijshin se kështu hakmerreshin ma mirë, tue më lanë gjallë e për gazep, me plagë ma të tmerrshme se ato të trupit, në zemër.

E ndërsa flitshe e shkruejshe lirisht e haptas të vërtetën, bajshe gjithnjë ma shumë anmiq, qysh prej qeverie, deri ndër biruca. "Molti nemici, molto onore, ma anche molto terrore!" (Shumë anmiq, shumë nderë, por edhe shumë tmerrë) kanë pasë thanë dikur autokratët. Shumica e atyne, ndërmjet të cilëve më kishte hjedhë urrejtja e diktaturës për Kishën katolike, ishin krejt të papërgatitun në të gjitha drejtimet. Nuk mërrijshin kurrresi me e kuptue se çka don me thanë "prift katolik" e shpesh më shikojshin me gojë hapun, si me pasë ra prej hane. Njeni, madje, mërrijti me më thanë se klerikët nuk ishin tjetër, veçse fëmijë të gjetun në rrugë të madhe për me u ba priftën. Madje, prej të gjitha anëve, e edhe prej drejtorit të burgut, vijshin breshni pyetjesh. Kryesorja: "Pse nuk martohen priftët katolikë?"

Si me ua shpjegue këtyne njerëzve, që gjithsesi nuk do të më kuptojshin? Me u shpjegue arsyen e vërtetë, apo me i ba pak me qeshë? Mendova me e marrë punën me gaz, tue e dijtë qysh ma parë se s'kishte me u ardhë mirë aspak.

U thashë, pra, se kur Zoti krijoi dyrnjanë, qiti në dritë edhe një hoxhë, një pop ortodoks, një prift katolik e tri gra. Njenën e mori popi, dy të tjerat, hoxha. Prifti, mbetë pa gja, iu ankue Zotit. E Perëndia iu gjegj menjëherë: “Merrja uha hoxhës!” Kështu u përgjegja, sepse nuk do të më kuptonte kush, po t’i shpjegojshem se vetë Krishti ka kenë beqar, kurse shumica e priftënve katolikë, deri në shekullin XI, martoreshin. Por një gjendje e tillë sillte shregullime në Kishë, sepse fillonte ndikimi i grues, e çdo burrë i martuem e di se s’mund të bahet kurrë pa marrë ma parë pëlqimin e saj. Mirëpo priftit, që kishte me kenë e mbara me u martue vetëm me Kishën, nuk i ka aspak hije me e kapë për hundet grueja. Për mos me thanë, mandej, se tue kenë i martuem, priftit iu donte me u da dysh: gjysa në familje e gjysa në Kishë, gja që nuk i lente kohë me u përgatitë si duhet nga ana kulturore, e aq ma pak me u thellue në virtyt. Kështu Kisha nuk e kishte atë seriozitet që ka sot. Prandej papa Gregori VII Hildebrandi, që u ul në fronin e Shën Pjetrit në shekullin XI, mori vendim që priftënt të mos martoreshin. E kështu qysh atëherë e deri më sot, kush don me ia hy kësaj rruge të vështirë, duhet të mendohet mirë para se me ia mësy e të bajë ma parë betimin se nuk do të martohet, për t’iu kushtue kështu krejtësisht Zotit e të afërmit.

E shpjegova me dy fjalë historinë e gjatë e jo të pandërlikueme të asaj që, në gjuhën e Kishës, njihet me emnin latin çelibat.

Po të kthehemi përsëri në burg, ku ishim kur e nisëm këtë histori. Si kudo, edhe në burg, terroristët e gangsterët baheshin menjëherë spijuj, për t’i shpëtue kështu dënimeve të randa. Shiteshin për dy aspra, pa u ba fare vonë se ktheheshin kështu në instrumente, që sigurimi i përdorte

lirisht kundër njerëzve të ndershëm. Zakonisht paraqiteshin si filosofjetikë. Shpallshin me za të naltë “idetë” e tyre, ndërsa shumë njerëz të ndershëm, tue e dijtë me kë kishin punë, detyroheshin me ua pranue të gjitha dokrrat. Njeni prej tyre, që s’kishte kurnjë ndihmë prej familjes, merrej me qepjen e rrobave të të burgosunve, për me fitue një kashatë bukë. Një ditë i dhashë me më qepë peliçen, apo jorganin e Stalinit, si i quejshim me tallje xhaketat e shëmtueme, të mbushuna me pambuk, që mbajshim në burg për t’u mbrojtë prej të ftohtit. Kur kreu punë, e pyeta : “Si don me të pague, si në Bashkimin Sovjetik, ku ke zemrën apo si në U.S.A?” M’u përgjegj aty për aty: “Si në Shtetet e Bashkueme”, sepse e dinte që rrezikohej me u nda me një grusht miza, si njohës i mirë i punës vullnetare që duhej të ishte.



Torturat

Nuk e di nëse e ka studiue kush historinë e torturave qysh se asht krijue njerëzimi. Sidoqoftë, duhet të jetë një histori tepër e pasun me modele, e sidomos me dhimba. E nuk e di as në e ka shkruie kush historinë e torturave në burgjet komuniste të Shqipnisë, si kontribut për historinë botënore të torturave, që mërrin deri atje, sa me kryqëzue vetë Zotin. Po mundohem me dhanë kontributin tem, tue përshkrue çka kam ndie e çka kam provue mbi shpinë.

Disa prej torturave të zakonshme, pa shumë fantazi ishin: sharrimi i duerve e i kambëve, natyrisht pa anestezi, frymja e trupit me pompë, varja për kambësh ose për krahësh në një pemë në mes të dimnit në murla, derisa paralizohej gjithë trupi. Kjo torturë zbatohej edhe ndër kampe, kur ndokush nuk e realizonte normën.

Mandej shtrëngimi i gjymtyrëve me hekura, që hyjshin thelle në mish, ndërsa gjaku rridhte pika-pika e formoheshin plagë të randa, të cilat shumë shpejt ktheheshin në gangrenë. Vijshin mandej me rradhë puna e randë fizike me orë të zgjatuna, izolimi ndër biruca frigorifere, rrahja deri në shtrim në spital.

Një prej torturave ma të tmerrshme ishte zhgjujla e mustakëve me pinca. Jo aq për shkak të dhimbjes fizike që s'ishte e paktë, sa të asaj morale, sepse – zhburrnimi ma i tmerrshëm. Mesa duket këtë torturë, si shumë të tjera, komunistat e kishin mësue prej orientalëve, të cilët e përdorshin sa herë dojshin me mbytë kend, tue e lanë gjallë e për gazep. Burri, të cilit i zhguleshin mustakët, nuk e delte

ma kurrë prapun e shtëpisë, përveçse në tabut! Ishte e tmerrshme me i pa burrat e maleve tue dalë prej qelisë me alamet mustakësh e tue u kthye me një njollë të kuqe gjaku aty ku pak ma parë kishin pasë simbolin e të qenunit burra. Qyqarët!

Kam njoftë ma se një shok mjerimi, që i kishte sjetullat të zgropueme, me kocat jashtë, për shkak se ia kishin djegë mishin me voe të sapoxjerruna prej ujit të vluem; ashtu edhe të tjerë, me shpinën bira-bira prej thumbave puntinë të ngulun gjatë hetuesisë ose prej cingareve të fikuna në mish të gjallë. Ma me fantazi ishte tortura e thesit: të burgosunin e futshin në një thes. E që të mos mërzhitej vetëm, me të mbyllshin edhe dy-tre daca. Si u bajshin të gjithë bashkë, thesit ia mbyllshin grykën. Atëherë fillonte dajaku, ku të kapte herë mbi njeriun e herë mbi dacat, të cilët të tmerruem prej të rameve, ia shkyejshin njeriut trupin me thoj e me dhambë. Kishte raste kur hetuesinë ta bajshin mbrenda në arkivol, me kambë e duer të lidhuna e të mundojshin aq, sa rrezikoheshë mos me u çue ma prej andej. Kur torturat mërrihshin kulmin, të burgosunit ja zhgulshin një ka' një dhambët, prej frike se han gjuhën e vet, e s'mund të trillojë ma sa krimet e veta e as të tjerëve. Mandej çuditen njerëzit kur më shohin pa dhambë. E kur u thom se s'mund t'i duroj ma dhambët në gojë. Kam frikë, mor zotni, se ha në dhambë gjuhën teme, shi tashti që asht disi e lirë, e nuk mundem ma me tregue çka kam pa e provue. Shpesh njerëzit në hetuesi shndërroheshin në kandelabra³² të gjallë: ndër thojtë e tyre nguleshin kuja pishash, të cilët mandej ndezeshin e flaka ushqehej me

³² *Shandanë.*

mishin e djegun të gishtave. Mandej vinte tortura e pagjumësisë: domethanë me të lanë pa gjumë me javë të tana, e për me ta nxjerrë gjumin, me të flakë në birucë me një gju ujë mbrendë. Mandej tortura e pikës së ujit: të leshin kambë e duer të lidhë ngri, ndërsa një curril uji rridhte ritmikisht, pa pra, pa u lodhë, mbi krye tand: tak, tak, tak, tak... Ishte një tmerr i vërtetë, që të bante me harrue gjithçka e mos me u kujtue kush je, prej ka ke ardhë e ku don me shkue. Ky tmerr kishte një qëllim të vetëm: me i ba të burgosunit me marrë frymë me mushknitë e Enverit, me shikjue me sytë e tij, me ndigjue me veshët e tij, me folë me gojën e tij, tue i hupë të gjitha cilësitë vetjake që e dallojnë njeriun prej njeriu! Hiç ndryshe, veç njashtu si kishte ba vetë Enveri, që s'ka marrë kurrë frymë me mushkni të veta, as folë s'ka me gojë të vet, por herë me gojë të Stalinit, herë të Titos, herë të Mao Ce Dunit, herë me gojë të gjallësh e herë të dekunsh... Deri sa mbet fare pa gojë e iu desht mandej mbasardhësit të tij me i mbledhë të tana gjuhët e preme burgjesh e me i ngucë me folë medemek lirisht, për me krijue idenë se kishte ardhë "demokracia". Sepse janë gjuhët e preme dje, ato që flasin sot!

Në fillim këto tortura zbatoheshin mbi trupin e të burgosunve ma të rrezikshëm e ma të panënshtuem. Mandej filluen me i ruejtë për shokët e vet, që përfunduen njeni mbas tjetrit ndër biruca, due të thom, për udhëheqësit e partisë, shokët e Enverit, si Kadri Hazbiu, Beqir Balluku e ndonjë tjetër komunist që thohej se nuk u ishte bindë urdhnave të Komitetit Qendror.

Kur merrte fund hetuesia e shokëve të partisë, ata delshin para gjyqit të shkatërruem plotësisht. Ishte e natyr-

shme. Prej parrizit³³ komunist ku jetojshin vetëm ata, kishin ra në fund të ferrit, ku jetonte populli që udhëhiqshin. Ishte e drejtë të vuejshin si të tjerët. Po shokët e partisë i bajshin me vuejtë edhe ma keqas se të tjerët. Natyrisht prej gjyqit delshin të dënuem me deké. Por, para se të pushkatoheshin, xhelatët kishin urdhën t'u pritshin hundën, t'u cungojshin veshët, t'ua stolisshin trupat me thika, biza³⁴ e stoli të tjera të kësaj natyre, që të shkojshin në vorr si prisat kundërshtarë të fiseve të egra, siç edhe kishin qenë. Atëherë në burg ndigjoheshin ulërime të llahtarshme, që edhe sot e kësaj dite, kur i kujtoj, më përqethet shtati. Mbas ulurimave, vijshin krismat e tmerrshme të hekurave, që hapeshin. Ishte preludi i pushkatimit, i shpëtimit, i lirisë. Njeriu pa hundë, pa veshë, pa kambë, pa krahë e ndjente veten krejt të lumtun, kur e zvarritshin për pushkatim, njashtu të sakatuem.

Kur vizitova Moskën, shoqnuesi më tregoi degën e punëve të mbrendshme që shtrihej në mjedis të kryeqytetit si një gjarpën gjigant. Në thellësitë e errëta të kësaj ndërtese ogurzezë ishin podrumet, ku kishin pësue të njëjtin fat Penkovski, Beria e shumë shokë të tjerë të Stalinit, nga i cili e kishte mësue mandej mjeshtrinë e kasapit “udhëheqësi ynë i lavdishëm”.

Në vende të tilla njeriu mund të shpëtonte vetëm nëse kishte hirin e lutjes: përndryshej s'mund të bante tjetër, veçse të blasfemonte.

³³ *Parajsë*, grafolekt katolik i zonës së Shkodrës, burimisht prej ita. *Paradiso*.

³⁴ Në Shkodër *biz* i thonë *fëndyellit*, një mjet këpucëtarie (zakonisht) i përballë prej një hekuri majehollë me dorcë druni, i cili shërben për me çilë bira në këpucë.

Nuk gëzohem për fundin e kurrkujt e as s'ma lejon feja, në të cilën besoj me gjithë shpirt. Por natyrisht që ndiej një keqardhje shumë ma të madhe për bashkëvëllazënt e miqtë e mi, sesa për ata të diktatorit, ndonëse lutem njëlloj për të dyja palët. Kujtoj se të njëjtin fat kanë pësue Sulçe Begu, i torturuem në mënyrën ma shtazarake, Dom Lazër Shantoja, që e zhgrranë drejt gropës me kambë e duer të sharrueme, Dom Lekë Sirdani e Dom Pjetër Çuni, të mbytyt në një gropë nevojtoje, mbasi u kishin pompue zorrët me pompë makinash. E jo ma pak ata që i çojshin deri te gropa e hapun, për t'i pushkatue, mandej i kthejshin përsëri në birucë, ku i ftojshin t'i vejshin gishtin kresë e të nënshkruejshin, tue pranue faje të trillueme. Ka njerëz që kanë shkue disa herë buzë vorrit e si janë shkatërrue psikologjikisht, sepse të dekun e të ngjallun disa herë, nësa njeriu des një herë e s'ngjallet ma për këtë jetë, kanë ra në kurthë e kanë firmosë. E mbas suksesit që asht mërrijtë me firmat e këtyne të dekunve, hetuesi shpërblehej nga ministria e brendshme, sepse kishte shpëtue regjimin nga rreziku i sigurtë i kundërrevolucionit!

Ndërmjet nesh kishte edhe njerëz, që e kishin sjellë kokën nga Bota e Lirë, në Shqipni, ku kishin ardhë me shijue realitetin e mrekullueshëm të ditëve tona, që ua kishte paraqitë aq të lustruem propaganda komuniste, e cila kur ishte fjala për me vu në jetë parullën ma donkishoteske: "Idetë e Partisë së Punës, janë e ardhmja e botës", nuk pritonte me e zgjidhë mirë qesen mbushë me djersë e gjak popullit. E mbasi e shihshin me sytë e tyne si ishin punët në realitet, të mësuem si ishin mos me i vu kurrfarë hallke gojës, nisshin me folë pak si tepër. Atëherë, për me shijue me fund epërsitë e komunizmit mbi kapitalizmin gjakatar,

përfundojshin pranë nesh ndër biruca. E, të mësuem shumë ma pak se na, me i ba ballë së keqes, virshin vedin me çarçafa ndër hekurat e dritoreve. Ose, ende ma keq tue besue se edhe këtu mund të përdroreshin format e rezistencës, që janë të zakonshme në botën e lirë, ku edhe ishin mësue, disshin gjatë grevës së urisë. Don me ndejë pa hangër? Aq më mirë. Ia kursen qeverisë edhe atë copë bukë me krymba! Në të vërtetë, të gjithë ishim në njëfarë mënyre në grevë të përhershme e të pavullnetshme urie. Uja aty ishte aq e tmerrshme, aq ngacmuese, sa të tanë kishim përshtypjen se një qen i madh na kishte hy në bark e aty rrinte tue na gërrye zorrët me nge, i patrazuem prej kurrkujt. Një torturë e hatashme kjo, që i shtynte të burgosurit deri atje, sa ta mshehshin shokun e dekun, për me i marrë racionin e bukës. Ishte aq i vogël i shkreti racion, sa shumica e hajshin përnjëherë, pa lanë kurrnga për darkë e për mëngjesin tjetër. Atëherë qeni rifillonte gërryemjen ndër zorrë, e në dhomë shtohet një i dekun tjetër, don me thanë, një racion ma shumë për të nesërmen.

Uria i shtynte shpesh të burgosunit me hangër të vjellat e shokut të sëmutë, që s'i barte ma stomaku i shkatrruem kurrfarë ushqimi, madje me hangër edhe vetë të dekunin. E mandej kur vijshin me marrë kufomën, vërejshin se i mungonte një dorë a një kambë. Shenjat tregojshin se ishte bre e besojshin se e kishin bre mijtë, që sillleshin me shumicë rreth nesh, tue na ba shoqni.

E torturë ishte edhe çasti i kryemjes së nevojave personale. Na kishin rrasë njeni mbi tjetrin, si sardelat në kuti në një odë të ngushtë, ose në një kaponon, ku jetojshim bashkë burra, gra e fëmijë, djelm e vajza. E aty, në sytë e të gjithëve, ishe i shtrënguem me krye edhe nevojat personale.

Më ka mbetë në mend si një prej torturave ma të tmerrshme, sepse ma e neveritshmja, që s'mund të tregohet me gojë.

Aty kuptova se njeriu i shtrimë e ndien vedin shumë ma kafshë se asht në të vërtetë. Ndoshta i duken edhe duert si kambë, ashtu plandosë për tokë. E tue kenë ngjeshë njeni mbas tjetrit, në mungesë të seksit tjetër, tek kafshët e flakuna mbi atë tog me kashtë lindte instinkti i ndytë. E ndodhte që ndonjë i burgosun nuk mujte ma me i qindrue këtij tundimi, e i verbuem prej epshit shtazarak i turrej atij që kishte pranë. Shpesh këta soj mashkujsh ishin edhe spijuj e ndoshta-ndoshta mendojshin se po i epshin një kontribut të ri Enver Hoxhës, tue i përdhosë në trup e në shpirt anmiqtë e tij. E merre me mend çka ndodhte me viktimën, që zgjohej trembshëm prej turret të tjetrit, me të cilin ishte ngjeshë e ngjitë. E me të tjerët, që rradhiteshin si tullat pilë.³⁵ Atëherë në qeli fillonte dalldia e përgjithshme, që shpesh përfundonte me grushtat e shtjelmat, shumë të nevojshëm për me shue instinktin shtazuer që i shtynte qenjet e arsyeshme të katandiseshin në katërkambësja. Ka ndodhë madje që njerëzit e kapërthyem t'i xjerrin deri sytë njeni-tjetrit. Unë kam kenë dishmitar i skenave të tilla, në fund të të cilave bahej gjyqi, sa i ndytë, aq qesharak, që përfundonte gjithnjë me dënimin e viktimës, don me thanë me shtimin e vjetëve gjatë të cilave do t'i takonte me provue rishtas sulmin e shtazës.

E jo ma pak torturë, kur pushkatojshin njerëzit ma të çmueshëm të burgjeve e të kampeve, e na ishim të shtrënguem me kenë spektatorë. Si i pushkatojshin, përsëritshin shfaqjen që u luejt sa herë te Zalli i Kirit: i vejshin

³⁵ Vendue vertikalisht.

kufomat e përgjakuna në trajtë rrethi, me qeleshe më nje-
nin sy e cingare në dorë. E mandej skuadra e pushkatimiit
këndonte valle labe e korçare rreth tyne. Koncert ma të
llahtarshëm besoj nuk ka pa kush në botë!

Më kujtohet se disa prej shokëve të mjerimit, tue
mos mujtë me i durue ma këto tmerre, çmendeshin; ose, në
rastin ma të mirë, shtriheshin si të çmendun, tue hangër
jashtëqitjen e vet, për me shpëtue jetën, që po i shkimbej
përditë mbas telave me gjemba. Më kujtohen edhe me
emën. E emni i parë që më vjen në kujtesë, asht ai i Muha-
met Kosovrastit.

Në mozaikun e torturave që komunizmi ka ushtruar
mbi mish të gjallë e mbi nerva, sigurisht nuk mund të mos
jem i pranishëm edhe unë. Sa herë kalojshe në hetuesi,
hetuesi epte urdhën të m'i shtrëngojshe hekurat, derisa më
hyjshin thellë në mish. Pikë-pikë, gjaku skuqte hekurat e
pikonte në dysHEME. Atëherë hetuesi epte urdhnin e dytë,
të m'i tundshin duert, tashma mish i gjallë, që dhimbja të
bahej sa ma e padurueshme. E kur më binte të fikët, ai
“samaritani i mirë”, përkulej mbi mue e m'i mjekonte plagët
me duhan. Mandej, sapo hapshe sytë, ia niste rishtas
shtjelmave. Si i lodheshin kambët, merrte dajakun. Mandej
më lidhte, më rrëxonte për tokë e më hynte përsëri në
shtjelma, tue më dhanë goditje mbi trup, aty ku i kapte
kamba. Qyqari. Kur kthehej në shtëpi, sigurisht ankohej se
ishte lodhë e këputë tue punue për ndërtimin e socializmit
në Shqipni. Sepse, si rraskapitej, ulej në karriken e zyrës e
më pyeste egërisht: “Do ta tregosh apo jo aktivitetin tënd
anmiqësor, do t'i tregosh apo jo bashkëpunëtorët!” I përgji-
gjesha: “Posi jo, po t'i tregoj menjëherë: kam bashkëpunue
me Mojzehin, me Elinë profetë, me Izainë, me Ezekielin,

mandej me Krishtin. “Çthua, ore – çakariste sytë tjetri. E fëtyra i mbushej me shpresë se ma në fund e kishte zbulue gjithë rrjetin e spijunazhit. – Cilin Kristo, si e i ka mbiemnin, ku banon?”. “Banon në Ungjill” – përgjigjesha, me humorin e njeriut, që i ka gjysën e kocave të thyem, por që mbështetet në një forcë, të cilën hetuesi nuk mund ta kuptonte kurrsesi, ashtu si nuk i kuptonte as emnat e atyne, që ishin me të vërtetë bashkëpunëtorët e mi ma të afërt, prej të cilëve e pritshe pëshitimin në atë zezonë që më kishte ra mbi krye.

Një ditë të përvëlue me Gushtit, polici i burgut të Burrelit hyni në qelinë ku më kishin shti, së bashku me 35 vetë të tjerë, shumica ordinerë dhe i tha njëfarë Sokol Martinut, gangster i njoftun: “Sokol, rrahe Dom Simonin se flet kundër qeverisë!”

Në fakt asnjë prej gangsterave nuk luejti vendit. Nuk kishin luejtë as herë tjetër, kur u kishin dhanë këtë urdhën, sepse jo gjithnjë zbatoheshin urdhnat e policëve. Njerëz si Sokoli baheshin shumë shpejt spijuj, por e kishin gjithnjë njëfarë nderi: iu duk pra, ligshiti me u kapë kotnasikot me një burrë të vjetër, me flokë të bardhë, si isha unë. Mandej jeta e tmerrshme që kishin ba, nuk ua kishte shlye krejtësisht njëfarë respekti për priftin. Në fund të zemrës së tyne të prishun vijonte me u ndie zani i Zotit.

Mbas do kohet, nuk e di pse u hap dera e dhomës sonë. Në derë po ruente i njëjti polic, Mustafa Lika. Memëzi ç’prita me dalë te dera e me folë me të: “Jam dënue me burg – i thashë – sepse flas e protestoj kundër padrejtësive të kësaj qeverie. Jam dënue me burg, por jo me u rrahë prej të burgosunve, me urdhën tand. Ti e ke veshë këtë uniformë me vu rregull e jo shrrëgull. Ti po e përdor uniformën për

me përça e me shkaktue turbullina edhe këtu, në këtë vend mjerimi, ku na ka rrasë padroni yt, Enver Hoxha, të cilin s'kam ku e gjej këtë çast se do t'ia kisha thye turijtë. Po meqë ai s'po më ndodhet ngjat,³⁶ po t'i thej ty, që je përfaqësuesi i dejë i tij!" Një të thanë e një të ba, t'ja ngjesha një grusht të fortë turijve e t'i shkoi kapelja pesë metra larg në koridor. Atëherë hynë në fushë të betejës spijujtë e burgosun Jorgo Laboviti e Rexhep Lazri, të cilët m'i banë turijtë pshesh me grushta, pa vu në hesap të shamet, sepse kisha marrë guximin me rrahë policin. E të mendosh se të dy ishin të burgosun politikë si unë.

Ishim mbledhë nën një pullaz pa u njoftë, jetojshim pa u dashtë e disshim pa u kja. Madje deka e njenit ishte jeta e të tjerëve.

Kallëxova një episod të vetëm të ndeshjes me policët, sa për me e kuptue pse s'mujta me e përmbajtë vedin mos me ra në kurtha kësisoji, unë që isha meshtar, që nuk më lejohej me përdorë grushtat, madje as me i mendue ndopak. Por kallëxojnë se një herë, në sapo delte prej kishe, një kapuçin u ndodh ballë për ballë me një anmik të betuem të Krishtit, i cili pa kurrfarë arsyeje, ashtu si policët mue, t'ia dha një shputë të fortë në njenën faqe. Si e pa se sytë e kapuçinit u ndezën e tue pasë kenë ai alamet viganit, fill mbas shpullës i kujtoi: "Thue të shkon mendja me ma kthye shputën? Ke harrue ndoshta se Ungjilli, të cilit i je kushtue thotë: Kur ndokush të bje një shputë në njenën faqe, ktheji edhe tjetrën?" Kapuçini, pa e zgjatë ia ktheu përvujtnisht edhe faqen tjetër e ai t'i ndeji gati me një shputë të dytë, që la shenjin e pesë gishtave në faqen e rregulltarit, ndonëse

³⁶ Ndañf. sin.: afër.

mbulue me mjekërr. Si kishte krisë edhe shputa e dytë, kapuçini iu kthye njeriut që i kishte ra e i tha: “A u ngive? Tashti Ungjilli flet vetëm për shputa e faqe, po nuk thotë kurrëgjia për shtjelma, prandej, si e zbatova pikë për pikë, tashti e kam rradhën unë!” E t’i hyni në shtjelma atij zotnisë, që dinte me e zbatue Ungjillin me shputa. N’diç!

Deri misionarët e huej e kanë marrë vesht, nga ata që kanë kenë me mue në burg, se unë gjoja i paskam ngucë vetë policët e drejtorin e burgut, tue e kërkuë kështu me dashje belanë. E atëherë natyrisht, ka krisë mbi trupin tem dajaku, janë shtue torturat e dënimet. Me një fjalë ishte dashtë me ndjekë moralin e të ligshëve; me u ba hipokrit, servil ose me ulë kryet e mos me ba za. Me e pasë ndjekë këtë soj moralit. Krishti nuk ishte kryqëzue: i ishte nënshtrur judejve e Pilatit e gjithkujt i kishte kalue ngjat e kishte vijue me ça dërrasa në shtëpi të karpentierit. E na kishim mbetë nën peshën e mëkatit mortar, pa shpresë shëlbimi. Në ndjekjen e moralit të krishtenë s’lejohet kurrfarë kompromisi, s’ka rrugë të ndërmjeme, por ka vetëm bardh e zi, pozitiv e negativ. Në moralin e krishtenë, kush nuk asht me mue, asht kundra mejet. E natyrisht që në burg policët nuk ishin me mue. Madje ishin aq kundra mejet, sa me m’i mohue të gjitha të drejtat. Çka kisha me ba unë atëherë? Me u nënshtrur? Me lavdue regjimin, si bajshin shumë prej shokëve të mi të mjerimit, vetëm për me shpresue se do të më lirojshin një ditë ma parë? Ç’vlerë do të kishte për mue ajo ditë? Me dalë prej burgut të vogël për me hy në burgun e madh i mbuluem me danga në ndërgjegje? Faqet e mia ishin të masakrueme prej pështymëve, shputave e grushtave: përdora edhe unë shtjelmat, e pranoj. Por forma ma e randësishme e kundërshtimit ishin letrat që i kam shkruë

Enverit e udhëheqësve të tjerë kryesorë. Nuk e di se ku kanë shkue me mbarue. Kishe pasë aq shumë dishirë me i rradhiti këtu në këtë libër. Po Dom Simonit nuk i asht lejuë kurrë me ba kërkime ndër arkiva. Këtë privilegj e kanë pasë vetëm ata që kishin udhëzimet përkatëse, ku, si, e sa me kërkue. Dom Simoni nuk i ka njoftë kurrë këto masa, prandej nuk mundet me pasë as letrat e veta, shkruë me gjak në qeli. Duhet me thanë shyqyr që kur dola prej burgut e kisha ende në rregull rrashtën e kresë, arkivin ku janë ruejtë me fanatizëm të gjitha kujtimet, shkruë ndër dredha truni. Ndoshta po baj gabim të randë që po e rrëfej këtë sekret, tue u rrezikue që qeveria të ma hjekë ma në fund rrashtën për me e shti në arkivin sekret të shtetit, e si ta ketë shprazë aty, me e vendosë mandej në muzenë kombëtar, si rrashtë tipike shqiptare. Në të vërtetë dajakët, grushtat e shtjelmat, si e thashë edhe ma sipër, më kishin ngjallë një dishir edhe ma të madh se kundërshtimi: atë të pushkatimit. Dojshe me u pushkatue, prandej i shkruëjshe ato letra. Pushkatimi do të më pështonte nga rreziku i tmerrshëm i ramjes morale, që e lexojshe përditë në fëtyrat e shokëve të mi të mjerimit, të cilët shpesh pa dashtë e me bremje të mëdha ndërgjegje, baheshin spijuj e merrshin njeni-tjetrin në qafë. Po Enver Hoxha, e dinte se ndërmjet vujtjes së vazhdueshme e dekës, ka një ndryshim të madh; prandej mbeta gjallë. Njëfarë Qamil Hajdinit, kosovar, filloi edhe ai me shkruë letra. Por s'muejti me vijue gjatë. U dorëzue e u lirue me kusht para kohet. Në të vërtetë, nuk ia vlente barra qiranë me jetue ndër kampe e burgje, ku vujtjet e zgjatuna i katandisshin njerëzit në shtazë, fjalë që përmbledh të gjitha veset e shfrenueme. Nuk më vjen aspak keq që kam kundërshtue e madje të vetmet medalje të meritue me që kam marrë gjatë

jetës seme, janë pikërisht gjurmët e plagëve të dukshme në trupin tem, dishmitare të koherencës, prej të cilës s'kam hjekë as s'hjeka dorë. Madje shumëkush mund të më quejë anormal, po do të vijë dita që me thanë: "Paska pasë të drejtë Dom Simoni!" Uroj të mos jetë tepër vonë.

Kam provue shtjelmat e shumë hetuesve mbi kocij-të e mi, por jo të gjithë meritojnë të përjetësohen: pa ia hangër meritat të tjerëve, në kujtesën teme, e jo ma pak në trupin tem, kanë lanë shenja të pashlyeshme veçanërisht Bib Ndoci prej Fanit të Mirditës, Shkëlxen Bajraktari dhe shoku Cirjaci ose Cirjazi, të cilit nuk mujta me ia mësue kurrë emnin e vërtetë, sepse sapo shfaqej ai në skenë, unë kalojshe menjëherë në botën tjetër prej torturave, të cilat ai i drejtonte me aftësinë e një drejtori orkestre. Ishte i dërguem drejtpërdrejt nga Ministria e Brendshme si dirigjent i orkestrës makabre, për me luejtë simfoninë e krimit mbi telat e nervave të mia. Duhet të pohojshë medoemos se kur më arrestuen isha gati me dhanë sinjalin e kryengritjes së përgjithshme, që synonte rrëzimin e pushtetit.

Gjithsesi tortura ma e tmerrshme ishte kur i burgosuni, që kishte hy në burg si njeri i ndershëm, thehej. Vujejtja gatiente te ai spijunin. Nëse përdorim fjalorin e drejtorit të burgut, rehabilitohej. Atëherë vujejtjeve të zakonshme të burgut, i shtohet vujejtja ma e mnershme: therja e ndërgjegjes, që nuk të len të qetë ditë as natë. Në burg hynte Meduza e fishkëllima e gjarpijve të saj shqetësonte natën e birucave e të qelive. E kësaj vujejtje, i shtoheshin torturat nga të burgosunt e tjerë e nga parazitët. Morrat ishin një armë e vërtetë në dorën e komunistave. Askujt s'i ka shkue ndër mend me i braktisë pushkë e topa e me luftue vetëm me morra! Për ta asgjasue pa kusht kundërshtarin, i

cili s'mendon ma për tjetër veçse si me u krue me një kruemje pa fund, gjithëherë, gjithëkund. Njëzet e pesë vjet më kanë hangër morrat e më kanë ardhë hakut horat! Spijujtë e gangsterat, që bajshin çmos me u lirue para kohe, pa llogaritë se shkelshin mbi gjakun e të tjerëve.

Këto ligje e këto diktatura sigurisht nuk i përmban *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, që po përdoret edhe sot e kësaj dite kundër popullsisë së veriut nga klani i Tiranës, i cili vijon me shkelë me kambë e me poshtnue Gegëninë. Kanuja nuk e pranon vrasjen tinëz të qytetarit, dënon randë mbytjen me helm, vrasjen me aksident, mbas shpinet; ligje këto të pashkrueme në kanu të sigurimit të shtetit shqiptar, që ka ndërrue lëkurë, por jo ves! Asht i gjithëpranishëm në pyllin ma të errët se kurrë, që quhet Shqipni. Kanuja e Lekës asht shumë ma progresive se të gjitha ligjet që janë zbatue në Shqipni, qysh prej ditës ogurzezë 29 Nanduer 1944. Vetëm kur historia e Shqipnisë, ta quejë këtë ditë ma të zezën e historisë së Kombit. Atëherë po, mund të shpresojmë se jeta mund të nisë aty ku e lamë, para '44-tës!

E vetëm atëherë kanë me na u xi rishtas flokët e kanë me na dalë dhambët!

Burgu i Burrelit

Qe si ishte i organizue burgu i Burrelit, ky ferr ma i keq se ai i Dante Alighierit. Për të ishte krijue rima e kobshme “Burrel – hyn – e s’del!”, sepse muret e tij naltoheshin mbi eshtë. Rreth e rreth ishin vorret e rrafshueme të të burgosunve, mbulue me dhe si shtazët, pa kurrfarë nderimi mbas torturave çnjerëzore, për të vetmin krim se besojshin Zotin dhe kërkojshin të drejtat e njeriut. Eshtënt e tyne dergjen gjithnjë atje ku i kallën, pa kurrnjë shenjë nderimi, pa lapidarë e monumente, që i meritojnë ma shumë se askush, ndërsa ndër sheshet tona lartohen monumentet e atyne që luftuen nën flamuj piratësh. Gjithfarë kokodrilash e peshkaqenësh.

Në Burrel jetojshim të ndamë e në dhoma tetë me katër, shtruve me një dysHEME çimentoje. Dergjeshim në këtë hapësirë mbi 36 vetë, shtri njeni bri tjetrit ndër dyshekë me kashtë të qelbun. Ndihehim si sardelet në kuti. E njëjta odë ishte fjetore, odë buke, nevojtoje, sallë leximi. Qelbej aq, sa me të ra të fikët e ziente gjithnjë prej një zhurme, që të krijonte idenë se tashma të gjithë kishim marrë dënimin e përjetshëm, në fund të ferrit! Ndihehim ma keq se bagëtitë në stallë, sepse ata së pakut dalin në diell e kullosin. Ndërsa na ishim ma të paracaktuem me u zhdukë në terr të territ, të djegun nga malli për një rreze dielli, për një lule, për një fëtyrë fëmije! Mund të merret me mend si zhgatërrohej sistemi nervor i të burgosunve, për shkak të jetës që ishte mbyllë në atë skëterrë, ku rrahja e përgjakja ishin ngjarjet kryesore të ditës. Për me harrue mjerimin, të burgosunit

lojshin bixhoz: ai që hupte, i lëshohej si lugati atij që fitonte: atëherë kryste grushti; mbas grushtit, dukeshin thikat, të cilat kishin lindë në trajtë luge e mandej, nga mjete paqësore, ishin kthye në armë. Si jashtë, edhe në burg, të gjithë mbajshin anën e ma të fortit, tue e zblue lakuriq karakterin e vet. Gjithçka ishte si jashtë, si nëpër ndërmarrje, ku në vend të operativit, ishte shefi i kuadrit e në vend të drejtorit të burgut, drejtori i ndërmarrjes. E sa për rrjetin e spijujve, ishin edhe ma të rrezikshëm jashtë, se mbrendë. Si atëherë, ashtu edhe sot, rreti i sigurimit ishte shumë i trashë, pa takt, pa dorca.

Ata që nuk mund ta durojshin këtë mënyrë jetese, çmendeshin. Atëherë ia behte “makina e mishit” që i merrte e i çonte në psikiatri, ku ishte edhe ma keq, sepse doktorët e infermierët ishin shërbëtorë të kryekatilit, Hoxhës, që nuk e njihnte betimin e Hipokratit, prandej e kishte vendosë fronin e vet mbi jetën e çdo shqiptari, me bindjen se diktatura forcohet vetëm kur ngrihet mbi eshtën njerëzish. Psikiatria, pra, ishte një ndër rrathët ma të rrezikshëm të ferrit tonë. Atje të sëmutëve u shkaktojshin plagë të randa për t’i mbajtur të mbërthyem mbi shtrat e sidomos, për t’i çue sa ma parë në gropë, si anmiq të popullit që ishin. Shpesh prej andej ndiheshin britma të tmerrshme: ndonjeni, tue mos mujtë me durue ma, virte vedin në hekurat e dritores. Si e hiqshin prej andej, të gjithë ia kishin lakmi, sepse e ndijshin vedin ma keq se kafshët. E andërojshin, madje, jetën e kafshëve, sidomos kur gjethonte pranvera. Kafshët delshin ndër livadhe të blerta, kullotshin në barin e njomë, blegërojshin e ndijshin tingujt muzikorë të kumbonëve, varë ndër qafat e tyne. Koncert i Çobajve! Po kasapi? – do të pyesë ndokush. A s’ishim edhe na të paracaktuem për të

kalue nën tehin e varcikut? Veçse pa diell, pa bar, pa lule, pa tinguj kumbonësh! Madje as në mort tonë s'do të vajtonte kumbona, sepse e kishte ba tashma vajin e fundit në mort të vet, kur e patën rrokullisë prej kumbonares. Ishim mbyllë deri ndër graham në atë birucë të qelbun, tue ia ngulë vështrimin një cope qielli të shkyeme prej hekurave, tue ndie vetëm rrenat e Radio-Tiranës. Shifshim çdo çast vetëm fëtyrat e njeni-tjetrit, të policëve, të hetuesve, që lëshojshin shkëndia urrejtje kundër nesh; muret e trasha, të himta, që na ndajshin nga njerëzit e dashtun, nga bota, nga liria, për të cilën ishim krijue e kishim ardhë në këtë botë. Të njëjtat mure, të njëjtat fëtyra, të njëjtat tela, të njëjtat spijuj, shokët tonë, që na terrorizojshin, na paditshin, na vidhshin, na rrihshin, na delshin dishmitarë. I shifshim ndërsa shkruiejshin paditë kundër nesh, bash njata me të cilët ndajshim vuetjtet në emën të një jete ma të mirë. Në oborr delshim rrallë, mbasi hapeshin katër dryj. Atje lajshim teshat, qetheshim, rruheshim dhe kur për fat kishte ujë ma shumë, bajshim edhe bajë. Kështu të lehtësohej trupi. Për dy tri ditë era e keqe mbetej jashtë e na vinte era sapun, ndonëse edhe vetë sapunit i vinte era nevojtoe. Sidoqoftë, mbas bajet, të afërmit tonë që vijshin për takim, nuk i xejshin hundët me shami, kur u afroheshim.

Ishte gëzim i madh kur kishim ujë; dritë elektrike me kandila, që qelbshin dhomën me erën e vojgurit; kur kishim vend me nde teshat e lame, kur këto tesha nuk na i vidhshin shokët në tel, kur delshim me u ajrosë në oborr. Kur klani ishte në gjendje alarmi, nuk na lejojshin me pa dritë dielli. Mbetshim ditë-natë në odë, ku edhe lajshim teshat e i ndejshim me u terë në tym duhani e në pluhun, që dyndej si retë në stuhi, sa herë lëvizte kush.

Uji mbetej gjithnjë problem, e jo vetëm ai që shërbente për bajë. Na mungonte edhe uji i pijshëm e s'mujshim as me shpërla gojën. Sidomos kur ndonjeni hante hudra, qelbsina bahej e padurueshme, e kur ndokush merrte gripin, tanë dhoma fillonte me u teshë e me u kollë në kor, sepse sëmundja kalonte me lehtësinë ma të madhe prej njenit te tjetri. Ngatërroheshin kështu ernat ma të pështira që ka nuhatë ndonjëherë hunda njerëzore: erë hudrash, gëlbaze, qyrrash, kambësh të palame, trupash të mbushun me morra e me varrë, dhambësh të krymbun, që e lëshojshin gjithë duhmën e tyne përjashta, për shkak se njerëzit, të ftofun siç ishin, detyroheshin me marrë frymë me gojë të hapun. Edhe ardhja e familjarëve, që aq e pritshim, bahej shkak pezmatimi për shpirtnët tonë të zezuem. E dijsim se ia hiqshin gojës atë që na bijshin. Atëherë takimet me familjarët shndërroheshin në shamje, protesta, disprim, vërejtje e udhëzime si me e drejtue familjen, të cilës ia kishim vu ferrën. Në atë mbretni mërziqe e disprimi nuk kishte festë që mund ta lante nga fëtyra jonë zehrin, zymtësinë, trishtimin e burgut të amshuem, ku ishim mbyllë pa shpresa. Si një stuhi që çon hinin mbi prushin e mbuluem, tue i zblue e tue i gjallnue gacat, që nisin e djegin, njashu takimi i frynte dramacitetit të shpirtit tonë, tue i zëvendësue përshtypjet monotone të burgut, me ato të jetës së kalueme në familje e në shoqni, prej kah na kishin zhgulë me gjithë rrajë. Në atë sportel, prej të cilit të afërmit shikjoshin fëtyrën tonë të shëmtueme, e ndiejshim veten si ferishtet, që duen me përqaftue e me pushue në krahë të nanës së vet. Por ndërmjet ishin hekurat e edhe në imagjinatë, përqaftimi përthehej në metalin e tyne të ftohtë e kthehej mbrapsht i coptuem.

Edhe letërkëmbimi, që e pritshim me padurim, bante të njëjtin efekt. Sado mjeshtër të ishte ai që shkruente, e ndiejshim se vinte prej një bote, që na e quejshim “burgu i madh”, sepse letra shkaktonte vetëm plagë. Mërzia varej kudo; ndër ne e jashta nesh. I vetmi varacion ishte kur, për shkak të ndonjë rrahje a të ndonjë faji tjetër, përfundojshe në birucë, ku zakonisht të mbajshin mbyllë një muej pa tesha fjetje, e lagështinë që të hynte në shpirt, vetëm me bukë e ujë. Po të protestojshe, të hiqshin edhe teshat e shtatit e njashtu picak, të lodhshin kambësh e duersh. Kështu merrshe pamjen e një suxhuku që përgatitet me e fërgue në fulteren vigane të qeverisë. Për me ushqye marrinë e saj që s’ngihej kurrë.

Vargëzojshin atëherë kësisoj: *“Prej këtij halli kur do të delet / ka vojtë puna ku s’mban ma / kanë vu ujqit me ruejtë delet / deri të mbesë vatha pa gja!”* Më duket se kjo bejte burgu vlen edhe për sot, ndoshta edhe ma shumë.

Kur diste e kjaishin kështu: *“Kur të shkojsh në botën tjetër, / Ke me u ndeshë me burra të vjetër, / Kanë me të pyetë si shkojmë na jetën: / ‘Shëndosh e mirë, tue dishrue dekën!’”*

Natyrisht mbas pesëdhjetë vjet torturash, terrori, tiranie që ushtruen shqiptarët kundër shqiptarëve, vëllazënt kundër vëllazënve, Shqipnia ndërroi pamje: ndërsa në 1944 të këqijtë njeheshin me gishta, në kohët tona me gishta njehen të mirët. Madje më duket se për këtë punë gishtat janë edhe shumë.

Kur rashë së parit në burg, isha naiv: mendojshe se së paku atje mbrendë të gjithë janë njerëz idealesh. Po s’ishte ashtu. Shumë shpejt naiviteti em do të bahej hi e pluhun, për të më zbulue para syve të hapun mirë spijuj, imorala,

hajna – sëmundje burgu këto. Këtyne u shtoheshin edhe të tjera, që merreshin tue ndejë e gjithfarë fëtyrash.

Ardhja e një të burgosuni të ri ishte ngjarje. Ai vehej menjëherë në qendër të vëmendjes. Rrethohej prej të gjithëve dhe së pari pyetej pse kishte ardhë mjes nesh. Por të nesërmen ishte ai që donte me dijtë pse ishte ti aty! Gradualisht i porsaardhuni i mësonte të gjitha historitë e të gjitha veset e burgut, e kur mbas disa vjetësh delte jashtë, kishte boll çka me shpërnda ndërmjet atyne që ndërtojshin socializmin, tue i përdorë drapnin e çekanin me korrë e me shtypë krena shqiptarësh. Delte, pra, prej burgut, i përkryem: njeriu i vërtetë i ri i krijuem nga komunizmi. I zoti me ba gjithçka.

Kishte edhe njerëz që lexojshin, ndonëse me hope. Pakkush lutej. Shumica shajshin Zotin, e të dispruem ulurishin: “Edhe Zoti asht ba i kuq!”

Edhe klima ishte anmiku ynë. Në verë pëlcitshim të xetit, e si fantazmat, fladitshim odën me çarçafa. Dimnit baheshim kaçë prej ngrice. Kjaishim pa arsye, e krejt pa arsye ia fillojshim gazit frenetik! Po nuk mungojshin edhe oazat, sepse njeriu asht poliedrik dhe luftëtar i lindun kundër së keqes, së cilës i kundërvehet me gjithë natyrën e vet, krijue simbas shëmbëlltyrës së Zotit, që asht gëzim. E gëzimi ma i madh i burgut ishte kur kishim ujë. Një gjendje e tillë quhej anormale, sepse krijonte qetësi të panatyrshme, krijonte kushte paqeje, na bante me harrue nevojën për me u rrahë, për me luejtë bixhoz. Atëherë nisshin diskutimet politike, sidomos kur ndërmjet klanit të Tiranës e botës së Madhe kishte polemika. Prej polemikave mësojshim të vërtetën, veçanërisht mbas 1966-tës, kur u hoqën gradat e mbas 1967-tës së tmerrshme, kur komunistat nisën sulmin e madh

kundër fesë. Kur hyjshin gazetat në burg, interesohesha bash për çka thonte Perëndimi, ndërsa dokrrat e Enver Hoxhës nuk më interesojshin fare. Isha abonue ndër 12 gazeta e revista dhe blejshe shumë prej librave që botonte zyra e përkthimeve në Tiranë. Në të vërtetë, një mbas një botohej një pjesë e mirë e kryeveprave botënore, e jo ma pak edhe vepra mbi historinë e Shqipnisë, natyrisht me kandvështrimin komunist mbi ngjarjet historike. Veç të gjitha shamjet kundër fesë, Perëndimit e Fishtës bajshin te na efektin e kundërt. Gjithnjë kështu lexojshim me ka të kundërt. E jetojshim me kah të kundërt. Çka ishte e mirë për ta, natyrisht ishte e keqe për ne e anasjelltas.

Isha kureshtar me lexue veprat e Enverit. I mora edhe ato e vërtetova se një vëllim 600 faqesh mund të lexohej në një orë të vetme. Nëse kishte ndonjë mendim të saktë, ndihej se s'ishte i tij e se ishte marrë prej thesit të tjetërkujt. Madje kam ndie se nuk ka shkruar vetë asnjë rresht, tue kenë se i ka pëlqye ma shumë e me e kaluar kohën, ndër hareme e defrime të tjera. Disa prej përkthimeve, që i kishin shpëtue cenzurës, si "Një udhëtim në SHBA" ose "Bankieri", i krijojshe lexuesit një ide të kjartë mbi jetën në USA. E librat e kulturës nuk janë gazeta, as filma. Ata përmbajnë analiza të thella e përshkrime, që të bajnë ta shikosh si në fotografi realitetin. E vetmja e mirë që pata nga burgu, ishte se muja me lexue shumicën e autorëve të mëdhaj në moshë të pjekun, kur kuptohen e shijohen si duhet. Madje, kur fillova me lexue në burg disa prej librave që i kishte lexue në rini, vërejtja se prej tyne nuk mbajshe mend kurrgja. Si kryejshë së lexuemi ndonjë libër, ia komentojshë të burgosunve, të cilët fillojshe menjëherë një diskutim të ndezun, njashtu si ua pritëte mendja. Fillojshe


me sha a me lavdue personazhet, me u ba me njenën apo me tjetrën palë, sikur edhe atë të shkretët të kishin dalë prej librit, për me hy në burgun tonë e me nda me ne fatin e zi, që na kishte ra mbi krye. Merre vetë me mend bukurinë e këtij arsyetimi: uleshin pranë nesh në birucat e Burrelit: Don Kishoti me gjithë Rosinant, Zonja Bovari, Ana Karenina. Shokët e mi të mjerimit e justifikojshin menjëherë sjelljen imorale të Anës së Tolstoit. Po unë u rrijshe gati e ua shpjegojshe simbas mënyrës së tyne, që të më kuptojshin, pa shumë filozofi: “Po të ishte ashtu, si thoni ju, Tolstoi nuk do ta kishte mbytë nën shinat e trenit. Por pikërisht se asht për t’u dënue, zhduket nga skena”.

Në fillim komunistat u dukën si futuristë të pastër, njerëz që dojshin me ndërtue një të tashme e një të ardhme pa të kalueme. Por shumë shpejt u bindën se truni i tyne shterpë, nuk ishte në gjendje me prodhue asgja prej vedit. U kthyen atëherë, rishtas, te kryeveprat botënore, por tue i interpretue, siç thojshin e stërthojshin, në prizmin marksist-leninist e gjithnjë ma shpesh tue i kijë³⁷ deri ku s’gjethon ma. E të mendosh sesi Marks, ashtu edhe Lenini, s’ishin tjetër veçse dy aventurierë, krejt profanë në interpretimin e kryeveprave të mëdha të njerëzimit, të cilat gjithnjë janë të përshkueme nga ideologjia fetare. Mjafton të kujtojnë Danten e Madh, “Komedia” e të cilit asht fund e majë filozofi e teologji. Kështu dokrrat e klasikëve të komunizmit eklipsohen krejt para gjigandëve të letërsisë botënore.

Në përfundim të këtij kapitulli rikujtoj se në burgun e Burrelit, ndodhen të vorrosun së paku pesëqind shqiptarë, të masakruem prej komunistave. Asht një shifër që duhet t’i

³⁷ *Me kí: me krasitë.*

shtohet numrit të përgjithshëm të atyne që hupën jetën në elterin e marrisë donkishoteske të diktaturës.



Biruca

Natyrisht birucën nuk e kam provue një herë të vetme, mbas arrestimit të parë. Kam pasë rasën me kalue shumë ditë të jetës mbyllë aty mbrendë. Po çka ishte biruca për të burgosunin? Ta thotë fjala vetë! Ishte vendi ku njeriu e ndiente vedin ngusht, ku rrezikohej me ra i thyem copa-copa, me bjerrë të gjithat tiparet, me u zvogëlue në përkim me përmasat e vendit ku e kishin ngujue. Ishte paradhoma e nënshtrimit e e nënshkrimit, prej nga mund të hyjshe ti e të delshe dikush tjetër. Në birucën e lagësht, të ngushtë, të acartë ishe vetëm me unin tand, siç jemi në deké.

Për të mos u tjetërsue, sa herë më ndryjshin atje, mendojshe se Zoti ma kishte hapë këtë derë jo fort të kandshme, që të kisha kohë me meditue të vërtetat e amshueshme e parimet e përjetshme, për të cilat jetojmë. Ishin po ato të vërteta e parime, që ua kisha mësue e predikue për ditë mirditorëve të mi, banorë të maleve të vorfna, të çveshuna, me shtëpija që nuk kishin ndonjë ndryshim tepër të madh prej birucës seme. Aty, në birucë, kuptova se regjimi, në pamundësi për ta bindë popullin, madje deri anëtarët e partisë, të cilët ditën rrijsin me Enver Hoxhën e natën me priftin, kishte vendosë me i hjekë e me degjenerue pa pasë kush me i dalë përballë.

Kujtojshe parime por edhe ngjarje të jetës, që rrëshitshin si në film mbi ekranin e mureve të ndyta, të errëta. Më kujtohej kur, para se të flakesha këtu, një natë, në banesën teme, që pak ndryshonte nga ajo e mirditorëve, ma patën vu pistoletën në tamth tue më kërcënue se do ta

shkrehshin, po të mos vendoshe atë ças me e braktisë famullinë. Më vinte parasysh fëtyra e nanës, e vëllaut, Dom Lazrit, e anëtarëve të tjerë të familjes, që sigurisht ishin tue hjekë si unë e ma zi jashtë, thjesht për shkak tem. Mendojshe për sendet e mia, të pakta por të domosdoshme për jetesën, që ishin sekuestrue të tana e nuk do ta kisha të lehtë me i vu prap në vend, nëse delshe ndonjëherë prej asaj vlime deke. E jo ma fort shqetësohesha kur mendojshe se Mirdita kishte mbetë pa meshtar, don me thanë, pa shpirt. Nuk mundem me e mshehë se më dhimbte zemra, kur më delshin para syve të mendjes ata të pafaj, që po pësojshin për shkak tem. Po merrshe menjëherë forcë, kur kujtojshe se isha aty për shkak të Ungjillit e të Kryqit; isha aty se nuk e kisha rrejtë kurrë popullin, që më besonte në gjithçka e më tregonte gjana, të cilat njeriu nuk ia thotë as vetvedit; isha pse të hollat që më kishte besue ai popull, hjekë nga kafshata e gojës së fëmijëve, ia kisha kthye përsëri, tue ia ndërtue kishat me banka e me të gjitha pajisjet, që duhet të ketë një ngrehinë, e cila përban zemrën e shpirtin e një katundi katolik; isha aty se nuk më kishte shkue as nëpër mend me qitë sekretin e rrëfimit; isha, pse vlerësojshe ma fort betimin tem, se jetën teme; isha aty sepse besojshe në atë që predikojshe; se isha gati me vepra, jo me fjalë, me dhanë edhe jetën për ngadhënjimin e Kryqit, don me thanë të qytetnimit të krishtenë në ato male, që më dojshin e i dojshe.

Kujtojshe shpesh edhe Meshën e njëmbëdhjetës që kremtohej në Kishën Françeskane. Prej predikatores gurrojshin predke, të cilat thadrojshin³⁸ jetët e atyne që i

³⁸ Ardhtë n'krye të herës nga em. *thadër*, mjet pune për latim.

ndigjojshin. Predikatarët, para se t'i nxirrshin fjalët nga goja, i jetojshin. E në një qytet të vogël ballkanik, ku të gjithë e dijnë çka han e çka pin, si flen e kur çohesh, nuk ishte e vështirë me e prekë me dorë si shejtninë, ashtu edhe shkandullin. Prej këndej respekti pa kusht ndaj atyne, që tue jetue si Krishti, u prijshin drejt progresit tokësor e lumnisë qiellore.

Sillshe ndër mend çasin kur mbaronte Mesha e nga gryka e rrugicës së Gjuhadolit, në shëtitoren e “Fushës së Çelës”, derdhej porsi lum, pjesa ma e qytetnueme e Shkodrës, gja që i bante me plasë komunistat. E shifshin se në duelin e Enverit të dekshëm e predkun e Krishtit të padekshëm, delte gjithnjë fituese fjala e Zotit.

Po a do të përsëritej ma kjo traditë? A do të lindshin ma predikatarë kësisoji? A do ta shifshe ma atë përrue fisnik vashash të bardha, grash të dlira e burrash të urtë tue dalë prej grykës së rrugicës së Gjuhadolit me Krishtin ndër zemra? Nuk e di, ndoshta gjithçka do të ndryshonte me kohën e mue do të më mbetej i gjallë vetëm kujtimi i bukur.

Mandej andërrojshe çastin kur do të rihapej seminari: po ku do të gjindeshin profesorët e mi të vjetër? Patër Faustat, Dajanët, Gardinët, Valentinët, që rrezatuan dritë kudo që shkelën? A do të gjindej në klerin e ri kush t'i zëvendësonte denjësisht këta kolosë, që kishin lanë mbrapa gjurmë shenjtënie, gjaku e mija faqe librash, pa të cilat Shqipnisë do t'i mungonte një pjesë e mirë e historisë? A do të kishte përsëri teologë e filozofë aq të përgatitun e njerëz aq shenjtën, siç kishin kenë mësuesit e mi misionarë? Populli i ka dashtë, sepse edhe ata e deshtën. Populli nuk i do misionarët vetëm atëherë, kur me intuitën e vet të pagabueshme e kupton se nuk janë të denjë për besimin e

tij. E kur nuk të don populli, nisu e shko në punë tande, sepse predikatarit të Ungjillit, rrezikon me u ba anmiku ma i rrezikshëm i tij. Ungjilli nuk pranon kurrfarë kompromisi o me të, o kundër tij. Kleri i vjetër kishte virtytin e vorfnisë ungjillore. E sa ma i vorfën ishte materialisht, aq ma fort pasunohej shpirtnisht e aq ma shumë fitonte shpirtën, me të cilët mandej naltonte kisha të reja, ndërtue me gurë të gjallë. A do të ishte kështu edhe kleri i ri, në një botë ku, si po na e thoshin ne të mbrapaperdes së hekurt, mbretnonte dollari, që i hapte e i mbyllte gojët simbas qejfit?

E ndër fretën, a do të vinte ma një Patër Gjergj, një Patër Anton, një Patër Augustin e një Patër Aleks?

Në atë birucë të zezë, ku s'kishte as hekura të kryqëzue, sepse nuk kishte dritore, shpesh më dukej vedi i vogël, e prandej i lumtun. Mendojshe se sa ma i vogël të jetë njeriu, aq ma i lumtun asht, sepse Krishti ka ardhë pikërisht për të vogjlit, për me i përforcue përballë të mëdhajve të tokës, që hahen njeni me tjetrin si qejt për një koc.

Isha në birucë, por jo vetëm. Kisha gjithnjë pranë Zotin tem, në të cilin besojshë me gjithë zemër. E besimi i ep kuptim jetës, e zbutë, e edukon, e ngushëllon njeriun, sepse i tregon kush e ka krijue, i mëson ligjet morale, e merr për dore deri në amshim, caku i fundit për të cilin asht krijue. Zoti nuk i çon kurrë njeriut vuetje e tundime, ma shumë se asht i zoti me bajtë. E kur vuetjtet na bajnë për hise e tundimet na trandin shpirtin, mjafton me u lutë vazhdimisht e i madhi Zot ka me i plotësue dishirat. E nëse nuk na plotësohej dishira ma e zjarrrë, shembja e komunizmit gjakatar, për të cilën luteshin të gjithë banorët e mjerë të birucave, mbulue me varrë të përgjakuna e të

përqelbuna, don me thanë se nuk kishte ardhë ende koha. Shpeshherë njeriu i kërkon Zotit çka s'duhet, ose kërkon t'i plotësohen dishirat, kur nuk ka ardhë ende koha. Prandej unë i lutesha për ditë atij të Lumit të më bante ato nderna, për të cilat kisha ma shumë nevojë, pa u dhanë emën, sepse nuk e dijshe cila prej tyre do të ishte e pëlqyeshme para syve të Perëndisë. Tue jetue me bindjen se Zoti gjindet në shpirtin e secilit prej nesh, isha i sigurtë se Ai e dinte ma mirë se unë për çka kisha ma tepër nevojë. Nuk isha i pari skllav që po vuejshe. Ehu! Sa skllavë kanë vuejtë e kanë deké me pranga ndër duer e ndër kambë në rrjedhë shekujsh: qysh prej qytetnimeve ma të lashta, e deri në shekullin tonë; një skaji, në skajin tjetër të tokës! E kush i din emnat e këtyne qyqarëve të paemën, që diqën ndër situata nga ma të tmerrshmet, u munduen e punë tepër të randa, u torturuen me njëmijë mënyra, u vorrosën të gjallë, me pranga ndër duer e ndër kambë, së bashku me zotnitë e tyre të dekun, të cilët besojsnin se do të vijojsnin të shërbeheshin edhe në atë jetë. Isha edhe unë një prej tyre, një skllav modern, që duhet të flijohej në elterin e marrisë. Isha i kënaqun me këtë rol kaq të vështirë, sepse më pëlqente shumë ma tepër me kenë viktimë, sesa fajtor. Kështu të paktën nuk do të më vritëte ndërgjegjja, e paqja e shpirtit asht thesari ma i madh që mund të dishrojë njeriu. Po diktatorin, a e vritëte ndërgjegjja? A i vret ndërgjegjja ushtarët e shejtanit? Apo s'kanë fare ndërgjegje, qysh se vehen në rradhët e ushtrive të së keqes. Ndërsa unë, armatosë deri në dhambë me Kryq e me uratë, isha rradhitë me ushtritë e së mirës. Isha pra në krye të detyrës seme historike aty në birucë, i lamë në gjak, tue pasë mirë parasysh se historia e njerëzimit nuk asht tjetër, veçse një betejë e vazhdueshme ndërmjet mbretnisë

të së mirës e mbretnisë të së keqes, mbretnisë së Zotit, temelue prej Jezu Krishtit që prej amshimit, e mbretnisë së djallit. E kështu, deri në ditën e gjyqit të mbramë. Më kënaqej shpirti kur mendojshe se një ideologji që kishte pushtue gjysën e botës, që ishte e armatosun e armët ma moderne, kishte frikë nga unë, dridhej nga uji i bekuem, nga Kryqi e Bibla, që mbajshë ndër duer kur më vunë prangat. Kujtojshin se tue ma hjekë duersh Librin, më kishin hjekë edhe fenë. Jo, fenë nuk mund të ma prekte askush. Ajo ishte atje thellë, thellë, ku nuk mund të hynte asnjë dorë njerëzore. Në atë vend mund të prekte vetëm dora e Zotit. Prandej mund të thojshë me plot gojë se isha njeriu ma i lirë, derisa kisha shpirtin krejtësisht të lirë.

Biruca m'i mbylli sytë e trupit, për me më hapë sytë e shpirtit. Fillova me hy në thellësi të disa fenomeneve, të cilat i njihshë vetëm në sipërfaqe, mësova me zbulue krejtësisht të mirë e të keqe. Në atë vetmi i dhashë dum disa fenomeneve që nuk i kisha kuptue fare kur isha jashtë, sepse i hutuem mbas njëmijë punëve, taman si fëmija, që pak nga pak njeh shkaqe e pasoja. Kur më ra për rrisht ky fat, kuptova sa i keq ishte shqiptari për shqiptarin, që shkatërroi vëllazënt e vet për me ia ba qejfin serbëve, rusëve, kinezëve, amerikanëve.

Fillova me shqyrtue hollë e me gjakftoftësi ambjentin ku kisha jetue deri atëherë, njerëzit që më paraqiteshin si miq, që merrshin frymë pranë e pranë meje, por që mandej ngitshin te operativi për me i kallxue sa herë kisha thithë ajrin e bekuem, që Zoti e ka krijuë për të gjithë, spijuj e të spijunuem, të shtrembët e të drejtë. Aty, në birucë, kur kthehesha i dërrmuem prej torturave, i kujtojshë emën për emën, ashtu si m'i kishte thanë hetuesi, për me vërtetue

fajsinë teme e me më frikësue me dishmitarët, që ishin gati me e mbështetë me fakte këtë fajsi, e cila mund të më çonte në plumb.

Gjatë 75 vjetve jetë në këtë Shqipninë tonë, kam pa tue hy e tue dalë, si kualt në han, nja pesë forca politike, krejt të ndryshme njena prej tjetrës, si përsa u përket kostumeve, ashtu edhe sofizmave e spekulimeve me të cilat e kanë rrejtë, vjedhë e torturue këtë popull, i cili kur ishte nën turk, thote: – Dreqi të vijë me na sundue, veç turku jo! Kur theu qafën turku e erdh italian, populli i mërzitun për dekë prej sundimit të huej, tha rishtas: – Dreqin e barim ma me qejf se makaronaxhitë! E mandej ia behu gjermani: – Dreqi njëqind herë ma i mirë! – thanë gjindja. E mbas gjermanit, si me dashtë me ia plotësue kërkesën popullit, që s’e kishte kuptue se njeni dreq kishte përzanë tjetrin, t’ia behu vetë Luciferri e u ul dyst në fronin e Shqipnisë, ku gjet terren të përshtatshëm me ndërtue një ferr krejt origjinal. Gjithsesi, “Fuqitë e ferrit nuk mund të ngadhënjë mbi dritën”. Padrejtësia ndëshkohet vetvetiu ngadhënjën pushteti i temeluem prej Krishtit, sepse pushteti i bazuem mbi dashuni, bamirësi, drejtësi, barazim, vëllaznim.

Pushtet tokësor e pushtet qiellor shtegtojnë në të njëjtën barkë, thithin të njëjtin ajër, drejtojnë të njëjtin popull: politikanët pretendojnë me e sundue me ligje të panumërta, por ligjin qytetari e respekton vetëm kur shëf policin. Kurse Kisha sundon me dashuni. Politikanët – me gjyqe, kampe, burgje, internime, pushkatime. Por historia e njerëzimit tregon se respekti s’u fitue kurrë më dhunë. Prandej atyne, që kanë shpirt me të vërtetë njerëzor, u pëlqen ma shumë me ndjekë Krishtin, sesa politikanët, sepse Krishti nuk e përçudnon shpirtin njerëzor me vese të

padeja për të, por përkundrazi e humanizon e për ma tepër e hyjnizon, e ban të përpiqet me i përgja atij, që asht i përkryem si Zot e njeri. Prandej që prej dymijë vjetësh Kisha me lutje, pendime, sakramende e udhëhjek njerëzimin drejt Atdheut qiellor. Ndokush mund të më thotë: Po gabimet e njerëzve të Kishës? Kemi pa e njoftë ndërmjet tyne edhe njerëz të neveritshëm, fare të padejë për çka përfaqësojnë e krejt në kundërshtim me Ungjillin që vijnë e na e predikojnë? Unë do t'i përgjigjesha kësaj pyetje me një tjetër pyetje: “Si shpjegohet atëherë që Kisha, me gjithë kundërshtimet e tmerrshme që i asht dashtë me përballue, deri në martirizimin e bijve të vet ma të mirë, nuk i ka mbyllë dyert e veta, por vijon të tërhjekë miliona njerëz, që çdo ditë gjunjëzohen ndër mija tempuj, të cilët naltohen deri në kufijtë ma të largët të botës? Në Kishë vërtet mund të takoni e të njihni njerëz të padejë. Kanë qenë, janë e do të jenë. Veç ky s'asht rregull, por përjashtim. E ajo që ka ma shumë randësi, asht se Kishën nuk e mbajnë njerëzit, po Zoti. Prandej asht ma mirë me pasë kundërshtar priftin e mik Perëndinë, kur prifti s'i përgjigjet detyrës së vet. I patën thanë njenit prej Papëve: “Atë i Shenjtë, po na e shkatërrojnë Kishën anmiqtë?” E ai i pat përgjigjë: “Mos u shqetësoni: kur s'kena mërrijtë me e shkatërrue na vetë, me gabimet tona, s'kanë çka i bajnë anmiqtë!” Kisha nuk asht forcë ushtarake, nuk ka armë tjetër veç Kryqit e uratëve. Prandej anmiqtë e saj e kanë pasë të lehtë me e la me gjak, tue ia shtue rradhët e martirëve të saj. Por pikërisht mbi gjakun e martirëve, ka lulëzue në shekuj qytetnimi i krishtenë. Historia e martirizimit të Kishës katolike asht njëkohësisht historia e qytetnimit të lashtë e modern. E kjo histori nuk asht me dorë njeriu, por me dorën e Zotit.

Meditojshe pra kështu në birucën teme të shkretë, e meditim me epte forcë me durue. Gati-gati edhe mue, të padejit, më dukej vedi sikur isha diku ndër birucat e amfiteatrove antike, në pritje të luanit që do të më shkyente a të kryqëzimit. Nuk më vinte aspak keq: ndihesha kryenaltë, që aty ku isha, më kishin flakue për fenë e Krishtit. Sjellshe në mend papët e mëdhaj e mbretënt e mëdhaj të krishtenë, të cilët i prunë botës qytetnimin që ka sot, qysh prej Kostandinit të Madh, të Karli i Madh; monastiret e famshme e murgjët e urtë, që ia ruejtën e ia zhvilluen njerëzimit kulturën, tue e xjerrë prej barbarisë. Prej kësaj barbarie, që më kishte flakë mue në këtë birucë, në këtë jetë sundonte terrori ma i madh.

E prej papëve, kardinajve e perandorëve, mendimi kthehej përsëri në Shqipninë tonë të mjerë, në jetën temë të shkretë. Prej Rishelisë,³⁹ mendja më shkonte të shoku em i fëminisë, Tonin Harapi. Më kujtohet se kur terrori mërrijti kulmin, deri ai shoku em i mirë, me të cilin kishim kenë të lidhun si mishi me kocin përmes një ideali të vetëm, m'i pat kthye fotografitë, të cilat i patëm shkëmbye në vjetët e idealeve të mrekullueshme të fëmijënisë e të rinisë, kur kishim një zemër, një andërr, një të ardhme. Mbaj mend se unë nuk pata mërrijte me ia kthye fotografitë e tija, sepse më patën kontrollue e m'i patën marrë. Mandej erdhën kohët tjera e secili ndoq rrugën e vet: atij i pat dalë bursa për në Konservatorin e Moskës, mue më doli bursa për në birucë, ku studiova 26 vjet me rradhë, tue dalë me një diplomë të pashoqe prej këtij universiteti, i vetmi që mund të quhet me këtë emën në Shqipninë nën diktaturë, ku biruca ishte

³⁹ Kleriku dhe shtetari frang Cardinal de Richelieu.

shkollë e shkolla birucë. S'e di cili prej nesh kje ma i lum e përfitoi ma shumë. Megjithatë, Tonini, tue kenë artist i madh, i la muzikës shqiptare disa kryevepra. Ndoshta përfitoi prej faktit se në kohën kur heshtin muzat e fjalës, janë ma të lira muzat e tingujve. Po çka do të kishte krijuar, po të kishte ndjekë rrugën tjetër, në të cilën pati ba bukur do hapa? Ndoshta do t'i kishte dhanë muzikës botënore ndonjë "Ave Mari" tjetër të famshme, sepse zemra e tij, ku kishte xanë një herë e mirë vend Krishti, nuk mund të këndonte "Ave Enver", përveç në formën klasike: "Ave Tiran, të dënuemët prej teje, janë gati me dekë për idealet e tyne të shenjta!" Kushedi ç'luftë të tmerrshme kanë ba notat në atë zemër, tue këndue kundërkangën, kundërmelodinë e shpirtit të artistit. Kjo asht një torturë edhe ma e keqe se ajo e birucës, ku lufton me forcat që janë jashtë teje, ndërsa shpirti yt asht plot paqë e qetësi, me bindjen se je tue luftue luftën e mirë, pa dredhue rrugë. Kush do të ishte sot Dom Simoni? E a mund të më përfytyrojnë ndryshe, përveçse si Dom Simon, ata që më njohin mirë? Dom Simoni u nis për Dom Simon, doli Dom Simon e po des Dom Simon, sepse nuk mund të ishte ndryshe!

Në qetësinë e birucës, fill mbas shokut tem të seminarit, Toninit, përfëtyrova një farë Xhafer Lezhet, një komunist të orëve të para, i cili pa dashtë, qyqari, ishte detyrue të delte në mal me zhelanat e Enver Hoxhës, që ndihmoheshin nga ajri prej anglezëve, për me i bezdisë gjermanët, tue luejtë pak a shumë rolin e mizave të kalit, ndërsa ata e kishin bjerrë luftën e po ktheheshin në shtëpi të vet të fyem e të poshtnuem, të shnderuem e të bombarduem, të ndjekun mbas e të bamë hi e pluhun.

Në Shqipëri gjermanët hyjshin nga Greqia dhe kishin vetëm një korridor shumë të ngushtë për me shkue në shtëpi të vet.

Kur mërrijtën në Borovë nga Greqia u takuen, sikurse e kishin zakon, me kryeplakun e fshatit dhe i thanë se ishin për kalim, se nuk kishin kurrfarë pune me popullin, por nëse ndokush do t'i cenonte, do të lejshin mbas vetëm hi, pluhun e kufoma të djeguna. Kryeplaku i shkretë nuk mund t'i komandonte partizanët, që mësheheshin mbas gardhiqesh e xejshin prita për me gjuajtë ndonjë ushtar gjerman, mbetë mbrapa shokëve. Kishin qëllim që kështu gjermanët të digjshin fshatin, të vritshin gra e fëmijë e pleq, ndërsa rinia, për me shpëtue jetën prej raprezaljeve, të rreshtohet me partizanët e Enver Hoxhës, pa pasë kurrëgjia të përbashkët me ta. Ashtu si ndodhte edhe që të bashkoheshin me ta shumë njerëz, që e shikojshin këtë si të vetmen rrugë për të vra kundërshtarët e vet, të rreshtuem në anën e kundërt. Porsa, pra, partizanët vranë në Borovë një ushtar në tërhjekje, gjermanët e dogjën e e poqën Borovën e mjerë, ashtu si kishin paralajmërue. Një prej të rijve borovas, që u bashkue pa hiri me të vetëqejtunit nacional-çlirimtarë, në atë rast, ishte edhe Xhaferr i shkretë.

Dhe shi këtë Xhaferr na e pat dërgue regjimi komunist ndër jezuitë, për me na mbajtë një konferencë e me na sqarue ne të rihtë me qafore të bardhë, që simbas padronëve të tij, ishim “gënjyer nga reaksioni e i kishim të gjitha mundësitë të shpëtonim duke i shërbyer pushtetit të ri”. Merre me mend të gjin Xhaferr, prej kësolles së tij të Borovës, që binte erë bagla, në shtigje mali që binin erë egërsinë, fill e konferencier në sallën e jezuitëve, ku ndihej menjëherë era e mirë e kulturës.

Si kreu konferencën e vet, Xhaferri kërkoi me dijtë nëse kishim ndonjë pyetje. Të parët u çuen eprorët tonë, Atë Gardini e Atë Vata.

Atë Gardini, jezuit i formuem në shkollat ma të mira të botës, e pyeti të gjorin Xhaferr, 18 vjeçar, ardhë prej shkollës së malit e të pyllit: “Mbasi komunizmi kenka sistemi i vetëm që mund ta pështojë njerëzimin prej mjerimit, mbasi ky Marksi e Engelsi yt kenkan aq të mendshëm, sa me gjetë formula e receta që shërojnë plagët e shoqnisë dhe zgjidhin të gjitha problemet morale, politike e ekonomike, sikurse the ti, pse s’e kanë adoptue gjermanët të parët, këtë sistem kaq gjenial? Meqë Marksi aty e shpiku. Por e morën popujt sllavë???”

Xhaferri i shkretë, që nuk e njifte as historinë e gjermanëve, as të rusëve e as të shqiptarëve, mbet me ato fletë që kishte lexue në duer, të cilat i dridheshin. S’po dinte se si me i përgjegjë jezuitit. Në sallë mbretnoi një copë herë të mirë një heshtje e thellë. Na zgërdhieheshim tue e pa në atë hall të zi, ndërsa eprorët tonë ia kishin ngulë sytë, me atë seriozitetin e tyre të pandryshueshëm. E ndërsa pritshim, pra se çka po na thotë, përjashta u hap dera e oborrit e hyni shend e verë gomari i ngarkuem me tambël. Prej gëzimit se mërrijti prej Bradhejve në Shkodër, t’ia filloi me garritë sa i hante zani. E garritja e tij, tue përshkue ajrin e amshtë që dante derën e oborrit nga salla ku na po zhvillojshim lektionin marksist të detyruem, mërrijti bash në kohën e duhun, tue thye heshtjen që po bahej disi e padurueshme. Na, dyqind nxanës jezuitësh, të mbledhun aty, ia plasëm me të madhe gazit, ashtu si rrallëherë bajshim në ato salla tepër serioze. Dikush tha: “Mos i ep ma zor vedit, se e dha gomari përgjigjen”. Tjetri ia pat: “Rri i qetë, se po të vjen në ndihmë

shoku”. Kështu lekcioni u prish. Xhaferri, kuq si mollatarta në fëtyrë, u nis e shkoi. Ai te shokët e gomari rishtas në Bardhej, mbasi edhe ai kishte pështue nga pesha e tamblit, si Xhaferri nga pesha e kapitalizmit gjakatar. Sigurisht do të ketë mallkue vedin që kishte pranue me ardhë në një vend, i cili do t’i jetë dukë më të vërtetë reaksionar, përderisa ngarkonte gomarin me përfaqësue partinë.

Në atë mjerim ku isha, më mori gazi. E m’u kujtue barceleta: “Na ishin një gjel, një qen e një gomar, që jetojshin si s’ka ma mirë në një vend perëndimor. I mori malli për me shtegtue në Shqipninë, që komunistat na e paraqitshin si parrizin e tokës. Erdh te na gjeli shi në vaktin ma të keq për gjelat, kur po ia pritshin tanëve krenat, mos me i çue në kooperativë. S’ndjeu kangë gjeli as s’pa kambë pule, e t’u nis fluturim me kthye kah kishte ardhë. Erdh qeni, posa e pa se te na ishte e ndalueme deri me lehë, ai mbathi me të katërta. Erdh së mbrami gomari. Prit e prit shokët e tij se po kthehet, e s’e panë ma. Tek e mbramja morën një letër, në të cilën shkruhej: “Mos më pritni. Nuk kthehem ma. Një vend që asht i vetmi vend në botë ku më thërrasin “shok!”

Gazin që më erdh pa dashtë në buzë, ma shleu menjëherë kujtimi i së nesërme së konferencës marksiste.

Ne e nesre nuk çuen ma te na Xhaferrin, po policinë e armatosun deri në dhambë. Ishte Korriku i vjetës 1945. Në seminarin tonë filloi shkatërrimi i madh: eprorët dolën prej andej me pranga në duer, për me shkue në pushkatim ose në burgime të pafundme, të ndjekun shumë shpesh prej nesh, nxanësve të tyne besnikë, për t’u ba për shumë vjet meshtarë burgjesh e kampesh. Gja për të cilën gjithashtu na kishin përgatitë.

E meditimet e mia vijojsin me u mbushë me kujtime e fëtyra të kalueme, miqsh e anmiqsh: më vinte para syve figura e sekretarit të partisë të rrethit të Lezhës, Xhorxhi Robo, fill mbas tij, natyrisht, e kryetarit të degës, Azem Kërxfhalliut dhe e kryetarit të komitetit ekzekutiv, Shaqir Dibrës, tre princat e Lezhës, të tre peshkaqej e kokodрила, që e merrshin nëpër kambë popullin e shkretë, 90% katolik. Më kishin thirrë sa e sa herë nga Ungrej për t'u paraqitë mbas 16 orësh rruge kambë para zotnisë së tyre, vetëm e vetëm për me ndigjue shamje e kërcënime: para syve të tyre unë isha shenjë kontradikcioni. Më duhej me qepë gojën para këtyne hajnave, që vidhshin çka t'u binte në dorë, pa e përbuzë edhe gjanë e Kishës; para këtyne njerëzve, jo vetëm të padobishëm, por edhe të damshëm për popullin, të cilët shkatërrojsin çka u prekte dora, e në rradhë të parë, shpirtin e njeriut. E pra udhëtojsin gjithë ditën me makina luksoze, ndërsa unë s'kisha të drejtë me udhëtue as në kal a në mushk tek ravgojshe katundeve të thepisuna të maleve të mia, ku herë-herë më duhej me u ngjitë kambadoras. Si nuk mujtën me e bindë popullin që mos të shkonte në kishë, ma vunë synin mue. Filluen me mendue se po të më arrestojsin, do ta zhdukshin Zotin prej shpirtit të katundarëve, thue se unë isha zëvendësi i Shpirtit Shenjt. S'e kuptojsin qyqarët, se me mue a pa mue, Zoti nuk do të zhdukej kurrë prej zemrave njerëzore. Do të rrinte aty, herë mshehë e herë açik, deri në diftimin e tij të plotë, një ditë, kur të shembeshin idhujt, ashtu si janë shembë përherë në historinë e njerëzimit, qysh kur kjo xu fillë.

Më përtrihej në mend mbledhja e organizueme në Ungrej, e kryesueme nga Xhorxhi Robo, ku ishin grumbullue me dhunë ma se 500 vetë për me demaskue

Dom Simonin. Servilat partijkë të famullisë mbajshin në dorë, si dishmi të gjallë kundër Dom Simonit, një radio dore marke së vjetër sovjetike, që nuk funksiononte, ashtu si nuk funksiononte as aparati i partisë, edhe ai i së njëjtës markë. Unë, që demaskohesha, isha krejt i qetë, përplot me vetëdijen se e ardhmja ishte emja, sepse unë isha i Zotit. E aty ku Zoti demaskohet e dënohet me dekë, mbretnon kaosi, urrejtja, vëllavrasja, morti. Deri në ditën kur Zoti, të cilin më kot mundohen ta vrasin, kthehet e rifillon jeta. Xhorxhi Robo, u ba shumë qesharak në këtë tubim popullor, kur më akuzoi se kisha pagëzue me dhumë fëmijët e komunistave. Njerëzit, sado të thjeshtë, nuk mund ta përfëtyrojnë kursesi priftin tue i ngrehë zharg ferishtet prej gjinit të nanës për me i zhytë në gurrë të Pagëzimit. Jo xhanëm! S'ishte punë që bahej! Në të vërtetë një komunist, që punonte si shitës në një dyqan, e kishte pagëzue foshnjën e tij natën shi në vendin ku punonte, për të ba mandej, po aty, një banket madhështor, në sofrën e të cilit ishin ulë të gjithë anëtarët e partisë, që ditën i ndezshin qira vjamt idhullit, natën qira dyllit Zotit. E natyrisht, Dom Simoni ishte në krye të vendit.

Madje edhe operativi i degës, së bashku me policin e mësuesin, më thirrshin shpesh me luejtë futboll. E unë shkojshe me kënaqësi, sepse më duhej me e mbajtë trupin në formë, për të kenë i gatshëm me iu ngjitë atyne shkrepave të thepisun, ku njerëzit kërkojnë orë e ças meshtarin.

Mirëpo në Dhëtor të vitit 1959, kur Nexhmije Hoxha foli për kulturën, në fjalimin e vet botue ndër organet e shtypit komunist, theksonte se një meshtar, tue mos muejtë me e përhapë fenë në Kishë, kishte shfrytëzue për këtë qëllim fushat e futbollit të partisë. Natyrisht që

njerëzit, të cilët më kishin thirrë, u kritikuen randë e u shkarkuen nga detyra. Atëherë populli, që s'ia kalon kush për fantazi, mërrijti në përfundimin e çuditshëm se më kishin demaskue vetëm e vetëm sepse ia kisha kalue tanë komunistave edhe në futboll. E tue mos pasë çka me më ba në fushë të topit, më demaskuen në log të kuvendit, meqë kishin në dorë gurin e arrën. E ky për ta ishte një autogol i tmerrshëm.

Tashma këto ishin kujtime, që vijshin me më vizitue në birucën, ku jetojshe në shoqni me mij, morra e pleshta. Ishte e madhe mërzia në birucë, s'kishte gja me ta kalue. Prandej e mbushëshe kohën me kujtime. Më ngushëllojshin deri diku, por mandej më lëshojshin krejtësisht forcat. S'ka pendë që i ka përshkrue e ka me mujtë me i përshkrue ankthet e përsekondëshme të birucës, ku trupi të des për minut e zemra çon krye për orë, ku sheh se e ardhmja të premtot vetëm tortura e dekë, ku ke ûjë e et, të përvëlojnë plagët e mishit e të shpirtit. Por aty ku mbarojshin forcat e mia, ndërhynte dora e Zotit. E s'di pse vijojshe, në çastet ma të vështira, me kujtue, Tuk Jakovën, që i dekun siç ishte, u ba shoku i em ma i ngushtë i birucës. Thojsh me vedi: Ky Nikodem shkodran, anëtar i Komitetit Qendror, shok armësh me Enver Hoxhën, flijoi rrogën e majme, gradat, privilegjet, nderimet, rahatinë e bllokut të udhëheqsave të Tiranës dhe mori guximin me i folë haptas tiranit në mbrojtje të fesë. I tha pra, ballë për ballë se nuk ishte e drejtë të vriteshin herojtë e kombit, klerikët që vunë bazat e qytetnimit europian në Shqipni, që ruejtën gjuhën shqipe, që nxorën kuadrot e para të inteligjencës shqiptare, përfaqësues të gjitha vlerave kombëtare. Nikodemi i Ungjillit e Tuk Jakova shkriheshin më një në fantazinë teme

të stërmundueme, e biruca ku më vizitonte vetëm deka, barej⁴⁰ në kohë e vende të tjera. Më dukej se isha ndërmjet farizejve të Ungjillit. E ndigjojshe Nikodemin që mbronte Krishtin ndërmjet të vetëve, të cilët tashma e kishin marrë vendimin e pakthyesëm për ta mbërthye në krygjë. E mbronte e thonte se Jezusi kishte folë si çmos kush, kishte predikue e jetue një moral aq të naltë, sapo ta ndiqte njerëzimi, do të ishte krejt tjetër: do ta donte të afërmin si vetvedin! E mandej, a ishte e drejtë me e gozhdue njeriun, pa e ndigjue ma përpara? Pa e lanë me u mbrojtë? Dje i arrestuem, sot në krygjë?! Edhe Tuku ashtu kishte ba: kishte mbrojtë krishtenimin, e me të natyrisht e në mënyrë të pazgjidhshme, Veriun, i cili dje, kunorue mbret, hynte ngadhnyes në Jeruzalemin e kulturës shqiptare, nësa sot gozhdohej pa dhimbë as mëshirë në krygjën e komunizmit. E ndërsa e krygjëzojshin, i mbërthejshin mbi krye, në vend të INRI-t (Jezu Nazareni Mbret i Judejve) – KFA (Krygjëzue për Fe e Atdhe). Ai Veri i krygjëzue simbolizonte disa prej bijve ma të mirë që kishte qitë në dritë deri më atë kohë Nana Shqipni, siç i kande me e quejtë koministave, të cilët e shndërruen në nanë që ha fëmijët e vet.

E kjo Krygjë asht gjithnjë atje, ku e patën ngulë komunistat e Veriu mbeti edhe sot e kësaj dite pezull “n’mje’ tokës e qiellit”.

Shpirti em në birucë ishte kthye në një skenë: në të luhej tragjedia e madhe që i kishte ra mbi krye njeriut të ndershëm shqiptar. Isha unë vetë autori e aktori i vetëm, si në kohët e lashta, ndërsa korin e luate gjithë ajo turmë, që vuente mbrendë e jashtë asaj biruce të lagësht, ku nuk

⁴⁰ Shkod. *bartej* (me u barë).

depërtonte asnjë rreze drite. Roli, që e kishin shtrëngue me luejtë, kërkonte prej meje të kalojshe nëpër tortura, pa hupë e pa flijue shpirtin tem. Ndokush mund të më akuzojë se po e teproj me skena të tmerrshme, sepse edhe grekët paganë në tragjeditë e tyne i vritshin personazhet mbas kuintash, për mos me e tronditë në tepri shikuesin. Po unë, more zotni i dashtun, pikërisht atë jam tue ba: tue i çue njerëzit mbrapa kuintash, ku s'pushon kurrë së premi krena spata e katilit. Sepse tragjedia eme nuk asht lojë teatri, po lojë jete, se gjaku që ka rrjedhë, nuk asht bojë e kuqe e shkrime në ujë, po limfë e jetës seme e njerëzve të mi. Prandej, tue kenë viktimë e dhunës ma të tmerrshme, jam i detyruem me u ba interpret i saj. E sa do të dishrojshe t'i kasha pështue, sepse nuk ka njeri në botë që i kande me u rjepë për së gjalli, sado shenjt që të jetë. E tue riluejtë në këto faqe tragjedinë e jetës seme, dëshiroj ta baj skenën e shpirtit katedër të humanitetit.

Tashti kam kthye në shtëpi, ku shpresojshme me jetue ma në fund në paqë, por ku u kujtova se jeta po bahet gjithnjë e ma e pajetueshme.

Kjo e keqe e madhe, që quhet birucë, ma mprehu trunin, më mësoi me i drejtue Zotit lutje të reja, mbasi jetojshe në skenën e një tragjedie të re, të panjoftun ma parë, që quhet skena e birucës. Sa drama janë shkruar deri tashti për birucën? Pak e aspak! Sepse njerëzit nuk i duen birucat, nuk janë krijue për biruca, janë krijue me fluturue të lirë, si zogjtë në hapësinat pa kufi të qiellit! Po biruca ishte aq e errtë, sa me t'u ba me besue se përjashta nuk kishte ma qiell. E sa për krahët, që lypen doemosdo për fluturime, puplat e tyne kishin përfundue, të përgjakuna, në plehnat e hetuesisë!

Nga britmat e kërcënimit e policëve, që më vijshin prej jashtë, kuptova se ma tepër e dronte Enver Hoxha popullin, se populli Enverin. Kuptova forcën e pathyeshme të fesë. Mora vesht çka don me thanë liri. Fitova guximin e paqen e mbrendshme, qetësinë shpirtnore që të ep besimi në Zotin; pashë nga afër edhe ferrin që përfton djalli në zemrat e klasës politike, gjithmonë të shqetësuese për me ruejtë pushtetin.

Mërrijta kështu në përfundimin se isha ma mirë unë në birucë se diktatori në fron!

Kur më shkapetën për herë të parë në këtë vend të tmerrshëm, që quhet birucë, muret e dyshemja ishin të lame në gjak. Si erdha në vedi, mbas përplasjes, u përqetha. E preka me dorë, i mora erë! Jo, nuk ishte gjak. Ishte bojë. E kishin derdhë aty vetëm për presion psikologjik. Gjithsesi as gjaku nuk do të mungonte. Sa herë më nxirrshin nga biruca për nevojat personale e sa herë më kthejshin, nuk m'i kursejshin shtjelmat e grushtat. Më shtjelmojshin pikërisht aty ku dhemb ma shumë, në pikat ma të brishta të trupit. Më shkaktojshin dhimbje të tmerrshme, që vijoishin disa ditë. Por, as dhimbjet, shkaktue prej shtjelmave, as hekurat që m'i shtrëngoishin duert, derisa hyjshin thellë në mish, as çimentoja e lagësht, nuk ma prishën qetësinë shpirtënore.

Kur isha vetëm, isha me gjithë botën. Po kur e shihshin se vetmia, në vend që të më ligështonte, më forconte, merrshin të gjitha masat me më dhanë kënaqësinë e shoqnisë. Për këtë qëllim drejtoria kishte përgatitë kaherë shumë shokë të mirë birucash, ndërmjet të cilëve, ma i specializuemi ishte Pjepri. Mue më tokoi për rrisk një shok vuejtjesh, një ortodoks injorant, Spiro Tata, caktue për me m'i xjerrë me mjeshtri të mshehtat, tue pasë parasysh se çdo

i arrestuem konsiderohej nga don Kishoti Enver Hoxha, si figurë politike që s'mendonte tjetër, veçse me ia grabitë Dulqinjën e Tobozës, don me thanë pushtetin, që ishte dashunia e tij e vetme. Kurse na të shkretët, të gjithë, s'ishim tjetër veçse mullinj eret, kundër të cilëve tirani ishte sulë i armatosun me heshtë e me shpatë, simbas të gjitha rregullave të kalorësisë, vetëm e vetëm sepse kishte dashtë me mbyllë një kishë ose me terrorizue një grup njerëzish të cilët, në andrrat e veta plot maktthe, i shihte tue thurë komplete kundër tij. Prandej edhe himni, që servilët i ngritën këtij soj Kalorësi të Fëtyrës së Vrerorur, titullohet "Enver Hoxha e mprehu shpatën".

Porsa e pashë tue hy në birucë shokun Tata, fjalët e mbrame ia thashë të parat e prita me: "Urdhnoni, shoku spiju!" I ngrati Spiro! Ishte mësue me u fye birucë në birucë. Madje diku-diku fyemja shndërrohej në shtjelma; kështu, si provonte dhe shtjelmata e debuluem të birucave apo birucianëve, siç mund t'i quejmë banorët e birucave, rod i ri gjindsh ky, që i përngjitshin ma shumë urithave se njerëzve, ai transferohej menjëherë në një birucë tjetër. Ku ishte ma pak i njoftun. Gjithsesi, mundohej, me sa mujte, me e krye sa ma mirë detyrën. Si e shihte se politikisht s'kishte çka me xjerrë, e sillte bisedën si çashtje morali. E, injorant siç ishte, mendonte se tanë moraliteti njerëzor përqendrohet në një pikë të vetme. Më pyeste, pra pse nuk martohen priftënt, e meqë s'martohen, si ia bajnë me jetue si njerëz normalë. Kush asht ma i fuqishëm i përgjigjesha – vullneti apo dryni që na mban këtu mbrendë. Kur po durojmë drynin që na ka vu qeveria, pse jo atë që e kemi vu vetë, me dëshirën e vullnetin tonë të plotë. Mandej tallesha me të. I thashë një ditë: "Po më dukesh si Lenini. Jo për gja, por vetëm sepse

Lenini, kur ishte në burg, rrinte shi me një prift katolik. I tha një ditë Lenini priftit: – Moralisht do ta sundoni botën ju katolikët, sepse feja juej asht hyjnore dhe hjerakija juej rrjedh nga populli, por politikisht do ta sundojnë komunistat, sepse edhe ata rrjedhin nga populli e nuk e trashigojnë pushtetin, si bijtë e monarkëve. Iu gjegj prifti: – “Asht e vërtetë se na do ta sundojmë botën, sepse me të vërtetë feja jonë asht hyjnore e jemi të popullit e për popullin: me meshtarë e me hjerarki. Kurse ju s’keni për ta sundue kurrë, sepse manastirin e keni të bukur, por s’keni murgj të mirë, mbasi tanë shokët tuej janë batakçi. Sistemi juej i përngjet ma shumë sistemit skllavopronar, e sa ma i mbrapambetun të jetë vendi, aq ma të fuqishëm e ndieni ju vedin”.

Spiro Tata nuk ndei shumë në birucë teme. Si e prunë papritmas, ashtu e hoqën. E takova mbrapa nëpër kampe. Më thanë se shumë shokë birucash e kishin rrahë. Unë natyrisht nuk vuna dorë në të. E dijshe se ishte dënue tashma për gjithë jetën. Besoj se edhe sot e kësaj dite, në qoftë gjallë e shëndosh, siç janë të gjithë xhelatët e naltpërmendun, torturohet prej asaj meduze me gjarpij të spërdredhun mbi krye, që dikur e kena pasë të gjithë e i kena pasë thanë ndërgjegje.

Përfitimi ma i madh që kam pasë prej birucës, asht se aty kisha kohë të bollshme për t’u lutë. Lutja m’i largonte të gjitha mendimet tjera, më epte guxim, ma ambëlsonte tmerrin e birucës, ku zdrypte vetë Zoti. Aty kuptova realisht se njeriu, sa ma në hall të jetë, aq ma shumë e thërret Perëndinë pranë, aq ma shumë i lutet. Mue, që e kisha fillue jetën me dishirën me u ba murg jezuit, Zoti më kishte dhanë qelinë ma të bukur që mund të andërrojë një murg i vërtetë.

Biruca ishte shndërrue pikërisht në qeli mungare, e unë, në njeriun që këndonte psalme e himne, të cilat tue përshkue mure e hekura, naltoheshin si fjollë kemi drejt qiellit.

Ma vonë kur i lirë, muja të vizitojshe banesat e anakoretëve,⁴¹ mshehë ndërmjet malesh e pyjesh të Europës, e pata kujtue rishtas birucën teme e më pat shkue mendja se ishte një nga vendet ma të përshtatshme për jetën e anakoretit, e vetmitarit, e atij që dishron me ndejë vetëm për vetëm me Perëndinë.

Si patën kalue ma se dhetë vjet qysh se jam lirue nga burgu i Burrelit, u ktheva rishtas në birucë, këtë herë si njeri i lirë. Kështu të paktën besojshe. Nuk më shoqnojshe ma policët e trashë e kriminelë të Hoxhës, por kameramanët e Radio Televizionit Italian, që kërkojshe prej meje një intervistë. As ndër andrra s'e kisha pa këtë mundësi që po më epej. Me folë për atë luginë lotësh, për ata 500 shqiptarë të pafajshëm, që dergjeshin me koca të thyem nën qershinë e egër, për lotët, rënkimet, dhimbjet që kalojnë cakun e mendës njerëzore, shnjërzimin, hupjen e dinjitetit, për të cilat deri në atë ças nuk ishte fajisë kurrkush, nuk ishte dënue kurrkush, kurrkush nuk kishte zdrypë në ato biruca, të cilave u vinte era deké.

U kërkova gazetarëve italianë, një minutë heshtje për kujtimin e të ramëve. Nuk pritën asnjë minutë, asnjë sekond. Sidoqoftë unë fillova punën teme, tue mendue se ky ishte nderimi ma i madh për viktimat: me i kallëxue botës çka kishte ndodhë në thellësitë e atyne vorreve, ku ishte

⁴¹ Prej gr. *ἀναχωρητής*, që buron prej rrajës *ἀναχωρέω*: me u tërhejë, në kuptimin fetar tërhekje shpirtnore, shoqnue me anë lutjesh, krye në vetmi e asketí.

kallë për së gjalli një turmë skeletësh; me xjerrë në dritë, çka ishte krye në terr të verbët. Nuk e kisha ndër mend me ba thirrje për hakmarrje, jo. Të gjithë e dijnë se një meshtar katolik, që përpiqet me i përngja Mjeshtrit të vet Hyjnor, nuk din e nuk don me marrë hak: din e don veç me falë e me përsëritë në amshim, së bashku me Zotin e vet: “Fali o Zot, se nuk dijnë çka bajnë!”

Intervista eme kishte për qëllim t’i tregonte asaj, që na patëm mendue se asht bota e lirë, të vërtetën tonë të idhtë, vetëm e vetëm që të mos përsëritej.

Kalova, pra korridor në korridor, birucë në birucë e tregova gjithë çka kisha pa e jetue, tue pritë mandej me padurim, ta shihshe në ekran, atë që ishte regjistruë. Por, kur mbas pak ditësh e pashë, mbeta krejt i tronditun. S’po kishte pra, botë të lirë, s’po kishte kurrkund as liri të vërtetë fjale e as shtypi. Pashë tue më kalue para syve disa skena pa randësi që nuk thojshin kurrëgjia e disa fjali me gjymtyrë të preme e të cingume, ma zi se të shokëve të mi të birucave para pushkatimit. Unë kisha pështue gjallë prej birucave komuniste, po intervistën teme ma kishin pushkatue shi gazetarët e botës së lirë. Nuk lejohej, pra as mbrendë as jashtë, me folë të vërtetën, për pushtetarët. Nuk lejohej me i kërkue llogari kriminelave, nuk lejohej me i hapë sytë popullit për me pa se po luhej rishtas me fatet e tij, nuk lejohej madje as me folë keq për Amerikën. Dje në burg si bashkëpunëtorë të Amerikës, rrezikohemi përsëri me u vu në pranga si anmiq të saj. Qyqarët na që s’u mësuem kurrë me i zgjidhë si duhet e në kohën e duhun miqtë e anmiqtë, ashtu si nuk dijtëm as me i trathtue në kohën e duhun e një kohë tjetër të duhun, me u puthë e me u rrokë përsëri me ta! Me një fjalë, me i qitë flamujtë në tregun e bagëtive të

Greqisë, Italisë apo Amerikës! E me ia shitë atij që na i paguen ma shumë. Po mbetëm përherë anmiq me të pushtetshmit e gjithnjë nën palët e një flamuri të vetëm, të laskaruem prej barotit të betejave për ideale të mëdha, të pandryshyeshme, të vërteta e prandej, të përjetshme. Sepse pikërisht ata që na patën vu në pranga tue na akuzue si spiuj të imperializmit amerikan, janë ba sot miqtë ma të ngushtë të SHBA, ku shkojnë e vijnë tash e parë, si me kenë tue shkue te ndrikulla. Me të vërtetë që një jetë e tillë nuk meriton aspak të jetohet, nëse nuk do të kishim ngushëllimin e fesë, që na tregon me gisht atdheun e vërtetë qiellor, ku ma në fund njeriu që asht pështetë gjithë jetën në Tynzonë, pështon një herë e përgjithmonë prej kësisoj shëmtimesh.



Si ishte i organizuem spijunazhi në burgun e Burrelit

Përfashta burgut ishte gardhi i dendun i telave. Mbi të, ditë-natë – rojet e Enver Hoxhës me automatik në dorë, të komanduem nga drejtoria e burgut. Mbrenda tij, dy operativa, disa nëpunës e shumë policë. Këta i quejshin “Qeveria e jashtme”, sepse kishin tepër kujdes për ne, natyrisht që të mos arratiseshim.

Po kishte edhe qeveri të mbrendëshme. Ndër oda, korridore e në oborr të burgut ishte mbrapavia, ose qenëria, siç i quente një mik i jemi nga Jugu. Ishin shokët tonë të mjerimit, kthye në persekutorë. Kishin rrogë, ushqim special, veshmbathje të posaçme nga drejtoria e burgut, së cilës i epnin informata të përditshme. Së parit spiunojshin njeni-tjetrin. Mandej policin, nëse i hapte e i mbyllte dyert i paarmatosun, e së fundi të gjithë të burgosunt tjerë.

Parlamenti dhe gabeti i këtyne zotnive, gjindej në zyrën e përkthimeve, ku punojshin për Ministrinë e Punëve të Brendshme. Intelktualët e burgut, spiujtë me shkollë kryesoheshin prej spiunit ma të rrafinuem, 24 karatësh, Pjetër Arbnorit, Pjeprit, siç e tallshin kur prej burgut na u naltue në majë të opes së Parlamentit. Pjepri nuk informonte në mënyrë vulgare, si spiju dosido, por i qindiste informacionet, tue vu gjithë mjeshtinë e vet në pikturimin romantik të karaktereve e të sjelljeve të të gjithë të burgosunve. Nuk e di nëse kanë pështue këto vepra të atij, që ma vonë do të ngjitej në majën e pushtetit, se atëherë nuk do të kishte fare nevojë të botonte shkarravina të tjera: do të

mjaftojshin këto, që të ngjitej edhe në Parnasin e letërsisë spijunore, në të cilën nuk mungojnë kryeveprat e të gjitha vendeve e të gjitha kohëve. Në botë gjinden kilometra arkiva me padi e shpifje spijujsh.

Po ap vetëm një shembull: kur regjimi donte me botue veprën Ali Pashë Tepelena të Sabri Godos, pyetën Pjeprin me specialistat që e rrethojshin se çka mendojshin për figurën e Pashait. Njeni, që vinte e m'i tregonte të gjitha marëdhënjat e operativit me odën e përkthyesve, më pat thënë se të gjithë iu përgjegjën se Pasha turk ishte Napoeloni i vogël i Shqipnisë, Napoleoni i vogël, po rrena e madhe. E kishin dhanë këtë përgjegje sepse dojshin me u lirue sa ma parë, ose me pasë sa ma pak telashe me drejtorinë.

Burreli mund të radhitet ndër shkollat ma të famshme të spijunazhit për spijujtë pa shkollë. Spiju pa shkollë ishte edhe Pjetër Arbënorë me shokët e tij. Kur m'i pat futë thojtë në fyt, thue se donte me xjerrë prej andej tana fjalët që kisha thanë gjatë gjithë jetës seme e me ia dorëzue një copet sigurimit, mbarë të burgosunt, tue e njoftë temperamentin tem kolerik, më ngucshin me ia kthye me të njëjtën monedhë. Madje kishin përgatitë edhe qullin e vluem me ia hjedhë mbi kryet e tij tullac e me e shëmtue për jetë të jetëve. Kështu do ta kishte gjithmonë në majë të kresë vulën e trathtisë! Por hakmarrja nuk asht e këshillueshme për asnjë njeri, aq ma pak për një prift, që jeton me bindjen se padrejtësitë i ndëshkon vetë Zoti, synit të të cilit nuk i pështon asgja. Po ta kisha sakatue atë fizikisht, do të kisha sakatue shpirtnisht vetvedin. Mandej, si do t'ia kishte ba, qyqari, me na drejtue parlamentin tonë me tollë të përzhitun prej qullit të përvëluem? Me tollë të djegun a të padjegun, bota pyet: Si mujti ky njeri me iu ngjitë shkallëve

të politikës me një lehtësi të habitshme, në një kohë kur burra shumë ma të mirë se ai jetojnë të harruem ndër rrënojat e tyre shkodrane?

Mbas zyrës së përkthimeve, vijshin spiujtë tjerë pa shkollë: kuzhinieri, pastruesi, marangoni, këpuctari, rrobaqepësi, llogaritari, magazinieri. Tepër të randësishëm këta zotni, sepse prej tyre përfitonte ekonomikisht edhe personeli i drejtorisë, mbasi askujt nuk i delte rroga për të jetue normalisht. Këta na delshin dishmitarë, kur duhet të dënoheshin rishtaz, na rrihshin, na vidhshin racionin e vojtit prej 7 gramësh, e bashkë me të, edhe makaronat, të cilat shtiheshin në ujë nga mbrapavija, apo qenërija, për t'u ba petulla. Shumica e këtyne spiujve i kishin pasë edhe babat e vet të burgosun në të njëjtin burg. Tashti babat flejshin dytri metra larg, në vorrezën që shtrihej rreth e qark e për qark vendit, ku bijtë i pritëte i njëjti fat. Natyrisht babat kishin kenë shumë ma të mirë se bijtë: i kishin mbytë për të vetmin krim, sepse kishin qindrue: kishin hjekë dorë nga dishira për të kenë të lirë, ata vetë e populli të cilit i përkisshin. Në fillim burgu i Burrelit përbunte⁴² luftëtarë të vërtetë të lirisë. Por ma vonë terrori i tmerrshëm mërrijti me i përkulë aq keqas të burgosunt, sa njeriu i ndershëm e kishte vështirë me gjetë mbrendë një shok si vedin, me të cilin të mujte me shfrye. Ma të ndershmit na porositshin mos me folë me za të naltë kundër regjimit, sepse veç atyne që përmendëm, aty kishte edhe spiuj të tjerë, që do të shkojshin patjetër me raportue. Përndryshej e pësojshin si ushtari në kufi, kur i rrëshitëte ndonjë skllav e delte në botë të lirë. Edhe në burg

⁴² Fjalë e ndërtueme me parashtesën *për-* dhe rrajës *me bujtë*: me kalue natën, a me ndëjtë dikund për një kohë të caktueme.

kishte një kufi, i cili nuk duhej kalue. Ishte kufini i buzëve. S'mjaftojshin dryjtë e burgut. Drynin ma të madh duhej me ia vu gojës. Po unë nuk kam mujtë kurrë me heshtë. Po të mos kisha shfrye, do të kisha dekë kaherë e mot. Kështu pra, kur isha mbushë, sa mos me mujtë me heshtë ma, u thojshë spijujve të bajshin gati letër e lapcë. Madje nga një herë ua epshe vetë. E atëherë fillojshe ligjëratën, që zakonisht kishte një trajtë të tillë, aspak ciceroniane: “Bibla thotë: Kur Zoti don me ndëshkue një popull, e lëshon në duer të fëmijëve. Ndërsa unë, këtu në burg, jam bindë se “Çdo popull ka atë qeveri që meriton!” Qeveria jonë s’asht gja tjetër, veç shpellë hajnash, imoralash, injorantash, që e kalojnë ditën tue sendërgjue vrasje, arrestime, internime”. E, sa herë kthehej në birucë njeni prej atyne që kishin firmosë, gja që lexohej kjartë në sytë e neo-spijunit, e pritshe gjithmonë me shprehjen lapidare: “Edhe ti Brut, biri im!”

Një prej ish-udhëheqësave, me të cilin kam ba burg, më ka tregue se për çdo ditë nga Komiteti Qendror delte një dosje e kobshme sekrete. Në të shënoheshin emnat e gjashtë-shtatë shqiptarëve, që duhet të zhdukeshin misteriozisht shi atë ditë, për t’i lanë rradhën gjashtë-shtatë të tjerëve që do të niseshin për të njëjtën rrugë n’e nesre. Natyrisht ishin njerëzit ma të drejtë, ma të guximshëm, pse jo, edhe prej rradhëve të komunistave idealistë, që shumë shpejt e kishin pa sa larg ishte teoria prej praktikës së përditshme kriminale të komunizmit. Kështu zhdukej materia trunore e Shqipnisë e mbetshin vetëm ata që nuk dijsin ma as kush ishin e as pse bajshin ndopak hije mbi dhe. Kjo ishte një ligjëratë tip që bajshe herë mbas here para spijujve të ngratë, që dridheshin vetëm tue më ndigjue.

Ata që nuk dorëzoheshin e nuk pranojshin kurrsesi me u ba spijuj të qeverisë, e kishin ndërgjegjen të qetë. Durojshin torturat fizike, po jo ato shpirtënore, që janë ma të tmerrshmet. Tragjedia e vërtetë për të burgosunin fillonte pikërisht kur ai vendoste “me u rehabilitue”, simbas shprehjes së operativave injoranta. E së bashku me “rehabilitimin”, fillojshin edhe bremjet e ndërgjegjes, që ishin aq të tmerrshme, sa shpesh “neospijuni” përfundonte i vetvarun ndër hekurat e kryqëzuem të dritoreve. Më kujtohet një qyqar, që e morën prej burgut për t’i dalë dishmitar të birit në degën e punëve të brendshme, ku ishte para hetuesve. Aty u vu ballë për ballë me t’anë i cili, prej drojes së torturave, e trathtoi. U kthye në burg i tjetërsuem. Nuk mund të qëndronte ma në kambë. Që ta shpërblejshin për trathtinë, e shtruen në infermierinë e burgut, ku mund t’i shtrinte mirë brijtë në një shtrat në vedi. Po shtrati nuk ishte ma për të. Tue trathtue të birin, kishte stërtrathtue vetvedin. Kishte vra gjumin. Për të s’kishte ma prehje, s’kishte ma natë as ditë, s’kishte ma qetësi. Therjet e ndërgjegjes ishin aq të padurueshme, sa mbas dy ditësh morëm vesht se kishte gjetë një copë xham e me të kishte pre dejtë, për t’u çlirue një herë e përgjithmonë prej torturave të shpirtit të vramë, tue besue, i shuemi, se me dekë gjithçka merrte fund.

Natyrisht asnjë i burgosun nuk pranonte se ishte spijun. Të gjithë thojshin se ua kishin ngarkue me detyrim këtë punë. Deri Osman Kazazi, kur u ba infermier, më pat thanë: “S’pata çka me ba, o me pranue, o me i kalue ditët që më kanë mbetë, në birucë”. Spijuni ma fatkeq ishte mjeku, sepse të sëmundët, kur nuk shëroheshin, e rrahshin dhe shkarkojshin mbi shpinë të tij gjithë mllfet me të cilat

shpirti i tyne, edhe ma i sëmundë se korpi, ishte i stërngarkuem. Për me i ba ballë kësaj gjendje, mjek burgu duhet të ishte Shenjti Shëna Ndue.

Sapo ai u dukte në sportel, të dënuemët grumbulloheshin si pulat kur u hidhen kokrrat. Shtyheshin për me marrë ilaçe, tue mendue se pastiljet të shërojnë prej mërzisë së tmerrshme të burgut, të lehtësojnë mallin për familjen e sidomos për lirinë, të cilën ata që ishin jashtë e gëzojshin edhe ma pak se na mbas hekurash e ndër hekura. Por ilaçet e tija nuk kishin shërue askend prej këtyne sëmundjeve të tmerrshme, prandej dahej gjithnjë i shamë, thirrej me mbiemnin spijuni, si gjithë mbrapavija e burgut, që i përkitëte së njëjtës familje, e jo rrallë, hante edhe grushta. Kur në kampin e përqendrimit mungonte mjeku, arrestohej menjëherë ndonjë, që deri atëherë e quente vedin mjek i lirë dhe kështu plotësohej kuadri. Nuk kishte randësi fare se çka kishte ba. Burgut i duhej një mjek dhe qe, mjeku ia behte në kohën e duhun. S'ishte vështirë aspak mbasi të gjithë shqiptarët ishin çdo ças kandidatë për t'u arrestue sepse natyrisht të gjithë ishin të pakënaqun, të gjithë flitshin kundër qeverisë dhe të zhdeshun prej çdo vlere shpirtnore, vidhshin ç't'u binte në dorë e bajshin gjithfarë mëkatesh. Ishin të gjithë nën të njëjtën zgjedhë, si kau në kular, por asnjëni nuk tërhiqte drejt. E kështu e shtrembnojshin për ditë e për natë hullinë e partisë.

Bisedojshim shumë në burg. Biseda niste gjithnjë me seriozitet, por menjëherë mbas degjeronnte në banalitet. Familjariteti kultivon përbuzjen e na ishim ma zi se në familje. E çfarë familje se. Të grumbulluem me dhunë. Jetojshim pranë e pranë pa u dashtë, deri në atë gradë, sa kur diste kush, të gjithë gëzoheshin se iu lirue sadopak vend.

Madje, në vend të lotëve, fillonte shamata për katërdhetë centimetrat që sapo ishin lirue. Jeta ishte e ngarkueme me tensionet që krijeshin pa pushim dy-tre gangsterat – spiuj, të cilët, si perandorët antikë, sundojshin gjithë atë mbretni të shejtanit. Ata e fillojshin veprimtarinë me të shame pa adresë, që prekshin e ngucshin gjithkënd. Megjithatë të gjithë i durojshin, madje u epshin edhe me hangër prej gjellëve të veta. Sepse i kishin shumë frikë. Unë s'u flitshe kurrë, e ata më thojshin me kërcënim: "Pse s'na flet, zotrote? Apo je ma i mirë?!" Përgjigjesha rishtas me heshtjen kryefortë. E dijshe se këta të poshtër dojshin me krijue idenë se janë të ndershëm, se shkojnë mirë me të gjithë, se i duen të gjithë. Të gjithë po, por jo Dom Simoni, që tue ia pasë thye dhambët, nuk mund ta hante këtë kokërr ullini!

Nuk shkruaj thjesht e vetëm për me kujtue, jo! Prej këtyne rreshtave mund të kuptohen lehtësisht ngjarjet që ndodhën, mbasi u hapën dyert e burgjeve, të cilat dikujt-dikujt i duken pak si të habitshme e të pashpjegueshme. Kërkojeni, pra shpjegimin, tue u nisë shi prej birucave të burgut, prej atyne që u patën flakë aty e që kur dolën, sigurisht nuk ishin ma ata që u patën hy. Prej atyne që prej birucave ulën në popen e qeverisë. Ndërsa shumë të tjerë, që kishin vuejtë edhe ma tepër, mbetën luftëtarë të panjoftun të një lirie iluzore. Prandej mendoj me i përmendë emnat e plotë. Përndryshej nuk do të kuptohet mësimi i historisë e ajo do të vijojë me u tallë keqas me ne deri në ditën e gjyqit të mbramë, kur ma në fund politikanët e të gjitha kohnave kanë me u detyrue me i tregue publikisht mëkatet e tyne, krimet e tyne.

Sadoqë ruheshin mos t'ia kapshim letrat që i shkrueshin drejtorisë, shpeshherë i kapëm, madje edhe

letrat e Pjetrit. Ky rrinte natën çue e shkruente, kur të gjithë ishin në gjumë të thellë. Thonte se shkruen romane e vepra të tjera, që do ta bajshin të padekshëm. Kur takoheshin spiujtë, ishte gjithmonë i pranishëm operativi, ndërsa në takimin e të tjerëve, mjaftonte një polic i thjeshtë. Edhe kur spiujtë lejoheshin me fjetë me gratë e veta gjithë natën, diku, ndërmjet, si shpata ndër romanet e kalorësve, ishte një spiju tjetër, edhe ma i sofistikuem se ata vetë: mikrospijuni, i cili regjistronte gjithçka ndodhte në shtratin e një nate burgu, dhuratë që drejtoria u bante spiujve. Në të gjitha takimet speciale të spiujve, mikrofoní ishte aty, gati për të regjistruar çdo dridhje zani. Ishte aty edhe operativi, që silllej e përsillej, gjoja se kishte punë, por në këtë rasë operativi i vërtetë ishte ai, mikrofoní i mshehun, gja që, megjithatë nuk ishte aspak e mshehtë, sepse e dijsin të gjithë. Mbas takimit me familje, i burgosuní agjent takohej me operativin dhe i epte gojarisht informatat e shtratit, të cilat nuk i kishte dhanë me shkrim. Unë i kam pa sa herë spiujtë tue u takue me operativin, ndërsa më hiqshin zvarrë në degë për të më dhanë një dënim të ri, si njeri i pandreqshëm. Bisedojshin plot mirëbesim për anmiqtë, sikurse na quejshin ne që nuk e pranuem kurrë punën e ndytë të spijunit. Një herë, kur Pjetri me shokë rrahën një spiju, dega, për me ruejtë unitetin e spiujve, e dënoi Pjetrin me një muej birucë, tue ia hjekë teshat e tue e lanë në brekë në mjedis të dimnit në çimento, sepse me rrahë një spiju ishte njëlloj si me rrahë një oficer të degës. Ndërsa kur Pjetri m'i nguli një ditë thojtë në fyt, nuk i tha kush as ma andej as ma kënde, edhe pse unë lajmova prokurorin, tue kërkue që ky njeri ordiner të çohet pikërisht në odat e ordinerëve. U shkrova edhe letër autoriteteve. Lajtmotivi ishte: "Ju doni me sundue burgun

me metodën përçaj-sundo! Prandej na keni përça kaq tmershëm, e na keni çue peshë njenin kundër tjetrit!” Pasojat e letrës nuk ishin të paprituna për mue. I kisha provue sa e sa herë. Nuk më dënuen përsëri me gjyq. Më kishin dënue e stërdënue. U pëlqeu kësaj rradhe me më torturue keqas. Më lanë në gjak, më flakën në birucë, ku u dergja një muej pa tesha e pa ushqimin tem personal. Operativi, Esat Lata, e kishte për nderë me u takue me satelitët e vet intelektualë, sepse ai vete ishte një injorant i madh dhe shpesh kalonte orë e orë kokë më kokë me ta, tue vjelë informata, të cilat besonte se janë burimi kryesor i kulturës. Përderisa delshin prej gojës së njerëzve të kulturuem!

Një herë, porsa duel nga ajo zyrë, Esati, pa farë takti, më thirri, s’la gja pa më sha, më rrahi barbarisht e më izoloi një muej, midis dimnit, pa tesha fjetje, pa peliçe, pa fanelë e pa ushqim personal.

Në kohën e takimit me familjen, policët vijshin e e lajmojshin të burgosunin të bahej gati, por kur i burgosuni qillonte spiju e operativi nuk ishte aty, atij qyqarit i duhej me pritë me orë të tana, derisa operativi të vinte. Na u kënaqshim tue qeshë, në mjerimin tonë, e i thoshim njeni-tjetrit: “Ka dy takime, prandej vonohet... veç i dyti asht ma i randësishëm se i pari. Se çka asht për një spiju, grueja, para operativit!”

As unë nuk pështova nga ftesa “fisnike” me i shërbye qeverisë. Porsa kisha krye hetuesinë, filloi një torturë tjetër. Kapiten Xhevdet Miloti, një ndër njerëzit ma besnikë të degës së punëve të brendshme, kur unë torturohesha, e po na thonë – një prej punonjësve ma të nderuem të Karitasit shi në Romë në kohë të asaj që po na e quejnë demokraci,

pështetë e ndihmue prej ofcieres së kahmotshme të sigurimit në Latina, Alma Galanit, më mori përsëri në pyetje. Këtë rradhë për me më ba një propozim që ma paraqiti tepër të leverdisshëm: me u ba spiju birucash! Thue bana keq që nuk pranova? Ndoshta, me pasë pranue, mund t'i kisha xanë vendin Pjetrit! Po a mund ta përfëtyrojë kush don Simonin pa dhambë, sepse lanë në birucë, tue drejtue parlamentin shqiptar krah për krah me ata që ia patën zhgulë dhambët? Më thotë, pra Xhevdeti: "Ti mund të na ndihmosh shumë nëpër kampe e burgje, sepse je meshtar e të beson gjithkush. Mandej, k'ton (kështu e shqiptonte fjalën kupton, tue ia hangër gërmat, ashtu si hante ditët e jetës sonë) rrëfimi t'i hapë tana dyert për me hy aty ku na s'mundena me hy kurrë: në të mshehtat ma të thella të njerëzve." Kaq i poshtër Xhevdeti! Kujtonte se rrëfimi asht si një autokritikë komuniste që mund të shitet në treg. E s'ishte kënaqë, maskarai, me dhetë vjetët e burgimit tem, as me torturat e hetuesisë, as me shkatërrimin e të pesë kishave që me sa mundë i kisha ndërtue në Mirditë, por donte me ma marrë njëherë e përgjithmonë edhe nderin, tue më ba me bjerrë edhe shpirtin që e kisha ruejtë me aq përkushti. Dhe nuk e shqiptonte kurrë fjalën ma të ndytë që ka njoftë bota, që ia kalon tana fjalëve të fëlliqta, fjalën spijunazh! Jo, jo, këtë soj zanati e quente "me punue për të mirën e përbashkët". Thue se këtë të mirë, të cilën ai e gëzote me të vërtetë, tue udhëtue me veturë, tue dalë jashtë shteti, ku e pritshin Almat, sa herë i donte qejfi, tue u veshë as të ishte kont Miloti, do ta gëzojshe edhe unë nëpër llomshtinat e kampeve, ku do të më duhej me jetue tue trathtue vetvedin, për me ia ba qejfin markezit Miloti, krijesë e pështirë.


Refuzova pa kurrfarë mëdyshe. Atëherë ai nisi me më kërcënue: “Mbylle gojën mirë – më tha – e mos guxo me i tregue kampesh emrat e spiujve që të kanë dalë dishmitarë e të atyne që janë bindë se rruga ma e drejtë asht me e pranue këtë propozim që t’u ba edhe ty. Ata kam me t’i vu shpinë më shpinë, ke me i pasë gjithnjë ngjitë, si pulla e postës mbi letër”.

Shpesh e kam pague trashë qëndrimin që kam mbajtë kur vijshin spiujtë prej takimeve. Sapo ktheheshin, unë luejshe rolin e korrespondentit të Vatikanit. I mblidhshe gishtat, tue u dhanë trajtën e mikrofonit dhe i drejtojshe të sapoardhunit një breshni pyetjesh, të denja me u transmetue drejtpërdrejt. Por sa larg ishte mikrofonit i Radio-Vatikanit, sa i papërshtatshëm mikrofonit i gishtave të mi të mbledhun tub e sa afër dajaku. E pyetshe, pra, të sapoardhunin, tue ia vu dorën e mbledhun te goja: “Na thoni, ju lutem, ma së parit, si ishte më shëndet kryetari i degës së punëve të brendshme, sepse si t’ia bajmë, me na i ndodhë larg qoftë, ndonjë e keqe..!” Natyrisht intervista ndërpritej brutalisht e Dom Simoni merrte si shpërblim thyemjen e dy e tre dhambëve të tjerë, derisa u zhdukën të tanë e i erdh rradha nofullave.

Më duhet edhe sot e kësaj dite me përdorë të njëjtin mikrofon, ndonëse po thonë se erdh liria e po lulëzon demokracia. Sepse mikrofonat janë të mbyllun për arrat gungçe, e sidomos, sepse në këtë botë e vërteta kenka tepër e idhtë për shumkend. Unë nuk jam burrë shteti, por nuk mund t’i duroj, njëlloj, as komunizmin, as mafien që sundon sot në vendin tonë. E më duket se nuk mund t’i durojnë edhe shumë të tjerë si unë, përderisa parapëlqejnë ma shumë me u mbytë në ujnat e deteve që ndajnë

Shqipninë me perëndimin, sesa të jetojnë nën terror, rrena e persekutim të vazhdueshëm të qeverisë tribale të Tiranës. Mbarimi i shqiptarit në kufijtë ndërmjet jetës e dekës nuk asht fenomen i ri: telat me gjemba janë rishtas aty ku ishin, të padukshëm, por realë!

Demokracia e re predikon jetën në paqë të ujkut (qeverisë) me kijin⁴³ (Kishën). Çudi! Kush, thue, ka me e hangër tjetrin?



⁴³ Qengj.

Ora e komedisë

Mos mendoni se në burg gjithçka ishte tragjedi. Kudo e sido të ndodhet njeriu, në jetën e tij, pranë e pranë tragjedisë, ka gjithmonë diçka komike. Kështu edhe në burg, ku shumë njerëz vëejshin prej kompleksit të inferioritetit. Tue mos pasë lexue kurrnjë rresht në jetë të tyne, kishin çaste kur për t'u barabitë me njerëzit e kulturuem, me të cilët rrihshin gjithë ditën në të njëjtën kuti sardelash, fillojshin me kujtue tituj librash e me citue autorë, që as në andërr s'i kishin pa. E njëkaj i shtrembnojshin emna e fjalë, sa ishte e pamujtun mos me u shkri tue qeshë. Mandej fillojshin edhe me shkruë libra. E, si i kishin krye, m'i epshin mue, tue shpresue se do t'i rradhitshe ndërmejt autorëve ma në za të letërsisë botënore, natyrisht aty diku ndërmjet Shekspirit e Molierit! Shkrimet u gitshin⁴⁴ si dy pika uji autorëve. Kishin aty-këtu ndonjë perlë, vjedhë prej thesareve botënore e qepë me spagën e burgut në rreshtat e shkrimit. Si ia hiqshe këto stoli, vepra tingëllonte si hartim i keq gjimnazistësh. Ia thojshë këtë e ata tërboheshin. Kujtojshin se ua baj prej zilisë e se veprat e tyne, kur të delshin prej burgut, do të shndritshin në vitrinat e librarive botënore, ku medet ajo pjesë e tragjedisë që ka mujtë me u shtypë, shitet me gjysë çmimi, sepse njerëzve të ngopun të perëndimit nuk u pëlqejnë historinat e martirizimit. As para e as mbas buke! Njenit, si ia pata lexue kryeveprën, i pata thanë se ishte nën

⁴⁴ U ngjanin.

nivelin intelektual të kalit të Skanderbeut! Një tjetri, se jetonte vetëm për me hangër!

Pjepri më thonte se operativi nuk i lexonte letrat e katundarëve, sepse, katundar edhe ai vetë, nuk i kuptonte marrinat e tyne. Mirëpo katundarët me opangë të trasha, mendtë i kishin aman sa të holla. Po kallxoj vetëm këtë shembull: një mik i jemi prej Bushatit, kishte marrë një ditë letër nga e shoqja. Ndër të tjera, i shkruente: “Ti je njëqind herë ma mirë se unë, aty në burg, sepse ata 600 gram bukë plot me dhe, guraleca e mbeturina të tjera, që ty të bien në skjep pa pare, mue më duhet me i fitue tue punue si shaka në shi e në diell, tue më shkue djersa për lug të shpinës. Ti pushon gjithë ditën aty në birucë, ndërsa unë kam mall për një ditë pushimi, sepse edhe n’e diele na e marrin shpirtin me punë angarije e me konferenca pa fund”. Një pohim kësisoji na kënaqi pa masë. Don me thanë se ata që quheshin të lirë, na kishin lakmi ne që ishim ndër pranga. Bukuri. Një komedi e tillë na shkonte për shtat që ç’ke me të, edhe pse i bante krejt të pavlefshme kërcënimet e drejtorit të burgut, i cili ndër të tjera, na thonte: “Sillu mirë, se përndryshej ta dërgoj familjen prej kooperative, në kamp të përqendrimit e nëse vijon me u sjellë keq, edhe në birucë të burgut”. Letra e katundares prej Bushatit na tregonte se kjo shkallë të çonte shi në parriz, aty ku na kishim mërritë prej kohe.

Burime të tjera krijimtarie për komeditë tona sihin shtypi e radioja. Fillojshim me gazetën “Zëri i rinisë”, që kishte marrë mbi vedi me zgjidhë hallet e të rijve. Lexojshim me za të naltë formulat e recetat për pajtimin e çifteve që vuejshin nga xhelozia e prireshin për shkak të hileve që i kurdisshin njeni-tjetrit. Rinia paraqitej krejtësisht e pastër

moralisht, ndërsa na kujtojmë pikërisht atë që nuk shkruhej, atë që ishte ndërmejt rreshtave. Na shkonte menjëherë e pa dashtë mendja te parku Rinia në Tiranë, ku po të ecshë pa kujdes, rrezikoheshë me shkelë orë e çast njenin prej çifteve të shumta, të kapërthyem. E nëse kishe rrezik me kalue atypari natën, të krijoheshë ideja se janë çue lugetënt prej vorreve, për shkak të grahamave të tmerrshme që naltoheshin si kor prej qylymit të barit, ku varzat e reja bajshin hapin e parë drejt abortit, sepse detyroheshin t'i mbytyshin fëmijët e xanun mbi bar, ndërsa zhyteshin, pa dijtë not, në detin e Erosit e të Venerës. E të kujtosh mandej këtu aksionet, zboret e zdërhalljet tjera, që organizoheshin për edukimin, don me thanë, për çedukimin e rinisë.

Vijojshim mandej me lexue, simbas mënyrës sonë, organet tjera të shtypit:

I burgosuni I: Na akuzojnë se nuk kemi vetura!

I burgosuni II: Po ç'na duhen veturat neve, që e duam njëri-tjetrin, aq sa na pëlqen të udhëtojmë të gjithë së bashku, kolektivisht, ndër autobusa, madje na pëlqen edhe më shumë të shtegtojmë në makina të hapura fare, në kamiona, sepse kështu ngopemi jo vetëm me njëri-tjetrin, por edhe ma ajër.

I burgosuni III: Ndërsa ata që jetojnë në perëndim nuk e duan njëri-tjetrin. Prandaj udhëtojnë secili për hesap të vet, në vetura personale. Pastaj të gjojnë, e kalojnë gjithë ditën në radhët e dyqaneve, për të blerë prasët apo purritë e importuar nga Shqipëria.

I burgosuni I: Njerëzit atje s'bëjnë tjetër, veçse të kërkojnë ndër plehra.

Nganjëherë unë s'e përmbajshë ma vedin e delshe jashtë tekstit. Një ditë i thashë drejtorit. "Pse nuk na dërgoni

edhe ne, për dënim, në botën kapitaliste? Me çka shkruajnë gazetat tueja, atje kemi me vëjtë ma keq se në Burrell!”

Në rasa të tilla, për mue hapej perdja e tragjedisë. Sepse, more zotni nuk duhen harrue kurrë fjalët e urta të popullit, që thotë se gazi i tepruem shpesh del vaj e për ma tepër shton edhe “goja llap e shpina dap!” Mbas këtij soj gazi, për mue fillojshin torturat deri në atë gradë, sa përfundojshe si Feniksi: hi e pluhun. Por kur hapej përsëri dera e hatashme e birucës, për me spastrue hinin tem, si Zogu Mitologjik unë çohesha rishtas në kambë prej pluhnit, gati për një komedi të re! Sekreti? Lutja, zotni. Ishe ajo që më epte jetë, kur më kishin braktisë edhe forcat e fundit fizike! Besoni me gjithë zemër e lutuni e keni me e pa si shndërrohet njeriu në Feniks! Madje në diçka ma hyjnore: në një të dekun, që ngjallet në të tretën ditë, për me u ngjitë ndër rrethe të epra, ku s’ka ma burgje as pranga!

Një burim tjetër për komedi ishte edhe radioja, që shërbente për të na edukue, sepse edhe vetë burgu quhej “Reparti i edukimit”. Kështu fjala e lemerishme burg zhdukej nga fjalori e bota nuk mund të ankohej se Shqipnia kishte burgje, e aq ma tepër se nuk kishte kurrnjë pëllambë të këtyne trojeve, ku të mos ishin hapë vorre, për të kallë mbrendë trupa koc e lëkurë të burgosunsh e të internuemësh, që janë dëshmorët e vërtetë të luftës për liri.

Për të na edukue pra, e çojshin në kupë të qiellës altoparlantit e Radio-Tiranës, prej të cilit patëm fatin të ndigjojmë lajmet ma gazmore të jetës sonë. Skena e parë e asaj që pritshim me padurim, ishte lajmi se Mehmet Shehu, mbas një krize të randë nervore, kishte vra vedin. Kulmi i komedisë mërrijti me dekën e Enver Hoxhës. Gazi që prodhoi ky kulm duhet shënue në analet botënore të

historisë së gazit, sepse nuk ka komedi tjetër që të ketë shkaktue kund një gaz ma të tërbuem, ma të tmerrshëm, ma ulurues se ai që shpërtheu në birucat e burgut. Më ushton ende në veshë zani i shokut tem të mjerimit, të ndjerit Ded Begeja, që naltohej mbi gjithë tjerët, në një dalldi çmendunie, prej gëzimit. Madje edhe në fëtyrën e policit, që hapi sportelin me pa se çka po ndodhte, lexohej gatishmëria me ia plasë gazit, sepse edhe ai i mjeri ishte në njëfarë mënyre, skllav, si na. Na ruente ne, sepse ishte ma kollaj se me ruejtë arat e kooperativës. Shpesh hante në sy tonë bukë me arra, që i kishte vjedhë e shoqja ndër pemishte të kooperativës.

Dëfrehesha prandej tue u tallë miqësisht me policët, të cilëve, kur isha në qejf, u thojshë: “Mirë unë, që rri këtu sepse flas e jam kundër komunizmit e komunistave, po ju çfarë krimi keni ba, që ju kanë dënue me më ruejtë mue 12 orë rresht!? E kur ju merr uja, hani ma keqas se unë, një copë bukë gur e dru me arra ose me mollatarta të vjedhuna prej grave tueja në kooperativë. Çka më dhimbeni, bre qyqarë: unë jam i dënuem me burgim të përkohshëm, kurse ju, me burgim të përjetshëm!”

Ndër regjimet diktatoriale, ma mirë se kushdo, jeton ai që rebelohet, që nuk i dhimbet jeta. Të tjerët, që nga ma i randësishmi, deri te ma i mbрами shërbëtor i diktatorit, jetojnë të gjithë në ankth, pa e dijtë ke kanë mik e ke anmik, tue pritë kur po ngrihet trekambëshi e po bahet gati stoli. E sigurisht s’i bjen kurrë ndër mend me marrë pjesë ndër komedinat që kemi luejtë gjithë zell e qejf në birucat e burgut. Sepse, qyqarët, lejnë e desin në skenën e tragjedisë.

Një skenë tjetër e komedisë së birucës hapej kur vijshin inspektorët e burgjeve nga Tirana. Të gjithë shokët e

dhomës i mbajshin sytë te unë, për me marrë zemër, sepse nuk dihej se çka do të shestojshin miqtë e padishrueshëm. Atëherë unë bahesha gati me shfrye, për mos me plasë. Ata që vijshin prej Tirane, kishin veshë me këtë rast kostumin e së dielës. Ecshin me krenari të parët e mbas tyne bisht, vinte karvani i autoriteteve të Burrelit me uniformat ushtarake. Gërsitshin çilcat e dryjtë, hapeshin me kërcëllime dyert dhe mysafirët dukeshin në kornizën e tyne me fëtyra të ngërdheshuna, sepse në hundët zyrtare përplasej menjëherë e pa pikë respekti, era që delte nga zhelet tona të ndyta e sidomos nga qypat në qoshe të dhomës, përplot me prodhimet e emocioneve të rastit. Në një skenë të mbushun kësisoj me aroma, i madhi nga Tirana merrte fjalën para 30 zhelanave, mbështjellë me jorganin e Stalinit, domethanë me do si mallota të randa, sepse të mbushuna me pambuk të keq, që për eufoni i quejshim peliçe. “Kemi ardhë edhe për ligjshmëni. Prandej, nëse ka kush ndonjë ankesë, nëse i bëhet ndonjë padrejtësi, ne jemi gati ta dëgjojmë!

30 zhelanat shikojshin me sy gati të shuem atë që kishte ardhë për me u dalë zot. Ndër zhelet e peliçeve mshehshin varrët e tmerrshme, të pathame të hetuesisë, që thershin si paralajmërim. Jo, ata nuk kishin asnjë ankim, nuk u ishte shkelë asnjë e drejtë! Mund të bajshin be të dlirtë. E si mund t’u dojshin me thanë: “Fol, pra, ti për ne!” E natyrisht domi nuk kishte si mos me iu përgjigjë atyne syve, që lirinë e kërkojshin pikërisht në fjalën e priftit, i cili për ta përfaqësonte Krishtin. U çojshë, atëherë, e t’ia fillojshe litanive të mëdha: “Ju këtu po na flisni për ligje. Për cilat ligje? Të shkruemet apo të pashkruemet? Se na këtu trajtohem si simbas ligjeve të pashkrueme, se ky s’asht burg, po institucion çfarosje, se nuk asht aspak gja e vështirë me

kuptue, që na jetojmë nën nivelin e shatzëve”. Natyrisht, nuk mërrijta kurrë me i përfundue litanitë, sepse ai shoku që kishte ardhë me mbrojtë drejtësinë e lidhun në hekura, epte urdhën që të më bajshin me vallëzue. Kështu komedia e burgut për mue e për shumkend, kishte gjithmonë fund tragjik!



Andrra në diell

Bisedat e të burgosunve, në përgjithësi, ishin vulgare, mediokre. Kryet e vendit e xente erotika. Shumica e këtyne njerëzve kishin zot barkun e Erosin a Kupidin, e secili mundohej me e paraqitë vedin aventurier të madh, që kishte ba kërدينë, sa kishte kenë ende gjallë, don me thanë, jashtë këtyne mureve sepse këtu mbrendë nuk dihej ma ç'rodë njerëzish ishim. Zotat e seksit sundojshin në mënyrë të veçantë shpirtin e atyne që kishin ra në burg, mbasi kishin pasë fatin me jetue jashtë shteti, ose të ish-qeveritarëve, të cilët i kishin detyrue vajzat e gratë e shkreta me shitë nderin për një vend pune e deri për një talon. Kështu edhe nëpër kampe e burgje, vende mjerimi, që duhet ta bajshin burrin sadopak serioz, u delte emni femnave të shkreta, viktima të këtyne soj mashkujsh, sepse burra nuk mund të quheshin. Natyrisht ata hyjshin në burg me një ves, por tue ndejë me të burgosun, që ishin të stolisun me të gjitha veset, pasunoheshin e baheshin mjeshtra. E burgu mund të rradhitej ndërmjet shkollave ma të mira të vesit, që ka pa ndonjëherë bota. Kjo shkollë e hidhte njeriun në prehën të disprimit të pashpresë, e zhdeshte nga çdo dinjitet njerëzor, e afronte gjithnjë e ma shumë me shtazët ma të ulta.

Njofta pak njerëz të vërtetë në burg, ndoshta edhe pse idealistat e regjimit të vjetër tashma flejshin gjumin e madh, me krahnoret e shporueme nga plumbat ose me arrçin e qafës të këputun prej konopit. Kur u arrestova unë, kishte teprue vetëm ndonjë plak, por gjithsesi pikërisht ai përfaqësonte njeriun e vërtetë, të cilin burgu nuk ia kishte

dalë me e shnjërzue e që jetonte me pulsën e situatës botënore, në një kohë kur të gjithë të tjerët, të zhytyn në pesimizëm, shihnin andrra në diell. Te kush mund të shpresojshim? Te superfuqitë, që na lëshuen në duer të komunizmit? Për shkak të të cilave ishim aty, në birucë, të kthyer në gjysa njerëzish? Na mbetej me shpresue vetëm te një luftë e mundshme ndërmjet dy kampeve, ndërmjet rusëve e amerikanëve. Prandej rrijshin tue shikjue qiellin, me shpresën që ta shifshim tue u kuqë prej zjarmit të luftës. Ishim të bindun se sikurse lufta e dytë na kishte pru komunizmin, ashtu një luftë e tretë do të na lironte prej skllavënisë së përvetshme dhe një rend i ri, do të na kthente dinjitetin. Andrra në diell! E andrrat tona ishin shkas i shtimit të mundimeve tona. Sepse këtu spijujtë hyjshin deri ndër andrra. Atëherë na kërcënojshin se po të realizoheshin andrrat tona, po të rrezikohej sadopak pushteti i Enver Hoxhës, na do të ishim të parët që do të ishim të parët që do të asgjësoheshim. E unë, për t'u tallë me ta, u thojsh se bashkë me ne do të detyroheshim me vra edhe spijujtë, që i kishin përgatitë me aq zell.

Të gjithë katolikët po se po, por edhe myslimanët e ortodoksët, kur flitej për të ardhmen e njerëzimit, e shifshin të ardhmen e botës të bazueme mbi parimet e fesë dhe kryekështjellën e mbrojtjes së këtyne parimeve, tek Kisha katolike, e vetmja forcë që i kundërvehet së keqes, tue e pague këtë kundërvumje deri me gjakun e bijve të vet, që asht derdhë rrëke në shekuj në emën të lirisë e të dinjitetit njerëzor. Enver Hoxha, megjithëse kishte tru ma pak se një zog pule, ia kishte marrë borxh idetë e veta së djathtës amerikane, ndërsa i mbushte gazetatat me shamje kineze kundër imperializmit amerikan, tue e quejtë “xhandar

ndërkombëtar” e “gjigand me kambë argjili”. Prandej unë, kur mbaronte ndonjë prej konferencave të zakonshme në oborrin e burgut, u thoshe të mos e shajshin imperializmin amerikan, se ishte shi presidenti Roosvelt, ai që nga Jalta, i kishte sjellë në fuqi, tue ia falë Stalinit Shqipninë e vogël.

Bisedojshin dendun për Shqipninë politike në rrjedhë të historisë. Dikush thumbit-dikush patkoit. Sa herë binte fjala për qeveritë, shumë prej nesh mërrishin në përfundimin se ndërgjegjja e shqiptarit ka kenë gjithmonë aq e tronditun, sa me dishrue ma mirë okupatorin se sundimtarin vendas. Me ndejë ma me kënaqësi nën turq, venedikas, austrohungarë, italianë, gjermanë e listë e gjatë kjo e të huejit, që na ka hypë më shpinë – *a thue se për b. të tij na fali Perëndia* – si thotë Patër Gjergji. Veç asnjëni prej pushtuesve nuk asht kapë me Zotin, si komunistat; e shqiptari i bardhë nën çdo lloj pushtuesi, përfshi edhe turkun, ka mujtë me e ruejtë fenë shumë ma lehtë se nën shqiptarin e kuq.

Kur binte fjala mbi argumentin se cila ishte ma e mirë, monarkia apo republika, diskutimet në “parlamentin” e burgut acaroheshin ma keqas se në parlamentet e mëdha të botës, sepse të dënuemët i përmbushëshin plotësisht kushtet për një parlament shumpartijak, tue kenë të të gjitha ngjyrave. E pikërisht ky i burgut duhet të ishte parlamenti i parë i një Shqipnie me të vërtetë demokratike. Disa mbrojshin me thoj e me dhambë monarkinë, për faj të së cilës edhe ishin ndër pranga, ndërsa mbreti pinte salep në botën e lirë. Derdhshin sheqer prej goje për hallmaxhinë e Matit, që e bante politikën prej haremit të vet ku po na thonë e pat vu kunorën e mbretnisë mbi një gjymtyrë krejt të padenjë për me kenë kunorue. Mbas po na thonë se atë

gjymtyrë ia kandte shumë ma tepër se kryet e se monarkinë. E tue ndjekë kësisoj andjesh, kishte mërrijtë me e kthye Shqipninë në kohë të feudalizmit klasik, tue vu edhe të drejtën e natës së parë, për vajzat në prag të martesës. E kur vashat nuk i bindeshin, s'i a pritonte edhe me i grabitë. E prej këndej meritoi titullin “baba i kombit”, jo për tjetër, veçse kahdo të silleshe, të shikojshin sy fëmijësh që të kujtojshin menjëherë sytë e mbretit!

Të tjerët, që kishin pasë fatin e zi me besue se e ardhmja e Shqipnisë po na ishte në dorë të italianit pushtues e ishin lidhë me fashizmin, mundoheshin me na e mbushë mendën se gjithçka e mirë në Shqipni, asht vepër e italianëve. Dhe s'e kishin krejt keq, për besë. Ajo që i shtynte me simpatizue fashizmin ishte se fashizmi kishte premtime Shqipninë etnike, e mbi të gjitha kishte rrëzue Zogun. Lakoheshin atëherë emna e ngjarje. E kujtohej se italianët i patën drejtue të gjitha ministritë, tue u mundue me ua mësue këtë art vetë shqiptarëve, për me i ba mandej zot të vedit. Taman njashtu si po na thonë edhe sot, ban be se italianët s'kanë punë tjetër, veçse me u shkri me gja e me mall për me pështue tonin, tue u flijue deri në atë gradë, sa me ardhë me jetue me ne pa dritë e pa ujë, thjesht për shkak të një flake dashtënie që i kenka ndezë befas në zemër pë ne.

Të pakët ishin ata të burgosun që studjojshin seriozisht e mundoheshin me e mbushë me kulturë mjerimin ku kishin ra. Aq sa i lejojshin kushtet e burgut. Shumica jetojshin pa kurrfarë shprese, mbasi e shihshin kjartë se po kalbeshin në burg, se kishin shkatërrue familje e farefis e se për ta pak e aspak kujtohej kush. Bota flitëte e flitëte për liri e për të drejta, po me ba nuk bante kurrigja, përderisa përditë njeni prej nesh përfundonte me bri' të

thyeme në vorrezën e lemerishme të burgut. Do të thoni se deka asht njësoj kudo e vorri, i ftoftë, si për presidentin, ashtu për të burgosunin. Po mos harroni, zotni, se njeriun nuk ka plasë toka me e xjerrë jashtë: ka le edhe ai prej nane, ka edhe ai motra e vëllazën, grue e fëmijë. Ka edhe sy, që do të dishronte me ia mbyllë një dorë e dashtun në çastin e fundit. Po të burgosunt nuk mund ta kishin as ngushëllimin me i pa të vetët në çastin e mbramë. E familjarët e shkretë nuk mujshin as me qitë vajin, po do të dëneshshin me lot gjaku, që dalin prej syve për me pikue drejt e në shpirt, mos me i pa kush e mos me u kujtue se po kjahej për dekën e një anmiku të pushtetit. Ishim të paracaktuem nga fati me i zëvendësue prangat me pranga, herë ruse, herë kineze e herë amerikane.

Ata që lexojshin romane, i lëshoi krejt zemra kur na sollën në burg romanin “Bankieri”. Kuptuen si lot cicmici në këtë botë të shkretë. Mësuen disa fjalë të reja, të panjoftuna ma parë, si *protestantizëm*, *CIA*, *masoneria*, pa të cilat nuk po mund t’u kuptueka Shtëpia e Bardhë, ku i kishin ngulë sytë plot shpresë, sepse simbol andrrash e zhgjandrrash. Andrra në diell, more zotni. Ndërsa na andrrojshim se si presidenti i Amerikës do të na i zgjidhte prangat, ai kush e di çka andrronte, veç ne jo, sigurisht, as prangat tona, as familjet tona në û⁴⁵ e në zi, as të ardhmen tonë nën qershinë e egër të burgut, ku s’pushojshin as qyqet për me na këndue te kryet një kangë vaji. E të mendosh se ishim aty shi si agjentë të Amerikës, të cilën s’e kishim pa kurrë me sy e e cila s’po kishte farë nevojë për ndihmën e disa leckapanëve, gjysa gjallë, gjysa vorrosë, si na.

⁴⁵ Tkurrje e ûjë: uri.

Megjithatë, ndërmjet të pranguemve, ka pasë edhe njerëz që meritojnë kujtim të përjetshëm. Nuk po ndalem shumë te meshtarët. Shembullin e shumicës së tyre tashma e njeh mbarë bota. Po kujtoj së pari një laik: Bep Malen.⁴⁶ Tue kenë themelues i grupit të parë komunist të Shkodrës, në kohë të pushtimit ishte internue në Itali. Por mbas kapitullimit, u kthye në Shqipëri, ku menjëherë iu kurdis një atentat nga Enveri me Mehmetin, që ishin në bazën e Pezës. Pështoi për mrekulli vetëm në sajë të territ. Qe si ma ka tregue ai vetë historinë e atentatit. “Enveri me Mehmetin më ngarkuen me dorëzue një letër në Hotel Dajti. Prita natën për me dalë nga baza dhe u nisa nëpër rrugicat e Pezës për me shkue në Tiranë. E ndërsa ecshe ndërmjet ferrash e gardhiqesh, mbi mue u zhgreh një batare pushkësh. Për fat, terri i pengoi atentatorët ta kryejshin veprën e tyre kriminale. Pata kohë me u hjedhë në mjedis të ferrave të një gardhi e me ndejë aty për një copë herë, i mshehun si iriq, ndërsa kontrollojshe gjithë trupin për me u sigurue se nuk më kishte kapë ndokund plumbi. Mbas një ore, kur u shue zhurma e hapave, dola prej gardhit e vijova rrugën. Po zbardhte drita. Diçka më shtyu me dyshue te pushkët e e dhe ma fort te letra, e cila i drejtohej një komunisti ortodoks, që punonte në hotel Dajti. Ishte letër autografe e Enverit. Shkruente: “Nëse ne nuk arrijmë ta vrasim gjatë rrugës, jepi fund ti sapo ta lexosh këtë letër”. Ishte një prej kurthave që shpejt e pata kuptue se dy krenat komuniste më urrejshin, sepse në fëtyrën teme shihshin si në pasqyrë injorancën e tyre të thellë. Ata nuk dijsin kurrë për komunizmin,

⁴⁶ Përndryshe Zef Mala (edhe nga Jubani del kështu ma poshtë), autor i veprës postume *Vox Populi*.

ishin krejt të papërgatitun nga pikëpamja teorike, aq ma tepër, filozofike.


Ndër të gjithë komunistat shqiptarë, teoricien i vërtetë i komunizmit ishte vetëm Sejfullah Malëshova. Dhe unë. E ata kishin shumë frikë prej trunit tem, prandej u munduen me më asgjasue. Dhe ia mërrijtën”.

Atentati që iu ba Zef Malës ishte si atentati që pat ba Mehdi Frashëri, i lidhun me Enver Hoxhën, kundër Atë Anton Harapit. Atë Antoni po udhëtonte në rrugën Shkodër-Tiranë. Para tij, e për fat të tij, kalonte një makinë me të njëjtën ngjyrë e të njëjtën formë. Atentatorët hodhën një tra të madh për ta ndalue, por kur panë mbrendë një familje, besuen se Patër Antoni kishte ndërrue mendim e nuk ishte nisë fare. E lanë, ndërsa Patër Antoni mërrinte shëndosh e mirë në Tiranë. Si e mori vesh çka kishte ndodhë me makinën tjetër, ku udhëtojshin miq të tij shkodranë, Patër Antoni nuk mujt mos me i kujtue Mehdi Frashërit se vetëm ai e dinte orën kur do të nisej nga Shkodra.

I zvjerdhun deri në neveri prej politikës e politikanëve shqiptarë, Patër Antoni desht me u tërhjekë plotësisht nga jeta politike. U nis për në Austri, ku kishte studiue, me mendimin që t’i kushtohej vetëm punëve të shpirtit, ndry në qelinë mungare. Po Mehdiu nuk e la rahat as në qetinë e manastirit: i shkoi deri në Austri, dhe ia mbushi menden me u kthye, sepse atdheu kishte nevojë për të e ai s’duhej të mënjanohej e t’i mungonte detyrës që ka çdo atdhetar. I prekun, Patër Antoni u kthye atje ku e priste deka, falsifikimi, mosmirënjohja e harresa. Si të gjithë bijtë ma të mirë të këtyne trojeve. Patër Antoni dhe Bep Mala ishin njerzë krejt të ndryshëm, por kishin të përbashkët

kulturën e gjanë e aftësinë për t'i mahnitë ata që kishin fatin me u ndejë pranë. Bepi mahniti burgjet me kulturën e sidomos me njohuritë e thella filozofike, ashtu si Pjetër Gjini i kënaqte të burgosunt me humorin e tij të pashtershëm e Dom Injac Gjoka, me shembullin e shenjtinisë së tij. Modestia mënjanë, edhe unë epshe shembull me rezistencën e me rebelimin tem, aq sa edhe sot ma thonë ndër sy se si paskam provokue vetë policët e sigurimit, kur vizitojshin dhomat tona në Burrel. Në fakt isha i vetmi që revoltohesha, kur ata mërijsnin ndër stallat primitive ku banojshim, me dorën në turi, për me pështue prej “aromave” që avullojshin prej trupënve tonë të mjerë, të laskaruem, të palamë, të stolisun me gjithfarë varrësh që qelbeshin.

Kështu, pra, i kalojshim ditët e netët, kur nuk ishim në tortura: tue andrrue atë që s'do të realizohej kurrë.



Revolucioni francez e kleri shqiptar

Lexues i dashtun, mos u shkandullo, kur të mësosh prej këtyne rradhëve modeste kujtimesh, se shumë nga shqiptarët u banë spiuj të komunizmit. Madje, nëse besoni, duhet të jesh krenar për klerin tand, që ka mbajtur një qëndrim shumë ma heroik se kleri i Francës gjatë revolucionit francez.

Rreshtova thjesht kujtimet e mia në këto faqe modeste libri, sa për t'i shtue edhe një dëshmi historisë së martirizimit të klerit e të besimtarëve katolikë në Shqipni, pa hy në analiza kontekstuale tue kujtue rrëshitas vetëm faktorët vendimtarët të jashtëm, të cilët e çuen Shqipninë në humnerë. Po s'mund të mos ndalem te zanafilla e kësaj së keqe, te Revolucioni Borgjez Francez, ku nisin rrajtët e krimit kundër Zotit e njeriut që i beson. Lexuesi do ta shohë vetë se qëndrimi i komunistave të të gjitha ngjyrave ndaj fesë, s'ishte tjetër veçse një fotokopje e keqe e qëndrimit të anmiqve të Zotit në Francën revolucionare, fotokopje të cilën tonët nuk e morën drejtpërdrejt prej France, por prej miqve të tyre jugosllavë, të cilët e fotokopjue prej vëllazënve të mëdhaj rusë. Rusët e patën marrë drejtpërdrejt nga burimi dhe e përdorën mbasi i banë ndreqjet e duhuna, simbas shijes aziatiko-komunisto-bizantine.

Uji, tue dalë prej burimit të turbullt francez e tue kalue nëpër hurdhata e Ballkanit, në trojet e të cilit ishte mbjellë kahmot fara e fanatizmit ma të tërbuem islamik, erdh e t'u ba një baltë tejet e ndytë, që shpejt do të mbruhej

me gjak kristian. Kjo asht e vërteta e pastër historike: të tjerat janë thjesht demagogji.

Mundemi me thanë se Revolucioni Francez filloi me një Meshë. A s'i ftuen edhe komunistat besimtarët shkodranë, strukë të tmerruem ndër shtëpija të veta, në një meshë solemne në katedrale, natën ogurzezë të Krishtlindjes 1944, sapo i kishin marrë frenat në dorë?

Me 5 Maj 1789, pra, para se të fillonte takimi i Asamblesë së përfaqësuesve të fisnikëve, klerit e borgjezisë, që njihej si shtresë e tretë, u kremtue një Meshë solemne. Menjëherë mbas, me 9 Gusht, kjo asamble u shndërrue në Asamblenë Kushtetuese, pikërisht me nismën e borgjezisë dhe me pjesëmarrjen e shtresave fisnike e kishtare. Filloi kështu lëvizja që do ta ndërronte rrësisht strukturën e shtetit, tue krijuë në Europë kushtet paraprake të demokracisë moderne.

Në Francën e monarkisë absolute, në regjimin e vjetër, katolicizmi ishte fe zyrtare e shtetit. Gjithsesi, diçka kishte fillue me ndryshue që në gjysën e shtatëqindës. Përhapja e ideve iluministe, që njiheshin me emnin “dritëzat”, kishte dishmue se krishtenimi nuk përmbante ma të vetmen pikë ideale referimi, përmes së cilës mund të shpjegoheshin proceset historike e fenomenet natyrore.

Edhe në Shqipni, nësa hyjshin idetë komuniste, sundonte monarkia, po sa ndryshonte Luigji XVI, nga Salep Sulltani ynë, i cili kje aq i meçëm sa me ua mbathë kambëve para se komunistat ta kishin ngritë gijotinën; e sa ndryshonte edhe situata shoqnore e fetare e vendit, me një kambë në Stambollë e një në Moskë – gjithnjë me vështrimin nga Lindja, tue u mundue me e shlye prej historisë ndikimin e “Romës së tretë e të vërtetë”.

Fara e ideve ateiste, ardhë prej kojshive sllavë, në Shqipni ra në një truell pjellor, punue me kujdes prej ekstremistëve islamikë, të cilët nuk ngurruen fare me vu maskën e sankylotëve, vetëm e vetëm që ta shrrajosshin një herë e përgjithmonë kristianizmin prej kësaj treve. Kështu Hoxhë-Sulltani i vogël, homoseksual i madh e prej këndej partizan i lirisë pa cak – jo të atdheut, por të veseve ma të ndyta, ish student pikërisht në Francën e revolucionit, mik e mysafir i përherëshëm i sllavëve të Veriut e të Jugut, pruni në atdhe, mbas shtegtimeve të tija aventuroze, një thes me farë veshesh e ateizmi. Mori menjëherë parmendën në dorë, e kaloi pa mëshirë mbi arën e mbjellun me farë virtyti e kulture dhe si spastroi gjithçka, hodhi farët e veta e e çoi në kambë tanë popullin me u shërbye ditë e natë: deri sa mërrijti stina e të korrave, që po i gëzojmë të gjithë sot e kemi me i gëzue për shumë kohë. Mbolli erë e korri furtunë!

Teologët ma të mprehtë frengë të fesë katolike, të cilët e kuptuen ndryshimin që po ndodhte, u përpoqën me e skjarue rolin shoqnor të fesë së krishtenë dhe dishmuen se Kisha nuk ishte aspak në kundërshtim, madje pajtohej fuqimisht me masat e shtypuna të popullit, me të cilat lidhej në mënyrë të pazgjidhshme misioni i saj.

A nuk u përpoqën me e ba këtë edhe meshtarët katolikë shqiptarë në prag të epidemisë së kolerës komuniste? Mjafton me kujtue predket e frymëzueme prej elterëve të gjitha Kishave, fjalimin e Patër Anton Harapit, kur pranoi të bante pjesë në regjencë, konferencat që mbajtën Patër Antoni e Patër Gjon Shllaku, pa llogaritë kontributin e madh që sollën revistat e Kishës katolike. Lexojini: janë si të shkrueme për sot! Vlejnë edhe për sot!

Gjithsesi përpjekjet e teologëve frengë ishin ende në fazën e projekteve e diskutimeve, pa ndonjë ndikim të dukshëm mbi realitetin politik, kur ia behi revolucionit. Anëtarët e asamblesë Kushtetuese, ndonëse nuk kishin fillue ende me mbajtë qëndrim të skajshëm antiklerikal, nisën të mendojshin se duhej rishikjue rrësisht roli që krishterimi kishte luejtë në regjimin e vjetër. Ishte fjala t'i siguroheshin të njëjtat të drejta politike e civile të gjithë francezëve, pavarësisht nga bindjet e tyre ideologjike ose fetare. Njëkohësisht t'i përshtateshin institucionet realitetit të ri, në të cilin katolicizmi do të ishte një nga pjesët përbase.

Kështu në Deklaratën e të Drejtave të Njeriut e të Qytetarit, u rradhiti edhe parimi i lirisë fetare, që nuk mungonte në fillim as në Kushtetutën e komunistave shqiptarë. Asamblistët, megjithatë, nuk deshën ta çojnë këtë parim deri në pasojat e skajshme: bukur e dijsin se pa ndihmën e klerit të urtë e të disa ipeshkvive "të ndriçuem", plani i tyre nuk do të kishte sukses.

E njihshin mirëfilli edhe ndikimin e kishës ndër masat popullore, e këto masa ishin të vetmet forca, të cilave mund t'u bante thirrje Asambleja Kushtetuese për ta ligjërue ekzistencën e vet. Fisnikët dhe kleri i naltë e konsiderojshin këtë asamble ilegale.

Me këtë sy e shikoj edhe kleri ynë vendosjen e komunizmit: e nuk mund të ishte as s'mund të jetë ndryshe, sepse ishin vu ballë për ballë Krishti me antikrishtin.

Por të kthehemi në Francë, ku pikërisht hymja e "Kushtetutës civile të klerit" (12 Korrik 1790), bani që të determinonte nevoja për ndamjen e Kishës nga shteti. Kushtetuta përjashtonte çdo ndërhyrje konkrete të papës në emnin e ipeshkvijve, çashtje që deri asokohe rregullohej

simbas Konkordatit të 1516-tës, i cili i njihte papës “institucionin kanonik”, don me thanë, miratimin e kandidatit për ipeshkëv, të shenjuem nga mbreti.

Një pjesë e klerit bani betimin për besniki, që i ishte kërkuar. Pjesa tjetër refuzoi e u quejt refraktare.

Kështu ndodhi që gjysa e meshtarëve dhe e ipeshkvijve francezë, me në krye Argjipeshkvin e Parisit, u rradhiten me revolucionarët, u banë, me një fjalë, as ma pak e as ma shumë se spiuj birucash e kaluen edhe ma përtej: u martuen e rrokën armët kundër gjysës tjetër të klerit, që i ndei besnik Krishtit e Kishës së tij. U rradhiten kështu 21 mijë përballë 21 mijëve: njena palë armatosë me pushkë e thika, pala tjetër me kryq e uratë. Por spiujtë, edhe pse kishin qeverinë me vedi, nuk do të fitojshin. Do të shuheshin të gjithë së bashku, me qeverinë revolucionare franceze, sepse e keqja asht gjithmonë e destinueme me e shue e me mbarue. E, për ironi të fatit, do t’u rrokulliseshin krenat pikërisht nën tehin e gijotinës, shpikë shi prej tyne për krenat e kundërshtarëve. Ishte një rrokullisje e hatashme. Bijshin përditë e ngatërroheshin së bashku në një kazan, krena kundërshtarësh, që edhe ashtu të përgjakuna, kafshojshin njeni-tjetrin. Hiç ndryshe, veç si në diktaturën shqiptare, që i hangri një nga një edhe bijtë e vet.

Sidoqoftë, si pasojë lindën çrregullime ndërmjet Kishës kushtetuese, që u njoh ligjisht prej shtetit e që subvencionohej prej tij e asaj refraktare e cila, tue iu kundërvu institucioneve të reja, nuk njihej fare nga autoritetet civile.

Situata e Kishës sonë kje edhe ma e keqe: meshtarët, që u vunë në shërbim të regjimit, të shuguruem kaherë, ose mbas shugurimit të tyne të parë në degën e punëve të

brendshme, jo vetëm që nuk banë ndonjë betim publik, por përkundrazi, u munduen me i mshehë sa ma mirë që mujtën gjurmët. Kështu partia komuniste shqiptare zhvillonte në mënyrë krijuese mësimet e islamizmit fanatik, të revolucionit freng, jugosllav e rus, tue e dijtë mirëfilli se e keqja e mshehun asht e keqja ma madhe.

Në Francë, forcat borgjeze, tue fillue revolucionin, nisën edhe politikën e laicizimit, ndonëse gjithnjë me hapa tepër të matun. Por, më 1793 hyni në skenën e revolucionit një forcë e re shoqënore: sankyloët, domethanë njerëzit pa brakesha, proletariati qytetar e fshatar. Në fillim ata kufizoheshin në kërkimin e të drejtave politiko-shoqënore, formulue si të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët dhe të rindamjes të të mirave materiale. Në vjeshtën e 1793-shit, revolucionarët filluen politikën e çkrishtenizimit të vendit, të udhëhequn nga krahu skajor i së majtës jakobine, që përpiquej ta mbante gjallë presionin popullor mbi Konventën, tue forcue kështu ndikimin e vet. Por jakobinët tuteshin se do të hupshin privilegjet e tyne, nëse proletarët do të vijoishin me kërkue vetëm reforma politioke-shoqënore. Atëherë i ngucën sankyloët t'i tureshin krishtenimit, tue vra kështu dy zogj me një gur, taman si nxanësit e tyne të vogjël në Shqipni, gati treqind vjet ma vonë.

Duhet theksue, por, se era antikristiane nuk ishte e përgjithshme e as e plotë. Franca e Karlit të Madh nuk rrëshiti kurrë në fundin e humnerës ateiste, sa me e shpallë vedin me një krenari të marrë, i pari shtet i pa zot në botë. Me dorca, zotni, me dorca, se ishin revolucionarë francezë, që kishin të bajshin me popullin francez e jo me shqiptarët, mësue me ndërrue fe e kanu sa herë t'ua kërkojë barku. Shkruen Shën Jeronimi, iliras prej Stridonie, krenaria e

krishtenimit shqiptar, qysh në shekullin e tretë mbas Krishtit: “Në atdheun tem njihet një Zot i vetëm; barku; jeta ka vlerën e një dite, kush asht ma i pasuni, ai asht ma shenjt!” Ta pyesë pak vedin shqiptari i ndershëm, në pastë mbetë ende ndonjë: “Kush asht ma i famshi sot në Shqipni? E çka ka ba për me kenë në gojën e të gjithëve? Ç’dobi i ka pru këtij vendi të mirë, të mjerë e të marrë, që vijon me brohoritë për xhelatët e vet? E për tregtarët fjalambël e punidhtë të flamujve?

Në Francën revolucionare shumë dokumenta dishmojnë njëfarë respekti për Jezu Krishtin, i cili natyrisht paraqitej si sankylot i mirë, si revolucionari ma i vendosun në Jude. Siç ka ndodhë sa e sa herë në histori, figura e Krishtit u përdor për të përligjë masat antiklerikale.

Dukej kështu se Kisha, si kishte hupë ndikimin politiko-kulturor, do të hupte plotësisht edhe ndikimin e vet mbi masat. Por situata në realitet ishte shumë ma e ndërlikueme e e turbullt. Si kaloi faza e parë, ma e tensionuemeja, e ndeshjes në shumë zona u kërkue të rifillonte kulti katolik, ose nisën të kremtoheshin rishtas, në mënyrë spontane, funksionet fetare. Kështu çkristianizmi nuk kje i plotë.

A nuk u kërkue edhe te na e njëjta gjë prej meshtarëve guximtarë ndër gjyqet komuniste e a nuk vijoi ndër katakombe feja në të gjitha shfaqjet e saj, tue e shpëtue Shqipninë prej çkristianizimit? Përndryshej, a do të kishin rra në Meshën e parë ma se 50 mijë vetë, pa i grishë e pa i lajmue kurrkush, tue dalë drejtpërdrejt prej katakombeve?

Në Francë borgjezia revolucionare e kishte kuptue ma së miri randësinë e një feje të “udhëhequn” prej asaj

vetë, si mjet për të kontrollue shoqinë. Aq sa Robespieri çpiku një fe të shtetit, kultin e Qenjes.

Edhe komunistat shqiptarët, tue xanë prej francezëve, u munduen me e vu fenë nën udhëheqjen e vet. A nuk flet për këtë Statuti i Kishës Katolike të Shqipërisë, që u miratue në mbështetje të nenit 7, të Dekret-ligjit nr. 743, datë 26.11.1949, mbi komunitetet fetare (Shih Dom Ndoc Nogaj, *Kisha Katolike shqiptare 1944 nëntor 1990 "Humbje e fitore"* Shkodër, Nëntor 1999, fq 101-109). Neni i parë, thellësisht kontradiktor, ma i randësishmi i gjithë statutit, duhet lexue ndërmjet rreshtave, sepse mshehë pikërisht marrëveshjen e mbrapaskenës ndërmjet Imzot Shllakut e Mehmet Shehut. Shkruhet: "Ajo (Kisha Katolike e Shqipërisë) frymëzohet nga parimet fetare të Kishës Katolike botërore, që është themeluar nga Jezu Krishti, nën kryesinë fetare të Papës, pasardhës i apostullit Pjetër".

Pra "frymëzohet nga Papa", ndërsa asht e shkëputun krejtësisht prej Tij! Nuk po zgjatem në këtë argument, trajtue me hollësi e objektivitet prej Atë Zef Pllumit në librin e tij "Rrno vetëm për të tregue" dhe nga Dom Ndoc Nogaj në librin e sipërcituem.

Neni i tetë kërkon: "Krahas me zhvillimin e ndjenjave fetare, funksionarët e kishës katolike të Shqipërisë do të zhvillojnë në besimtarët edhe ndjenjat e besnikërisë ndaj Pushtetit të popullit, Republikës Popullore të Shqipërisë, ndjenjën e atdhedashurisë, të paqes, të mirëqenies".

Kujtojmë se mbas skjarimeve të Imzot Shllakut, Statuti u miratue njëzani nga kleri katolik i Shqipnisë.

Statusi Shqiptar ishte një fotokopje, e rikrijueme e në përshtatje me kushtet e kohës e të vendit, e Kushtetutës civile të klerit, miratue prej Revolucionit Francez. Kjo

kushtetutë e ndante klerin vendas në dy grupe numerikisht thuejse të njëjta: konstitucionalët, që banë betimin për besniki dhe refraktarët, që nuk e pranuen. Ipeshkvia, që vinte kryesisht nga klasa fisnike, u rradhiti plotësisht me refraktarët: vetëm 7 prej 135 ipeshkvijve të Francës banë betimin për besniki ndaj revolucionit e kushtetutës së tij.

Në Shqipëri nuk u vërtetue një fenomen i tillë. Jo për gjë, por thjesht sepse shteti gjakatar komunist i kishte marrë të gjitha masat për të mos lejuar krijimin e grupeve të tilla, tue e zhdukë fizikisht hjerarkinë e Kishës katolike. Lista e meshtarëve që miratuen Statusin famëkeq, ka në krye emnin e prelatit të vetëm që kishte pështue gjallë, Imzot Benardin Shllakut, Ipeshkëv i Pultit: Statuti vijon me shkaktue diskutime sepse i analizuem edhe sot e kësaj dite, e deri në Simpoziumet e organizueme prej vetë kishës, nga peshkaqejt e kokodrilat e zakonshëm të historisë sonë të mjerë. Duket se Shqipëria asht shurdhure, se nuk ka veshë me e ndëgjue dishminë e gjallë të njerëzve që kanë teprue, tue shpresue se me deken e tyne, jo të largët, do të mund të zhdukë çdo gjurmë të së vërtetës, tue pështue kështu ato mija faqe rrenash që janë shkruar tash një gjysë shekulli në të gjitha fushat; libra këta, që populli shqiptar duhet t'i djejë publikisht, nëse dishron ma në fund me pasë edhe ai historinë e tij të vërtetë, si gjithë Kombet e kulturueme të Kontinentit, të cilit dashtë e pa dashtë, i përket.

As në kohën e Revolucionit Freng nuk ishte lehtë mos me e pranue bashkëpunimin: mos me u betue donte me thanë me u përjashtue prej të gjitha funksioneve kishtarë, të cilat rrezikoheshin me pësue ndryshime të papranueshme për Kishën Katolike. Kështu, në pranverën e 1791-shit francezët u thirrën te kutitë e votimit, për me

zgjedhë ipeshkvijtë e rij, të gjithë nga rradhët e klerit konstitucional (ke do të kishte zgjedhë populli shqiptar, se nëse zgjedhja do të ishte ba në këtë mënyrë në sa mëkambej hjerarkija kishtare në Shqipni?) Në këto kushte, ipeshkvijtë e persekutuem emigrojshim në masë, mbasi delegojshin në drejtimin e Kishës vikarët e tyne refraktarë, që kishin guximin me vazhdue misionin në Francë. Mund të ikshin lirisht kudo në botë. Askush nuk i kapte në kufi për t'i pushkatue, si ndodhi me tonët. Madje qevria revolucionare ishte e kënaqun që po spastroheshin vetë, gja që qeveria jonë e kuptoi tepër vonë. Atëherë tha me vedi: sa t'i jap vedit zahmet me i burgosë e me i pushkatue, ma mirë po ia hapi dyert e të nisen e të shkojnë vetë. Ndërmjet tyne, mandej di vetë ke çoj për me u pri. E kështu ndodhi një ditë të bukur fillimi i emigrimit në masë, që e çoi pjesën ma të madhe e ma të aftë të kundërshtarëve të regjimit në dhena të hueja, prej kah ndjekin me zemër të plasun farsën e demokracisë, pa pasë forcë e as dishirë me iu kundërvu, sepse edhe të pafuqishëm për ta ba këtë. Natyrisht ndërmjet tyne ka edhe ndonjë klerik, që shikjon se vendi i vet nuk asht ma i veti, e tue kenë Kisha universale e ai vetë afër atdheut qiellor, për shkak se kanë kalue shumë vjet qysh kur asht largue prej tokësorit, parapëlqen ma mirë me ndejë larg e ma larg ferrit prej të cilit asht përzhitë njëherë.

Po të kthehem në Francë: këto ngjarje shkaktuen çrregullime aq të mëdha, sa Asambleja Kushtetuese e asokohshme u detyrue me ba një hap mbrapa, tue e shndërrue Kushtetutën civile të Klerit nga norma kushtetuese, në ligjë të së drejtës së zakonshme. Kështu shumë klerikë e kishin ma të lehtë me ba betimin, sepse një akt i tillë kishte vetëm kuptim politik e nuk e prekte

ligjshmëninë kishtare. Gjithsesi tashma secili e kishte xanë pozicionn e vet, aq sa për të fillue ndeshje të ashpra ndërmjet dy grupeve të klerit, që do të zgjatshin deri në epokën napoleonike.

Ndeshje të tilla ndërmjet klerikëve katolikë të Shqipnisë nuk pati kurrë, sepse shumica dërmuese i ndei besnike Ungjillit, tue mos pranue kurrë me e da dyshë Korpin e Krishtit.

Ndërkaq në Francë çrregullimet fetare politizohe-shin gjithnjë e ma shumë: opozita e Kushtetutës, tue marrë zemër nga dënimi formal i Piut VI, bashkohej me të gjitha forcat tjera opozitare, që i kundërveheshin revolucionit. Me 29 Nanduer 1791 (datë ogurzezë) me kërkesën e së majtës jakobine dhe të deputetëve të klerit kushtetues, Asambleja e Re legjislative miratoi masa të randa kundër klerit refraktar; kishat e tyne duhet të mbylleshin dhe ata vetë, nëse dyshoheshin për kryengritje kundër ligjit, duheshin mbledhë së bashku tue i mbajtë nën mbikqyrje të rreptë.

Edhe në këtë paralele, te na u veprue ndryshe: ma parë u burgosën e u pushkatuen klerikët, mandej u mbyllën Kishat. E s'pati kush t'u delte përballë e t'u vente veton, si pati ba Mbreti Luigji XVI, që u përpoq, i gjori, për ndalimin e masave ndëshkimore të bazueme vetëm mbi dyshime. Gjithsesi as asokohe autoritetet lokale nuk e përfillën fare kundërvuemjen e mbretit, të cilit iu pre kryet me 7 Maj 1794.

Situata u randue ma tej kur me 20 Prill 1792, Franca hyni në luftë me Austrinë e Prusinë, e kështu filloi përndjekja e atyre që akuzoheshin për lidhje me anmikun e jashtëm (shih paralelizmin e kuartë me persekutimin e klerit shqiptar që në shumicën e rasteve akuzohej si spiju i

Vatikanit dhe shteteve të tjera, të njohuna për traditën e tyre katolike), Një qëndrim i tillë, që mbahej kundër të gjithë qytetarëve, kje jashtëzakonisht i ashpër kundër klerit refraktar, që i bindej Papës, i cili mbështeste Austrinë e Prusinë. Klerikët refraktarë morën urdhën të largoheshin sa ma shpejt nga Franca. Nëse nuk bindeshin, do të internoheshin në Guajanë. Jo të gjithë iu bindën urdhnit. Shumica nuk u larguen nga grigja, ashtu si nuk u larguen shumica e meshtarëve shqiptarë. Mjafton me kujtue Patër Anton Harapin e martirizuem, që nuk pranoi të tërhiqej me trupat gjermane, i bindun se vendi i tij ishte në Shqipni, ku nuk vonoj të bahej kortarë-kortarë. Shtrohet këtu edhe një herë, problemi: a ishte ma mirë me u largue nga Shqipnia e me vijue misionin në botën e lirë, apo me shkue në plumb? Ndoshta edhe ashtu edhe kështu! Shqipnia kishte nevojë sa për një za të lirë jashtë, aq edhe për lutjet e atyne që flijuen jetën, a të atyne që u banë ejtë⁴⁷ e birucave.

Në Francë persekutimi mërrijti kulmin me kasaphanën e shtatorit, kur u rrëzue monarkia e dështoi regjimi kushtetues. Atëherë Asambleja Legjislative dha urdhën që të gjithë njerëzit e Kishës, pa asnjë përjashtim, të betoheshin rishtas për besniki, kësaj rradhë pastërtisht politike, për me mbrojtë lirinë e barazinë. Kleri, i cili kishte refuzue betimin e 1791-shit, u nda në dy grupe të tjera, që mbajshin qëndrime të ndryshme ndaj ligjshmënisë së këtij akti, tue pasë parasysh se Papa kishte dënue jo vetëm Kushtetutën civile të klerit, por edhe Deklaratën e të Drejtave të Njeriut.

⁴⁷ Shkod. (shumësi i tkurrun) për *engjëjt*.

Situata vijoi me u tensionue. Me 23 Prill 1793, Konventa urdhnoi të internoheshin të gjithë klerikët që nuk e kishin ba ende betimin për mbrojtjen e lirisë e të barazisë. Në vjeshtën e të njëjtit vit shpërtheu terrori, që kishte si qëllim kryesor çkristianizimin rrajësor të vendit. Natyrisht që terrori goditi shumë ma tepër klerin refraktar sesa atë konstitucional, i cili në masë të madhe nuk u prek fare, tue dishmue kështu kjartë falimentimin e parimeve të lirisë e të barazisë, që me aq pompë i trumbetonte Revolucionin Francez, siç do të ndodhte ma vonë me të gjitha regjimet, që do ta imitojshin. Në të vërtetë kleri refraktar iu kundërvu me të gjitha forcat Konventës, në të cilën sundonte tashma ekstremizmi jakobin.

Filloi për herë të parë në historinë e njerëzimit një sulm, që do të përsëritej ma vonë në shumë vende të botës. Kishat u mbyllën ose u dogjën, kumbonaret u rroposën, heshtën kumbonët, pajisjet liturgjike u vodhën, u përdorën ndër manifestime antifetare, u dogjën. Ishin të gjitha vepra arti të klasit të parë, dishmi të gjenisë së njeriut, frymëzue prej Krijuesit suprem të bukurisë. U ndryshue deri kalendari, tue shlye edhe të dielën. Java do të kishte dhetë ditë me solemnitete civile në ditën e dhetë. U ndryshuen edhe emnat e muejve. Meshtarët, që shpëtuen nga masakra, u detyruen të bajshin publikisht abjurën, don me thanë të hiqshin dorë nga feja.

Kleri shqiptar nuk veproi as si kleri francez, as si ai anglez. Madje edhe ata që u ligështuen e nënshkruen, kur u munduen me i shtrëngue të delshin publikisht, bashkë me klerin mysliman e atë ortodoks, me ba abjurën para popullit, pranuen ma mirë me deké, se me mohue. Duket kjartë se e kishin ba mish e gjak, ma mirë se kleri francez, edukatën e

fuqishme që i ep njeriut katolicizmi, edukatë e cila e mëson kryesisht mos me ndërrue flamuj. E jo ma pak u ndihmoi betimi i çelibatit, zbatue me besniki, që e çliron meshtarin nga detyrimet familjare. Ata s'kishin çka me hupë. Fëmijët e tyne nuk do të rrëshaheshin ndër kampe përqendrimi, gratë e tyne nuk do të shnderoheshin, sepse nuk i kishin. Ata e dijsin se po të shkojshin në plumb, tue i ra gjoksit me grushta për me i kërkue të falun Zotit për mëkatën e randë të spijunimit, do të çliroheshin një herë e përgjithmonë nga ferri i ndërgjegjes e nga çdo lloj prange, sepse ai që ka Zotin në zemër, asht i lirë në çdo situatë, gjallë a deké. Sa herë mendojshe me dhimbë për bashkëvëllazënt e mi të ligështuem, ndonëse tepër të paktë, më vinte në mend Shën Pali, shndërrimi i tij, e besojshë se Zoti do të kishte mëshirë për ta e do t'i kthente në rrugën e vet, tue i mësue me u bashkue me Krygjën e tij, me durue vuetje e tortura, në emën të idealit ma të madh në botë, që asht ideali ungjillor.

Në Francë, në fazën ma të tërbueme të Revolucionit, u mbytën shumë meshtarë e murgesha. E gjithnjë ma shpesh persekutimi udhëhiqej prej njerëzve fanatikë ose të korruptuem, të cilët nisën t'i godasin deri priftënt deputetë, siç ishte rasa e abatit Lamourette, republikan e veprimtar i pajtimit, të cilit iu pre kryet në gijotinë më 1794, ose si abati Fenelon, që u ngjit në gijotinë sapo i kishte mbushë 90 vjetët. Në Nantë, ndërmjet 16 mijë “kundërrevolucionarëve” që kenë mbytë në lumin Luarë, ishin 145 klerikë. Në Rochefort, ku ishte kampi i përqendrimit për priftën, diqën 542 prej tyne.

Nuk kemi ende një statistikë të saktë që vërteton numerikisht shfarosjen e klerit, shekullar e rregulltar, si dhe

të laikëve katolikë në Shqipëri, por mund të thomi me siguri se tragjedia e Francës revolucionare u vu në skenë në trojet tona me një tërbim që i shkante për shtat një vendi, ku shartoheshin urrejtja komuniste me atë islamike kundër krishtenimit. Pipi që doli prej këtij shartimi të kobshëm asht njeriu ynë i ri!

Shfarosja e klerikëve francezë përligjej me mbrojtjen e atdheut. Gjithnjë ma shpesh flitej haptas për domosdoshmërinë e zhdukjes së fesë. Revolucionarët mbajshin fjalime, gjatë të cilave suleshin si të dejun kundër njerëzve të Kishës, tue përsëritë me një lehtësi të çuditshme, pa kurrnjë fakt, akuzat për trathiti dhe thirrjet për dënim me deké. Puna mërrijti deri aty, sa të dehej edhe populli të cilin, turmë e verbër siç asht, s'kishte ma gja që e ndalonte. Atëherë filluen të ngjiten në karamanjollë⁴⁸ edhe vetë oratorët e terrorit. Ata që e kishin shpikë gijotinën, nisën edhe ta shijonin, tue lanë krenat në të Dishmitë e kohës flasin për një klasë politike, që si kishte ndezë popullin me idenë e gijotinës, nuk mund të kthehej ma mbrapa nga frika e të njëjtit popull, prandej u katandis në gijotinare. Nga dishmitë e kohës mësojmë se terrori mërrijti deri në atë shkallë, sa çdo akt mëshire nisi të quhej “trathiti ndaj popullit”. E natyrisht, trathtarin e pritëte gijotina. Por, ndërmjet atyne që u ngjitën në gijotinë, shumë meshtarë e murgesha dhanë shembuj të shkëlqyeshëm heroizmi: vunë kryet në the me buzë në gaz, me Parrizin që i pritëte ndër sy, tue i falë xhelatët, mund tue u lutë për ta, me bindjen se së shpejti do të shihshin Zotin.

⁴⁸ Prese krenash, kund si gijotina.

Po kujtojmë këtu vetëm një shembull: “Sapo kishte kalue pesëvjetori i marrjes së Bastijës, kur me 17 Korrik 1794 gjashtëmbëdhjetë murgesha, tue këmdue “Salve Regina” dhe “Veni Creator”, ngjitën shkallët e palkut të tmerrshëm në Sheshin e Revolucionit, në Paris, për t’u ekzekutue. Akuzoheshin si spijunë të anmiqve të Francës dhe konspiratorë kundër institucioneve republikane. Ishin të gjitha rregulltare të një kuvendi në Compeigne, shtatëdhjetë kilometra larg nga kryeqyteti. Dhetë ditë mbas tyne, me 28 Korrik edhe Robespieri, si nuk mujt me i dhanë fund jetës me një plumb në tamth, kje ngrehë rrëshanë mbi të njëjtin palk, ku nuk ishte terë ende gjaku i karmelitaneve”.

Kjo ngjarje i dha shkas lindjes së një vepre të mirënjoftun me titull: “Dialogët e karmelitanëve” (1949), shkruie prej Georges Bernanos, autor i librit të famshëm “Vorrezat nën dritën e hanës”, për të mos përmendë të tjerë. Vepre, bazue në kronikat e kohës, rrëfye nga një rregulltare karmelitane e pranishme në ngjarje, shërbeu ma vonë për realizimin e një filmi me titull “E fundmja para gijotinës” me autor Raymond Bruckberger dhe Philippe Agostini.

Ngjarja tregon se heroizmi nuk asht aspak i thjeshtë. Njeriu mbushet me frikë e ankth, kur e ndien se po e prekë tehu i kosës mortore. Po kur asht fjala me u martirizue për Zotin, ai nuk ta mohon kurrë forcën për me e përballue atë, që autori e quen “Agonia shenjte”.

Dialogët rikrijojnë dramatikisht e plot delikatesë gjendjen shpirtnore të gjashtëmbëdhjetë krijesave të brishta, që bahen gati me dekë për Atë, të cilit ia kishin kushtue jetën, Ndonjena prej tyne e ndien vedin gati-gati të lumtun, kur mendon se Zoti e ka caktue me ba për Të dishminë e

gjakut. Po ky asht heroizëm i kotë e tundim lavdie. Një karmelitane që e dishron martirizimin e parakohshëm, asht karmelitane e keqe, ashtu si asht ushtar i keq ai që dishron me dekë pa fillue ende beteja e pa i çue në vend urdhnat e komandantit... Nëse studjojmë jetën e shenjtëve të mëdhaj, kemi me pa se ndërmjet tyre ka asish e asosh që gëzohen nga ideja e dekës, të tjerë e përbuzin; por ka edhe të tjerë, që mundohen me i ba bisht. Me dishrue dekën, kur je gjithë shëndet, don me thanë me e mbushë shpirtin me erë, si një i marrë që beson se mund të ushqehet me aromën e mishit të pjekun.

Njena nga murgeshat, ma e reja, rishtarja Bianca de la Force, vuen tmerrësisht para idesë së gijotinës. Ka frikë prej deke, por edhe turp për me iu vjedhë fatit të motrave. Asht tepër e re, njomcake, për me vu kryet nën tel të spatës. Në shpirtin e saj zhvillohet një luftë e tmerrshme, që e shtyn me u largue prej kuvendit. Si kthehet në shtëpi, frikës ia xen vendin disprimi. E prej kësaj ndienje, për të buron një jetë e re. Nuk mund të rrijë ma larg palkut të gijotinës. Ditën kur motrat e saja ngjiten aty tue këndue, papritmas, nga një skaj i sheshit, ndihet fuqishëm zani i saj, që bashkohet me kangën e karmelitaneve, të cilat ngjiten në palk. E, tue e naltue gjithnjë ma shumë zanin e saj fëminor, ecë drejt vendit të ekzekutimit nëpër turmën, që ndahet dyshë për me i ba shteg. Nuk ka ma kurrnjë shej frike në fëtyrën e saj të paqtë. Asht libruë prej anktheve. Vijon me këndue, deri sa kryet i rrokulliset, si krenat e simotrave. Ajo e ka krye revolucionin e saj (Marrë nga “Storia della Chiessa”, botim i “Duemila anni di cristianesimo”; volume terzo, “Famiglia Cristiana”).

Po i vemë ballë për ballë historisë së karmeliteve franceze, një episod të vetëm prej fillimeve të martirizimit të klerit shqiptar, fundin e martirit të parë: poetit të ambëlisë e të atdhedashunisë: Dom Ndre Zadejës: gjykojeni vetë cili asht ma i tmerrshëm.

Ishte famullitar në Sheldi me 4 Fruer 1945, kur e arrestuen. Kje ba tepër i njoftun për predket e tija të flakta, përmes të cilave paralajmëronte popullin për rrezikun e komunizmit të pa Zot. Të paharrueshme kishin mbetë në kujtesë të besimtarëve tri predke, mbajtë për Shëna Rrok në vjetën 1944, në Shirokë e në Shkodër.

Me 3 Fruer në Sheldi pushkatohej pa gjyq fshatari Tomë Marku, i akuzuem për mbajtje armësh pa leje. Famullitari, i pranishëm, i afrohej me guxim të pashoq për me i ba shërbimet e mbrame. Mjaftoi një gjest i tillë, për me i vu prangat. Një javë ma parë ishte prangue një tjetër meshtar: Dom Lazër Shantoja, bashkë me fshatarin Kolë Sheldija, që e strehonte.

E nisën kambë, nëpër natë, për në burgun e Shkodrës. E flakën në një qeli, ku gjet shumë prej bashkëvëllazënve, ndërmjet të cilëve Dom Mikel Koiliqin e Patër Dionis Makën.

Me 25 Mars 1945, e Dielja e Larit, Dom Ndreu me 13 të tjerë delte prej qelie për t'u nisë drejt dekës. Nuk e morën mundimin fare as me organizue një gjyq farsë, siç banë me shumë të tjerë. Me të ishte dhe Prekë Cali, shtat-selvi, Heroi që i pat pështue Shqipnisë Vermoshin, antizogisti i flakët. Kryet i delte mbi tanë krenat, që mbas pak do të përshkoheshin prej plumbit të vëllaut trathtar.

E nësa grupi i të dënuemve delte në oborrin e burgut, meshtarët e mbetun në qeli, pështetë për hekura,

çojshin tue u dridhë dorën e shugurueme, për me u dhanë bekimin e mbramë të dënuemve për dekë, ndërsa lot të nxehtë pikojshin mbi hekurat e kryqëzuem. E, sa e panë shenjën e shëlbimit në dritëhijen e dritores, të trembëdhetët, si një trup i vetëm, ranë në dy gjuj të mëdhaj në kalldramin e ashpër të oborrit të burgut. Po merrshin simbolikisht viatikun, ushqimin për shtegtimin e mbramë për ku ishin nisë. Jeta e tyne nuk do të mbaronte te Zalli i Kirit, siç besojshtin xhelatët komunistë, disa prej krenave të të cilëve, më fal o Zot, jo shumë ma vonë do të rrokulliseshin ma keq se kryet e Robespierit.

Ishte agu i një dite të zymtë, të lagësht dimnore. Si zakonisht, ekzekutimi do të kryhej në gjysëterrirën e natjes, tue i lanë, mandej, kohë gjithë ditën njerëzve të tmerruem me soditë tragjedinë e luejtun nëpër terr. Grupi mërriji te Zalli i Kirit, afër pendës, ku naltoheshin stomije me plehna. Edhe një tjetër bekim! U afrohet Dom Tomë Laca. Marrin Krishtin në zemër. Frika e ankthi zhduken: fëtyrat e tyne shndrisin prej një drite që nuk asht e kësaj bote. Meshtari, që pak ma vonë do të ishte protagonist i një skene të ngjashme, s'kishte mërrijtë ende me u largue, kur në rrugicat e qytetit të lashtë jehoi breshnia e plumbave. Qysh se kishin hy komunistat, Shkodra nuk kishte ma nevojë as për gjel, as për sahat me kumbonë. Qeveria e re i kishte pru peshqesh pikërisht këtë soj zgjimi: breshni mitralozi. Breshni që korrshin e grijshin bijtë e saj ma të mirë, ata që e naltuen në majet e kulturës e të përparimit, ata që s'janë ma, që s'po përsëriten, e nuk do e di a do të vijnë ma apor jo! Sepse nën ata plumba binte dekun vetë Qyteti i Veriut.

Të trembëdhetët ranë njeni mbas tjetrit. S'ishte gjë e jashtëzakonshme. Të tjerët kishin ra me ballin shoshë

përpara tyne e të tjerë do të bijshin. E jashtëzakonshmja filloi mbas. Sapo zbardhi drita, një dritë e ndytë dimni, si plehnat e vendit ku ndodhte ngjarja, shkodranët e tmerruem rranë⁴⁹ te penda e Kirit me pa se kush e kishte pasë rradhën. Kështu bajshin sa herë ndiheshin breshnitë. Partia u kishte dhanë të drejtën të kënaqeshin gjithë ditën tue pa bijtë e vet të bamë shoshë prej plumbave. Si ndër amfiteatrot e Çezarëve. Por këtë herë iu desht me pa çka s'ka pendë që e përshkruen as ujë Kiri që e lanë! Breshnia e plumbave, lëshue në të njëjtën naltësi prej plotonit të ekzekutimit, kishte kapë në pika të ndryshme, në përkim me gjatësinë e shtatit. Mesa duket, tue pasë inatë të madh në Prekë Calin, pushkët ishin ngrehë në naltësinë e krahnorit të tij, selvi ndërmjet selvive që blerojshin pak ma 'nde. E breshnia e kishte shi në kokërr të zemrës. Po ndërsa shponte zemrën e fatosit, breshnia e merrte Dom Ndrenë ndërmjet flokëve e syve, në lule të ballit, tue ia shkëputë krejtësisht kapakun e kresë e tue e lanë ashtu, me tru përjashta, me një shi gjaku që ia mbulonte fëtyrën si një duvak i purpurtë. Të tjerët i kishte marrë plumbi dikë në ballë, dikë në zemër, simbas gjatësisë së trupit. Pamje e hatshme, që s'mund të harrohet, që s'duhet harrue, ashtu si nuk duhen harrue as ata që diqën tue i falë fajtorët. Po këta fajtorë me faj, s'u mjaftuen me kaq. I zvarrisën kufomat te një stom plehi, i pështetën ndejun, ashtu tanë plagë e gjak, i vunë në trajtë rrethi, si të dojshin me zgjidhë në log të kuvendit problemet gjithmonë të pazgjidhuna të këtyne trojeve të mjera e me endë fillin e asaj që sapo kishin pa e jetue, për me ia lanë në buzën e dekun, prej kah varej një curril gjaku.

⁴⁹ *Renden, u turrën.*

Si u kënaqën tue i pa ashtu, ndërsa turma e njerëzve me fëtyra, ndër të cilat endej hija e dekës, sodiste me tmerr, ata varën pushkët vrastare në sup, u kapën dorë për dore e t'ia filluen valles labërishte. Ishte lajtmotivi që ndihet edhe sot në Shkodrën e shkretnueme: nanë pa bij, pa vepra, pa rrugë, pa lavdi: "Luaje, luaje këmbënë, se ia bëre gegës nënënë!"

Me të vërtetë asht krejtësisht e kuptueshme që shumë prej atyne të cilët luejtën këtë valle makabre, po kthehen sot në kristianizëm. Madje mbushin rradhët e para të kishave. Kanë hak, për besë! Se po të mos ishim na bijtë e atij që, tue kenë Zot, la ta kryqëzojshin e dha shpirt tue iu lutë Atit, që me një gisht mundet me rroposë botën, "Fali, o Atë, se s'dijnë çka bajnë", sigurisht që sot, mbas një gjysë shekulli, do të kishim ndie andjen e natyrshme me ta dredhë vallen gegënishte në të njëjtën mënyrë! Po për ne një gja e tillë asht e papërfytyrueshme. Edhe në andërr me e pa, ngasim vrap ne nesre me u rrëfye! Tue besue se asht mëkat deri me andrrue shënitime të tilla. E pra gjithë kjo nuk ishte andërr, po zhgjandërr. E nuk duhet harrue. Do të thonë të rijtë. "E pse duhet t'i kujtojmë këto tmerre?". Po, o bijtë e mi, mund e duhet t'i harroni, nëse jeni të sigurtë se një ditë të bukur nuk do të shihni te Zalli i Kirit babën tuej, vëllanë tuej e ndoshta vetvedin para plotonit të ekzekutimit. Historia përsëritet: Në mos më besojshi, besojini këtyne dy skenave kaq të ngjashme, njena e ndodhun në Francë, treqind vjet ma parë, tjetra në Shkodër, në shekullin kur ke le ti vetë. Aq e vërtetë, sa katilat ndoshta i ke kojshi e vijnë me lypë një grusht krypë në derë tande, kur kanë harrue me e ble, sepse i ke gjallë e shëndosh, tanë mallë me vallëzue përsëri si dikur te plehnat e Zallit të Kirit, ku, po të kishte

ndërrue me të vërtetë havaja, duhet të ishte naltue prej kohe ma i bukuri monument kombëtar! Ashtu si duhet të ishte naltue tashma në elter së paku njeni prej atyne që lagën me gjak Zallin e Kirit, tue përmbushë e tejkalue tana kushtet që duhen për t'u quejtë martir i kshtenimit. E pse s'ka ndodhë kjo? – do të pyesë me të drejtë besimtari i thjeshtë. S'ka ndodhë sepse nuk asht tregue kujdesi i duhun për me e ndjekë çashtjen e tyne në instancat përkatëse kishtare. Sidoqoftë, duhet me na ngushëllue mendimi se kujdesi apo moskujdesi i të gjallëve, nuk e prekë asfare figurën e tyne: ata padyshim gëzojnë fëtyrën e Zotit me petka të bardha, të panjolla, të lame me gjakun e Kingjit e me palmat e martirizimit në dorë, sepse në harroftshin njerëzit, Zoti nuk harron kurrë me i shpërblye bijtë e vet! E Shkodra e vërtetë tashma asht një nga lagjet kryesore të Jeruzalemit qiellor.

Po të kthehemi edhe njëherë në Francë: për të mos harrue se dënimi me dekë binte edhe mbi krenat e atyne që i përbujshin ose i mbrojshin priftënt e rregulltarët e persekutuem, E megjithatë, edhe kur salvimi ishte në kulmet e veta, pati gjithnjë njerëz që s'ngurruem me u vu kryet në tehtë të gijotinës për me shpëtue meshtarët e murgeshat, pa llogaritë Biblat, rruzaret, fuguret e simbolet tjera shenjte. E kështu ndodhi edhe në Shqipni. Madje kishte me u dashtë që dikush, prej kishe ta pret mendja, të kujdesej fort për me i ba të njoftun emnat e këtyne njerëzve, të torturuem dje, të harruem sot. Janë heroj të vërtetë të historisë shqiptare të këtij shekulli. E natyrisht duhen ndihmue bijtë e tyne, që lenë e u rritën ndër kampe përqendrimi, për të vetmin faj, se prindët e tyne kishin mbrojtë klerin. Asht krim që Kisha të çojë në shkollat ma të mirat bijtë e atyne që e lanë në gjak. Simbas dishmisë së

Dom Prenkë Ndrevashajt, studentët shqiptarë që u nisën me bursë kishtare ndër shkollat e nalta të Kishës në SHBA, porsa komunizmi bani kinse ra, ishin që të gjithë bij të nomenklaturës. E kur vjen puna për me shkollue ata që s'panë dritë dielli, bahet pyetja e marrë: "Di anglisht? Po kompjuter?" Jo, sigurisht që nuk dinë. Ku patën me mësue, more zotni? Ndoshta ndër baltat e kënetave? Bijtë e tonëve dinë vetëm me përdorue kazmën e lopatën, për faj se na dolën zot ne! Asht detyra e Kishës t'ua mësojë bijve të vet, që kanë dhanë prova besnikie, kulturën ma moderne, në dashtë me pasë në të gjitha fushat njerëzit e vet e jo judat e vet. Populli i krishtenë duhet t'i dijë këto të vërteta. Ka njerëz që qesin e bërtasin se na katolikët po e paskemi zakon me ia xjerrë tana hordheqet në shesh njeni-tjetrit, e deri njerëzve të kishës. Mirëpo, po na thonë se horlleqet duhen me u mshehë se po na e damtokan Kishën me ba me dalë për fushë. Mendim i kotë e i pavlerë. Njerëzit e Kishës duhet të kenë kujdes t'i përngjasin sa më shumë Krishtit, t'i largohen çdo tundimi të shejtanit, e atëherë nuk kanë pse me pasë frikë prej kurrkujt, prej kurrgjaje. Po nëse Ungjilli: fëtyrë për fëtyrë ma parë: me dy-tre dishmitarë mandej, e së fundi në mjedis të bashkësisë, nëse tjetri don me u zhytë ma keq në shkandull. E mos harroni, Kisha nuk asht dega e gjithë besimtarëve e nëse një prej meshtarëve nuk jeton vetë simbas këshillave ungjillore, që u ep të tjerëve prej elterit, ai sigurisht që nuk e përfaqëson Kishën. Po na thonë edhe se fetë tjera kenkan specialiste për me i mshehë të metat e klerit të vet. Natyrisht. Kanë parime të ndryshme prej tonave. Ungjilli i Krishtit tonë na mëson se Kishën nuk e mbajnë njerëzit, po vetë Krishti, prandej nëse ndihet ndonjë

shkandull, askush nuk ka pse me pasë frikë. Besimtari të shikojë Zotin, jo imzotin!

Por të kthehemi te Dantoni e Robespieri. Ata u përpoqën, mandej me e vu fre teprimeve në çkristianizimim e vendit. Por, ndonëse pati shpallë me fjalë “lirinë e kulteve”, Konventa nuk i lejoi të krishtenët t’i riorganizojshin Kishat e tyne. Vetëm në kisha konstitucionale e ajo refraktare mujtën me rifillue veprimtarinë e tyne baritore, nën hijen e regjimit termidorian,⁵⁰ në një atmosferë neverie për teprimet e maparshme, ndërsa ringjalleshin fuqishëm ndjenjat fetare popullore e dishira për me ndjekë kultet. Kishin kalue vetëm dy vjet prej fillimit.

Po në Rusi, ku morën yrnekun, e në Shqipni, do të kalonte një gjysë shekulli. Ma se një jetë njeriu.

Sidoqoftë, nuk ishte hera e parë që Kishës i duhej, e do t’i duhej gjithnjë, të përballonte anmiq të egjër e të fuqishëm: prej amfiteatrove të lashtësisë, ajo do të ngjitej në gijotinë e do të krygëzohej me qindra herë në vende e ndër kohë, tue hy nën dhe e tue ridalë, gjithnjë e ma e fuqishme, pikërisht sepse nuk asht vepër e njeriut!

Nuk kanë kenë të gjithë shenjtën meshtarët katolikë shqiptarë, sepse nuk ishte e lehtë me u shenjtinue në ferrin ku jetuen. Pati edhe prej atyne që u dorëzuen. Ndonjë meshtar, e ndoshta edhe ndonjë ipeshkëv. Po nuk kanë gjysë për gjysë, si në Revolucionin Freng. Shumë pak u ligështuen prej torturave deri në atë shkallë, sa të pranojshin me mësue

⁵⁰ Simbas Kalendarit revolucionar francez gjatë Revolucionit Francez, term që buroi prej Kuvendit mbajtë më 9 Thermidor, Vjeta II (përndryshe 27 korrik 1794), dhe u ashtuquejt revoltë parlamentare, çka solli ramjen e M. Robespierre-it.

prej komunistave ateistë zanatin e ndytë të spijsunit kundër Kishës së vet. E kështu mund të pohojmë se kleri, i përbamë prej njerëzish me mish e me gjak që dhemb kur pritet e përcëllohet, me gjithë ligështitë e të ligshtrët, mbajti qëndrim ma heroik edhe se kleri katolik anglez në shekullin XVI, nësa Henriku VIII, babëgjyshi i diktatorit tonë kur duhej me pre krena, e shkëputi krejt Kishën katolike të Anglisë nga Vatikani dhe ngriti kishën anglikane, tue i shtue vedit, veç titullit të mbretit, edhe atë të papës, domethanë të të parit të fesë, e doemos, atë të katilit.



Disidenca

Kush mund të quhet me të vërtetë disident, në një kohë kur jo çdo njeri që ka bajtë pranga, i ka bajtë veç pse ka dashtë liri. E jo çdo njeri që ka kalue nëpër sitën e mëndashtë të hetuesisë, ka dalë prej andej pa krunde. Lum ata që qëndruen e nuk i shitën idealet, shokët, miqtë, familjen. Që nuk u thyen prej plagëve, as prej joshjeve. Që s'u përulën prej shpresës se shejtani do t'u hapte para rrugët e gjana drejt pushtetit njerëzor, ku edhe kanë mërrijtë shumë prej atyne që u thyen, ndërsa s'asht afrue kurrnjë prej atyne që qëndruen. Vërtet tepër pak e të shpëtuem për mrekulli, sepse herojtë e mëdhaj bajnë gjumin e fundit ndër gropa, që askush nuk mund t'i gjejë ma, zgropue ndër grumbuj plehnash në rrethina qytetesh e burgjesh. Jua pret mendja ju se diktatori gjakatar, që ka këputë krena për një fjalë të marrë thanë pa mendue, do t'i lente gjallë disidentët e mëdhaj? Prandej s'i qeshte buza së mjerës moj Shqipni. Sepse disidentët e vërtetë nuk janë ma mes nesh! E në fronin e qeverisë janë ulë përsëri ata që ia kanë mohue popullit shqiptar edhe të drejtat ma elementare, siç asht e drejta me jetue i qetë në shtëpinë tande, në katundin tand, në qytetin tand, në vendin tand. Se, më thoni, çfarë burra shtetesh janë ata, që së pari u banë vasalë të diktatorit, mandej të anmiquë të vet, si i patën quejtë, ndërsa mbajshin fjalime, shkruiejshin vepra filozofike, poezi, romane, muzikë? Ma dinjitet kishte një i burgosun i laskaruem, por i pa nënshtruem në burgun e Burrelit, sesa ata njerëz, që shpallë vedin disidentë, rrijnë tue u dridhë prej friket se kur e kush po ua xjerr horlleqet në shesh. Jetojnë kështu me një hipokrizi e servilizëm të

neveritshëm, tue i buzëqeshë qenit e shkopit me buzë vesh më vesh. O servilizëm i amshuem i atyne që vetëquhen disidentë e marrin sot shpërblim, për spijunimet e djeshme! Për paditë që banë, për librat që shkruen, për kangët që kënduen, për fëtyrat që pikturuen. Nuk janë ata që e rrëxuen diktaturën, jo, ata e mbajtën, ata e mbajnë, me arrogancë e brutalitet.

Kur isha në OKB, pata pyetë disa burra amerikanë shteti se cili simbas tyne, mund të quhej disident në Shqipni. Ulën kryet e si heshtën një të imtë, së fundi më dhanë një përgjigje efimere. “Ti e ke provue mbi lëkurë tande Enver Hoxhën. Ma mirë atë, apo pluripartizmin?” Sikur nuk kishte alternativë tjetër për Shqipninë! Ose-ose. Sokrat i vuejtun ose derr i pakënaqun!⁵¹ O një diktator i vetëm, ose një turmë me diktatoruca, të gjithë bij besnikë të atij që na patëm pasë kujtue se pat dekë e shkue. E të gjithë, peshqesh prej Amerikës, ku i patëm ngulë sytë e mekun prej torturave për me pa një rreze lirie! Faleminderës Amerikë! Merita për Shqipninë e djeshme e të sotme asht krejtësisht e jotja!

Po ç’pret prej Amerikës. Ajo nuk mundet kurrsesi me na tregue kush asht e kush nuk asht disident i vërtetë. Në këtë vend, që e mban vedin si simbol i lirisë, janë strehues e strehohen shi njata që kanë vu nën thembër luftëtarët e vërtetë të lirisë. A e dini kë takova gjatë njënës nga vizitat e mia në Amerikë? Ndoc Vasilin – si ta quej – sepse kur leu, njihej me emnin Ndoci i Kolë Vasilit të Berdicës, mandej, si françeskan, me emnin Fra Tarçiz Vasili. Ashtu siç njihej shoku i tij i ngushtë, Lukë Kaçaj, me emnin Fra Severini.

⁵¹ Referenca lidhet me alternativat migjeniane.

Ishte shi njaj zotni, i cili më 1946 u qit prej kuvendit të Gjuhadolit, si spiju i Fadil Kapisyzit; shi njaj që i vodhi çilcat e Kishës Fra Ndout, shi njaj që ndihmoi Pjerin Kçirën me mshehë armët në Kishën françeskane, shi njaj që të nesërmen e dëbimit, siç ma kanë tregue ma vonë dishmitarë pamorë, shkoi ndër fretën, hyni te Provinçiali, Atë Mati Prendushi dhe e përshëndeti me grusht në ballë, tue shqiptue me mllef: “Vdekje fashizmit!”, si të donte me thanë “vdekje fretënve” – “vdekje atynë që deri dje i pata vëllazën”, vdekje fesë, atdheut, kulturës, paqes!” Kishte përkrah, mjeshttrin e vet të ri, Fadil Kapisyzin. Atë Matia ua kallëxoi ne nesre të gjithë fretënve këtë skenë, tue i përgatitë shpirtnisht për aktin e parë të tragjedisë.

Ky kriminel, frat-surrat, s’u kënaq vetëm me trathitinë. Shkoi edhe ma ndej: torturoi mizorisht fretënt ndër burgje. Asht dishmitar Profesor Sami Repishti, të cilit Atë Çiprian Nika, ia besoi amanetet e fundit, më sa vuejshin në të njëjtën qeli. Mandej, si e pa se nuk kishte fitue çka mendonte, a ndoshta për të vijue nëpër botë zanatin që kishte mësue në degën e punëve të brendshme të Shkodrës, mori udhën e arratisë e shkoi e na u vendos si disident shi në vendin e madh të lirive. E kështu përbindëshi bregabuenas gjet strehë në Amerikë. Ndryshoi rishtas emën, ta pret mendja: e quejti vedin Anthony Kapaj e u vu nën mbrojtjen e FBI-së. E na mandej çuditemi, kur i shohim tek ikin e rahatohen menjëherë në Amerikë tanë njata surretën, që i kemi njoftë prej kohe si trathtarë e spijuj. E atje mandej na dalin disidentë me namë, marrin shpërblime e nishana e fillojnë, natyrisht, me shkruë libra, për me mbulue trathtitë e tyne, tue vijue me e falsifikue historinë. Taman si Anthony, që s’ka lanë gja pa shkruë për fretën, me bukën e

të cilëve rriti shtatin. Kam lexue rrenat e tij e edhe përgjigjen që me të drejtë, i ep Nikë Stajka. Kur erdh me më përshëndetë, me atë trupin e tij të gjatë, si të krymbit të ferrit. Desht me më ba për vedi, si pat ba Dom Zef Oroshin, edhe ai i strehuem në vendin e lirive e i rradhitudun në kopenë e kësaj fare disidentësh. Po ia preva shkurt: “Çudi si nuk ta paska xanë ende birën e fytit buka e fretënve! Në vend që të sajosh rrena pa fund për të tjerët, ban mirë me i ra gjoksit me grushta e me kërkue të falun. Me ba vaki e mban mend prej kohës kur ke kenë xhakue, se zoti falë edhe kriminelët ma të mëdhaj. Kur pendohen, natyrisht! Ashtu si duhet ta mbajsh mend se Juda i papenduem, shkoi e vuer vedin. Kam pasë kujtue, se Judë tue kenë, do ta kishe gjetë një të shkretë fik në Amerikë e do ta kishe vjerrë vedin shi me konopin e Shën Françeskut, të cilin e ke trathtue aq përvnershëm. Ose do të ishe vjerrë në Berdicë, ku e quej të arsyeshme me ta kujtue se nuk mungojnë degët e fikut”.

Të ishte Amerika vendi i lirive për mbarë popujt, si e ka simbolin, e jo vetëm për vedi, nuk do të kishte pasë vend për Juda, kur filloi tragjedia jonë, e nuk do të ishim djegë e pjekë edhe tash vonë, për të mos harrue përcëllimin prej diktaturës. E si mund të quhen burra shteti presidentat e shteteve të bashkueme Karteri, Bushi e Klintoni, përderisa lejuen të pranohej në Organizatën e Kombeve të Bashkueme Enver Hoxha, që i pushkatonte njerëzit vetëm pse shikjojshin përtej telave me gjemba, të cilët rrethojshin skllavët në Shqipni; ose meshtarin, vetëm-vetëm pse pagëzonte një fëmijë; ose arrestonte një babë fëmijësh, i cili pohonte se kishte vjedhë për kafshatën e bukës së familjes, sepse jetonte në mizerjen e kooperativave bujqësore... E vijojnë me lejue e madje rrahin shplakë për qeveritarët e

soçëm, autorë krimesh edhe ma të rafinueme, ndërmjet të cilave paga që paguejnë për mundin e djersën e ndershme, tue e ba krejt të pamundun jetesën në një Shqipni me rroga mjerane e me çmime europiane, në një treg ku shiten plehnat e lindjes e të perëndimit. Të gjithë këta soj burrash shteti, të afërt e të largët, do të përgjigjen një ditë. Mallkimi i popujve randon mbi të gjithë, e pikë ma së parit, mbi burrat e Washingtonit, sepse fillojnë atje shkeljet e të drejtave të njeriut, për me mërijtë së mbramit edhe në Tiranë.

Të vogjlit përpiqen me e modelue jetën e tyne simbas shembullit të të mëdhajve të botës, me u përgja sa ma shumë, po kur të mëdhajtë janë krejt të kalbun prej veseve, çka mundesh me pritë prej vogjëlisë?

Të gjithë të burgosunit politikë, edhe ma qyqarët, që me politikën s'kishin asgja të përbashkët veç akuzës, e dijshin se komunizmin e solli në Europë Jalta më 1945, e solli U.S.A, tue ia falë këtë copë tokë, të mbjellun me eshtën, prej të cilave mbin veç deka, demokracisë së lashtë e të re “të Tiranës”, e cila edhe sot e kësaj dite orkestrohet nga këshilltarët amerikanë, që banojnë “nën hijen e hurmave”, në kodrat romantike të Tiranës.

E me njetë indiferencë që shikjojshin ambasadat europiane vuejtjet e popullit shqiptar gjatë terrorit enverian, po me njetë indiferencë po e shikjojnë sot mafien shqiptare vëzhguesit e Bashkësisë Europiane, që zdërhallen me vetura luksoze nëpër rrugët tona të shkarravituna, tue u shqetësue vetëm se ky vend virgjin asht tepër gropa-gropa për me ia ndie taman lezetin udhëtimit.

Lirimi

Ishte data 13 Prill 1989. Sapo më kishin xjerrë prej izolimit 18 mujor, kur u hap sporteli i derës së qelisë. Në atë plasë të vogël u duk një si sy çiklopi. Kërkonte dikend ai sy, që bahej edhe ma i lemeritshëm nga efekti i kundërdritës. Ishte syni i një polici, i cili më kishte përkëdhelë sa herë me shtjelma e me të shame. Më kërkonte mue. E si më gjeti, ma bani me gisht, ndërsa bërtitëte: “Ej, ti! Merr teshat tua personale e del këtu në korridor!” Unë bana sikur nuk e pashë as nuk e ndjeva. Sytë e mi studjojshin me vemendje të jashtëzakonshme tavanin e ndytë, si me dashtë me e zbulue aty enigmën e jetës. Zani i policit u egërsue, ndërsa përsëriste të njëjtin urdhën. Arra gungçe edhe ma indiferente atje në skajin e mykun të qelisë. E ndërsa luejshe rolin e njeriut që s’i bahet vonë për kurrëgjia, më dridhej korp e shpirt, tue dijtë mirë sesa shtrejtë paguhej këtu kryenejëçësia. Tana gjandrrat e trupit ishin të ngacmueme në kulm. Truni punonte me ritëm të shpejtuem e zemra pomponte me vrull gjakun ndër dej, në pritje të shtjelmave e të grushtave. Gjithë qenia eme, në kulmin e tensionit, pritëte që syni të hynte nëpër birucë të derës, për t’u shndërrue në katalla të vërtetë, në qenie që e then me një të rame edhe arrën ma gungçe. Polici hapi derën e hyni në atë odë mjerimi. M’i nguli kësaj rradhe të dy sytë, se kishte dy e jo një, siç të krijohej përshtypja kur e shifshe nëpër plasë. Ishte ba si mollatartë e kuqe në fëtyrë. Më shënoi me gisht, tue përsëritë për të njëqindtën herë: “Ej, ti!” Iu përgjigja: “Çka don me thanë “ti”?”. Unë kam emën e po s’u thirra si duhet, nuk e los kambën prej këtej!”

Polici u detyrue me ma plotësue dishirin. Më thirri me emën: Simon Juba! E ndonëse ky emën nuk ishte bash-bash i emi, u çova e u bana gati me dalë. Mendimi i parë ishte se po më transferojshin; i dyti – se më pritëte një hetuesi e re. Punë e madhe! Isha mësue tashma me ra prej shiut në breshën e anasjelltas. Variacion! Vetëm këto ishin variacionet e jetës sonë; nga biruca, në qeli, nga qelia në hetuesi. Të paktën për disa çaste ndërronte pamja: nuk kishe ma parasysht të njëjtat mure të nxime, të njëjtat fëtyra, edhe ma të nxime, gjithnjë të vranta, si qielli në ditët ma të zymta të vjeshtës. Dera u hap e unë, për çudi, ndjeva një keqardhje të madhe që po largohesha, ndoshta për mos t’u kthye ma aty. Isha prift. Me këta njerëz të sertë më lidhshin njëmijë fije, që i kanë rrajët ndër shpirtën. Ata e dojshin Meshtarin, sado mediokër të ishte. Te Meshtari gjejshin forcën morale për me përballue vujtjet e matejshme. U dava pra i përmalluem, prej shokëve të mjerimit, për t’u nisë në drejtim të një adrese të panjoftun. Polici më vuni para e më nxori në oborr të burgut. Ishte hera e parë mbas aq kohe, që delshe në oborr pa hekura ndër duer. Fillova ta ndjej vedin të lirë. Çudi! Polici më shtyu përpara, tue m’i prishë andërrimet, e më dorëzoi në një zyrë, ku ishin ulë të gjitha autoritetet e Burrelit, me një fjalë trekandëshi, siç i thojshim asokohe. E para herë që rrijshe i vetëm sepse nuk i kishim duer e kambë në pranga. Numri një, kryetari i degës, m’u turr me këto fjalë: “Nuk po sillesh aspak mirë!” I përgjegja aty për at: “Mos e ke fjalën për çka kam thanë kundër jush”, natyrisht që kam folë, e do të vijoj me folë. Për këtë ma ka falë Zoti gojën: me kërkue liritë e të drejtat që më takojnë. Mandej, natyrisht edhe me ngranë, e jo këllinat e thive me të cilat po më ushqeni ju tash sa vjet...”. U banë, aty shumë

polemika, që s'ia vlenë barra qiranë me i kujtue, sepse të përshkrueme me hollësi edhe prej ish – të burgosunve të tjerë në librat e tyre të kujtimeve. Kishte me u dashtë me i kapë e me i lexue e me shenjue këtu: shikjo fq kaq e aq të filan e të fistek libri. Por ku ta gjej unë atë durim, kur gati-gati më mungon deri me përfundue këto shënime, që lumni Zotit, po i afrohen mbarimit e që i shkrova, sepse mendoj se kurrigia nuk duhet me hupë: as ngjarjet e as sidomos, emnat e kriminelave që na shkatërruen Fe, Atdhe e jetë; sepse copëz e një historie që shpresojmë se ka me u shkruie në të ardhmen, tue meritue ma në fund të titullohet “Historia e vërtetë e Shqipnisë e e shqiptarëve”. Por a ka me u shkruie ndonjëherë e vërteta mbi Shqipninë e Shqiptarët, nësa deri më sot thuejse gjithçka asht shkruie në rrenë? Llapet pamasë për atdhedashuni, për vëllazni e sidomos për bashkim, ndërsa askush nuk don as me ia përmendë vuejtjet e randa që shqiptari i Jugut i shkaktoi shqiptarit në përgjithësi e atij të Veriut në veçanti. Nëse na, që i kemi ende plagët e hapuna, guxojmë me i quejtë faktet me emnin e vet, fillon menjëherë kundër nesh ulurima. Na quejnë të marrë, përçamës, antiatdhetarë! Ndërsa askush nuk kujtohet me ulurue si ujku ndër net të gjata dimni, veshë me kristalin e akullit, nën dritën e ngrime të hanës, “Kriminelëëëëë! –sa herë kujtohen ata që na masakruen shpirt e korp! Të shkuara e të harruara – do të përsërisë me nervozizëm ndokush, që kujton se ngjarjet mund të shihen me gomë. E kështu, harresë më harresë, do të mërijmë, po na thonë, me jetue kingja e ujq bashkë në një stan e në një mriz. E provën gjenerale tashma e kemi ba, për kënaqësinë e madhe të ujqëve, të cilët kanë zëvendësue barijtë në krye të grigjës.

Burreli ishte një Shqipni e vogël, nësa Shqipnia, një Burrel i madh, don me thanë, një çorganizim i organizuem në mënyrën ma të përsosun. E për të mërrijtë në shkallën ma të naltë e këtij farë qytetnimi, kishin themelue edhe Universitetin e Akademisë e shkencave, që kishin si mision kryesor me krijue sa ma shumë konfuzion, me ia ba shqiptarit jetën sa ma të padurueshme e vetë Shqipninë, sa ma të pabanueshme e këto institucione të lavdishme, që i kanë *dhuruar* popullit aq shumë *vepra të shquara*, të gjitha të karakterit të Fjalorit Enciklopedik shqiptar, prej të cilit mësojmë gjithçka që duhet shlye prej kujtese një herë e përgjithmonë, janë ende në kambë, e autorët e tyre e kanë gjoksin e stolisun me shenjat e akademikut e vijnë me shitë mend e shqise, në një kohë kur duhet t'i faleshin nderës Zotit që nuk i kanë duert e stolisuna me të njëjtat pranga, që randuen një gjysë shekulli mbi duer tona. E në fund të fundit, ata edhe e meritojnë! Sepse dikush dikur duhet të përgjegjet për shkatërrimin e kaq veprave, kaq viseve, kaq jetëve, kaq shpirtënve, për rrenimin e Shqipnisë e të shqiptarëve.

Kur po pritëshe, pra rifillimin e torturave të reja, e isha mprehë me i durue, kryetari i degës më dha lajmin ma të papritun, ma të dishruemin: “Je i liruem” – më tha, gati me tërbim – “e tani e tutje gojën ta kesh vetëm për të ngrënë. K’ton (kupton)!? Bëj gati plaçkat dhe për pesë minuta të jesh jashtë!” U mrekullova: pra isha me të vërtetë i lirë. Ai më shikjoi me sytë prej kriminelit, tue pritë që t’u falesha nderës. Po goja eme pa dhambë mbet e mbërthyme si me gozhda. Asnjë fjalë falenderimi, asnjë sjellje servile. E pse me e falenderue? Thue për varrët, që i kisha ende të freskëta në shpirt e në korp? Thue për prangat? Apor për

dhambët që i kisha lanë aty? Çka kishte me zbulue, nëse do të vejshe buzën në gaz? Shpellën e hatashme të gojës, katandisë në atë gjendje prej njerëzve, si ky zotnia që, mbasi më kishte shkarravitë, në vend që me më kërkue të falun, vijonte me më kërcënue. Gati-gati s'po i besojshe veshëve. I thashë: "Tek e mbramja e paskeni kuptue se sistemi po shembet shi mbi krenat tueja. Vërtet po më lironi? Apo tashti keni ndërrue taktikë, tue i zëvendësue torturat me tallje. Jam i sigurtë se ma parë keni me lirue spiujtë tuej. Tashti ata ju duhen ma shumë jashtë se këtu mbrendë. Mandej vjen rradha eme e e shokëve të mi disidentë, që kishi me dashtë me i pa të gjithë dekun, tue kujtue marrisht se të dekunt nuk munden ma me folë. Flasin, zotni, flasin! I bajmë na me folë, në paçin harrue!

Ai u tërbue. Me fjalor karrocierash u kërkoi policëve të më nxirrshin jashtë me shtjelma b..., mbasi të më kishin kontrollue imtësisht, që mos të majshe me xjerrë asnjë copë letër përjashta. Policët shpejtuen me zbatue urdhnin. Kontrolloni, kontrolloni, u thashë me tallje, se në xhep kam pikërisht letrën ku ndodhet sinjali i kryengritjes së përgjithshme! Ata, të tërbuem, më dhanë shtjelmin e fundit e më flakën, bashkë me lekat e mia, të cilave u vinte era mi biruce, fill e në liri! Dyshova! Kisha hy në burg me grushta e dola me shtjelma. Liri e çuditshme, kjo!

S'kisha vu mirë kambët në atë hapësi, që besohej se ishte e lirë, kur e kuptova menjëherë se kisha dalë - prej burgut në kaos. S'gjeta një karrocë, me thanë, për me bajtë teshat e mia, që më duhej me i marrë me vedi doemos, sepse në shtëpinë e sekuestrueme dy herë rresht, nuk do të gjejshe as një lugë për me ngranë. Mbas disa orësh, memzi gjeta një kamion të zbuluem, ngarkue me mall, me të cilin mërrija

deri në Milot. Aty më kishte xanë pritë spijuni i parë i përte' burgut. Më përshendeti. E përshendeta. E ai menjëherë filloi me më folë, si të ishim miq të vjetër, tue m'u drejtue me një familjaritet të çuditshëm. I thashë se nuk e kam zakon me hy në biseda kësisoji e njerëz të panjoftun. Atëherë ai filloi me më lavdue për qëndrimin tem në burg, tue kallëxue deri hollësi, që edhe vetë i kisha harrue. Nuk m'u da kurrkund. M'u qep si morr. Ishte pjesë përbase e asaj që në Shqipni quhet liri. Megjithatë tue kenë përplot me emocionet e lirit, s'e ndiejshe praninë e tij, ashtu si s'e ndiejshe aspak të ftohtin e as erën që më shikte në majë të kamionit, të mbuluem me mushama, i cili tek e mbramja më pruni në Shkodër aty kah mjesnata, së bashku me ejllin e rojës. Ai faqezi më tha se ishte prej katundit e se s'kishte ku me fjetë tjetërkund, veçse në shtëpi teme. Mërrijta, pra në Shkodër me zhelet e mia në krah. Ma në fund po i afrohesha shtëpisë seme, që ndodhej e ndodhet gjithnjë pranë e pranë vorrezës së Rrëmajit. Dy hapa larg prakut të saj naltohen selvijat e blerta qindvjeçare, ndërmjet të cilave duken e zhduken kryqet e bardhë të monumenteve mortore prej mermeri: të vetmit kryqa që i kishin pështue tramundanës⁵² komuniste, ndonëse të plasun e të laskruem, si shpirtënt e njerëzve, që nuk mund të shpresojshin ma as me u prehë së bashku me etënt e vet në ato selvi. Shteti kishte hapë një vorrezë tjetër në Shtoj e flitej se mbi Rrëmaj do të ndërtohej një lagje e re. Thojshin se të dekunt ishin shumë ma të kënaqun në Shtoj, sepse ndërmejt vneshtash që pikojshtn musht e venë mbi gojët e tyne të dekuna e kështu e kalojshtn kohën edhe ma dejshëm se kur kishin

⁵² Italianizëm (khs. *tramontana*): erë e ftohtë që fryn kah Veriu.

kenë përsipër. Me një fjalë, mbi deké do të lulëzonte jeta. Shkodranët talleshin, sepse e dijsin mirëfilli ç'lulëzim mund të vinte prej dimnit të acartë komunist... Po s'u shkonte ndër mend aspak se Zoti e kishte caktue atë copë truell të mbjellun me eshtën përmbrenda e përjashta, për t'i rikthye e për të dhanë sinjalin e parë të një pranvere të vërtetë. Aq ma pak më shkonte ndër mend mue, që atë çast e kërkojshe e s'e gjejshe shtëpinë teme, pështjellë me heshtje e terr, ma keqas se një vorr. E dijshe se njeni prej nipave, le me sëmundjen e persekutimit, si tanë shqiptarët e ndershëm, kishte ikë në Amerikë, se vëllaun ma kishin internue, por ma gjatë nuk dijshe. Kur e gjeta derën e shtëpisë atënore, në mjedis të atij pështjellimi muresh e dyersh e barakash të reja që ishin ndërtue në mungesën teme, vetë e dijta. Mërrijta, pra te dera atënore, mbas të cilës nuk më pritëte askush, e prandej më dukej si kapaku i një libri të lashtë, shkruar në një gjuhë të panjoftun. Nuk dukej asnjë rreze drite. Natyrisht. Ishte mesnatë. Edhe nëse aty banonte ndokush, do të ishte kahmot në gjumë të thellë. Më kishin thanë se aty vijonte me jetue nipi tjetër të cilin, gjithnjë simbas thanë e thaçve, nuk e kishin internue, sepse gjoja ishin zbutë ligjet. Me dorën që më dridhej kapa trokaçen. Nuk ishte ma trokaça e moçme, ajo trokaçe që kishte lajmue aq gëzime familjare në këtë shtëpi të vogël ndërtue pranë një vorreze. Trokitja jehoi në heshtjen e natës, u përhap në tanë atë rropulli gjysëm kësollash e shkoi me trazue gjumin e prindëve të dekun në vorrezë. Trokita disa herë. Së mbrami u ndez një dritë kandili e u hap edhe dera. Mbas saj pashë një fëtyrë të panjoftun, me flokë të shpupurishun e me sy të ajun prej gjumit. Më shikjoi si të kisha zdrypë prej hanet, e kur i thashë kush isha, i doli krejt

gjumi e iu prish humori sepse, si mora vesht ma vonë, po flente me dashnoren e vet pikërisht pranë shtëpisë prej kah kishin dalë dy meshtarë katolikë. Dom Lazri e unë. Kisha gjësitë gabim. I kërkova të falun me gjysë zani njeriut me flokë e humor të shpupurishun e vijova kërkimin nëpër natë. Ma vonë mora vesht se këtu vijshin edhe të rij të tjerë, shokë të tij, për me shfrye epshet shtazarake.. Kur kjo shtëpi, në zemër të një rrugice katolike, kishte vojtë në këtë hall të zi, po shtëpitë tjera, ku s'ishte ndie prej një shekulli emni i bekuem i Zotit!... Po kështu e ma zi ishte katandisë edhe Argjipeshkvia... Persekutimi ishte ndeshë për jetë a dekë me fenë e qytetnimin dhe ia kishte dalë ta ndërpriste përkohësisht çdo zhvillim. Në mes të këtyne njerëzve jetojshin edhe nipat e mi. Po të mos e kishte ndërpre zhvillimin toska i parodë, ata do të kishin kenë krejt ndryshe, do të ishin edukue ndër institucione fetare, bashkë me të rij të tjerë e Shqipnia nuk do të ishte kthye në një strofull hajnash, imoralash, injorantash e tregtarësh, që shpejtuen me ikë nëpër botë për me shitë, si antikitetë, flamujt e shkyem të besës, të burnisë e të fesë atje ku ua paguejnë ma shumë, tue qelbësue gjithë botën!

Ma në fund e gjeta edhe derën e shtëpisë seme, të cilën ma hapi një burrë tjetër i shpupurishun. Ishte em nip. Hyna mbrendë i prekun thellë në shpirt. E ndërsa shikojshe me mall atë vend aq të dishruem, nipi më shtroi me hangër çka iu ndodh në atë çast. Hangra shpejt e shpejt bashkë me mikun e padishruem e mandej hyna në odën teme në katin përdhesë. Odë prifti, e vorfën, e pastoli, e shtrueme me çimento, që kishte mbetë në katër muret. Shtrova zhelet e burgut e rashë me ndjesinë se ndodhesha rishtas në birucë. Çka më pritëte të nesërmen? Të mbasnesërmen? Çka do të

hajshe? Si do t'i vente filli i jetës seme? Vullnesa e Zotit u baftë – thashë me za – bana kryq e i lashë tana mendimet e zeza mbas asaj dere që e kisha andërrue aq shumë.

Ne e nesre m'u desht me u dukë menjëherë në degë të punëve të brendshme, ku paraqita fletën e lirimit nga burgu, që vërtetonte se kisha dalë kështu nga kopeja e skllavëve të pranguem për të hy në tufën e skllavëve të lirë. Oficeri e hapi fletën, e lexoi, e tue çue sytë me më vërejtë ma mirë, më tha: “Shtatë vjet. Tepër pak! Kohë e pamjaftueshme për t'u penduar një njeri si ti, që është dorovitur prift e është kthyer në armik!” E unë: “Edhe po t'ju thojshë se jam pendue, nuk do të më besojshi...” Madje do të më urrejshi edhe ma tepër, do të më shajshi e do të thojshi: “Çfarë prifti qenke ti që shkel mbi bindjet tua fetare nga frika!” Prandej po jua them këtu copë e do t'jua përsëris sa herë që të më pyetni: “Kam hy në burg një herë e kam dalë njëqind herë ma shumë prift. E nuk asht aspak e vërtetë se kam ba vetëm 7 vjet mbas hekurash. Kam ba 26 vjet e duhet të vuejshe edhe 20 të tjera. Me një fjalë më duhej me pasë disa jetë, të gjitha të kalueme në burg, për me ju falë kënaqësi ju!” U tërbue, por s'pat çka me më ba. U detyrue me më lanë me shkue në hallin e ri që më kishte gjetë.

Se si m'u dha, as vetë s'e di, por tue u largue, murmurova italisht: “Il comunismo e un regime di fame e di sangue basato sulla menzogna e sul terrore, e una disorganizzazione organizzata in modo piu perfetto e non e altro che la personificazione della degenerazione umana”. Oficeri hapi sytë i çuditun, mandej bani sikur kuptoi gjithçka e tundi kërcënueshëm kryet. Kur dola, ndjeva se shoku i tij e pyeti: “Çka tha!?” E ai, për mos me u dukë injorant, përgjegji: – “Foli rusisht: Këta meshatarët janë

dreqi vetë, e ka mësue edhe rusishten në burg. Po çka i duhet xhanëm: thua meshon rusisht? – Jo ore – ia pat tjetri – rusisht e thonë meshën orthodoxët. Ky është pop katolik!”

Prej dege shkova menjëherë në postë, ku i nisa disave prej shokëve të mi të burgut, që nuk kishin familje, një pjesë të të hollave, të cilat m’i kishte dorëzue llogaritari i burgut kur u lirova, sepse në burg nuk kishim të drejtë me mbajtë pare. Mbas pak ditësh drejtorja e burgut m’kthei rishtas paret në Shkodër. Nuk ua dorëzoi atyne të mjerëve, tue e dijtë mirëfilli se skami asht burri ma i fortë që ka jetue ndonjëherë mbi këtë dhe. Ishte edhe kjo një nga torturat që përdorte e përdorë edhe sot e kësaj dite klani, si mjet për të shkelë nën thembër dinjitetin e njeriut, sepse njeriu pa ideale që nuk ka asgja, e ka tepër të vështirë ta ruejë dinjitetin e vet njerëzor. Prej skamit vjen sherri, shamata e deri te divorci e krimi. E këtë klani e di mirë! Prandej vorfnia në Shqipni ka marrë sot një pamje edhe ma të lemerishme se përpara, kur të tanë ishin njësoj të vorfën. Sot kur sheh tue u pasunue krimineli, kontrabandisti, tregtarët e skllavëve, vështirë mos me të lindë asnjë tundim, e mos me thanë, nëmose me vedi: “Si s’kjeçë i zoti për kurrnga”, e të mos ia kesh kojshisë lakmi pasunitë që ka vu pa djersë, gjithnjë si dje, me lejen e bekimin e degës së punëve të brendshme, klysh të së cilës kanë kenë e janë të gjithë ata që notojnë mbi ujna, në një kohë kur barka shqiptare asht përmbytë prej kohe.

Ndërkaq unë pata ngushëllimin ma të madh: fillova, në shtëpinë teme, veprimtarinë fetare. Nisa madje të shkoj edhe ndër familjet, që më thirrshin, në qytet e në katunde. Veprimtaria eme e parë kanë funeralet publike. E ndërsa

unë i prijshe të dekunit me ritual në dorë e me kotë të bardhë, shumica e kalimtarëve ndaleshin, sa për me nderue të dekunit, aq me pa se kush ishte ai prift kryenejç, që guxote me ba shërbime fetare publike pa lejen e policisë sekrete.

Në shtëpinë teme filluen me u mbledhë qindra vetësh, si për shërbimet fetare, ashtu edhe për me pa Meshën, që e kremtojshe simbas të gjitha normave, edhe me predk. E nuk isha i vetmi. Klerikët tjerë, që kishin dalë nga burgu, i kishin shndërrue, para mejet, shtëpitë e tyre në kisha të gjalla, ku të krishtenët e ndijshin vedin pak a shumë si bashkësitë e hershme të krishtenimit.

Ndër punë të para që bana, sa dola prej burgut, ishte vizita te vorri i tem vëlla, Dom Lazrit, martirit të helmuem prej sigurimit. I pagova menjëherë ndërmarrjes shtetnore përkatëse të hollat për ndërtimin e vorrit të tij. Por kanë kalue ma se dhetë vjet e nuk kam pa me sy as vorrin as paret. Madje, tue kujtue këto pare, po më vjen ndër mend edhe radioja me voj gurit që kisha në Mirditë, kur isha famullitar si dhe një viç, që e pata shitë në ndërmarrjen shtetnore të grumbullimit e ky shtet i pafëtyrë më pat vjedhë radion e nuk m'i pat dhanë as paret e viçit, ashtu si nuk po m'i ep paret e vorrit. Shtet hajnash, që përveç vëllaut, vorrit të tij, radios me voj gurit e viçit, më ka borxhe të tjera shumë më të randa. E zgërdhahet, tue mendue se s'ka me m'i pague kurrë, madje as në jetën tjetër, sepse edhe kur të paraqitemi së bashku para gjyqit të mbramë, meshtar tue qenë, ka me m'u dashtë me thanë: "Fali, o Zot, se s'kanë dijtë çka kanë ba!" E kur të ndigjojë se i fali unë, që më kanë rjepë për së gjalli, si s'ka me i falë ai i Lumi, që asht mëshira e pambarueme? A mundem unë, që në këtë botë u dogja e u

përvëloma në zjarmin e tyne, me t'u thanë amen me shtjelma e me t'i flakë në zjarmin e pambaruem? Por ani. Ndoshta shkojnë vetë atje, se çka kanë me ba në Parriz? Nuk mundem as me e mendue Enver Hoxhën tue ba muhabet, bie fjala, me Shna Nduen a me Shna Rrokun. Madje as me qenin e këtij të fundit. Le ma, ruejna Zot, me më ra mue me i ndejë pranë në shekuj të shekujve... Ma do mendja se me apo pa faljen teme, ata të gjithë mbarë kanë me shkue e me mbarue në shërbim të djemënve, gja që gjithashtu s'më kënaqë, sepse specialistë të torturave siç janë, kanë me i mundue ma zi se dreqënt profesionistë shpirtënt e djerrun!



Fantazma e dyshimit

Fantazma e komunizmit, që endet edhe sot e kësaj dite në trojet tona të shkreta, u mundue me përfitue sa ma shumë prej përvojës së krishtenimit. Natyrisht tue i hjekë Zotin e tue e zëvendësue me idhullin, me diktatorin. E nësa imitonte, mendoj edhe ajo, si Zoti, me krijue njeriun e ri. Mblodhi, pra një grusht me lllomshtinat e veta e i mbruji, në gjasim të Hyut. E si e kishte ba gati baltën, i fryu në birat e hundës. Por në vend të njeriut, që mund ta krijojë veç Zoti, kishte qitë në dritë fantazmën e dyshimit, e cila nisi ma zi se fryma e ndytë amë, të futej birë në birë: prej shtretënve, ku mundoheshin me fjetë burrë e grue, tanë frikë se i prigjonte kush edhe në të shtrueme, ndër plasat e shkambijve e deri ndër retë, që dyndeshin papra në qiellin tonë. Fantazma e dyshimit asht krijesa ma e rrezikshme e diktaturës! Ma e keqe edhe se mjerimi. Një ndër të këqijat ma të mëdha, që e bajnë gjithnjë e ma të pabesueshme e ma të pasigurtë jetën tonë. Të gjithë dyshojnë për të gjithë. Për ty, e doemos, për mue.

Fantazma e dyshimit ishte e pranishme kudo, kur filloi të frynte era e asaj që na e quejtëm demokraci. Ishte aty, kur unë përgatitesha me çue Meshën e parë. Ishte edhe në Meshë e u frynte në vesh njerëzve, deri besimtarëve ma të bindun, e u thoshte: “Si tepër guximtar ky domi! Prej kah doli, more ky? Mandej, kush e shoqnon? Kush e mbron? S’ka tjetër, mbas elterit, ku ai po çon Meshën e parë, asht sigurimi i shtetit. Ose ndoshta asht nën elter! – Kush more – përforconte një tjetër – nën cilin elter! Asht shi në elter. Ai

që po çon Meshë asht një oficer sigurimi. Madje tash e mbrapa tanë ata që kanë me u ngjitë në elter, kanë me kenë oficeria sigurimi. Këtu e ma nalt, more deri në Vatikan i ke. Pvet, në mos më besosh. Pvet ata që i dijnë ma mirë punët me emna e me mbiemna. Jo për gja, por ku kanë me shkue të gJORËT, tashti që po na thonë se sigurimi mori fund? Tashti kur unë e ti mund të llapim sa të na teket. Atë punë kanë ba ata, me prigjue çka po thomi na. E tash, ku kanë me u mbytë? Me i lanë pa bukë fëmijët, a? A nuk asht Kisha gurrë mëshire. Vend ma të përshtatshëm s'kanë ku gjejnë: karitase, sakrestina, shoqata, radio, shtyp”.

Fantazma e dyshimit endet kudo, qytet më qytet, shtëpi më shtëpi, njeri më njeri. Kushdo dishron me ba një punë të mirë, të pastërt, do të hyjë në gojën e saj, që qelbet erë kufome. E do të dalë prej andej njeriu ma i përdhosun. Ajo ia fillon menjëherë: “Kush more, ky? A s'ishte ky një prej atyne që hangri bukën e Enver Hoxhës pesëdhjetë vjet. Me çka jetoi, hë. Jo ma ka kenë në burg! E pse s'e mbytën? Si ia bani që doli gjallë prej burgut? Kush e mban me bukë, se punë s'i kanë dhanë ma kurr. Mandej ke ka miq? Ata që u ngjitën sot, në pope. S'ka, spiju edhe ky. Tregtar flamujsh! Mister puna e tij, se le ata që i njohim e i dijmë!”

Fantazma e dyshimit më çifillon në vesh, ndërsa shkruiej: “Ti kujton se ke krye detyrën tande shenjte, tue botue një libër-padi. Po kush po ta lexon, more i ngratë. S'asht koha e këtij lloj libri sot. Njerëzit kanë kja boll, tepër madje. Nuk duen me kja ma, nuk duen me ndie ma punë torturash, gjaku, kufomash. Ma mirë të kishe shtjellue gjane e gjatë njatë kapitull, ku flet për punë erotizmi, tue i vu një titull të dejë, si për shembull: “Erotika e një të burgosuni”, “Dashuni me polic nën shtrat”, “Puthja e drejtorit të

burgut” ose “Erotikë prej rrëfyestores”. Ani ti, që çka s’të kanë ndigjue veshët gjatë rrëfimeve. Sigurisht që libri kishte fluturue. Se njerëzve sot këto punë ia kande. Sa për të tjerat: kujtesë historike, njohje e fakteve, dënim i kriminelave, rrezik i rifillimit. Këto, sende s’duen as me i ndie: duen me harrue se ka kenë ndonjë herë diktatura, dajaku, plumbi, vorri, e as s’u shkon fare nëpër mend, se gjithçka mund të përsëritet prej së parës, po harrove. Jam unë, që ua ndezi fantazinë e sëmuet për marrina, sepse po u bane të urta masat e verbëta të popullit atëherë prit kryengritjen e armatosun e gjakun deri në gju, i vetmi që mundet me i la me të vërtetë fajet e mëkatet, të cilat randojnë mbi këtë tokë. Prandej unë shkoj tue përsëritë skutë më skutë se fitorja ma e madhe që ka pa historia e këtij populli, sa të mjerë, aq të marrë, asht fitimi i demokracisë pa gjak more zotni. Prandej kot e ke që shkruen libra. Librat tuej i flakim në grumbujt e plehnave, që kanë përmytë qytete e katunde. Ku shkojnë e zhyejnë mustakët mica e daca, që kanë me kenë të vetmit lexues tuej. S’asht koha e idealeve: asht koha e pares. A je i zoti me ia thye njerëzve kryet me pare? Me nga në të katër anët e botës tue shpërnda grushta me dollarë? Ke me fitue menjëherë çmimin Nobel, ke me u ba i famshëm në të tanë botën, madje, kush e din, po thom kështu sepse nuk jam krejt-krejt ekspert në këtë lamë, ndoshta-ndoshta mbas deke të naltojnë edhe në elter. Cilin ke pa tue u dënue? Përkundra, tanë ata që t’i kanë ngulë thojt në fyt janë ba zotni të mëdhaj: kanë ble deri ishuj! E tanë kjo mbrenda dhetë vjetëve, ndërsa miqtë tu të mirë, në rasë se nuk pushojnë ndër gropa të harrueme a nuk kanë ikë nga sytë kambët, rrëshahen si hije rrugëve të qyteteve, ba me iu dhimbë gurit e drunit, kah shohin se idealet e tyne janë

shkelë nën të njëjtën thundër hekuri. Ti gëzohesh se e përfundove librin e burgut, se nuk diqe pa lanë si trashigim dishminë tande. Kujton madje se tanë atyne që e mbajnë vedin të persekutuem ka me iu ba qejfi. As mos të rrejë ajo mende. Shumëkush, prej tuejve, ka me folë të nandëdhete e nandat për librin e për ty. Në të paçin harrue, ka me u ra menjëherë ndër mend për ty e kanë me zhbirilue deri në nën ahër të jetës tande. Sepse libri i ka prekë, se s'kanë mujtë me qëndrue ose se në të gjejnë fëtyrat e tyne të shëmtueme. Atëherë kanë me ia nisë me vjellë gjithë të zezat e kanë me të shqetësue ma keq se kur ishe në birucë. Sepse, more i miri zotni, faji asht jetim e tash në kohë tona po na dalin martirë shi njata, që i çuen martirët tonë në gropë. Për sa kohë veteranët e luftës nacional-çlirimtare të mbessin veteranë, shenjtent tu kanë me mbetë kriminela! E po t'i vrasin madje dy herë: një herë me plumb e herën e dytë me harresë”.

Punë e madhe – i përgjegja fantazmës së dyshimit, që s'më la rahat: – do ta shkruiej librin e do ta botoj. Së paku kam me ua mbyllë gojën kundërshtarëve, që po mërrijnë deri atje sa me shkruie libra për baballarët e tyne kriminela, tue ngatërrue keqas xhelatët me viktimat. E në mos e çilshim gojën, mbasi na ropën së gjalli, kanë me na quejtë edhe kasapë! Tue i shikjue punët simbas interesit të vet, merret vesht e tue ia lanë kështu trashigim së ngratës mori histori. Në mos e lexoftë kush tjetër, le ta lexojnë micat e dacat. Po të siguroj se mbasi ta kenë krye, kanë me u tërbue në një farë feje, sa kanë me i këcye ndër turij me thoj e me dhambë tanë njerëzve që të kalojnë andej pari, tue besue se të gjithë janë shnjërzue, si personazhet e librit të sapo lexuem! Diçka del, pra edhe prej këtij soj lexuesi!

Fantazma u zgërdhi me një zgërdhimje tragjike, e cila ushtoi në hapësinën e dhomës seme, si çekiçi mbi gozhdat që mbyllin një arkivol. U përqetha tue e ndie. Më tha: “Ne, që kemi hyrë atje ku s’ta pret mendja, që kemi regjistruar deklaratat e gruas kundër burrit e të burrit kundër gruas, të atit kundër birit e të birit kundër atit, të ipeshkvit kundër priftit e të besimtarit kundër Zotit, që kemi organizuar rrjetin e gjerë të dëshmitarëve, i cili mbahet përsëri, që i kemi e s’i kemi djegur dosjet, thua s’jemi në gjendje t’i shkruajmë përsëri? E ashtu siç duam ne? Provat i kemi ne, jo juve. Çdo të thuash zotrote, kur ta shikosh emrin tënd në krye të listës, me dëshmi e dëshmitarë krejt të rregullt? Çirru sa të duash. S’do të kesh kurrë forcë të dalësh mbi dokumentin e mbi dëshminë. Njerëzit do të shikojnë shtrembër e do të thonë: Ama, edhe priftërinjtë, në të cilët patëm aq besim të verbër, sa t’u rrëfenin të fshehtat që s’ia rrëfenin askujt, na paskërkan tradhtuar! Kujt t’i besosh, nëse janë shitur edhe ata që i dinin zëvendësin e Krishtit mbi tokë? E ai s’i ka gjuajtur me rrufe për këtë sakrilegj? Kështu do të lindë dyshimi se edhe vetë Krishti ka bashkëpunuar me sigurimin! E, pas gjithë kësaj dalldie të Kishës së pas diktaturës do të kthehemi sërish tek fillimet, tek sulmi mbi kishat që ti na i paske ndërtuar në Mirditë, tek prangat, tek burgimet. Bota është e rrumbullakët e rrotullohet vetëm kur i fryjë unë!” – tha fantazma e dyshimit, e sigurtë në vetvedi.

Ishte një andërr edhe ma e keqe se andrrat e birucës! Fantazma kishte të drejtë. Ajo, bijë e djallit, asht zojë e situatës e na, të pafuqishëm për ta zhdukë prej faqes së dheut! E do të vazhdojë me kenë kështu, derisa të dahan një herë e përgjithmonë delet prej dhive e gruni prej egjret. Ma së parit në një gjyq të drejtë njerëzor, mandej...

Ishte vetëm një ças blasfem dyshimi ky. Një ças tundimi e mëkati. M'u kujtuen ezorçistat e tundimi m'u davarit: fantazma e dyshimit nuk ka me mujtë kurrë me e përballue Kryqin! E shtrëngova pra kryqin tem (jo atë prej metali që kam në kolet⁵³ të xhaketës) e e ndjeva vedin ma të fortë se Davidi profet armatosë me bahre.⁵⁴ Fantazma e dyshimit u zhduk tue fishkëllue si lugati e tue lanë mbrapa erën e vet të qelbun. Ndeza një qiri dylli në elterin e vogël të dhomës seme të vorfën e qelbësina u zhduk, për t'u përhapë era e kandshme e fashojve. Zoti din gjithçka. Më ngushëllon shpresa se së paku në Gjyqin e mbramë do të hapen edhe dosjet e djeguna e të padjeguna të sigurimit! E do të vehen njësoj në kandarin e amshuem e do të dalë ma në fund e vërteta në shesh. Në qoftë se Zoti nuk asht mërzitë pak si tepër prej paudhësive të njerëzve e të gjitha epokave e të gjitha vendeve! E prej një turre kolosale me dosje spijunlleku që ka shkruar njeriu për njeriun, tue pasë një qëllim të vetëm: me ia hangër rrashtën!



⁵³ Prej ita. *colletto*: qafëz, jakë.

⁵⁴ *Bahe, hobe.*

Arrestimi qoftë i fundit...

Në Janar 1990 në Shkodër dikush filloi me i fry me dy bulshijtë prushit të lirisë, gjysë të mbuluem me hinin e harresës. Dikush i ngarkuem me detyra e dikush në marrinë e vet, shfrenue prej 50 vjet salvimi. Në marrinë teme edhe unë ndjeva tue m'u ngjallë në zemër një shpresë e madhe me thanë Meshë në publik. Vetëm kështu mund t'i fryjshe edhe unë prushit të lirisë e ta kthejshe në një flakë të pastër, që djeg e ndrit si qiri në elter. Kjo, po ishte detyra eme! Detyrë që tashma kisha fillue me e krye gati publikisht, në shtëpinë teme, rrethue prej spiujve. Përveç atyne që i kishin dhanë arsenikun vëllaut tem, Dom Lazrit, caktue si specialist në ndjekjen e Jubanëve, kishte edhe të tjerë, që ndërroheshin ditë-natë mbas deret e që kojshitë i njëfshin, sepse rrijshin si hu gardhit para shtëpisë seme.

Zaten kjo ishte veprimtaria kryesore e shtetit komunist, e prej këndej shprehja popullore: “Kur s’ke punë, luej derën” u modifikue në “Kur s’ke punë, ruej derën”. Gjithsesi katolikët e vërtetë nuk kishin frikë me më ardhë në shtëpi, sidomos kur ndigjuen Zanin e Amerikës, që lajmëroi lirimimin tem. Ata shifshin rregullisht Meshë në shtëpitë e meshtarëve të tjerë e te unë vijshin me ndërrue prift, me ndigjue një za të ri e me pa një fëtyrë të re, që delte si prej vorrit, mbas 26 vjet burgimi. Në kohën e terrorit, prania e meshtarit asht një forcë e jashtëzakonshme, edhe nëse nuk flet. Madje, sa ma pak të flasë me fjalë e sa ma

shumë të flasë me shembull, aq ma bindës bahet. Shqiptari, s'kishte aq shumë nevojë për receta e formula, sa për shembull, për ngushëllim, që t'epte forcë, guxim me vijue vozitjen në atë kënetë të qelbun, në të cilën e kishte kthye komunizmi Shqipninë.

Natyrisht unë thashë dy-tri Meshë në ditë, mbarështojsh sakramendet, sa herë më kërkohet, gjithnjë nën vëzhgimin e imtë të "ëngjujve të zinj të rojës së sigurimit", që më fluturojshin mbi krye si lakuriqa natet kudo lëvizshe. Madje vijshin edhe me pa Meshë. Njifeshin menjëherë, sepse impresionoheshin, ngatërrojshin fjalët; shtiheshin si katolikë të flakët, po s'dijshin me ba kryq as me thanë ma të voglën uratë.

Ndërkaq satelitët e Kremlinit një nga një merrshin urdhën prej Moske me fillue politikën e decentralizimit: u shtuen arratisjet, po familjet nuk internoheshin ma; njerëzit flitshin haptas, e nuk veheshin ma ndër pranga; radiostacionet perëndimore ndiheshin në të katër anët, e nuk trokiste kush te dera me hekurat gati; kooperativistët filluen mos me dalë ma në punë e me vjedhë gjithnjë ma shumë, e askush nuk merrte masa kundër tyne. Po na vinte, pra mes nesh liria: këtë fëtyrë kishte liria, që aq shumë e kishim pritë. Fëtyrën e anarkisë së organizueme nga vetë shteti, që kishte ndërrue taktikën, në pritje për t'u duke përsëri në skenë me dhambë e me thoj të mprehun!

Por popullsisë, ushqye me psikozën shekullore të skllavit, nuk i bahej me besue. E në këtë fillesë të pashembullt anarkie, ndërmjet turmave të shfrenueme, unë vijova atë veprimtari, së cilës ia kam kushtue me bindje të patundshme, jetën. Kalojshe përditë rrugëve tue përcjellë të dekunt në vorrezë. Më printe një fëmijë me kryq në dorë, si

motit. Drejt vorrezës, veshë me tesha meshe, me ujë të bekuem e me ritual në dorë, ndiejshe katolikët anë rrugës që thojshin: “Shife këtë, trimin e çartun!” e bajshin kryq; ndërsa myslimanët shtojshin: “Katolikët kanë fe; kanë kler; shife priftin me petka meshe midis të pjacës tue përcjellë gjenazen”.

Kjo ishte atmosfera që parapërgatiti zhguljen e Stalinit prej qendrës së qytetit bashkë me hedhjen në pleh të katërqind mijë triskave të partisë.

Po fundi nuk kishte ardhë ende, nuk ka ardhë as sot e kësaj dite.

Tirana, që ndërronte orë e ças dha urdhën me i arrestue ata që kishin çue krye. Ndonjë qyqar, i cili kishte veprue në mende të vet, e hangri keqas. Ndër të parët që u arrestuen përsëri pata nderin me kenë edhe vetë, ndonëse nuk kisha marrë pjesë në asnjë turbullim, jo prej frike, po prej urtie, sepse i urti kurrë nuk ngutet, prej burrnisë, jo prej tutet.

Një ditë të bukur Kallndori të vjetës 1990, nësa po u epshe mësim katekizmi nga 10 fëmijëve, një autobus i gjatë u ndal kund 20 metra larg shtëpisë sime. Ndërkaq te dera vijonte me ruejtë ai që gjindja tashma e kishin pagëzue me emnin “spijuni i Dom Simonit”. Qyqarit, i kishte ardhë shpirti në majë të hundës, i ngarkuem, siç ishte, me detyrën me zbulue të pazbulueshmen, don me thanë veprimtarinë teme anmiqësore, që përmbledhej e tana në mesazhin ma paqësor e ma njerëzor që ka pa ndonjë herë kjo botë: në flijimin eukaristik, simbol i dashtënisë ma të përkryeme; i asaj që ka Zoti për njeriun. Po a mund ta kuptojshin këtë sambistat, edukue e stërvitë në përngjasim të shtazës me fëtyrë njeriu? Tre prej tyre hynë me turr në ahrin ku po

punojshe me fëmijët, që kishin ndie thirrjen e Zotit për rrugën e meshtarisë. Më përsëritën me kërcënim atë shprehje që e kisha ndie atë herë: “Në emën të popullit, je i arrestuem!” Në emën të popullit të ngratë, që strukej prej tmerrit të këtyne njerëzve ndër skutat ma të mshehta të vetvedit. Në emën të popullit, që s’kishte emën! Fëmijët e shkretë, që më rrethojshin, pa llogaritë këtu familjarët, u shtangën. Patën kujtue, rrezikzeptë, se terrori kishte marrë fund... Po mue s’më luejti as qerpiku. Isha mësue kaherë e mot me këta çakaj. U dhashë, pra qetësisht, përgjegjen e vetme të saktë që mund t’i epej situatës: “O, jo unë e kam krye kahmot detyrën e të burgosunit, tashti e ka rradhën Ramiz Alija juej, që e ka shitë vendin te serbët, te sovjetikët, te kinezët e po përgatitet me e shitë te amerikanët, sepse ka ndërrue taktikë ee...”, s’më lan me mbarue fjalën. M’u hodhën në fyt si dikur e ma keq se dikur, sepse tashti ishin kthye në forca moderne dhune. Ishin kriminelë me shkollë. M’i lidhën duert mbrapa, tue m’i shtrëngue deri në koc. Ndjeva përsëri shijen e idhtë të zehrit, të njëjtën shije që pat ndie Krishti në kryq, kur pat et e ia shuen me tamth. Më ngrehën rrëshanë deri te autobusi, tue ma mbyllë gojën me duert e tyne të fliqta, sepse sa herë majshe me e çilë gojën teme të shkretë pa dhambë, bërtitshe në kupë të qiellës: “Pjella të ndyta të Enver Hoxhës, e keni rradhën ju për pranga!” Nuk e mohoj se ndoshta gabova e se nuk mërrija me ia përngja fare Krishtit në kryq, ndonëse po rrëshahesha pikërisht si bir besnik i Krygjës. Nuk mujta, pra, me u thanë butësisht, siç ma lyppte rangi e petku: “Fali, o Zot, se s’dijnë çka bajnë!” Ndoshta edhe pse m’u duk se ata e dijsin mirëfilli se çka po bajshin. Mëkat tjetër ky, për të cilin Zoti më ka ndëshkue me të drejtë, tue mos ma plotësue dishirin

me dekë martir. Kështu, herë me gojë mbyllë e herë tue vikatë, për qejfin e madh të kojshive, sepse njerëzve të marrë gjithmonë u kanë pëlqye ma shumë ata që vikasin sesa ata që heshtojnë, më flakuen në autobusin, që për mos me ra tepër në sy, zëvendësonte gazin e degës, e mbyllën dyert. Atëherë ia filluen me zell e qejf zanatit të moçëm të kasapit: më rrëzuen në dysHEME e më hynë në shtjelma, aq sa më ra të fikët. Kështu ia mërrijtën ma në fund me ma mbyllë gojën. Më shkarkuen në degë. Isha i gatshëm për këtë soj shkarkimi, me petka në shtat, me shkop e strajcë në dorë – si thotë Ungjilli për apostujt e Krishtit. Në të vërtetë, rrijshe ditë-natë i veshun me tesha të trasha, sepse e pritshe orë e ças kthimin ndër birucat e acarta. Sikurse e pres edhe sot. Më lanë në kambë në fund të korridorit me pritë mërrijtjen e të tjerëve. Atë ditë në Shkodër lëvizshin pa pushim makinat e degës, tue shkarkue të arrestuem mbas të arrestuemësh, të cilët mesa duket dojshin me i nisë për Tiranë. Ia behën ndërkaq të gjithë nëpunësit e degës, ofciera e nënofciera. Nësa kalojshin, të gjithë më epshin si dhuratë o një pështymë, o një grusht turijve o një shtjelm. Ishin dhuratat e fundit që nxirrte pushteti popullor prej thesarit të vet të torturave. Shyqyr që tashma m’i kishin thye tanë dhambët, madje isha aq i tronditun, sa gati-gati s’i ndiejshe aspak grushtat e as shtjelmat. E kur isha ba krejt i pandieshëm, m’u afrue ma i djallëzuemi prej tyne, një ofcier vocrrak, e më vuni te hunda një medaljon të Zojës së Bekueme, rreth të cilit ishte shkruar: “Ave Maria”. Ai nuk më pështyu. Përkundra, më ftoi mue me pështy. “Pështyje – më tha tue ma afrue medalionin – pështyje, e po të liroj menjëherë!” Skenë makabre që përsëritej e përsëritej pa fund në historinë e njerëzimit, ndër vise e ndër kohë. Sa

herë u kishin kërkuë martirëve me shkelë a me pështy Kryqin, Virgjinën a simbole të tjera shenjte të idealeve të tyre! Iu përgjegja: “E pse me e pështy? Nuk asht Zoja ajo që po më torturon, por ti e shqiptarët tjerë si ti, vëllazënt e mi, që po më torturoni prej një gjysë shekulli vetëm pse unë nuk due, çka doni ju: don me thanë nuk due Tito as Stalina as Maoceduna, prandej po të qëlluen përdoresh këta që përmenda, bjeri shpejt e shpejt se po t’i pështyj me gjithë qejf, tue shpresue se më ka mbetë sadopak pështymë për ta në gojën që m’asht tha e shkrumbue”. Atëherë edhe ai, i tërbuem, më dha racionin e vet të grushtave, të shtjelmave e të pështymës.

Mbas pak me morën rrëshanë dhe e ndjeva vedin në një taksi, ndërmjet dy sambistash, me hekura të shtrënguem fort mbi plagët e vjetra e me fëtyrën përjargë prej pështymëve të tyre, që më kullojshin prej ballit, syve, buzëve e s’mujshe me i fshi, se s’kisha duer! Gjithsesi, çka më mundonte ma shumë, ishte vendi i ngushtë: sambistat shtrëngoheshin mbas meje e unë ndiejshe një shqetësim të padurueshëm nga kontakti me trupën e tyre. Më mungonte vetëm kunora me ferra në krye, për me më thanë: “Ecce Homo!”

Sambistat filluen muhabete sporti, tue e dijtë të kaluemen teme sportive. Besojshin se s’do ta përmbajshe vedin e do të fillojshe biseda me ta. Në këtë dishirë, ndoshta kishte diçka nga prirja e kryetarit të degës së Burrelit, i cili kur donte me e sha qeverinë, tue mos mujtë me e ba vetë, vinte drejt e në birucë teme e më ngucte e u kënaqte tue ndie talljet që i bajshe qeverisë tribale të Tiranës e edhe atij vetë. Herë i thojsh: “Sot po më dukesh si kinez; herë tjetër – sot ke krejt pamjen e sovjetikut... e tjetër herë – dukesh sot si shkja i gjallë, sepse të gjithë kanë lanë vulën e vet në

filozofinë tande, me një fjalë shqipe, në turinin tand!” Në të vërtetë më pëlqente kur vijshin te unë me ndigjue shamje kundër pushtetit, sepse e dijshe mirë se edhe këta ndryjshin shumë helm mbas uniformave prej skllavi. Më kallëxonte Abdullah Sollaku i mirë për Shkëlxen Bajraktarin se kur ishin shokë në universitet, ai s’lente gja pa thanë kundër Enver Hoxhës, por mandej, për një copë bukë, torturonte të arrestuemit gjatë hetuesisë. S’e kishte për gja, kriminelin, me vra një njeri, vetëm për me fitue një pikë ma shumë para syve të eprorëve të vet, të cilët i urrente e do t’i vriste me të njëjtin mllef, në mos ma keqas, nëse do t’i bijshin në dorë. Me këto mendime në krye, nuk e ndjeva edhe aq fort dhimbjen e hekurave, që vijoshin me u ngulë në mish, shi aty ku ishin plagët e vjetra të përthame, që më kishin lanë për vjet e vjet të njëjtat hekura. Por kur m’i hoqën, njaty kah ora dy mbas mesnate, në një prej birucave të burgut të Tiranës, e ndjeva me tanë tmerrin e vet dhimbjen. Aq ma tepër sepse mërritja në birucë ishte po aq triumfale, sa të gjitha hymjet e mia historike: don me thanë, s’pata nevojë me i dhanë fort vedit që ta kapërcejshe atë prak aq të njoftun, sepse më erdh në ndihmë polici, tue ma dhanë një shtjelm të tmerrshëm nën vedit, për ta shpejtue mërritjen teme në atë hotel pa pare, pa dyshek, pa dritë, që po ma dhuronte, për me hjekë mallin, qeveria në hjekashpirt.

“Kolonel” e quejshin hetuesat liliputa kryehetuesin e tyne nga Vlona, të cilit i shkojshin bisht mbrapa gjithë servilizëm. Hetuesi, ashtu si hetuesia, s’kishte pikë ndryshimi prej të gjitha seancave të moçme, me të njëjtat pyetje e të njëjtat përgjigje, të cilat janë tfillue fill e për pe ma nalt. Natyrisht, përveç torturave, sepse këtyne hjenave s’ua mbante ma me gërrye ndër kufomat tona. E gjithnjë në

mënyrë të natyrshme, mue s'më mbeti aspak hatri që lashë aty ndonjë thue a ndonjë copë mish, si ushqim për ta. Sidoqoftë ky kje arrestimi ma i shkurtë. Nuk beta gjatë në birucë: kështu, më 17 Janar 1990, u zhvillue hetuesia eme e njëmbëdhjetë, që nuk zgjati ma shumë se 24 orë. Mbas saj më nisën menjëherë në Shkodër, prej frike se mos bante tepër bujë arrestimi em i njëmbëdhjetë, menjëherë mbas lirimt.

Ndërkaq rreth meje vijonte çthurja e organizueme, me përmasa që nuk janë pa kurrë në histori. Populli, i shnjerrëzue deri ndër rrajë të shpirtit, vidhte gjithçka: pritëte pyjet, zhgulte telat e telefonit, barte shinat e hekurudhës, rrafshonte çka kishte mujtë me ndërtue ai vetë, me djersën e vet, nën kamxhikun e diktaturës, tue ba kinse punonte, ndërsa qeveria bante kinse e paguente. Prandej populli i urrente frytet e punës së vet, që nuk kishin kenë kurrë të tijat, sepse gjithçka kishte krijuë shkonte me mbarue në pus të pafund, don me thanë ndër vilat e skllavopronarëve në Shqipni e nëpër botë e ndër marrinat tjera të pandigjueme ndonjëherë, që pillte mendja e tyne e sëmuet: qysh prej bunkerave qesharakë, që do të na mbrojshin prej fantazmave, ndër xhepat e miqve të partisë nëpër botë, aventuriera me një arën⁵⁵ lidhë nën grykë, pantallonat me gjyslykë, që ia hajshin qenit e ia pijshin qenit e i bijshin karadyzenit mbi shpinë të këtij populli të shkretë. Sepse idetë e partisë së punës, duhet të ishin e ardhmja e botës. Mbarë bota duhet të gëzonte, si na. E sa do të kisha dishirë të gëzonte kështu, së paku për ndonjë vjetë, kjo botë

⁵⁵ Ose *arnë*, përdorë simbas ortoepikës/-grafisë shkodrane, ku *e*-ja pazane zgjatë zanoren paraprîse nësa: *ārn*.

e trashë, tashti që e kam njoftë për afër. Sepse nuk e ka kuptue e aq ma pak e ka mësue mësimin e historisë, që i asht shpjegue aq konkretisht në auditorin vigan të Europës lindore. Turp për botën që na e patën quejtë e dijtë të lirë, por që paska mbetë edhe sot e kësaj dite, kurvë e motit!

Populli harronte se kur zhgulë linjën e telefonit, s'ke ma ti vetë mundësi me u marrë vesht me kend në rasë nevoje, se kur çon në shtëpi tande shinat, për me ba me to tanda e me kalue jetën dejshëm, s'do të kesh ma tren për vedi; se mbasi të presësh pyjet, do të merret ty vetë fryma në verat e përvëlueme. Populli, të cilit ia kishin grabitë gjanë e vet, tue u mundue me e edukue me gjanë e përbashkët, don me thanë të askujt, s'donte me e ndje fjalën pronë kolektive, madje e urrente. E tashti, si bubreccë e mirë, po mundohej me bajtë në birucë të vet gjithçka mendonte se i ishte marrë padrejtësisht. E si e mbushi birucën përplot, iu neverit edhe ajo. Pse – tha, tanë jetën në birucë do të jetoj? Atëherë erdhi ora e zezë e harakirit: shqiptarët u derdhën në perëndim, si zorrët e shpërthiquna prej një barku të çamë, e vijnë në derdhen, tue e lanë vendin e vet me një zgavërr të hatashme barku, që i ka bjerrë të gjitha përmbrendcat.

Ndërkaq, tashma i lirë, unë vijojshe shërbimet fetare, pa marrë pjesë kurrë ndër xhullurdina, si disa rrezikzezë që shkuen si qeni në rrush. Njata që kryesojshin lëvizjen, flitshin zi e ma zi për Pjetër Arbënorin dhe ushtarët tjerë besnikë të policisë sekrete, që po u ngjiteshin me shpejtësi të çuditshme shkallëve të nalta të të ashtuquejtunës politikë e re, së cilës Komiteti Qendror i kishte ngarkue si detyrë kryesore me ia mbushë mendjen popullit se komunizmi po merrte fund e po fillonte epoka e re e demokracisë.

Demokracia e re, veshë me kostumin e vjetër të komunizmit, arnohej aty-këtu me ndonjë spiju birucash.

Po, të kthehemi mbrapa, për me i kuptue ma mirë ngjarjet që tregova ma sipër e ato që do t'i stërholloj ma poshtë: Më 1 Nanduer 1990, kryeministri i asokohshëm, Adil Çarçani, erdh në Shkodrën gjithmonë të pabindun e prandej gjithherë të ndëshkueme, për me ia mbushë mendën popullit se agimi i bardhë i demokracisë po dukej në horizont. Mblodhi komunistat, të cilët ishin të ngarkuem me përgatitë popullin për ndryshimet që do të ndodhshin gradualisht, gjithmonë nën drejtimin e Komitetit Qendror e në disa sektorë, që nuk i cenojshin aspak karrikat e tribusë. Kishin vendosë, për shembull, ta lejshin të lirë fenë, të pushohej lufta e egër kundër saj dhe të merreshin masa të moderueme kundër shfaqjeve fetare. Ishte shi koha! Sepse tashma kishte mbetë në kambë vetëm një grusht meshtarësh e murgeshash, krejtësisht të shkatërruem fizikisht, ndonëse të patundun moralisht, të cilët vështirë se do t'ia delshin me lidhë nenin e këputun me shpatën e Damokleut e me i rikthye Kishës fëtyrën e parë, shkëlqimin e parë. Kisha, që do të rilindte, do të merrte shumë shpejt fëtyrën e asaj që vijon ta quejë vedin demokraci: në rradhët e para të kremtimeve të saj do të dukeshin gjithnjë ma shpesh Juda e Pilati, të paraqitun para popullit si autoritetet ma të nalta civile të vendit.

U vendos pra, të shpallej, në një farë mënyre, liria fetare. Po kjo nuk u pëlqeu aspak komunistave, sepse ishin prishë me popullin e deri me familjarët e vet, tue pengue veprimtaritë fetare. Kishin shkue aq thellë, sa me zhgulë deri kryqat mbi vorret e të parëve të tyne besimtarë të cilët, të gjithë, ishin nisë për në atë botë tue marrë ma parë shujtën

e shtegtimit që çon drejt amshimit: Vojimin shenjt. Mandej shpesh kishin paditë e demaskue ata që nuk kishin pranue me ba poshtërsi kësisoji. Kishin ndjellë mbi vedi mëninë e amshueme hyjnore, për me ua ba qejfin idhujve kalimtarë. Çka me ba tashti? Veç me u zhburruen edhe ma keq, tue dalë me predikue lirinë e fesë! Gjithsesi shqetësimi u kaloi shpejt e shpejt. Punë e madhe! Mos ishte hera e parë që po ndërrojshin bajrak? Thue ishte hera e parë që ndërrojshin kostum? A s'kishin sha njëqind herë atë që ma parë e kishin lavdue? E mandej kishin lavdue shi atë që e kishin sha? Një herë ma shumë, një herë ma pak, s'çonte kandar. Madje filloi me u pëlqye ideja e ndërrimit të kostumit lindor, vjetruen kahmot, me një kostum të ri perëndimor, i cili nga Moska e Pekini rjepacuk, do t'i çonte drejt Parisit, Londrës, Washingtonit... në fund të fundit, po kthehshin në zanafillë: sepse deri më 1944 me kostum perëndimor kje mundue me veshë Shqipnia, tue hjekë fesin tonuz të turkut, me tufë të madhe; por pa u mësue ende mirë me të, e detyruen ta ndërronte kapelën me kopicë e të veshej me kostum jugosllav, që e mbajti në shtat deri në vitin 1948, kur e deklaroi tashma të vjetruem; veshi atëherë kostumin sovjetik, sllav e edhe ky, e vuni në krye kokoren që e mbajti xetë deri në vitin 1960, kur i hyni teja e iu hapën bukur do bira; atëherë, ai s'mujti me durue “dimnin e vetmisë së madhe”, që sillte erna të acarta nga Moska, ngau me veshë kostumin kinez, tue marrë para syve të Botës perëndimore, së cilës i përkiste, pamjen e Arlekinit. Vuni pra në krye kasketën aziatike të Mao Ce Dunit, mbërtheu pullat deri në mjekërr, e me këtë kostum për bind, shtyu deri më 1978, kur edhe ky u ba zhele-zhele e s'duel ma kush me i dhurue një palë tesha të reja që t'i shkojshin për shtat. Kështu stofa

kineze ra copa-copa e shokët e partisë mbetën krejt lakuriq me iu dhimbtë gurit e drunit. Deri në ardhjen e ndihmave ndërkombëtare të emergjencës, që i prunë një kostum, lanë prej babagjyshit të Europës, dekë kaheër e mot. Europeanët, tue drashtë se po i shtje tejën ndër kostumet e tyne moderne, e hoqën qafe e ia falën shokëve në fjalë: si ndihmë humanitare. Sidoqoftë, mbetën një copë herë picak! E në këtë lakuriqësi të frikëshme, të gjithë e kuptuen se idealet, ndërgjegjja kombëtare politike, europiane e qytetare në këtë vend, kishin kenë gjithmonë vetëm dokrra në hi. Me një fjalë shqipe, kishin kenë tana rrena. Prandej ka të drejtë populli i Shkodrës së martirizueme që ka vu e ven mbi gjithçka Zotin, sepse Zoti nuk ndryshon: mëshira e dashtënia e tij janë të amshueme. E Zot e komb ecin krah për krah!

Merre me mend, pra çka ndodhi, kur populli mori vesht se vetë qeveria po donte me e lanë të lirë fenë. Për të, ku ishte shpirti i Zotit, aty ishte liria. Po vinte me të vërtetë liria pra. I shkreti popull! I kande me u rrejtë e me rrejtë! E xjerr rrenën e vet në Pazar e kur e ndigjon po atë rrenë nësa zdrypë në qytet, i beson menjëherë. U përhap, pra në Shkodër një thashethemnaje që s'ishte ndie prej kohe. Erdhën e t'u pështjelluen fjalët në një lamsh të ngatërruem, fija e të cilit mund të gjindej vetëm tue përmendë së pari emnin e Adil Çaranit, i cili paska pasë thanë në mbledhje me komunistat: "Myslimanët, le ta hapin xhaminë e plumbit (paçka se s'ka plumb, sepse e kanë vjedhur); ortodoksët të ngrenë një kishë në Vrakë, aty ku është një magazinë e vjetër, e katolikët të meshojnë në kapelën e vorrezave të vjetra të Rrëmajit".

Mesha e parë

Ishte nanduer, moji i të dekunve. Vorret e vjetra katolike vijoishin të dhunoheshin. Prej rrasave të thyeme dukeshin rrashat e të dekunve. Ditën për diell njerëzit hyjshin e delshin prej gropave të hatshme, ku dikur hynte për vizitë vetëm deka. Kujtoishin se janë miniera florini. E si kontrolloishin një copë herë, pa drashtë Zot as njeri, në rasën ma të mirë delshin prej andej me medaliona, sahata të stërmoçëm e unaza arit, në rasën ma të keqe, me ndonjë palë dhambë e me ndonjë kllef arit. E filloishin me kafshue njeni-tjetrin me dhambët e të dekunve! Në prag të një veprimtarie të tillë, biografia e të dekunit studiohej me të njëjtin kujdes, që tregonte partia për biografinë e të gjallëve. Tue mos i kushtue aq vëmendje opinioneve politike, natyrisht, të cilat ishin avullue bashkë me trutë e me zemrën. Por mbetej një tregues i dorës së parë; origjina familjare e mosha! Sepse në Shkodër pasanikët e të rinjtë vorroheshin me stolitë ma të dashtuna, që kishin pasë nësa ishin gjallë. E si delshin prej andej hjenat njerëzore, hyjshin qejt. Ai që sodiste grykën e ndonji vorri të zbuluem, ndinte krismën e kocave, që theheshin prej qejve, të cilët dëfreheshin gjithë ditën në atë parriz kocijsh. Gjysa e kryqave e e fotografive ishin thye kahmot; emnat ishin përgjysë të shlyem. Gjithë kjo – nën selvijat shekullore e çinarët vigaj, gjethimi i të cilëve përqethej prej këtyne pamjeve të papame kurrë. Sapo hyjshe në derën e vorrezës e bajshe hapin e parë në rrugicën e ngushtë mes selvive, të binte menjëherë në sy kapela, me pullazin e shembun, me trenët e djegun e të vithisun, me

façatën e gërryeme prej kohës, që memzi rrinte në kambë. Dukej si një i dekun i pavorruem. Pranvera e mëshirshme mundohej me e zbutë sadopak këtë shëmtim: e stoliste vorrezën e vjetër me vjollca e drandofille, i veshte muret e kapelës me bimë kacavarëse. Edhe dimni mundohej me e mshehë shëmtimin nën jorganin e trashë të borës. E të dekunt vijoishin me fjetë pa ba kurrfarë kundërshtimi kundër dhunës që ushtrohej mbi vorret e tyne, thjesht sepse komunistat drojshin se çohen me ua marrë pushtetin. Prandej ua thjeshin rrashtat e dekuna, i bajshin me dekë rishtas, që të ktheheshin në hi e pluhun, me emën e me eshtën. Të dekunt, që s'mujshin me i trembë hjenat, tue qitë prej rrasës së thyeme një sy a një dorë, sepse kalbë kahmot, çuditeshin se si nuk lëvizshin sadopak të gjallët, që gjithsesi dukeshin shpesh në vorrezën e vjetër: me kja për të gjallë e për të dekun. Sidomos në ditët e ndriçue nga dielli i ambël i nandorit, kur vijshin me pastrue barin, që harlisej si në xhungël mbi kufomat e tyne, me ndezë qira e kandila, për prehje të shpirtënve të tyne, të cilët në atë gjendje që ishin katandisë, nuk mund të gjeshin paqe as pushim. Atëherë vorreza e vjetër merrte një pamje fantazmagorike. Selvitë naltoheshin drejt qiellit me majet e tyne të mprehta, si flakë të blerta. Nën to fafiteshin qinda flakëza e puhia lonte me mija petale lulesh. Tiparet e të dekunve, ngurrosë kahmot ndër fotografitë e fundit, dukej sikur lëvizshin, sikur dojshin me u ringjallë, me dalë, me ia kthye rishtas shkëlqimin Shkodrës, që bashkë me brezninë e para pushtimit komunist, po bierte dalëngadalë të gjitha tiparet e veta, tue zdrypë në vorr bashkë me të dekunt e vet. Të gjallët mbaheshin, me shpresën se Zoti vonon, por s'harron.

Me 4 Nanduer 1990, në orën 9 paradite, po vjen në shtëpinë teme shoferi i ambulancës, Mark Murana. I çuditshëm edhe mbiemni i tij, si i sajuem apostafat për atë ditë. Burri me këtë mbiemën, që më kujtonte shauretënt, më tha se disa njerëz, mbledhë në vorrezë me pastrue vorret e të dashtunve, dojshin me pa Meshë e e kishin çue me më thirrë mue, sepse isha meshtari që e kishte shtëpinë ma afër. E unë, që memzi ç'pres me ia hy aventurave shenjte, tue shpresue se askush nuk do të guxonte me më thanë gja, për shkak të fjalëve, të cilat tashma kishin marrë dhenë, i lashë katekumentët⁵⁶ që më rrethojshin e bana gati me ngut valixhen me të gjitha orenditë e Meshës. S'kisha paramente, por do të mjaftohesha vetëm më stolën. Në dy minuta isha gati. Dola e u nisa me Markun e do të tjerë që më pritshin mbas dere. Edhe kësaj herë Zoti kishte zgjedhë për një punë kaq të madhe, njeriun ma të përvujtë e ma të pamerita! Natyrisht frika ka le para trimnisë. Prandej ai pak popull që ishte mbledhë në vorreza, vetëm më përshëndeti, pa më folë fare, tue vijue me goditë vorret e familjarëve të vet. Kështu, në rasë rrezikut, do të thoshin se jo vetëm që nuk më kishin thirrë, por as s'më kishin pa tue hy mbrendë. Unë shkova drejt vendit ku dikur kishte kenë elteri, shi aty ku vendosej arkivoli, i cili mbas shërbimit të fundit fetar, mbyllej përfundimisht, tue shpërnda në vorrezë jehonën e hatashme të gozhdave që nguleshin mbi të dekunin. Ishte një ças i fuqishëm meditimi. U ndala mbi grumbullin e plehnave e

⁵⁶ Prej gr. *κατηχούμενος*, e mbrapa nga lat. e vonë *catechumēnus*: instruksionet e nevojshme për me përgatitë dikënd për pagëzim. Në këtë rast, udhëzime katekistike.

prita; Marku u kthye sakaq prej shtëpisë së tij, që e kishte aty afër, me një tavolinë të vogël në dorë.

Ishte ky elteri i parë që ngrihej në Shqipni mbas rrenimit të madh: ngrihej mbi lutjet e popullit e të shpirtënve të purgatorëve, mbi lotët e të munduemëve e mbi djersën e të pashpërblyemëve, mbi gjakun e martirëve e mbi vuetjtet e papërshtueshme të të zhdukunve e të atyne që kishin mbetë gjallë e për gazep. Pranë atij elteri të jashtëzakonshëm, përgatitesha për Flijimin Eukaristik, pa mendue kurrë tjetër, veç atij që do të përfaqësojshe në elter. Ai elter ishte vendosë në një kapelë të djegun e të dhunueme, ajo kapelë, në Shkodrën e martirizuese; ajo Shkodër në Shqipninë e gjakosun, të rrethueme me tela me gjemba; ajo Shqipni në Europë; ajo Europë, në botën e lirë, e cila nuk do ta lejonte ma klikën e Tiranës me çue krye. Gjithsesi, isha ballë për ballë me antikrishtin! Ia fillova me një parathanje të shkurtë, tue i ba thirrje popullit t'u lutej shpirtënve të purgatorëve me na ndihmue për ta mposhtë përfundimisht këtë antikrisht dhe fillova Meshën latinisht me një Mesalin doracak, që kishte pështue gjatë kontrolleve të panumërta të komunistave në shtëpinë e dy meshtarëve. Dalëngadalë turma rreth elterit u dendësue, sepse në vorrezë vijojsnin me ardhë njerëz të tjerë për me rregullue vorret e të dashtunve të dekun, në atë muej që u ishte kushtue. Natyrisht ishin ma shumë gra e fëmijë. Burrat kishin frikë se hupshin punën, e me të bukën. Po atë ditë pashë edhe burra rreth atij elteri, ku kremtohej Mesha e shenjtë mbas 24 vjet heshtje. Lajmi do të merrte dhenë menjëherë!

Mesha e parë, në madhësinë e vet, mbet një fakt i izoluem në mendën e në zemrën e të gjithë atyne që patën fatin të takoheshin të parët me Krishtin e kthyem rishtas në

tokat tona. Së pari, sepse e dijshin mirë që Krishti nuk ndërron e as s'trathton; së dyti, se nuk pat ma asnjë ngjarje të madhe që të ngjallte aq shpresa; e së treti, sepse s'u ka mbetë tjetër andërr, veç me pritë dritën e lume kur ta lanë përgjithmonë Shqipninë, jo për me punue si skllavë në perëndim, që i tradhtoi ma keq se komunistat, por për me gëzue lirinë e vërtetë, çlirue prej peshës së trunit të tyne të turbulluem keqas, që zor se kullohet për këtë jetë.

Ishte kjo Meshë preludi i Meshës solemne të 11 Nandorit, prej së cilës po kujtoj këtu vetëm homelinë e mbajtun me atë rasë e mandej, në përkujtim të pesëvjetorit e të dhetëvjetorit të kësaj ngjarje të madhe. Asaj i kam kushtue një libër më vedi, që tashma ka dalë nga shtypshkronja shqiptare edhe ma i sakatuem, se autori kur doli prej burgut. E prandej, për mos me e përsëritë gabimin, këtë libër të ri vendosa me e shtypë në shtëpi botuese të huej.



Tri homeli ndërmjet qindave

Mendova me rradhitë ndërmjet këtyne kujtimeve, tri homeli – ndërmjet qindave, mbajtë nëpër botë e nëpër ndryshime, gjatë të cilave vetëm një gja nuk ka ndryshue: Ungjilli i Krishtit.

E para asht homelia e shpresës, e dyta – e humbjes së shpresës, e treta – e bindjes se drejtësia do të ngadhënjejë vetëm në Gjqin e mbramë, përderisa në harkun e dhetë vjetëve nuk asht vërejtë as shenji ma i zbetë i zbatimit të saj. E ku nuk ka drejtësi, nuk ka paqë. Ku nuk ka drejtësi, nuk ka shpresë. Ku nuk ka drejtësi, nuk ka besim në klasën politike e në asnjë forcë tjetër. Por njeriu nuk mund të rrnojë pa paqë, pa shpresë e pa besim. Atëherë s'i mbetet tjetër, veçse të çojë sytë kah qielli e të kërkojë gjykimin e atij që e ka krijue! T'i lutet ta shpejtojë paksa Gjqin e mbramë! Të paktën për ato troje që quhen Shqipni!

Homelia e Meshës së parë: predikimi i shpresës së madhe.

Shkodër, 11. 09. 1990.

Vëllazën e motra

Le t'i kujtojmë për një minutë në heshtje të gjithë këta të dekun që kemi ndër vorreza dhe të gjithë ata vëllazën e motra tona, që ranë për një Shqipni Europiane gjatë këtyne 46 vjetëve të shkueme.

Në vjetën 1443, kur Heroi ynë Kombëtar, Gjergj Kastrioti u arratis prej Stambollit dhe u kthye në Atdhe, e

përsëhëndeti popullin shqiptar me këto fjalë: “Lirinë nuk jua solla unë, por e gjeta midis jush”.

Unë, i padejë për këtë mision, po ju thom se fenë nuk jua pruna unë, por e gjeta të ndezun në zemrat tueja.

Se kjo fe ka kenë gjithmonë e flakët ndër zemrat tona e dishmon ardhja juej sot në këtë vend të shenjtë prej të katër anëve të Shqipnisë, për me e adhurve, me e falenderue e për me e lavdue të madhin Zot për këtë MREKULLI të madhe që po shohim sot me sy.

Se ky besim ka kenë përherë i ndezun në shpirtënt tonë, e vërteton restaurimi i kësaj kishëze vorrezash, ku kanë dhanë kontributin e vet, me punë e me të holla, edhe vëllazënt myslimanë e ortodoksë.

Se kjo fe ka kenë gjithmonë inkandeshente në mendjet e zemrat tona, e dishmon edhe ma mirë shenjtoria e Shëna Ndout në Laç, kur midis terrorit, mbi ato gërmadha, kanë ra mija shqiptarë për çdo vjetë. Secili në fenë e vet e secili në gjuhën e vet vazhdimisht po i luten Shenjtis Shëna Ndue për të gjitha nevojat shpirtnore dhe trupore dhe këto lutje u kunorëzuen sot me këtë Panair plebishitar.

Për të madhin Zot e për fenë në Të, ma bukur se unë flitni ju, me ato ngushëllimet e panumërta që gjeni te kjo fe, e cila i ngushëllon e i forcon, i zhdrivillon, i zbutë, i qytetnon mendet e zemrat e të gjithë njerëzimit.

Për të madhin Zot e për Shenjtënt e tij, ma bukur se unë shprehen shurdhët që ndiejnë, pagojcat që flasin, sakatat që ecin, psikopatët dhe epileptikët që shërohen.

Sikurse ajri që thithim asht i domosdoshëm për ekzistencën tonë fizike, njashtu për ekzistencën tonë shpirtënore asht e domosdoshme ekzistenca e një Qenje të

mbinatyrshme, që na ndihmon me përballue vështirësitë e kësaj jete me optimizëm, entuziazëm, kurajo; dhe kjo Qenje e mbinatyrshme na ban me pa me sytë e shpirtit lumninë e Parrizit, që na pret mbas kësaj jete të shkurtë, njashu sikurse shofim me sytë e trupit bukuritë e rruzullit tokësor.

Kudo nëpër botë, si në qytetet moderne, ashtu edhe në katundet ma të harruemet, naltohen kah kupa qiella kupola, minare xhamijash, kumbonare, të cilat janë simbol i kontakteve, i lidhjeve që njerëzimi mban përherë me qiellin, me Perëndinë. Majat e tyne të mprehta u përngjasin heshtave të një ushtrie të heshtun, që raca njerëzore ka krijue ndër shekuj për të ruejtë vlerat morale e kulturore.

Çfarë interesash botënore përfaqëson feja?

Kush i zbuti barbarët e kohës së mesme,⁵⁷ gotët, vizigotët, hunët e vandalët, përveçse murgjët e murgeshat, që i zbutën hordhitë e egërsinave me Kryq në dorë e me lutje në buzë?

Kush ia dha Europës unitetin shpirtënor, kulturor e politik, përveçse kristianizmi?

Krejt zhvillimi moral e intelektual i Europës e ka burimin te filozofia e teologjia kristiane.

Kush i çliroi vendet arabe në shekullin e shtatë nga paganizmi, politeizmi dhe u fali monoteizmin e i ngriti fiset primitive në shtet të organizuem dhe ma vonë në Perandori arabe e otomane, përveçse islamizmi dhe profeti i tij, Muhamet?

Po në shkallë kombëtare, çfarë roli qytetnues ka luejtë feja?

⁵⁷ Kështu e kanë quejtë të moçmit Mesjetën.

Në aspektin moral feja asht një digë. Diga nuk i lejon ujnat me vërshe e me i shpartallue tokat pjellore e shtëpiat e banimit. Njashtu feja asht një digë morale që nuk i lejon veset, perversionet, degjenerimin, korrupsionin me depërtue në mendet e zemrat e njerëzimit dhe në këtë drejtim feja i ep kontributin ma të madh rendit publik. Në aspektin kulturor: të gjitha shkollat fillore e gjimnazet, të gjitha institucionet kulturore e shoqnore në vendin tonë janë krijuar e drejtue nga bazilianë, benediktinë, françeskanë, jezuitë, etj. Deri shtypshkronja e parë, deri ferma e parë moderne e Bardhejve, asht temelue prej murgjëve të Shën Injac Lojollës.

Por feja asht determinate edhe në mbrojtjen e atdheut.

Tue mos kenë në gjendje idetë e shekullit me ua dhanë shqiptarëve bashkimin politik, vetëm feja diji me i bashkue princat shqiptarë të shekullit XV kundër anmikut të përbashkët, Perandorisë Osmane. Të gjitha mbledhjet janë zhvillue në kishën e Shën Nikollit të qytetit të Lezhës dhe në këtë kishë janë marrë të gjitha vendimet, për të gjitha operacionet ushtarake që ka zbatue Besëlidhja. Por bota e qytetnueme na njeh edhe për famëmadhen, Lidhjen e Prizrendit.

Kryetari i Lidhjes, Haxhi Ymer Prizrendi, së bashku me krenët tjerë muhamedanë, ortodoksë e katolikë, si Eljaz Pashë Dibra, Vaso Pashë Shkodrani e Abdyl Frashëri, të gjitha mbledhjet i zhvilluen në xhaminë e Prizrendit, e prej kësaj xhami, dolën të gjitha direktivat.

I madhi Zot, për t'i ushqye shqiptarët me begati, e pajisi Shqipninë tonë me dy mushkëni, me tokën e me detin: Për ta ruejtë këtë frymë të shëndoshtë, prej toke e prej

deti, jetuen, luftuen e diqën princat shqiptarë të shekullit XV si dhe fatosat e kreshnikët e Lidhjes së Prizrendit.

Vjeta 1989 ka kenë vjeta e paqes dhe e lirisë për gjithë botën, sepse në këtë vjetë u shembën muret e perdet e hekurta, që ndanin vende e popuj, por ma tepër ndanin zemrat e njerëzve. Në këtë vjetë pushoi së rrjedhuni gjaku, po fshihen lot, mbaroi djersa e pashpërblyeme e mori fund lufta e të gjithëve kundër të gjithëve. Njerëzimi hyni në një epokë paqe, lirie, mirësie, harmonie e begatie. Begatia e harmonia e një populli varen nga liritë që u akordohen qytetarëve.

Liria, në kuptimin filozofik të fjalës, asht progresi gradual i ndërgjegjes dhe i kulturës njerëzore. Këtë liri dhe këto të drejta po na epen gradualisht dhe me rrugë paqësore. Rruga paqësore asht tipike për një popull të qytetnuem. Duhet ta përballojmë tundimin e të mos përdorim dhunën, as brutalitetin. Dhuna e brutalitetit nuk i kanë zgjidhë kurrë problemet kombëtare e as familjare.

Vetëm kështu do t'ua mbyllim gojën atyne që na quejnë "Shprehje gjeografike", tokë e pazbulueme dhe i askujt vetëm kështu do t'ua mbyllim gojën anmiqve tonë, që na konsiderojnë popull kopil, i gjetun në mjedis të katër rrugëve nga nana histori.

Shkodra, qytet me histori ma të lashtë se dymijë vjeçare; Shkodra dikur kryeqyteti i Ilirisë; Shkodra e Teutës, e Gentit, e Agronit; Shkodra që deri para 50 vjetësh i pati dhanë Shqipnisë tonin moral, kultural, politik, fetar e ekonomik, kjo Shkodër asht gati edhe sot me bashkëpunue me Tiranën e me të gjitha qytetet e Shqipnisë, sepse trashigimtare e Balshës së Madhe e Marin Barletit, mbasardhëse e Fishtës e e Bushatlinjve, e Oso Kukës, Dom

Ndoc Nikës, Dom Ndre Mjedjes, Luigj Gurakuqit.
Trashigimtare e Frashërlivje, Konicës. Shkodranët gjinden
këtu, në këto troje shqiptare, të gatshëm me ripërtri edhe
një herë traditën e autoritetin që ka gëzue Shqipnia në kohët
e saj më të mira, mbrendë e jashtë atdheut. Amen!



Pesë vjet ma vonë

Homelia e freskimit të kujtesës dhe e dyshimeve për të sotmen e të ardhmen, që naltohet në një britmë disprimi për andrrat e parealizueme, gjithnjë pa e hupë shpresën, mbajtë me 11 Nanduer 1955 – në Katedralen e Shkodrës me rastin e pesëvjetorit të Meshës së parë.

Komunizmi donte ta shuente në kronin e mjerimit etjen e popullit shqiptar për përparim. Vinte nga lindja barbare, për të shti në dorë me dhunë e brutalitet, çka bota e kulturës e kishte fitue me lutje, djersë, mundë e zotësi.

Shkodra për mbarë Shqipninë ka kenë e asht si Greqia e Lashtë për botën: e lulëzueme dikur, e zhdukun sot; nanë burrash të qytetnuem dikur, që nuk patën frikë me dhanë gjithçka për ideale, për të vërtetat e përjetshme, për parimet themelore që mbajnë jetën; Nanë pa djalë sot! Sepse bijtë e saj më të mirë ranë nën plumbin e vëllaut me bindjen se idealet e tyre do të triumfojshin një ditë. Në Shkodër e në botë. Shembull klasik i kohnave tona asht ai i Imre Nagit në revolucionin hungarez të 1956-tës. Kur u arrestue nga rusët e mandej u vu para skuadrës së pushkatimit, deklaroi: “Ju po më vritni, por ta dini se pikërisht ju do të ma naltoni edhe monumentin!”

Njëmbëdhjetë nandori asht kunorëzimi i rezistencës heroike, i rezistencës aktive që Shkodra e qytetnueme i bani klikës gjakatare të Tiranës, tue fillue prej traktit të parë të Mark Çunit që u pushkatue bashke me mija e mija njerëz të ndershëm, prej të cilëve po kujtojmë vetëm Atë Faustin, Atë Dajandin, Atë Shllakun, Dilo Kalin, Imzot Prennushin, Dom

Dedë Malajn, Xhemal Naipin, Imzot Volajn, Qemal Draçinin, Dom Shtjefën Kurtin, për të mos mos vijue ma, sepse lista, e papërpilueme ende plotësisht deri më sot, do të ishte tepër e gjatë. Të përmendun ose jo, ata janë të gjithë ushtarë të njoftun e të panjoftun të lirisë e të demokracisë.

Njëmbëdhjetë Nandori asht brima, vikama, piskama e asaj mori kocash, kafkash që prej gropave të përbashkëta të burgut të Burrelit, të Bedenit, të Maliqit, të Vloçishtit, të Zallë Herrit, e të Zallit të Kirit, protestojnë ma tepër se me za dhe kërkojnë gjyq e drejtësi para Zotit e para historisë, për korrigjimin e së cilës askush nuk e ka marrë deri më sot përgjegjësinë, as mundimin. Mbi vorret e martirëve të vërtetë të demokracisë nuk u ngritën lapidare, as monumente; ndërsa vijnë të vendosen lule të freskëta mbi vorret e gjaksorve të tyne, njerëzve që shkaktuen në vendin tonë luftën civile, që u vunë futën nanave, grave, motrave tona, që e kthyen Shqipninë në një kopsht zoologjik, që shpuen tej për tej zemrat e atyne të cilët, tue pasë etje për liri, provuen me kapërcye telat me gjemba. Po vehen, pra kunora, mbi vorret e atyne që ndërtuen mbretinë e çthurjes morale, të padijes, të mjerimit, të rebelimit; atyne që mbytën mizorisht fe e kanu, që kryen genocidin rrajësor, që shkombëtarizuen vendin dhe shkaktuen mbrapambetjen, e cila na peshon aq fort mbi supe e që, mesa duket, nuk do të mund ta shkarkojmë aq shpejt, sa mendojshim në fillim.

Më duket si me e ndie edhe këtë ças gumëzhitjen e motorrave të kamionave, që kalojshin para shtëpisë seme në terrin e natës, tue prishë qetësinë e orës së vonë të pushimit. Çojshin intelektualët e burrat ma të mirë të Veriut per t'u pushkatue në Zall të Kirit. Më përqethet edhe tashti shtati, kur më vjen në veshë ushtima e zanit të kojshisë sem, Luigj

Kastratit. Prej kamionit të dekës e ndjeva tue britë: “Lamtumirë e natën e mirë, nanë!” Më vijnë para sysh skenat makabre të mbaspushkatimit, dhunimi i kufomave, vallja labe rreth martirëve të fesë e të demokracisë, që kishin në ballë lulen e gjakut. *Lule Sofo Lule djalë...* Motivi vijon... A mund t’i quejmë çlirimtarë këta njerëz? A mund t’i rreshtojmë në listën e qenjeve racionale?

Jemi mbledhë këtu për të përkujtue 11 Nandorin 1990: asht një datë e papërsëritshme, kur rinia shkodrane, pa dallim feje, më thirri, më mbrojti, më barti ndër krahë deri te elteri, për me kremtue Meshën e parë në mjedis të terrorit komunist. Kjo ngjarje ua hoqi frikën gjithë shqiptarëve dhe hapi në vendin tonë një epokë të re, atë të lirive fetare, që janë në temel të të gjitha lirive të tjera. Po të mos ta kishte zbulue Amerikën Kristofor Kolombi, sigurisht do ta kishte gjetë një tjetër zbulues. Por merita i takon ekipit të lundëtarit gjenovez, që vuni kryet në rrezik, tue vozitë nëpër dete e oqeanë të panjoftuna. Kështu liritë e fesë do të kishin ardhë edhe pa Shkodrën, por asaj e sidomos rinisë së saj, i takon merita e kësaj ngjarje të madhe. Asnjë prej të 50 mijë vetëve që u grumbulluen atë ditë, nuk ishte i sigurtë se do të kthehej në shtëpi. Shumë prej tyre ato ditë u rrahën, u torturuen e banë disa muej të mirë burg, para se të ndërronte moti. Prandej atyne që janë mësue me e shtrembnue historinë, u thomi: “Trimnia mbas beteje e urtia mbas kuvendit s’duhen gja”.

Njëmbëdhjetë Nandori 1990 asht historikisht i papërsëritshëm përsa u përket emocioneve. Atë s’do të mundet me e shlye askush, sepse tashma ka hy në histori.

Ai oqean njerëzish ishte i pushtuem nga dy ndjesi: ndjesia e dekës dhe e jetës. Secili e ndiente vedin ma shumë

se kurrë pranë atyne që pushojshin në paqë aty poshtë. Por kur nisi Kremtimi Eukaristik, akti ma sublim i fesë, që lajmon deken e ngjalljen e Krishtit, Zot e njeri bashkë, mbi ndjesinë e dekës ngadhënjeu ajo e jetës, e ringjalljes! Në atë ekstazë të paprovueme prej vitesh, të gjithë kishin dalë nga vetja. Deri policët e sambistat harruen se kishin në brez pistoleta e thika. E këtë e harroi edhe ndonjë shkodran, që atë ditë ishte nisë me pa Meshë si të nisej për betejë, tue xjerrë prej birës së murit e tue e mshehë nën petka të njëjtat armë. Atë ditë, si atë ditë, kurrkush s'ndihej mysliman, katolik a ortodoks: fantazmat e përçamjes ishin arratisë: të gjithë e ndiejshin vedin bij të të njëjtit Zot, që na kishte mbledhë aty me forcën e vet për të kremtue fitoren akademike kundër antikrishtit. Të gjithëve na shndritshin sytë: ishin lot dhimbe e pikëllimi për të ramët, përse s'ka familje shqiptare që të mos e ketë një viktimë. Por ishin edhe lot gëzimi, sepse në atë vend që deka e kishte mbjellë me vorre, frynte fuqishëm era e ringjalljes. Ah! Sikur ta kishim ruejtë gjithmonë atë bashkim e dashuni që na ngjalli ndër zemra Mesha e Parë!

Njëmbëdhjetë Nandori asht historikisht i papërsëritshëm përse i përket guximit.

Ishte ditë terrori dhe frikë, sepse ende shumë shkodranë kur shihshin tue ardhë në drejtim të tyne ndonjë hoxhë ose prift, që kishte teprue nga persekutimi, ndërrojshin rrugë për mos me e përshendetë, sepse kleriku ishte ende anmiku numër një i klanit. Ishin ditë terrori, kur bijtë tonë bijshin dekun, në përpjekjen me ça perden e hekurt të kufinit. E, si masakroheshin, lidheshin kambë e duer e telaistikami, hidheshin përmbi kamiona me sponda të uluna e sorollateshin nëpër qytet, për me terrorizue popullatën. I

kemi pa këtu, para kësaj katedrale! Kemi pa sesi, tek i dorëzojshin në shtëpi, pyetshin me cinizëm nanat: “A e njeh?” Jo, nana nuk e njifte të birin, aq e kishin shpërfytyrue!

Pjesëmarrja do të ishte kenë edhe një herë aq e madhe, po të mos e kishin terrorizue popullin me konferenca nëpër lagje, ndërmarrje, shkolla e po të mos i kishin nisë jashta Shkodre dheta kamiona të ngarkuem me të rij për me mbledhë shëga të egra nëpër Tarabosh.

Po qinda të tjerë ishin këtu, gati me flijue të ritë te kambët e elterit ku kremtohej Mesha e parë e mbas salvimit. Prandej s’kam si mos me brohoritë sot, pesë vjet ma vonë: “Ty rini ta lumsha krahin / se ai rritë Shkodrës pahin!”

Ti kje e para që me sfidë dhe pa kompromis rrëxove prej elterëve zotat e rrejshëm, Stalinin e Enverin e në vend të tyne naltove Perëndinë e vërtetë, tue u përpjekë kështu me e zbutë me fe shqiptarin e bamë bishë prej terrorit.

Mërrijti deri në Tiranë, fama jote, rini shkodrane. I tregove edhe rinisë së kryeqytetit se në Shqipni ka një qytetnim ma të mirë se ai serb, rus e kinez. Ti deshte me e marrë për dore tanë rininë shqiptare për t’i pri nëpër rrugët e qytetënimit perëndimor. Zani yt, që s’ishte za dredharak politikanësh, u ndie në të katër anët e botës, ku unë, i padenji, qeshë ftue për me folë për ty: kujtoj vetëm Universitetin e San Francisko-s, ceremoninë që u organizue aty më 1991 për me i dhurue Shkodrës diplomën “Honoris causa”. Autoritetet e vendit nuk ta njoftën kurrë botënisht atë rol, që ta njofti bota, sepse liria që duen ata, nuk asht liria që do ti. E liria që do ti, asht fundi i vërtetë i tyne!

Asht liria që din me dhurue veç Zoi, liria e mshehun pesëdhjetë vjet nën dhe, prej kah ndihej shpesh si ushëtimë tërmeku e si gjamë vullkani, që ia dridhte tokën nën kambë

diktaturës e diktatorëve. Krateri ishte në Fushë të Rrëmajit. Prej aty lava do të derdhej nëpër të gjitha rrugët e Shqipnisë, për me përcëllue tiranët, me mposhtë katilat, me paralajmërue krenarët; me ngritë të përvujtit, me naltue të ndershmit, me gazmue viktimat.

Njëmbëdhjetë Nandori ishte fryti i pjekun nën rrezet e lutjeve të martirëve e shpirtënve të Purgatorit, për të cilët na lutemi posaçërisht këto ditë.

Ti, rini e ndërtove për tri ditë kapelën e djegun të vorrezave, por mos harro se trolli ku shkel asht krejt i djegun: duhen rindërtue shpirtënt, vlerat morale, doket e zakonet e shenjta shqiptare, ba zhari prej ateizmit pesëdhjetëvjeçar. Mos u largo nga vendi yt, rini, sepse larg votrës të presin punët ma të përvujtuna, që vendast s'i begenisin, të pret përbuzja e njerit të paatdhe, të pret malli e zhgënjimi i skllavit.

Rini e Shkodrës martire dhe e demokracisë: Djalli nuk ndalet, por as na mos të ndalemi! T'ia prishim gjumin, gjithmonë me zhurmë paqësore, t'ia shëmtojme panoramën që i pëlqen, t'ia rrënojmë humorin, t'ia therim ndërgjegjen, derisa një ditë të bukur ta shporrim prej trojeve tona. Vetëm atëherë kemi me gëzue liritë e të drejtat që patëm mendue se do t'i fitojshim së shpejti, ndërsa kremtojshim këtu pesë vjet ma parë!

Mbasi kaluen dhetë vjet

11 Nanduer 2000

Mbajtë me rasën e dhetëvjetorit të Meshës së parë, kundër vullnetit të episkopatit që e suprimoi këtë përvjetor.

“4 Nandori asht një prej ngjarjeve ma të randësishme, që duhet të xanë vend nderit në panteonin shqiptar; sepse së pari: ka origjinë qiellore; asht tubim spontan, që shpërthei nga zemrat e njerëzve të thjeshtë, asht triumf, fitore akademike e vetë Perëndisë, që shpërblente një popull për lot e djersë, derdhun kot, si moskund.

4 Nandori asht i papërsëritshëm përsa i përket fesë së gjallë, guximit, emocioneve të papërmbajtshme, saqë edhe sot kur i kujtojmë, na mbushen sytë me lot. Janë lot gëzimi, janë shprehje e ngadhnjimit të Mbretnisë së Zotit mbi atë të djallit, por janë edhe lot idhnimi për ata që ranë për një Shqipni europiane.

Më 11 Nanduer 1990 solemniteti i Meshës shenjtë na pati elektrizue të gjithëve, na pati ba me kalue në ekstazë. E patëm ndie vedin të barabartë me njeni-tjetrin, si vëllazën, si bij të të njëjtit Zot. I patëm harrue të gjithë armët që kishim mshehë, kush për të sulmue e kush për t’u mbrojtë; e kur u kujtuem për to, ndiemë dishirën për t’i përdorë vetëm për me i ba “për nder armët”. Atij që flijohej në elter, që na ftonte me i dhanë fund armëve, egërsisë, hakmarrjes, padijes e me fillue një jetë të re.

4 Nandori tashma ka hy në të gjitha enciklopeditë e botës, përjashto Shqipninë, së pari sepse nuk ka fare enciklopedi, e së dyti, edhe po ta kishte, vështirë se do të kishte pranue se liria e fesë asht baza e të gjitha lirive.

Në Meshën e parë nuk pati gisht të huejsh: venedikasish, turqish, austro-hungarezësh as sllavësh, gisht që ku ma pak ku ma shumë, hedh gurin e mshehet në disa nga ngjarjet kulmore të historisë së Kombit.

Më 11 Nanduer nuk pati gisht askush, veç popullit të thjeshtë shqiptar, që vërshoi nga të katër anët rreth elterit të meshës së parë, o me dekë o me i hapë përsëri kishat e xhamijat e me e ftue rishtas në Shqipni Zotin, që kishim marrë guximin me e dëbue, thue se s'ishin edhe trojet tona pronë e Perëndisë.

Klasa sunduese bani çmos me ndërtue një shoqni pa Zot. Nxiti kështu luftën e të gjithëve kundër të gjithëve, që luejti rolin kryesor në egërsimin e shpirtënve dhe në edukimin e kriminalitetit, i cili sot po del gjithnjë e më në pah: mjafton me kujtue sesi rezultat e edukatës ateiste, sot vetëm në Itali kemi nëpër burgje ma se pesëmijë shqiptarë dhe në të katër rrugët, ma se tridhetëmijë vajza.

Sot, mbas dhetë vjetësh, mbas aq e aq ngjarjeve, shumica të padishrueshme, Mesha e parë mbetet në kujtesën kombëtare e ndërkombëtare si ngjarje e madhe, e pastër e frymëzuese. Gjithnjë e ma shpesh rifillimi i Kishës, do me thanë rikthimi i Krishtit, mbetet e vetmja mbështetje e shpresë për njerëzit, thellësisht të zhgënjyem në andrrat e tyna ma të shenjta. Dhetë vjet ma parë, ndërsa njerëzit e thjeshtë grumbulloheshin me mija rreth elterit, edhe klasa politike veshi simbolikisht kostumin e murgjëve, ftoi Nanë Terezën e Papën Gjon Palin II, të cilëve u tregoi se në mes

të Tiranës kishte vendosë Atletin e Krishtit, Gjergj Kastriotin Skënderbeun. Ishte si me dashtë me thanë se kishin vendosë me u konvertue. Vijuene pra me zell përpjekjet për me bindë botën mbarë për këtë konvertim; u organizue Simpoziumi “2000 vjet krishterim ndër shqiptarë”, u suell “Kumbona e paqes” e bekueme nga Papa flitet gjithnjë ma shesh për ngritjen e një Universiteti katolik (në Tiranën qeveritare kuptohet, jo në Shkodrën që ep përditë shpirt mbi rrënojat e veta të lavdishme, pa pasë kush me ia ngjitë dorën? Përpiqen, kështu me ndërtue për Shqipninë një façiatë të mrekullueshme, si ajo me të cilën në qytetet e mëdha të botës maskojnë ngrehinat që janë tue ra mbrendë. Façiatë katolike, sepse kështu mund të gënjesh perëndimin kristian, prej të cilit mërrijnë ndihmat kryesore që na mbajnë jetën gjallë, Façiatë false, sepse po të hapësh vetëm një dritore për me shikjue çka ka përtej, do të shohësh një Shqipni pa drita, pa ujë, zhytë në trafiqet ma të ndyta, pa rend publik, pa arsim, pa shëndetësi, pa bujqësi. Kudo të sheh syni korrupsion të thellë e vorfni edhe ma të thellë, në një vend që s’asht në gjendje me i sigurue shtetasve të vet bukën e përditshme fitue me djersën e ballit. Prej këndej, shikjon sesi populli shqiptar plaket për ditë e ma shumë, rranxë votrave mbesin vetëm pleqtë, që kjajnë e dënesin, që rrinë ditë-natë me sytë mbërthye ndër male e detna, të cilët i ndajnë prej bijve e bijave të tyne të arratisuna, nisë zhyt-mbyt për të punue si skllavë në Perëndim për një copë bukë: bukë për vedi e bukë për pleqtë që rrezikojnë me dekë në vetmi të thellë, në skutat e zeza mbas façiatës. Numri i të rijve të dispruem që marrin rrugët, shtohet për ditë: ikin nga skëterra, nga streset, nga terrori e deka, që mbretnojnë në vendin tonë. E shtohet edhe numri i pleqve e shumëfisho-

het trishtimi i tyne, kur mendojnë se rrezikojnë deri me mbetë mbi dhe, se s'ka me pasë kush as me i vorrosë.

Kemi dërgue mjaft djelm e vajza jashtë shteti për studime të nalta. Një pjesë e mirë i kanë krye me sukses, por fatkeqësisht janë sistemue ndër vende të hueja, tue pasunue kështu trunin e botës e tue e vorfnue atë të Shqipnisë. S'kanë faj djelmtë e vajzat tona: Shqipnis e tejfaçiatës deklaroi se s'ka vend për ta, se nuk i duhen, ndërsa mbetë vendi ma i vorfën, pra me ma pak tru, i Europës. Na kujton Fisha i madh: *"Neper terr mâ se nji nieri / Të parin vend ká xânë pa hiri / Verë e dimën kualt e shkjeptë / Gjejnë kullosë në livadh të rjeptë"*.

Para dhetë vjetësh kishim ndër duer prangat prej hekuri të komunizmit. Mbas dhetë vjetësh, jemi sërisht me pranga në duer. Prangat prej hekuri janë zëvendësue me prangat moderne amerikane kibernetike. Vetë Kontinenti ynë i plakun, asht katandisë në gjendje skllavënie, rënkoi nën thundrën e bazave ushtarake amerikane, të cilat duhet t'i shporrë, nëse don të kenë të ardhme. E aq ma pak do të ketë të ardhme Ballkani ynë i stërpushtuem nga të njëjtat baza, që janë ngritë pikërisht gjatë këtyne dhetë vjetëve.

Dhetë vjet ma parë patëm mendue se po bahemi ma mirë, sepse patëm pa një Gorbaçov hipokrit në gjuj para Papës, tue kërkue të falun; patëm pa e ndigjue një Bush, me lajmue botën se lufta e ftohtë kishte marrë fund. E patëm kujtue se edhe për ne do të fillonte stina e ngrohtë. Tepër zharitëse stina që sollën të dy udhëheqësat e superfuqive së bashku. Ishte vepër e tyne, lufta e nxehtë, që shkrumboi Shqipninë e Ballkanin këto vite, gjatë të cilave gjetën deken ma se 300 mijë vetë, ndërmjet të cilëve dhetëmijë fëmijë, që

i kositi mordja nësa merreshin me lojnat e tyne të pafaje, pa llogaritë rrënojat, ndërmjet të cilave 200 ndërtesa kulturi.

Kemi një parlament europian gjoja kristian, që po miraton martesën e homoseksualëve e të lesbikëve, tue shkatërrue kështu familjen e temelueme prej Zotit qysh në Adamin e Evën.

Po jetojmë kohën e antikrishtit, kohën e atentateve ma të rrezikshme kundër vlerave, prandej asht detyrë e të gjithëve t'i kundërvehem këtij perversioni të organizuem nga klasa politike.

Klasa sunduese botënore disponon sot mjete ekonomike stërgjigande. Po të dishronte, mund të ndërtonte në glob parrizin e tokës dhe ta zhdukte vorfëninë, mjerimin, ankthin, sikletin, në të cilin jeton sot mbarë Planeti. E aq ma shumë shqiptari, të cilit qeveria nuk i siguron as bukën e gojës.

Po ajo nuk dishron çka don njerëzimi: me prirjen e pangopun për hegjemoni, dy superfuqitë po e bajnë edhe ma të thellë fundin e ferrit, tue afrue ditën e mbrame.

E prova gjenerale e ditës së kjetimit, siç e quen populli, u ba në Shqipni në vitin 1967, kur u mbyllën kishat e xhamijat dhe u vranë, u burgosën e u internuen të gjithë klerikët.

Me arsenalin ushtarak, që asht zmadhuhue jashtëzakonisht vjetëve të fundit, klasa sunduese po përgatitë ditën reale të kjetimit universal.

E duhet ta dinë mirë se shi në çasin kur do të mendojnë se kanë fitue, shi më atë ças do të kemi ardhjen e dytë të Krishtit përmbi tokë për me dënue persekutorët e keqbasit e për me shpërblye të mirët, besnikët, që të gjallë e të vdekun, do të mblidhen sërish, si u patën mbledhë me 4


Nanduer, në këtë vend shenjt. Ashtu si jemi mbledhë edhe sot; jo me zort, si me kenë tue hangër mollën e ndalueme në bahçe të huej, a si mos me kenë në shtëpi tonë, si jemi tash një shekull. Jemi mbledhë si vëllazën e motra, si bij të një Ati, për të falenderue të madhin Zot e për ta lutë që të shtohen rradhët e së djathtës së Zotit e të kthehet paqja ndër zemrat tona të shqetësue, ndër familjet tona të travajueme, në Shqipninë e botën tonë të turbullueme e ashtu kjoftë!”



Shembja e idhujve

Një të diele të bukur banorët e Qytetit të Veriut u dyndën në Sheshin kryesor, pranë asaj që vijohte me u thirrë turqisht Milet Bahçe. Nga balli i lulishtes, që më kot shteti ishte mundue me ia përkthye emnin, si e dashtë me vërtetue se historia e këtij qyteti ishte rrokullisë prej pushtimit në pushtim, prej thundrës nën thundër, Stalini prej bronxi hidhte vështrimin e vet të egër, si me dashtë me thanë: “Jam unë sundimtari i Shkodrës!” E shkodranët atë ditë kishin da me u dënue me dekë pikërisht këtë soj burri, që kishte ardhë me i sundue prej çin e ma çinit. Mbasi s’ishin të zotët me iu vërsulë sundimtarëve të gjallë si e donte e mira e e mbara e punës, iu sulën burrave prej metali. E pra s’asht ma kollaj me thye metal, se koca njeriu! Njëpër turmë filloi me qarkullue emni em e me u folë për krijimin e një komisioni, që duhet të vinte me më marrë në shtëpi, tue m’u lutë të mbajshe fjalën para ekzekutimit. Njerëzimit thojshin: “Të shkojmë vrap e ta thërrasim. Ai din me ia hjedhë konopin në fyt kanibalit”. Këto e shumë fjalë të tjera, m’i bajshin orë e ças në shtëpi bestarët, që shkojshin e vijshin për shërbime fetare. Në të vërtetë ky soj besimi jo vetëm që s’më kënaqte, por madje më shqetësonte. Unë jam meshtar e nuk më takon me vjerrë në konop as njerëz e as shtatore. As qafa metali, as mishi. Pa i pasë vjerrë, edhe shih çka po na thonë, jo ma me ia pasë nisë kësaj lloj veprimtarie e mandej me u ngjitë në elter e me i drejtue prej aty popullit fjalët e Krishtit: “Fali o Atë, se s’dijnë çka bajnë!” Në ç’rast do të kishte kenë ma i besueshëm? Unë jam njeriu i elterit,

jo i karamanjollës e i trekambëshit. Prandej nuk pranova kurrfarë propozimi që m'u ba atë ditë, më mjaftonte hiri që më kishte dhanë Zoti me thanë përsëri Meshë në publik. Me mue a pa mue, Stalini u zhgul. E po më thonë se do ditë mbrapa u pa një kamarier i Milet Bahçes tue e lagë me zorre gropën që kishte mbetë mbas zhguljes së asaj bime të helmatisun. E një shkodran që i thonte: "Pashë Zotin që të ka dhanë e të ka falë, mos e lag, se po na mbin prap". E po thonë se kishte pasë kenë profetë ai shkodrani.



Epilog në tokë

Farsa e demokracisë.

Kështu u rrokullis për Shqipninë e mjerë një gjysë shekulli: ndërmjet rrenash e torturash. Po torturat s'lidhin kokrra; rrenat s'japin bukë. Prandej vendi u katandis në mjerim të thellë, njashtu si gjithë lindja e kuqe. E prandej nisi të rritej revolta. Jo te na, zotni, shqiptarit s'kishte mbetë ma asnjë pikë gjaku. Te fqinjët, te miqtë e dashamirët e djeshëm marksistë-leninistë, me të cilët ishim kenë lidhë e zgjidhë njëmijë herë. U shembën mure e shpërtheu rebelimi shi atje ku kishte fillue kolera e kuqe, prej së cilës ishte infektue menjëherë e prej së cilës po diste dalëngadalë Shqipnia e vogël, me trupin e brishtë gjithnjë të ligштуem. Ashtu, të paktën, na u duk ne. Ndërsa na endshim andrra ndër biruca, qeli e galeri të zeza minierash, qeveria e kishte kuptue mirë se kishte lindë rreziku me ndërrue rolet. Atëherë sapo kishte dalë nga skena diktatori gjakatar, për me ia lanë vendin një regjisor ma të rafinuem, Ramiz Alisë, i cili, natyrisht, merrte mësim nga një tjetër regjisor, ma i madh, misterioz. Po na thonë, madje, se dikur paska kenë shkodran!/? Ai, mbase kishte ecë për do kohë në rrugën e traditës së lavdishme, e mbasi kishte arsyttue hollë-hollë mbi kohët e reja, gjithnjë tue imittue Kremlinin, mendoi me i dhanë fund tragjedisë, e cila rrezikonte me mbarue me vrasjen e të gjithë personazheve, madje edhe të autorit e regjisorit. Ta kthejmë – tha në komedi, madje në farsë. “E kemi vërtetuar gjatë një shekulli se jemi po aq të zotët për farsa, sa për tragjedi. Mjaft më me gjak të derdhur birucash.

Ta derdhim rrugësh. S'është nevoja të shpenzojmë fishekë kot. T'ua japim armët në dorë e do të vrasin njëri-tjetrin. T'ua hapim kufijtë, e do të ikin nga sytë këmbët, duke na lënë të qetë në punën tonë. T'ia mbushim mendjen këtij populli, që tashmë nuk ka asnjë gram tru, se e vetmja rrugë është e jona. E ai do të ecë me dashje në këtë rrugë”.

Kështu regjisori mendoi se ishte në gjendje me e shkruar e me vu në skenë farsën e re, që do të luhej në skenën shqiptare. Nuk e pat aspak të vështirë. Ndoq përsëri besnikisht traditën. Mori tekstin e një farse moderne, që po vehej në skenë në Moskë e filloi menjëherë t'ia përshtaste Shqipnisë. A s'kishte ba kështu Noli i madh? U zhyt, prandej, në përfytyrimin e skenës së re, ku do të luhej farsa, me male të shkretnueme, pyje të përgjysueme, bregdete të pashfrytëzueme, liqej të përumbun përkaj kufijve, qytete të mërdhituna, me njerëz të frikësuar deri në atë gradë, sa ishin në rrezik me u ba trima të çartun prej tmerit që u kishte hy në palcë. I patën tregue sesi njenin prej këtyne qytetarëve e kishin thirrë për me e dekorue me medaljen e trimnisë. Por, meqë nuk kishin mërrijtë me ia shpjegue me kohë arsyen, ai i shkreti shkoi me e marrë këtë medalje, tue u dridhë prej friket.

Kështu pra, regjisori u ul në të njëjtën tryezë, ku kishte nënshkruar sa e sa dënime me dekë, prej nga kishte dhanë urdhna me i xjerrë sytë sa e sa njerëzve e filloi me përkthye farsën ruse në gjuhën shqipe.

Farsa fillonte me një revoltë popullore, të organizueme e të drejtueme prej vetë regjisorit, ku natyrisht do të merrshin pjesë edhe ata qyqarë, që do të besojshin se ishte rebelim i vërtetë e se u kishte ardhë ora. Ishin aq pak, të gjorët, sa roli i tyre do të ishte i pandieshëm, si gjithmonë.

Mandej, skena e formimit të partive të reja. Situatë komike me të ba me u fikë gazit. Komunistët e djeshëm do të bajshin kthesën e madhe, do të delshin ndër mitingje, do të çirreshin kundër vetvedit, për me ruejtë vetvedin, tue e ba sa ma të besueshëm. Por, gjithmonë me masë, gjithmonë mbrenda kufijve. Mandej në skenë do të delshin spiujtë e birucave, Pjepri, Mandela i Shqipnisë, që kishte vuejtë aq shumë burgjesh. Ky po që ishte bindës, ky e të tjerë si ky. Le të delshin pra prej birucave, për t'u ngjitë ndër tribuna mitingjesh. Madje edhe në elter e edhe në tribunën e parlamentit. S'kishte kurrëgjatë të keqe. E kishin mësue tashma përmendësh leksionin. Mandej, për me e mbajtë ngrehë vëmenden e spektatorit, vijshin ca si skena gjysëtragjike, me thyemje xhamash, djegie makinash, komitetesh partie, me vrasje, me shkatërrime, me sulme kundër institucioneve (sepse të komunizmit, e për t'u shkatërrue të tana), me hapjen e depove të armatimeve, me shkrehje armësh ditënatë, me mungesë buke, me frikën për të xjerrë hundën jashtë prej shtëpie. Njerëzit duhet ta hupshin paqen e sigurinë, duhet të mos guxojshin me qitë kryet jashtë. E në këtë atmosferë do të vijontë të endej konflikti i farës së re, do të shpërbahej ekonomia, që nuk mund të ecte ma kështu, do të shkatërrohej ajo industri qesharake, me teknologji të vjetrueme, do të copëzohej gjithçka, për të krijuar idenë e ndryshimit të madh. Kështu, për ca kohë, autorë e aktorë kryesorë duhet të msheheshin mirë mbrapa kuintave, tue pritë çasin e përshtatshëm për t'u ba rishtaz zot të skenës. E gjithçka do të mbetej në të njëjtat duer, që për pak kohë duhet të ishin sa ma të padukshme.

Në skenë do të thirreshin edhe mërgimtarët, sigurisht. Sepse nuk duhej harrue kurrë se skena e vogël shqip-

tare ishte pjesë e një skene ma të madhe, asaj botënore. Nëse aktorët nuk e bindshin botën me vërtetësinë e lojës së tyre, skena mund të ndryshonte papritë e pa kujtue. Prandej, kryekreje duhej pasë parasysh pikërisht skena e madhe. Mërgimtarët ishin aktorët ma të përshtatshëm për t'i rregullue këto hesape të vogla. Po ata ishin shumica të arratisun, anmiq të përbetuem të pushtetit; ata s'do të lejshin gja pa thanë, do të shprazeshin krejt. Mrekulli, ashtu e donte edhe akti që luhej. Kjo do ta bindte botën e madhe se këtu po luhej drama e demokracisë e jo farsa ose tragjedia e saj. Mandej ata do të shprazeshin me gjithsej, do të lejshin këtu fjalë e kuleta. E si të kishin pa me sy të tyre ndryshimet kolo-sale ndërmjet vendit ku jetojshin e atij ku kishin pasë fatin e zi me le, do të ktheheshin përsëri, në pika të vrapit, në botën e madhe, për me i tregue trimnitë që kishin krye. Tue u betue në zemër të vet mos me kthye ma kurrë në atë vend, që e kishin andërrue aq shumë e që e kishin gjetë të tjetërsuem. Mrekulli! Hoshgjelden! Mirë se kjoishin të ardhun.

Si e kreu përkthimin, regjisori natyrisht u vu me kërkue aktorët. Këtu kishte fushë të hapët krijimtarie, s'ishte punë përkthimi, por përshtatje me kohën e vendin. Tha, prandej: "Të ndërrojmë taktikë. Deri tani shqiptarëve u kemi shtënë në bark lepurin e janë dridhur ditë-natë prej tmerrit. T'ua heqim lepurin, ta zëvendësojmë me qenin. Qeni që lehë, s'kafshon! E kështu do të mund të lehin si e sa t'u dojë qejfi. E nësa ata lehin, ne kemi kohë të mjaftueshme ta vëmë plotësisht në skenë farsën tonë".

Shqyrto me vëmendje njerëzit që mund të ishin të aftë me e luejtë atë kryevepër: aktorë të parë e dublantë. Thirri së parit në skenë Sali Berishën, infermier kardiologjie, tue kenë se diploma shqiptare e mjekësisë nuk

njihet kurrkund në botën e kulturës. Përgatiti si zakonisht, opinionin e trashë publik, tue shfrytëzue deri “Zanin e Amerikës”, që asokohe ishte i besueshëm si zani i Zotit, e s’na pat shkue ndër mend kurrë, ne të marrëve, se edhe Amerika e madhe mund të shitet për 30 aspra. E t’na erdh, pra, lajmi prej Ameriket, se na kishte dalë në skenë një komunist i flakët antikomunist, një sekretar partie kundërshtar partie. E ta hangrën tanë e t’ia nisën me brohoritë e me u rrahë në grushta me miq e dashamirë të bindjeve tjera, për me i dalë zot. Mandej regjisori vijoi: thirri Sabri Godon, me duert e stërvituna në sigurim të shtetit, për me drejtue partinë republikane; Pjetër Arbnorin, përfaqësuesin ma bindës të së djathës, derisa ishte shkri ndër burgje, me mbajtë fjalime të zjarrta me zgalemë e zogj të tjerë furtunash... Mandej vendosi me krijue partinë e gjelbërt, që i përngjet aq shumë shelqinit: jeshile përjashta, e kuqe përbrenda; thirri prandej zotin Hoti me kapelë që s’e hiqte as në televizor e e emnoi kryetar. Gjindja banë vetëm një vërejtje: më duket se asht qiros, qysh se nuk e hjek kurrë kapelen! E mandej vijoi me komedianin Zef Bushatin, emën e mbiemën i përshtatshëm për demokristian. Ishte një demokristiane e rregullt, e vulosun në sigurimin e shtetit, jo si ajo që deshtën me krijue shkodranët e marrë, të cilët ende kujtojnë se në këtë botë ka liri e demokraci të kullueme. E kështu me rradhë, fantazia e regjisorit u harlis, e si të ishte dosë e mirë polli ma se njëzet gica, due më thanë parti. E kështu trupa ishte gati.

Atëherë i dau në dy krahë. Pozitë e opozitë. Fatos Nano me shokë nuk do të quheshin ma komunistë, por socialistë, përfaqësues të së majtës; Sali Berisha e Pjetër Arbnori me shokë, nuk do të thirreshin ma me emnat e

pakandshëm komunistë ose spijuj birucash, por e djathta demokratike. E jurra bre burrë me e vu në skenë sa ma parë e sa ma bindshëm farsën e re, për me e shtensionue paksa shpirtin e ximë të një populli që kishte harrue me qeshë.

Madje, në kundërshtim me çdo teknikë skenike, në premierë vendosi me xjerrë sa ma shumë dublantë: pothuejse të gjithë të parapërgatitun për rolin që do të luejshin ndër biruca, me nga një firmë të vume në ditë të zezë. Kështu ai i kishte plotësisht në dorë, e në çastin e duhun mund t'i zëvendësonte pa probleme, me aktorët e vërtetë, me ata që kishin kenë gjithnjë zotër të skenës, e nëse s'kishin ma takat me e luejtë farsën moderne, i kishin përgatitë bijtë shi ndër vendet kapitaliste, të cilat ai i kishte marrë për yrnek në veprën e re që po kurdiste. Kështu, pra, mbloodhi gjithë komunistat, agentët e sigurimit e spijujtë dhe me ta nisi të vente në skenë farsën e re, jetën e re politike. U shpërndau të gjithëve tekstin dhe i porositi ta mësojshin sa ma shpejt përmendsh. E si të kishin ecë sadopak përpara me tekst, do të fillojshin menjëherë provat. Por kujdes! I duhej qëndrue tepër besnik tekstit. S'kishte vend për shumë krijimtari. Me krijimtari, gjatë vuemjes së tij në skenë, kishte të drejtë të merrej vetëm regjisori i madh, që kishte në dorë tana fijet e aktorëve-kukulla. Nëse nuk do ta kuptojshin si duhet rolin, duhet të paraqiteshin menjëherë tek ai. Dinte ai si ua mësonte.

Atëherë nisën provat e para, mandej prova gjenerale. U organizue demonstrata e parë në Shkodër; u rrëzue Stalini, iu këput kryet Enver Hoxhës para prefekturës së Shkodrës, u dogj komiteti i partisë, u vranë njerëz, u shkruambuen dosje. Regjisori fërkonte duert. Boll me kenë shkodran, se tana i ban! E kishte studiue mirë edhe dekorin

ku do të niste shfaqja: qytetin ku kishte lindë, i cili me pishtarin e ndezun të lirisë, nuk do të bante tjetër veçse të digjte përfundimisht vetvedin. U formuen partitë e njerëzit u mrekulluen kur panë ndër role kryesore pranë e pranë xhelatët e viktimat, ish-sigurimas e ish-të burgosun. Panë si ujnat e Buenës e të Drinit u kuqën me gjak – do të thotë ndokush, që e njeh mirë historinë e Shqipnisë. Jo, pra. Mos harroni se vijon farsa, jo tragjedia. Njerëzit e vorfën, të hutuem prej ndryshimeve të shpejta, menduen se do të ishte gjaku që aq shumë e pritshin, gjaku i atyne që kishin derdhë aq shumë gjak, i vetmi që mund ta lante krimin shekullor. Jo more zotni! Valët e lumejve u kuqën me tesarat e partisë, shi në çastin kur regjisori realizonte mizanskenën e braktisjes masive të saj. Por shihni botë! E ç'randësi ka tesera e flakun, more zotni, kur e ke krymbin në krye e në zemër? Mandej u shpërba ekonomia, mandej u shkretnuen arat, mandej aktorët e tepërt u hypën ndër gomone e u nisën nga sytë-kambët, për me u lirue pak nga pak skenën aktorëve të vërtetë. Bam-bum, zhyt-mbyt, populli i shkretë mërrijti ma në fund pikërisht aty ku kishte dashtë me e çue regjisori i padukshëm, që tashma kishte zgjedhë si vendin ma të përshtatshëm për të vijue drejtimin e farsës, birucën. Ishte vetdënue për t'u ba sa ma bindës. Pështjellimi u ba aq i madh, sa të gjithë besuen se ishte pikërisht fryt i mungesës së çdo regjisure, se nuk e drejtonte askush, se ngatërrohej, e zhgatërrohej vedit, lamshi i përjetshëm i punëve të Shqipnisë. Ku ishte, pra shteti, që lejonte zhgatërrimin e përgjithshëm? Pak kush e kuptoi se shteti ishte pikërisht aty e luate edhe ai rolin e vet të caktuem nga regjisori, i cili ishte aty edhe kur filloi skena e financierëve. Ishte ai që nguci njerëzit të shitshin shtëpi e katandi, me mendimin e

marrë se parja pjell pare. E dinte, more zotni, se për shqiptarin punë e mirë asht vetëm ajo ku nuk ka nevojë me punue fare. Prandej i la të tanë pa punë. Atëherë farsa iu afrue kulmit: ata që e kishin andërrue një jetë të tanë rrëzimin e komunizmit, votuen për të, e kërkuen vetë, e ngjitën vetë përsëri në skenë, tue i dëbue të gjithë dublantët e aktorët që ishin përdorë si protagonistë në fazën tranzitore.

Vërtetohej kështu çka më patën kallxue disidentët, që u kapën në Shkodër mbas rebelimeve të para. Xhelatët e vjetër. Që po përgatitshin me ngut maskat e reja, u thanë troç viktimave, gjatë hetuesisë: “Mos të kujtojë Simon Jubani apo ndonjë shkodran tjetër, se po e ndajmë me ta pushtetin. Pushteti asht e mbetet i yni!” Qyqarët: as nëpër mend s’duhet t’u kishte shkue se mund të ulesha gju më gju me ata që deshtën me ma mbytë Zotin. Mandej ata nuk mund ta kuptojnë se unë s’kam nevojë të bahem ministër, sepse jam ministër: ministër i Zotit. E ma merr mendja edhe se shumë prej tyne nuk e dijnë aspak se ministër don me thanë shërbëtor, përndryshej nuk do të shtyheshin e të shtypeshin në atë farë feje për me xanë një karrikë ndër ministri, të cilat ma shumë se shërbëtorësi, janë poshtërsi.

E përsa u përket dublantëve, tashma e kishin luejtë si duhet rolin e tyne, prandej meritojshin të gjithë nga një kafshatë të mirë. Ta merrshin pra, nga ndihmat që, vijshin si përrue për këtë popull aq të shkretë, sa me tmerrue deri harapët e shkretisë. Atëherë në skenën e farsës, pranë e pranë me shtëpijat e ulta, të mjera, gjysë të kalbuna, filluen me u ngritë shtëpija të reja, luksoze. E njerëzve, të shtrydhun me fund, iu besue një rol i ri ai i kontrabandistit, gjithnjë në shërbim të regjisorit. Kështu ia dolën mbanesh me

shkatërrue gjithçka. Veç një gja mbet në kambë: nomenklatura e vjetër komuniste, që vijon me e ngrehë rrëshanë mbas vedit vendin, njësoj si përpara. E Shqipnia i përgjet gjithnjë ma fort një qerrje lidhë mbas kalit të coftë. Paret e gjakut, që fitohen në perëndim, aty kthehen përsëri, sepse shqiptarit të vorfën i duhet me e ble përjashta gjithçkafen: qysh prej mollatartave, deri te potkojtë e kalit, që mund të prodhoheshin mrekullisht në Shqipni, në qoftë se të mëdhajtë e kësaj bote do të na lejshin rahat në punë tonë.

Zotni, farsa nuk ka mbarue! Uroj të mos kthehet përsëri në tragjedi, tashma kjo varet plotësisht nga regjisori misterioz, që rishtas i mshehun mbas kuintash, lot me kukullat e veta prej dërrase, derisa vendi të shkretnohet krejt, sepse siç ka thanë një mik i emi që sot jeton në Amerikë, ka shumë njerëz që e falenderojnë me gjithë zemër regjisorin, pa të cilin nuk do të kishin mujtë kurrë me pa botën e madhe, ku faleminderës Zotit, nuk të bjen ma në mend as për burgje, as për biruca as për regji e regjisorë! Urraaa, pra! Rrnoftë regjisori e komedia e re që u shkruie mbi lëkurën e shqiptarëve e po luhet bash mbi skenën e shpirtit të tyne, i cili do të ishte bjerrë krejt, po të mos ishte kthye edhe një herë mes nesh Zoti, edhe ai me miratimin e regjisorit të vogël, i cili kishte studiue gjithçka deri në hollësitë ma të imta. Madje kush e di, ndoshta edhe asht pagëzue, si shumë miq e dashamirë të tij, që i këcyen sipër Karitasit e vetë Kishës. Në Shqipni e jashtë. A s'janë pagëzue në Romë nipat e Mehmet Shehut? A s'e ka shpallë këtë Kisha si fitoren ma të madhe të së mirës kundër së keqes? Se qysh kur u pagëzuen ata, për ne zbardhi dita e lumnisë aq shumë të pritun, po na thonë. Sidoqoftë, jam i bindun se ai nuk ka mërrijtë me kuptue kryesoren: se skenën e madhe të

Planetit nuk e rrotullojnë regjisorët, të vogjël a të mëdhaj qofshin, por një regjisor i amshuem. Akti i fundit nuk asht luejtë.

Gjithsesi farsa vijon. Skena asht e njëjtë. Nuk ka ndryshue kurrë! As frika e tyne. Ata kanë frikë. Dronë se del ndonjë kritik, që e njeh mirë artin e tyne skenik e ua shkatërron shfaqjen. Dronë se spektatorët do t'i fishkëllojnë e ata do të detyrohen me dalë prej skene, taman tashti kur duhet të ndiheshin të sigurtë në lojën e kurdisun kaq me art... Ban pjesë në skenar edhe kjo! Ka teprue ndokush që nuk e konsideron gojën si organ të mjerë, që shërben vetëm për të ngranë, si kafsha, por që e përdor kryesisht për me kërkue liritë, të drejtat, tagret e veta. Gjithsesi njerëz të tillë janë të pakët. Shumica e atyne që kanë folë fjalë lirie, kalben ndër gropa pa emën. Po regjisori, që pak u druhet të gjallëve, ka frikë pikërisht prej eshtënve të të dekunve. Prandej dha urdhën me i zhvarrosë e me i rivarrosë me nderime, që të qetësohen edhe ata, të bahen edhe ata aktorë farse. Filluen, pra, kërkimet ndër zaje, që prej Zallit të Kirit në Zallë Herr. E t'ia nisën funeralet e vonueme, me Kishë e me Meshë, me fjalime, nderime e dekorime. E t'u mbushën gjokset e skeleteve të moçëm me nishana! E shko e eja me arkivola ndër duer, aq sa me ta mbushë mendën se vetëm të dekunt përfituen sadopak prej gjithë kësaj komedie. E megjithatë, një pjesë e mirë mbetën rishtas të vorrosun në vorre të panjoftuna e në harresë. E mbasi kishte edhe eshtën, nxjerrë prej vorreve e tretë, si ata të Skanderbeut, të Bogdanit e të Fishtës, tue mos mujtë me i gjetë ma, regjisori dha urdhën të ngriheshin monumente mbi vorre boshe. Edhe ma mirë, prej tyne nuk mund të delte ma asnjë lugat për me i trazue gjumin demokracisë së re. Me ia botue edhe veprat? Daha

ma bukur. Del mandej ndonjë prej aktorëve tanë, prej ma të talentuemve, me thanë se u ba mirë që u botuen, se kështu u pa kjarhtë që ishin pa farë vlere. E mbyllet puna një herë e mirë!

Farsa vijon, nësa jeta eme po i afrohet vorrit. Des i kënaqun se i dhashë Çezarit çka i takon Çezarit. Fola kudo e kurdoherë, edhe kur m'u desht të ngjitesha në skenën e farsës, tue mendue se mund t'ia ndërrojshe rrjedhën ngjarjeve, të cilat pata kuptue mirëfilli qysh në fillim, me gjuhën që ka përdorë Krishti përballë skribëve e farizejve: "Rracë shlligash, hipokritë, vorrre të zbardhueme përjashta, të mbushuna me qelbësinë përmbrenda!"

Po des me bindjen se ia kam dhanë Zotit atë që i takon Zotit, tue ia kushtue tana energjitë e mia, tana vuejtjet e mia, tanë jetën teme ngadhënjimit të mbretisë së Krishtit, Atij, që kur u plotësue koha, ndërhyri në punët e njerëzve dhe i ndryshoi rrjedhën historisë njerëzore, tue hapë rrugën e zhvillimit të një kulture shpirtnore e materiale të pakrahasueshme me gjithçka kanë pru në botë të gjithë filozofët edhe ideologët, qysh kur xuni fillë rraca njerëzore. Më kënaq mendimi se jam ushtar i thjeshtë i një ushtrie madhështore teologësh, filozofësh, shkencëtarësh, shkrimtarësh, artistësh që tue besue në të njëjtin Krisht, i dhanë kulturës botënore 90% të pasunive, për të cilat krenohet e vazhdon t'i japë njerëz të vërtetë.

Barka e Shën Pjetrit asht gjithnjë në det të hapët e me rrjeta të hedhuna! Asnjë tragjedi e asnjë farsë në botë nuk mund ta pengojë të lundrojë në ujn timer e amshueme deri ditën e gjyqit të mbramë, sepse në timonin e saj asht vetë Zoti!

Epilog në qiell

Po tashti o Zot, kah t'ia mbaj?

Kishte krye, ma në fund, edhe nata e vetme, e tmerrshme. Rrijshe mbi vetvedin, shtri në arkivol, vendosë pikërisht më atë kapelë ku pata le për së dyti, rrethue prej selvive e çinarëve. Kisha dekë, pra, ma në fund. Për kënaqësi të atyne që më patën halë në sy e për idhnim të madh të dashamirëve. E kisha krye këtë shtegtim, që për mue nuk pat pak ferra, ndonëse as lulet nuk më munguen, përderisa Zoti më ruejti sa me pa pranverën, madje me ia çilë unë vetë derën ma së parit. Kufoma eme rrinte aty pa lëvizë, gja e pazakontë për mue. Rreth saj parakalojshin qinda njerëz. Më duket se kjo quhet “me ba homazhe”, don me thanë me e nderue të dekunin. Po unë nuk kisha ma kurrfarë nevojë për nderime. Më duhej ndonjë kokërr uratë, për me ma ba ma të kollajshme mërritjen te caku i mbramë. Ndonjë “Epja o Zot”. Po kurrkujt s’i binte as nëpër mend se shpirti ka nevojë për lutje. Shumica çifillojshin vesh në vesh punët e mia sa isha kenë gjallë. Ndonjë madje qeshte nën mustakë.

Në rreshtat e parë, si zakonisht e si për ironi të fatit, gjithmonë lojçak me mue, autoritetet ma të nalta komuniste të vendit. Ta pret mendja se ishin aty për me kja për dekë teme? Sa kishem dashtë me u çue atë çast prej arkivolit. E dojshe me luejtë e s’mujshë sepse, simbas zakonit, kambët m’i kishin lidhë me lidhcat e këpucëve, për mos me u çue lugat. Dhe s’e kishin pasë keq, për besë. Trupi em ishte mbytë përsëri me djersë të ftohta në përpjekjen e kotë me uluri: “Çka? Ju kujtoni se kam dekë? Jo more zotni! Deshta

vetëm me qeshë paksa me këtë melodramë që po luhet rreth arkivolit tem”. Por ishte e kotë.

Tashma isha pezull ndërmjet tokës e qiellit. Ende nuk e dijshe ku jam e ku do të shkoj. Prandej kënaqësia që më falte mendimi se e kisha krye rrugën tokësore, turbullohej pikërisht nga një mendim tjetër, ma i zorshëm: duhet të fillojshe shtegtimin e fundit për amshim. Sapo trupi em i dekshëm të zdrypte në dhe të zi. E deri atëherë shpirti do të sodiste, jo pa dhimbë, atë kllëf, mbrenda të cilit ishte endë për shtatëdhjetë e sa vjet nëpër rrugët e botës, tek fillonte me u prishë e me lëshue erë stërvinë. Si çdo coftinë. Shpirt e trup ishin ende të lidhun së bashku me një vjegcë të brishtë, që do të këputej së shpejti. Si vjegca që e mban bushiqin fluturak lidhë për fill të penit. Sa tragjike, aq qesharake më dukej ceremonia, me ipeshkvij e meshtarë që çojshin meshën për shpirtin tem aty, ku kisha kremtue sa e sa herë. Mandej predku, me fjalë që kisha pasë ma kënaqësi me i ndie sa isha gjallë. Flitëte e flitëte predikatori, tue u paraqitë besimtarëve një Dom Simon që s’kishte kurrëgjia të përbashkët me të vërtetën, me atë që kishte mbetë prej mejet e që gjindej as në qiell as në tokë. Në vend që me theksue se i prina shkodoranëve drejt elterit të Meshës së parë të mbas persekutimit, s’prani tue vu në dukje se jam rritë jetim. Nuk po e merrshe vesht a ishte meritë kjo, apor u donte me më ardhë marre se isha rritë pa babë. Mendova me keqardhje: “Ma shumë anmiq ban kur kryen një heroizëm, se kur përdhosesh me ndonjë poshtërsi”. Po mandej më muer gazi: mbas pak, kur të shkëputesha përfundimisht prej korpit tem, s’do të kisha as miq e as anmiq. E nuk do të isha ma as jetim. E marrja e merita do të peshoheshin në një kandar,

që s'gabon. Hej bela, bela! Mbeta tanë jetën reaksionar: me të huejt e me të mitë.

Salikimet mbaruen. Kumbona, shi njajo që e kishin xjerrë prej dheut për me kumbue në meshën e parë të mbas salvimit, ra më njenë anë, përmallshëm e përvajshëm. Kumbi ushtoi nëpër selvitë, që lëshuen pika të blerta loti. Në vorrezë u përhapën tingujt përqethës së “Dies irae”. Kori nisi me këndue himnin e dekës, të amshimit, të zemrimit të Hyut. Një kokërr e madhe loti u shkëput prej shpirtit tem fluturak e ra mbi fëtyrën teme të ngrime, pak para se të mbulohej përgjithmonë me kapakun mortor. S'pashë se kjau kush tjetër. M'u kujtue e çuditshme, ndoshta e vërtetë, që përsëritet sa herë des ndonjë rregulltar: “Mblidhena pa u njoftë, jetojmë pa u dashtë, desim pa u kja”. Punë e madhe! Kjajshe unë vetë për vetvedin. Kështu kam ba gjithë jetën: kam qeshë për e me vetvedi e kam kja për e me vedi! Tashti fundja ishte loti i mbramë. Mbrapa vinte... Pikërisht ajo që vinte mbrapa kishte fillue me më shqetësue tashti, ndonëse shpirti em ishte i lehtë, i lehtë, i lehtë. Në zemër kisha marrë Shëlbuesin tem, pak minuta para se goja eme, me dhambë të thyem ndër burgje për ta dëshmue, ishte mbyllë përgjithmonë.

Vargani i gjatë i klerit, me paramenta bojë vjollcë, kinse për jazë teme, u shtrëngue rreth arkivolit për herë të fundit. Krisi çekiçi mbi gozhdat e kapakut e unë nuk e pashë ma vetvedin. U zhduka, si mos të isha kenë kurrë. Tashti, po që kisha dekë ma në fund. Katër burra e çuen peshë arkivolin e u nisën, të ndjekun prej turme, për te gropa e hapun ndërmjet vorreve të thjeshta të Rrëmajit. Më erdh inatë: a s'kam ba aq, sa me me meritue të vorrosem në katedrale, pranë e pranë me ipeshkvijtë e me kardinalin e

parë? – thashë me vedi. Por mandej më muer gazi. Tashti s'kishte pikë randësie se ku do të pushojshe. Madje duhet të isha edhe ma i kënaqun që po më takonte me fjetë gjumin e fundit diku pranë doktor Shirokës së madh. Do të më ndihmonte me u çue i pari në ditë të Gjyqit të mbtramë, edhe po të më mungonte ndonjë koc i randësishëm.

Në vorrezë u ndie zhurma e përvajshme e dheut që i bie të dekunit mbi fëtyrë. Lopatat lëvizshin me shpejtësi. Ndërsa më mbyllshin përgjithmonë në gropë, të gjallët mendojshin për punët që i pritshin aty, mbas dere, ku rrinte gjithnjë në pritë pangopësia njerëzore për jetën e gjithsa përmban.

Ma në fund mbi vorr tem u ngrit një stom dheu e u ngul një kryq i thjeshtë druni, ku ishte shkruar: “Pax: këtu pushon Dom Simon Jubani”.

Pushon? Jo more zotni! Gabim! Pushimi ishte i largtë. Ndjeva se po fluturojshe drejt naltësive. Isha i rrethuëm prej reve puplake, që lëvizshin shllunga-shllunga si leshi rudë i deleve peshtarake. S'di prej ç'skajit të kujtesës më doli kjo frazë, që e kisha mësue dikur përmendsh nga një antologji shkollore. Më duket se e kishte shkruar Luigi Gurakuqi. Kam me e takue në Parriz – mendova me kënaqësi. O ai, o kurrkush! Pata po atë ndjesi, që e kisha provue sa herë fluturojshe me avion. Ma në fund, mërrijta. Retë lëvizën me shpejtësi e formuen para mejet një portë madhështore: ishte dera e Parrizit, që shndritëte si ar nën rreze të panjoftuna. Ishte e mbyllun. Meqë ishte pa reze e s'kisha si me lajmue se kisha mërrijtë, pa dashtë lëshova zanin, si kisha ba sa herë në prag të kullave të Mirditës seme: “A don miq, o i Zoti i shtëpisë”. Më muer prap gazi. Po mandej u bana menjëherë serioz. Dreshta se po ma merr për

të keq Shën Pjetri, që nuk vonoi e ma çili. I kallëxova shkurt e shkurt kush isha. Dhe s'e pata vështirë, për besë, sepse më ushtojshin ende në veshë fjalët që ishin thanë për mue në vorrezë. – A ...a...a ? – më tha – je ti ai prift që s'ka ndejë një minut rahat! Tashti ti, tue kenë meshtar, e din se në Parriz nuk hyhet pa i peshue një herë mirë e mirë punët që ke ba në atë jetë. Mandej të shohim kah po randon kandari. Sh'Pjetri hapi përgjysë kapakun e derës madhështore e më la me ba vetëm një hap mbrendë. Mendova se tashti do të kisha punë me Sh'Mëhillin. Kisha predikue sa herë për të e për kendarin e tij të amshuem, prej të cilit varet nëse do ta shohim apo jo fëtyrën e Zotit. Kur, çka me pa more zotni! I mjeri unë i mjeri. Po shoh tue m'u afrue me kandar në dorë, as ma pak as ma shumë se Enver Hoxha dora vetë. Ishte veshë krejt me të bardha e kishte një palë krahë të mëdhaj. Taman njashtu si i kanë kryengjujt ndër fugure. Më hyni hataja, më hyni. Brita tue m'u marrë goja: – Sh'Pjetër (pa dashtë kisha kujtue Pjeprin), bre, po ky s'asht Sh'Mëhilli. A e dini bre, kush asht ky? S'asht arkangjull, asht dreqi vetë. Asht shejtan! Shejtan! Shejtaaaan! Ushtoi zani em, si ai i një shpirti të bjerrun në hapësinën pa fund të qiellit. Deri unë vetë u tremba prej atij za lugati. Korpën ma kishte ba copa njai që po vinte drejt meje me kandar në dorë. Tashti do të ma coptonte edhe shpirtin e njashtu edhe do të ma hidhte me u pjekë në zjarm të ferrit. Prej tij nuk pritshe kurrfarë mëshire, e natyrisht as kurrfarë drejtësie. Shën Pjetri mbylli veshët me dorë për mos me ndigjue brimën teme të marrë. Si pata pushue, hoq duert e më tha: “Na qitët sharrën në krye, ju meshtarët e Shqipnisë! Keni mbetë krejt mbrapa! Jeni të vjetruem, të vjetruem! Të mykun! Sh'Mëhillin e ka thirrë i madhi Zot për një punë urgjente.

Me ty tash po merret njëky, që asht zëvendësi i tij. E sa për çka po na thue ti, mos u tut aspak. Ka hy rregullisht në Parriz, simbas të gjitha rregullave të Kishës nanë Katolike e Apostolike, sepse, more zotni, dy sekonda para se me dekë, ka thanë se asht pendue e se tue i ra mohit Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, asht kthye me mend e me zemër në fenë e Krishtit. Mandej, një të ardhë këtu, asht sjellë në mënyrë shembullore. S'len shpirt për be me hy në Parriz. Sidomos shpirtënt e shqiptarëve, që ti e din mirë se janë të krymbun në vese. Aq sa Shën Mëhilli e ka emnue, as ma pak as ma shumë, se zëvendës të vetin. E ma të shumtën, tue kenë gjithnjë Sh'Mëhilli i xanun me mbledhjet e partisë, ky i peshon shpirtënt. E deri tash, keq po më vjen me të thanë, po tanë bashkëvëllazënt tu t'i ka rrokullisë në fund të ferrit, sepse, po na thotë se kenkan ngatërrue me politikë, gja që përban mëkat të randë për një meshtar, i cili duhet me shikue vetëm punët e shpirtit. Në Parriz, more zotni, s'ka nevojë me u marrë me politikë, sepse s'ka pluralizëm: këtu sundon Ati i gjithëpushtetshëm, Krijuesi i qiellës e i dheut. Ai që sheh gjithçka. Atë nuk mundet me e rrejtë kurrkush! – kështu briti Sh'Pjetri – kështu e më shikoji në dritë të synit, si me dashtë me më thanë: Boll tashti, hyp në kandar e mbaro punë, se presin të tjerët e po na bahet te dera e Parrizit rradsa edhe ma e gjatë se ndër dyert e kasapëve tuej në kohë të komunizmit”.

Shikjova kandin, atë që e mbante, derën e Parrizit, gjysë të çilë e ia mbatha në pika të vrapit. Si kisha dalë jashtë, me kambët që më humbojshin ndër retë e bardha, mendova me tmerr: “Po tashti kah t'ia mbaj!”

S'kisha mbarue mirë këto fjalë, kur më duel gjumi. Isha ba ujtë e mbytyun në djersë. Shyqyr Zotit, kisha kenë në

andërr. E tanë fajin e kishte mbledhja ku kisha marrë pjesë një ditë ma parë. Ishte një takim që e kisha pritë aq shumë, me aq dishirë. S'kishte shumë kohë që ishte hapë kisha, kur filluen me ardhë në Shqipni misionarë e personalitete të ndryshme të Kishës sonë. Disa me ndejë përgjithmonë me ne e me na ndihmue të çohemi në kambë, të tjerë me na shërue pak ka' pak plagët e shpirtit e me na vu në korrent të ngjarjeve që kishin ndodhë në Kishë, mësa na si po na thonë, kishim mbetë në kohë të Testamentit të Vjetër... Kjo nuk më shqetësonte aspak. Si njeri i Kishës, unë e kisha ndie vedin gjithmonë në kohë të Testamentit: të Vjetër e të Ri. Atë kisha dëshmue e atë edhe mbrojtë, deri me gjak. Prandej e ndiejshe vedin bash të kohës sepse Ungjilli s'njeh kohë e ngjarjet tjera, edhe ato kishtare, sado të randësishme qofshin, nuk munden kurrë me e tejkalue Ungjillin, që na asht dhanë për amshim.

Gjithsesi, me folë fjalë të reja e me u rinue shpirtnisht nuk asht kurrë keq. Çdo njeri me mend në krye duhet me i lexue shenjat e kohës, me ecë me kohën, përndryshej s'i mbetë tjetër, si po na thonë, veçse me hy me kambët e veta në një muze e me ndejë ngri njaty, pranë brandavekëve e fesave tonuzë. Ne e pranojshin madje. Se shumëkush asht aq jashtë çdo kohe, sa bahet qesharak edhe me e vu në mjedis të qypave të thyem e mumjeve në muzenë arkeologjik.

Shkova shend e verë, veshë e ngjeshë në kostum të zi me kolarino të bardhë e t'u ula në shi në rradhë të parë, si më takonte. Lктору ishte jezuit. Aq ma mirë. Isha shi nxanës i jezuitëve. Salla u mbush plot, pak pse njerëzit s'kishin çka me ba tjetër, pa punë siç kishin mbetë, e pak pse kishin et me pa e me ndie çka ishte ba në botë, kur na ishim jashtë

bote e çka kishte ndodhë në Kishë, kur na ishim në ferr. Bukuri, takimi filloi me faqe të bardhë. Lektori na njofti me Koncilin II të Vatikanit, tue na porositë me e përvetësue sa ma parë, nëse dojshim me shkue në përkim me Kishën Universale. Foli shkurtimisht për dokumentet kryesore të Koncilit, për gjendjen aktuale të Kishës Katolike në Botë, për papninë e Gjon Palit II, për të ardhmen tonë e të Kishës sonë. Dëgjuesit rrijshin ngri, tue ia marrë vesht fjalët gjysa-gjysa, sepse ai flitëte italisht e kishte pranë një përkthyes që edhe ai bash mirë s'i kuptonte termat kishtare që po i ndigjonte për herë të parë. Madje edhe ata që dijshin italisht, e ndien vedin krejt të vjetruem. Kjo do të ishte se çka kishte me kenë, përderisa pak po kuptojshin prej çka po thohej.

Ma në fund u kalue te pyetjet. Ajo që u kishte mbetë në mend të gjithëve, ishte çështja e shëlbimit. Prandej pyetja e parë ishte: “Çka duhet me ba njeriu për me u shëlbje? – e – A mund të shëlbepen edhe ata që kanë ba krime të randa, si Enver Hoxha, bje fjala?”

Sa për pyetjen e parë, nuk kisha nevojë me ndigjue shumë skjarime, sepse skjarimet ua kisha dhanë vetë sa herë atyne që më kishin pyetë. Tue u pështetë në Ungjill, merret vesht. E sa më kishin pyetë. E sa për pyetjen e dytë, më tha mendja se jezuiti po i përgjegjë me dy fjalë të vetme atij qyqari që kishte ba një pyetje kaq të marrë: “Ferri asht ba shi për Zotmohuesit!” Po jo more zotni, jo. Unë paskam mbetë me taman ndër lopë! “Në qoftë se ai asht pendue në çasin e fundit – tha jezuiti, mundet edhe me kenë i shëlbuem. Madje ndoshta tashti gëzon lumninë e Parrizit!”

Më kapne do të dridhuna, që aman o Zot. Për sherr atë ditë pikërisht për mos me u dukë tepër i vjetruem, kisha

vu në gojë edhe protezat e dhambëve, të cilat nuk mund t'i duroj fare. Ato të shkreta filluen me më shtrëngue në njëfarë feje, sa m'u duk se isha tue luejtë mendsh. I hoqa, i shtina në xhep, e si e ndjeva gojën pa pranga, çova menjëherë gishtin e bana pyetjen: "Padre, ju po na thoni këtu se Enver Hoxha ndoshta-ndoshta na prët në Parriz. Në kjoftë se ai ka shkue në Parriz, unë ku kam me shkue? Se Dom Simoni e Enver Hoxha në një vend bashkë s'mund të rrinë. Përndryshej Parrizi i Enver Hoxhës kishte me kenë ferri i Dom Simonit. A e sheh këtë gojë pa dhambë. Ai m'i ka zhgulë të tanë. E çka ka me zhgulë ma, në ndejsha me të në Parriz? Se ai veç me zhgulë mendon. Atëherë Parrizi kishte me kenë vend dënimi e jo shpërblimi për ata që e kanë la me gjak flamurin, për mos me e ndërrue! Jooo, more zotni, në daç me falë, në daç më vra, unë në atë soj Parrizi që po na thoni ju, s'kam punë as sot as kur të më dalë shpirti!"

Në sallë plasi gazi. Natyrisht shumica ishin në një mendim me mue, prandej e vulosën me duertrokitje të stuhishme atë që kisha thanë.

Por mue s'më bahej vonë për duertrokitje, as për brohoritje. Më kishte hy keqas në krye ideja se do të mund ta gjejshe shi në derë të Parrizit, atë që më kishte rjepë për së gjalli. Apo s'po din me u shti. Thue të jetë i zoti deri me rrejtë Atin e gjithëpushtetshëm? Si rrejti popullin e vet? E nëse asht ashtu, atëherë kah ka me ia mbajtë i ngrati Dom Simon? S'mjafton burgu, po u dashka me shkue edhe në ferr për faj të atij, që mësuesi em jezuit, i cili po kalueke edhe vetë perëndinë për dhimbë e mëshirë, m'ia hapi dyert e Parrizit, tue m'i mbyllë mue e mbarë shokëve të mi. Hej bela! Çka më gjet. Zemër Dom Simon - i thashë vedit ndërsa po

hapshe derën e shtëpisë, që për tash m'u duk taman Parriz, zemër pra. Së pari s'ke dekë ende. Së dyti, Zoti i madh e i gjithëpushtetshëm s'mundet me ba gabime kësisoji. Në fund të fundit, e skjarojmë, se gojën ai na e ka falë shi për me folë! Kështu, tue u mundue me qetësue disi vedin, rashë i këputun në shtratin tem të fortë. E pashë andërr se kisha dekë! Njatë andërr që ju kallëxova.

Po tash kah t'ia mbaj? Pyetja m'i rrihte tamthat edhe mbasi më kishte dalë gjumi e andrra ishte davaritë. Çuditënisht më erdhën në buzë fjalët që Shën Pjetri ia pat thanë Krishtit: "S'kam ku shkoj larg tejet, o Zot! Vetëm ti ke fjalë jete të pasosun!"



Mbasfjalë

Ndërsa përshkojshe perlat në fillin e tyre, ndërmjet punëve të tjera e leximeve nga të cilat nuk dahem kurrë, ndesha pa dashtë në origjinalin e asaj që autori me të drejtë e quen keqeshkrojë të “farsës së demokracisë”.

Fragmente të këtij origjinali janë botue vazhdimisht në shtypin botënor. Por një nga aktet ma të randësishme, sheh dritën e shtypit në gazetën italiane të së djathtës “Il Giornale” me datë 31 Korrik 2001. Asht një intervistë e ish-kryeministrit sovjetik Valentin Pavlov, dhanë italianit Francesco Bigazzi në Moskë qysh më 1991, atëherë kur tashma ishin luejtë disa akte të farsës së demokracisë. Por botimi i saj u ba i mundun vetëm më 2001-shin, ndoshta pikërisht sepse e merr për dore lexuesin nga skena në mbrapaskenë, ku u luejtën e vijojnë të luhen dramat dhe tragjeditë e vërteta të jetës së secilit prej nesh, ndërsa rrijmë harû në shtëpitë tona, tue besue se s’ka kush punë me ne e se nuk na gjen kurrëgjia, pikërisht sepse nuk kemi ba kurrëgjia. Harrojmë atë që asht kryesore: rreziku i madh nuk vjen prej shtëpisë sonë. Rreziku i madh vjen prej shtëpive të zeza që quhen të bardha! Janë shumë ma të mëdha e ma të fuqishme se e jotja, e janë fuqizue pikërisht tue hangër shtëpi të vogla, si kësolla ku ti mundohesh mos me gandue kurrkend, për mos me kenë i gandum prej kurrkujt. Gabohesh, zotni. Fatet tona të vogla luhen pikërisht në skenat e mëdha. E këtë ta tregon edhe shkrimi që po radhis ma poshtë. Ka titullin kuptimplotë: “Gorbaçovi ishte në dijeni të plotë për grushtin e shtetit që tronditi Moskën në Gushtin e 1991-

shit”. Asht njësoj si me thanë: “Ramiz Alia kishte dijeni të plotë për ngjarjet e 1991-shit. Madje ishte organizator i tyre”.

Përkimi i asaj që ndodhi në ish-Bashkimin Sovjetik me atë që në përmasa ma të vogla, sepse simbas vendit bahet kuvendi, ndodhi në Shqipni, asht aq i dukshëm, sa s’ka nevojë për kurrfarë komenti. E pa koment kuptohet se çka ndodhi në Shqipni, ishte pasojë e drejtpërdrejtë e asaj që ndodhte në Moskë. Po e shtrijmë, prandej, këtu intervistën, tue u mundue me i ndejë besnik, ndonëse pa ia mohue vedit edhe ndonjë trill krijimtarie, tue marrë posaçërisht çka na duhet për me shpjegue mendimin tonë. E pa pasë fare nevojë për paralelizmat që ban Dom Simoni, kur shkruen për Revolucionin Francez, sepse ngjarjet, tepër të freskëta ndër kujtesa miqsh e anmiqsh, na lejojnë të zbulojmë mbas çdo skene të luejtun në Rusi, keqeshkrojnë e farsës së demokracisë, që vijon me u luejtë në Shqipni.

Pavlovi vetë kërkoi që intervista e dhanun në një qeli burgu, të transferohej dhetë vjet ma vonë, kur historia do t’i epte arsye dhe gjithë bota do ta shikjonte, ndoshta tepër vonë, se ai kishte thanë të vërtetën: Flet ish-kryeministri sovjetik: “që golpi apo grushti i shtetit i abortuem, ishte ideue për me asgjasue traktatin e ri federal, këtë e pat dyshue e e pat thanë shumëkush që më 1991, por qëllimi i fundit i kryengritësve ishte t’i epnin Gorbaçovit, pushtetin real, të domosdoshëm për të marrë kreditë nga perëndimi, këtë sot për sot, për t’ia mërrijtë këtij qëllimi, gjaja e parë që banë puçistët kje izolimi i kryetarit të shtetit e të partisë dhe paraqitja e tij si njeri i sëmuetë, gati-gati i paaftë nga ana mendore. Siç dyshoi shumëkush, Gorbaçovi ishte në dijeni të plotë të komplotit dhe dëshironte vetë të zhdukej

përkohësisht nga qarkullimi, të kalonte në mbrapaskenë, tue ia lanë në dorë puçistëve ta kryejshin pjesën ma të ndytë të punës, për ta marrë mandej pikërisht prej duerve të tyne, pushtetin e plotë diktatorial. E këtë e kanë thanë haptas golpistët në një konferencë shtypi, organizue me rastin e dhetëvjëtorit të ngjarjeve tragjike, tashti që po dalin në dritë procesverbalet e mbledhjeve të mshehta, të cilat dekretuen ndryshimet, thjesht për me mbijetue.

A duhet që dikush të përgjegjet para gjyqit për krijimin e situatave të tilla? – pyetet ish-kryeministri.

Jo, ai asht i mendimit se sot procesi gjyqësor nuk do t'i shërbente askujt. Nuk do të sillte asnjë rezultat konkret. Do të shkaktonte një tensionim të kotë e të padobishëm të situatës. Ai mendon se një proces i tillë asht krejtësisht i padëshirueshëm.

E asht e natyrshme të mendojë kështu, sepse do të ishte edhe ai vetë në bankën e të akuzuemve, nëse dikur, sa do vonë, do të ketë një “Gjyq Nurembergu” edhe për komunizëm. Që ndryshon prej nazizmit si kolera me murtajën. Deri atëherë punët do të vijojnë të shkojnë rrokopujë e do të ndodhë që shi Perëndimi i pangopun me pare të vijojë me zgjidhë qesen e me mjekue kambët e trasha e të randueme prej pleqnie, me reumatizma të vjetra e të reja, të Lindjes së Kuqe. Historia dishmon se bota perëndimore, “kurvë e motit”, ndërron orë e ças myshteri!

Po të kthehemi te artikulli: Gjendja eme asht tepër e ndërlikueme – thotë ish-kryeministri sovjetik... Nuk di çka me shtue tjetër... Janë gjana që nuk varen nga unë, që nuk mund t'i komentoj ma tutje...

Retiçencat na lanë me kuptue se e vërteta nuk asht zbulue ende e se nuk mjaftojnë dhetë vjet për me qitë në shesh gjithë lojën e ndytë të mbrapaskenës.

Pason pyetja: “Ju mendoni se Gorbaçovi ishte në dijeni ose ma mirë me thanë, kishte rolin kryesor në përgatitjen e puçit?”

“Nuk e mendoj, e di. Jam i sigurtë se ai ishte në dijeni të plotë se po përgatitej një puç, ma mirë me thanë farsa e një puçi” – përgjigjet ish-kryeministri.

Intervistuesi ngulmon: “që vendi po shkonte drejt shpërbamjes, drejt shkatërrimit të plotë, jo vetëm politik, por sidomos ekonomik, këtë e shihte gjithkush – kishte të dy sytë në ballë. Ishte e natyrshme, prandej të diskutohej gjithnjë e ma shpesh se në ç’rrugë duhej ecë për ta ndalë katastrofën e plotë. Asht kjo arsyeja që çoi në shpalljen e situatës së emergjencës. Nuk kje asgja e rastit. Vendime të tilla nuk improvizohen, mendohen mirë para se me u marrë. Na të dy mund të takohemi në kafe e të vendosim si me e kalue fundjavën, por jo si me shpallë situatën e emergjencës. Tjetër kund e në tjetër mënyrë studiohen e merren këto vendime.

Nëse analizojmë dy ekipet, Gorbaçov-Elsin, mund të thomi se çka asht vlerë te njeni, asht antivlerë te tjetri. Gorbaçovi donte të tregohej i mirë në të gjitha rastet. Po nuk mund të jesh i mirë e njëkohësisht i fortë” – thotë ish-kryeministri.

Na vjen pa dashtë ndër mend Berisha ynë, i cili desht me u dftue i mirë me të gjithë njëllorj: komunistë e antikomunistë e me vlerësue po njëllorj gjithkend e gjithçka. Tregojnë se ndërsa po vizitonte një shtëpi handikapatësh, për me ua ba qejfin, u pat thanë me atë gjuhën e tij zyrtare,

shartue keqas me tropojanshen: “Ju më keni mue, e unë ju kam jue! Juve jeni e ardhmja e Shqipërisë!” Dhe s’e pat keq, për besë!

Vijon ish-kryeministri rus: “Nuk më pëlqejnë fare fjalët puç, golp, grusht shteti, kryengritje, që u përdorën nga gazetarët, pa harrue se këto fjalë, shto edhe fjalën kriminelë, për ata që po luejshin farsën e grushtit të shtetit, u vunë në qarkullim nga vetë Presidenti i Republikës, gja që asht e papranueshme për një kryetar shteti. Aq ma tepër po të kemi parasysh se nuk asht ba kurrfarë hetimi, që të mund të vlerësohen juridikisht ngjarjet. Në këto kushte, t’i imponosh kandvështrimin tand opinionit publik e bashkësisë ndërkombëtare asht krejt e paligjshme. Sidomos për një president...”

Në atë kohë – vëren ish-kryeministri – tue kenë se e njihshe së afërmi Gorbaçovin, do të kisha ba mirë me mendue se mund edhe të më trathtonte. Këtë duhet të ma kishte këshillue përvoja e shevernaxes (ministër i jashtëm i Perstrojkës), Jakovlievit (ideolog i Perstrojkës) dhe shumë të tjerëve. Duhet t’ia kisha vu ma shumë menden kësaj mundësie, tue e dijtë se ai ishte i zoti me i braktisë deri njerëzit ma besnikë.”

Sidoqoftë, problem i vërtetë ishte se bashkimi po shkonte drejt shpërbamjes së pashmangshme. Kjo ishte logjika e thjeshtë e ngjarjeve. Madje, bashkimi duhet të shpërbahej, sepse nuk kishte ma kurrfarë force jetësore: e kishin katandisë në këtë gjendje. Megjithë situatën e vështirë, bashkimi i Republikave e ruejti për një kohë të gjatë stabilitetin, tue përballue të gjitha tentativat që ishin ba nga mbrendë e nga jashtë... ma tepër nga mbrendë, kuptohet, për ta hedhë në erë. Në këtë çast vendi që po

thërrmohej, kishite nevojë për Gorbaçovin dhe ndryshimet e befta që solli ai, sepse duheshin sigurue kreditë reale nga Perëndimi. Nuk ishte fjala për ndihma të vogla e të përkohshme, jo: por për kredi të mëdha me afate të gjata, pa të cilat vendi nuk mund të qëndronte ma në kambë, sepse duhej rindërtue e modernizue ekonomia. E Perëndimi ishte i gatshëm të ndihmonte pikërisht Gorbaçovin. Megjithatë, nuk ia dolën mbanesh t'i zgjidhshin këto probleme: marrëveshjet formale ishin gati, por linjat e kredive ishin bllokue, sepse bota e pares nuk e zgjidhë kollaj qesen, nuk ep pare, kur nuk asht plotësisht e sigurtë se jo vetëm nuk ka ku me i bjerre, por ka me xjerrë edhe fitimin e llogaritun prej tyne.

Prandaj gjatë bisedimeve dëgjojshim shpesh të thohej: “Na jemi të gatshëm, por, na falni, deshtëm ma parë të dijmë, Zotni Gorbaçov, sa asht real pushteti juej? Sa asht i qëndrueshëm? A asht në gjendje t'i garantojë investimet tona në ekonominë sovjetike”. Kështu mendohej se pa Gorbaçovin, nuk do t'i kishim kreditë. S'ishte punë simpatish personale. Në politikë simpatitë personale vlejné deri diku. Realiteti ishte i vështirë: vendi kishte nevojë për kredi e këto kredi mund t'i siguronte vetëm përmes Gorbaçovit, gjithnjë me kusht që ai të kishte pushtetin përmes Gorbaçovit, gjithnjë me kusht që ai të kishte pushtetin real e të ardhmen. Dilema ishte: nëse Gorbaçovi shkon, s'ka kredi; nëse rrin, por pa pushtet real, rezultati mbetë i njëjtë. Në fund të fundit mund të bahej edhe pa kreditë, por ishte e qartë se po të ecej në këtë rrugë, ristrukturimi dhe modernizimi i ekonomisë do të kërkojshin një kohë shumë të gjatë dhe shpenzime tepër të mëdha. Politikani që do të zgjidhte një rrugë të tillë, nuk do

të qëndronte gjatë në pushtet, sepse populli nuk mund të durojë në amshim, ndonëse në vendin tonë të gjithëve u pëlqejnë përrallat!

Këtu po e këpusim intervistën, që përkon aq me realitetin shqiptar të dhetë vjetëve të fundit, i cili i përngjet ma shumë përrallave. Në kohë të Enver Hoxhës tregohej kjo anekdotë: “Enver Hoxhës i pat ra mall me ndigjue përralla. I kishin pasë thanë se në Mirditë jetonte një plak, përralltar me nam e me za. Çoi e e thirri. E ia behu mirditori me çakçirë e opangë e hyni në pallat të mbretit e shkeli mbi qylymin me push aq të gjatë, sa iu duk se po shkelte mbi lendina të vendit të vet. E priti Enveri tanë dashtëni, i lidhun si ishte si mishi me kocin me popullin, e i tha: “A e sheh këtë qilim ku po shkelin këmbët e tua me opingë ia muarëm Vërlacit, pikërisht që të shkelësh ti, njeriu i popullit. Dhe kështu siç e kemi ne, e ke edhe ti në Mirditë!” Mandej, tue i kallëxue një televizor të madh me ngjyra, i tha: “Ja edhe televizori. E shikon ç’bëri Partia? Siç e kemi neve, e ke edhe ti atje në Mirditën tënde!” E kallxo me gisht herë ’i send e herë ’i tjetër, e poho me krenari të ligjshme se njashtu si mbreti i kishte edhe skllavi. S’mund u durue i mirditasi, e tue ia pre ma në fund fjalën, i tha: “A më ke thirrë mue me kallëxue përralla, apor po m’i kallëxon ti?”

Njëkështu pra! Edhe popullit shqiptar ia kande përrallat. Ka ma se një shekull që ushqehet me përralla, që jeton me përralla, pa kenë në gjendje ta shohë sy në sy të vërtetën e tmerrshme, që po ia shkatërron jetën e tij të vogël të përditshme. Po a ka me dalë ndonjëherë në dritë e vërteta? Besoj se kjo mund të ndodhë vetëm nëse populli shikjon Ramiz Alinë, Sali Berishën e Fatos Nanon tue pritë radhën për me u rrëfye para rrëfyesores së Dom Simonit! Edhe

atëherë, madje, populli nuk duhet me besue plotësisht, së pari sepse Dom Simoni nuk mundet me qitë rrëfimin, e së dyti sepse mbas tanë atyne rrenave e krimeve që kanë ba, s'po çon kandar një rrenë ma tepër e thanun në rrëfyestoren e një Zoti, të cilin ata e besojnë vetëm kur emni i tij u shërben për me marrë kreditë e nevojshme nga perëndimi. Atëherë, si ka pasë thanë Berisha në fund të një mitingu: “na rroftë Zoti”.

DIFTOJSI

ME RRËFYE PËR BURGJET, QË ME KUPTUE BURGJET MBRENDIA NESH.....	6
▪ Para se me e lexue librin <i>Burgjet e mia</i>	6
▪ Leximi i parë i <i>Burgjet e mia</i> ose si u njoha realisht me Dom Simonin.....	9
▪ Leximi i dytë: letrariteti i <i>Burgjet e mia</i>	31
▪ Leximet e tjera.....	37
▪ Rruga drejt procesit të publikimit.....	42
Parafjalë.....	46
Autobiografi.....	54
Thirrja për rrugën meshtarake.....	62
Një park zoologjik, që quhet Shqipni.....	66
Në Tiranë në 1947.....	71
Martiri Imzot Ernest Çoba.....	73
Gegë e Toskë, janë një komb, me u da s'duron!.....	77
Raprezalja.....	85
Modele.....	93
Spijunazhi.....	97

Arrestime psikologjike.....	99
Ndër pranga.....	103
Torturat.....	120
Burgu i Burrelit.....	134
Biruca.....	143
Si ishte i organizuem spijunazhi në burgun e Burrelit.....	167
Ora e komedisë.....	179
Andrra në diell.....	186
Revolucioni francez e kleri shqiptar.....	194
Disidenca.....	219
Lirimi.....	224
Fantazma e dyshimit.....	236
Arrestimi qoftë i fundit.....	242
Mesha e parë.....	254
Tri homeli ndërmjet qindave.....	259
Pesë vjet ma vonë.....	265
Mbasi kaluen dhetë vjet.....	271

Shembja e idhujve.....	277
Epilog në tokë.....	279
Epilog në qiell.....	290
Mbasfjalë.....	302

KENS



Dom Simon Jubani

Burgjet e mia: kujtime

Kolana Kêns [2021]

~ Acta non verba.

Edhe pse Jubani i vetëdijshtëm se “mikrofonat janë mbyllë për arrat gungçe”, ai me anë të kësaj vepre ka futë kulturën e dëshmisë pa iniciale, pa pseudonime, pa asnjë fshehje a maskim, nganjherë edhe artifice fiksionale, gja e cila ndodhë edhe sot, mbas 20 vjetësh që asht botue vepra. Kultura shqipe, peng i një tranzicioni post-komunist, ka nevojë me u përballë ma drejtazi me historinë e vet në mënyrë që me reflektue qartë mbi përvojat e së nesërmes. Prandej, mishmashi i sotëm tridhetëvjeçar nuk prodhon përvojë të re përpos riciklimit të enverizmit: lundrimi historik ma katastrofë i kombit shqiptar.

~ Me rrëfye për burgjet, që me kuptue burgjet mbrenda nesh



Acta non verba